



Në bashkëpunim me
Fondin për të Drejtën Humanitare, Dokumentën, Qendrën Hulumtuese – Dokumentuese,
Shoqatën *Shpresimi* dhe Community Building Mitrovica

organizojnë

**Forumi i Katërt Rajonal
për vendosjen e drejtësisë në shoqëritë post-jugosllave:**

**Komisioni Rajonal për vërtetimin e fakteve të krimeve të luftës
dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut në ish
Jugosllavi**

28-29.10.2008.
Prishtinë, Kosovë

Natasha Kandiç: Mirdita të gjithëve. Unë jam Natasha Kandiç nga Fondi për të Drejtën Humanitare. Më lejoni që në emër të koalicionit të organizatave joqeveritare dhe shoqatave të familjeve të viktimave, të cilat deri më tani janë bashkuar në koalicionin për themelimin e Komisionit Rajonal për përcaktimin e akteve që kanë të bëjnë me krimet e luftës, t'i përshëndes të gjithë pjesëmarrësit dhe pjesëmarrëset nga shtetet e ish Jugosllavisë, mysafirët nga ambasadat e shteteve të ndryshme në Kosovë, mysafirët nga institucionet e Kosovës, përshëndes gjithashtu aktivistët e shumtë për të drejtat e njeriut nga pjesët e ndryshme të ish Jugosllavisë, të cilët kanë ardhur sot në Forumin e katërt rajonal mbi drejtësinë tranzicionale. Ky Forum që po mbahet sot, është mundësuar nga ndihma e gjithanshme e ofruar nga Fondacioni Kosovar për Shoqëri Civile - Fondacioni Robert Bosch, Komiteti Suedez i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Qeveria Holandeze dhe Organizata Kombëtare për Zhvillimin e Demokracisë në Uashington. Sot po mbajmë Forumin e katërt rajonal dhe unë shfrytëzoj rastin që t'i ftoj përfaqësuesit më të lartë të institucioneve kosovare, sikurse edhe përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar, që të na ndihmojnë në realizimin e nismës së shoqërive civile nga të gjitha shtetet e krijuara pas shpërbërjes së ish Jugosllavisë. Lus Kryetarin e Kosovës, zotëri Fatmir Sejdiu, që para nisjes për në udhëtim zyrtar, të na nderojë me përkrahjen e tij dhe ta deklarojë të hapur Forumin e katërt rajonal, ashtu siç ka vepruar edhe zotëri Stjepan Mesiq në Kroaci, siç ka bërë Oliver Duliq në Beograd, si dhe anëtari i Kryesisë së Bosnjës dhe Hercegovinës kur ka hapur Forumin e parë rajonal. Unë ju lus që t'i drejtoheni këtij takimi me disa fjalë dhe të ofroni mbështetjen tuaj për këtë iniciativë.

Presidenti Fatmir Sejdiu: E nderuara zonja Kandiç, të nderuar anëtarë të kryesisë së punës, të nderuar mysafirë, të nderuar pjesëmarrës më lejoni që të shfrytëzoj rastin dhe të ju përshëndes të gjithëve në një iniciativë të rëndësishme, e cila ka të bëjë me përpjekjet për zbardhjen e fatit të të pagjeturve dh të viktimave të luftës duke e pasur parasysh se rajoni në të cilin jetojmë, Kosova juglindore në fundshekullin e kaluar ka pas përjetimet

më të vështira do ta quaja dhe të papara të historisë së saj, me këtë dua të them se tek të gjithë vendet e ish federatës jugosllave që tani janë shtete të pavarura dhe sovra në këtë kuadër edhe Republika e Kosovës do të jetë një përkushtim i nevojshëm që të ndriçohet fati i të gjithë atyre që në rrethana të vështira kanë pas edhe përjetimet por edhe tretjet, në këtë thërret zëri i nënave, në këtë thërret zëri i fëmijëve, në këtë thërret ndërgjegjja çdo qytetari, në këtë thërret edhe ajo që ne mund të quajmë caktimi i mirëfilltë shtetërorë që duhet të jetë i secilit vend. Siç e dini edhe Kosova ka pasur përjetimet e saja jashtëzakonisht të tmerrshme, atë që mund të them është se është përkushtim i institucioneve të Kosovës, i qytetarëve të Kosovës që kjo histori s'mund të harrohet asnjëherë por jemi shumë të përkushtuar ta mbyllim në kaptinën e kujtesës për të pas një lëvizje të fuqishme në ecjen përpara, në qasjen e trajtimit të barabartë të të gjithë qytetarëve të Kosovës për hir të brezave të tanishëm dhe për hir të brezave të ardhshëm, është shumë esenciale që një vend sovran të bëjë ndihmesën e tij të drejtpërdrejtë bashkë me institucione dhe mekanizmat e shoqërisë civile, mekanizmat e tjerë joqeveritar për aq sa ta mund ta ndihmojnë që të zbardhet fati i secilit, e dimë se na mungojnë shumë njerëz, se dhembja për ta është e gjithmonshme, por në të njëjtën kohë besojmë edhe në drejtësinë ndërkombëtare se do të jetë aktere e rëndësishme edhe në hulumtimin e të gjithë atyre arkivave që ekzistojnë dhe besojnë se janë tek ata që kanë bërë krime dhe po ashtu në ndritjen e fatit të të gjithë atyre që nuk janë në mesin tonë, dhashtë zoti që të jetë storie e fundit e konfrontove, e konflikteve e përgjakjeve dhe e asaj që mund të quhet e dhunimit të të drejtës njerëzore, liria njerëzore është një liri hyjnore për të gjithë prandaj në konceptin tonë të përgjithshëm është të mbështesim përpjekjet tona për paqe, të mbështesim përpjekjet tona për stabilitet, të ecim në një rrugë të zhvillimeve dhe të integritimeve atje ku e kemi vendin të gjithë së bashku, andaj them se Kosova është thellësisht e orientuar që të ketë marrëdhënie të mira me fqinjët e saj, të ketë marrëdhënie edhe me Republikën e Serbisë, e cila edhe pse edhe sot e kësaj dite nuk ka kërkuar një falje për krimet që ka bërë, pavarësisht nga ky fakt unë moj jashtëzakonisht lartë rolin që keni ju, zërin e arsyes që e keni ngritë në çdo kohë për të gjitha viktimat pa dallim etnie, andaj është shumë e rëndësishme që të mbështeten edhe qasje të tilla, është shumë e rëndësishme që ato pjesë të investimeve të mëdha që janë bërë deri tash të materializohen edhe në pjesën praktike, flas edhe për të drejtën ndërkombëtare edhe për gatishmërinë e bashkëpunimit, flas edhe për këtë qasje apo ecje të sotshme që e kemi për ta lëvizur vendin tonë dhe të njëjtën kohë besoj edhe vendet e tjera paralelisht lëvizin në proceset më të mira zhvillimore, ne e themi një aforizëm të përgjithshëm që e kemi na qytetarët e Kosovës se prej të mirës nuk ka keq, na gëzon fakti se për të gjitha ato vende që kanë lëviz më herët, që janë lidh me rrjedhat e integritimeve evropiane, që kanë mundësinë që zhvillimin e tyre ekonomik dhe social ta përshpejtojnë edhe më tepër dhe në modelet e punës së tyre, në modelet e demokracisë së tyre duke e kombinuar po ashtu punën tonë të madhe të brendshme të ecim edhe ne për një të ardhme më të mirë, për paq, për drejtësi, për perspektivë për të gjithë, prandaj ju faleminderit që më dhatë mundësinë që të jem me ju, ju përsëritet ju dhe ju përsëritet po them edhe në aksionet e mëtejshme. Ju faleminderit shumë!

Natasha Kandiç: Ju faleminderit z. Kryetar dhe ju dëshirojmë rrugë të mbarë. Më lejoni që tani të ftoj zotëri Roy Reeve, zëvendës shefin e Misionit të Eulex-it, që në përputhje me vlerat e Unionit Evropian, vlerat më të larta që kanë të bëjnë me respektimin e të

drejtave të njeriut dhe sundimin e ligjit, të thotë disa fjalë në lidhje me kontekstin e iniciativës tonë, e që paraqesin vlerat të cilat ne duhet t'i respektojmë në shoqëritë tona të pas-konfliktit. Urdhëroni.

Roy Reeve: Zonja kryesuese, zonja dhe zotërinj pjesëmarrës, më lejoni që para së gjithash të falënderoj ngrohtësisht komitetin organizativ të këtij Forumi për ftesën drejtuar EULEX-it që t'i thotë disa fjalë në hapjen zyrtare. Ne sapo kemi arritur në Kosovë, por do të doja t'ju sigurojë të gjithë juve se sapo misioni ynë të bëhet operacional, në fillim të dhjetorit, ne do ta marrim përgjegjësinë nga UN-i për hulumtimin e krimeve të luftës dhe fatin e personave të zhdukur. Ne kemi ndërmend të bashkëpunojmë ngushtë me përfaqësuesit e shoqërisë civile në lidhje me këtë problem. Mendojmë t'i qasemi kësaj pune me seriozitet, duke qenë plotësisht të vetëdijshëm për rëndësinë e problemit me të cilin po përballemi. Në të ardhmen do të jemi shumë të hapur në punën tonë për bashkëpunim me partnerët vendor dhe të huaj. Sikurse edhe thashë, EULEX-i do të bëhet operacional në fillim të dhjetorit. Ky është misioni më i madh për vendosjen e sundimit të ligjit të cilin e ka ndërmarrë ndonjëherë Unioni Evropian. Ne do të kemi një personel prej rreth 3.500 pjesëtarësh vendor dhe të huaj, të angazhuar gjerësisht në fushën e sundimit të ligjit dhe kemi mandatin, por edhe qëllimin, të përpiqemi t'i rrisim standardet e qasjes në mbrojtje policore, drejtësi dhe grumbullim të taksave brenda territorit të Kosovës. Duke pasur një mandat kaq të gjerë, ne mbajmë përgjegjësi konkrete për hetimin e krimeve të luftës dhe fatit të personave të zhdukur. Presim që nga Misioni i Kombeve të Bashkuara t'i marrin dosjet e rreth 1.200 rasteve të pazgjidhura të krimeve të luftës dhe për këtë qëllim kemi përgatitur një ekip që ka në përbërjen e vet rreth 35 zyrtarë ndërkombëtarë të policisë, të cilët do të bashkëpunojnë me personelin vendor për shqyrtimin e hollësishëm dhe hulumtimin e të gjitha këtyre rasteve, të cilat janë përmbledhur në rreth 300.000 faqe dokumente, që do t'i marrim ne. Kemi filluar t'i shikojmë këto çështje dhe më pas do ta krijojmë strategjinë e hulumtimit. Prandaj, të theksoj edhe një herë, gjatë punës tonë ne do të jemi të hapur për pjesëmarrjen e shoqërisë civile gjatë këtij procesi. Do të jemi transparent dhe të përgjegjshëm në masën më të madhe të mundshme. Gjithashtu, do të jemi përgjegjës edhe për marrjen e çështjeve së personave të zhdukur nga UN-i. T'ju përkujtoj, është fjala për rreth 1.550 persona të cilët deri më tani nuk janë identifikuar apo gjetur dhe për rreth 400 persona tjerë, të cilët pritet të identifikohen në muajt e ardhshëm. Ne po përpiqemi të zbatojmë një qasje gjithëpërfshirëse, e cila nënkupton bashkëpunimin me organet e pushtetit dhe shoqërinë civile jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë, me komunitetin ndërkombëtar dhe shoqëritë civile të interesuara. Gjithashtu, në kuadër të misionit tonë ekziston edhe njësi për zbatimin e planit për të drejtat e njeriut. Kjo njësi do të ketë për detyrë që të krijojë kontakte dhe ta mundësojë transparencë e procesit, sepse puna jonë në lidhje me këto probleme në të ardhmen do të udhëhiqet sipas këtyre parimeve. Personeli i EULEX-it gjatë kësaj konference do të marrë pjesë aktivisht në diskutim dhe shpresoj se ju do t'i shprehni idetë dhe mendimet tuaja për atë se si do të mund të bashkëpunojmë në lidhje me këtë problematikë që e kemi përpara. Mendoj se kryesuesja e ka ilustruar shumë mirë rëndësinë e detyrave që gjenden para nesh. Unë dua t'ju siguroj se, që nga momenti kur EULEX-i do të bëhet operacional, ju do të keni bashkëpunimin tonë të plotë në lidhje me këto probleme. Ju uroj një konferencë rajonale të suksesshme. Shpresoj se gjatë ditëve në

vijim ne do të mësojmë nga ju po aq sa edhe ju nga ne dhe do të bashkëpunojmë ngushtë në të ardhmen. Ju faleminderit shumë.

Natasha Kandiç: Tash do ta lusja Ministren e Drejtësisë, zonjën Nekibe Kelmendi, që të na drejtohet me fjalë të ngrohta dhe shpresëdhënëse, ashtu siç foli mbrëmë në Lobin Rajonal të Grave, anëtare e së cilës është. Unë dhe zonja Nekibe kemi një miqësi që zgjat më tepër se një dekadë dhe gjithmonë e kam admiruar atë për mënyrën se si ka arritur t'i tejkalojë të gjitha dhe t'i kthehet drejtësisë, e të deklarojë se gjithë ajo që ka përjetuar nuk do të ketë kurrfarë ndikimi në veprimet e saj si Ministre e Drejtësisë. Unë e lus që të mbahet, të jetë e fortë dhe t'i ndihmojë kësaj shoqërie në vendosjen e drejtësisë dhe respektimin e të drejtave të njeriut. Urdhëroni.

Nekibe Kelmendi: E nderura zonja Natasha, të nderuar anëtar të kryesisë, më lejoni që në emrin tim personal dhe në emër të Ministrisë së Drejtësisë ta përshëndes këtë konferencë, që për mendimin tim është e një rëndësie të veçantë sepse synon zbulimin e të vërtetës rajonale për të gjithë ato që kanë ndodhur në shtetet e ish-Jugosllavisë. Ju e dini fare mirë se rëndësia e zbulimit të së vërtetës e ndihmon edhe sjelljen drejtësisë në vend edhe ballafaqimin e akterëve të krimeve me të bëmat, me krimet, me ndihmat e të gjitha llojet tjera që kanë qu deri te vrasja, zhdukja, torturimi, burgosja e tjera për periudhën prej vitit 1990 deri në vitin 1999. E përmend këtë periudhë sepse mu në këtë periudhë në Kosovë kanë filluar torturat, vrasjet, proceset politike, gjykimet e montuara të cilat kanë qenë një paralajmërim ogurzi se në rajonin e ish-Jugosllavisë ka filluar shpërbërja e Jugosllavisë por ajo shpërbërje do të jetë e përgjakshme dhe zotërat e luftës apo zoti i luftës sido që ta merrni, siç deshti ashtu edhe bëri, i zhvilloi katër luftëra të përgjakshme, të ndyta, të përcjellura edhe me dhunime, të përcjellura edhe me zhdukje, të përcjellura edhe me persekutime të llojeve të ndryshme po edhe të përcjellura me zhdukjen e gjurmëve vetëm e vetëm për mos me ndodh drejtësia, por ja që fal zonjës Natasha Kandiç, e cila edhe gjatë atyre viteve është angazhuar që të mos vij deri te lufta ose së paku në Kosovë të mos vij deri te lufta por thashë edhe përpara ata që e kanë dashtë luftën e kanë nis edhe vetë. Qasja rajonale këtij problemi mendoj se është shumë e rëndësishme edhe për një fakt sepse të gjithë së bashku do të ia dalim ti vërtetojmë të gjitha ato fakte, të cilat deri më sot nuk janë zbardhur, për mendimin tim si një fakt më i rëndësishëm është fakti që të dihet apo të zbardhet fati i të zhdukurve i cilitdo nacionalitet, unë nuk e mohoj se ka të zhdukur edhe në radhët e komuniteteve tjera në Kosovë, por nuk dua ta mohoj faktin se numri më i madh i të zhdukurve i përket komunitetit shumicë sepse fundja kundër atij komuniteti është nisur lufta dhe ka përfunduar si ka përfunduar me një kapitullim të turpshëm, por më vonë pas angazhimeve të gjithë bashkësisë ndërkombëtare edhe me pavarësinë e Kosovës që sot njihet nga 51 shtete si shtet i pavarur dhe demokratik. E vërteta është e rëndësishme dhe në mos më e rëndësishmja për zbardhjen e të pagjeturve, është kjo një dhembje e madhe, vërtetë kam pësuar një tragjedi jashtëzakonisht të rëndë, për 15 minuta kam humbur gjysmën e familjes: burrin dhe dy djemtë e mi, të cilët i kanë marrë prej shtratit dhe për 15 minuta i kanë dërguar në ekzekutim, pa gjyq, pa kurrfarë procedure dhe kanë marrë pjesë në atë aksion katër formacione ushtarake, shërbimi informativ ushtarak, policia e Serbisë dhe policët special të shërbimit të sigurisë të Serbisë përkatësisht ish-Jugosllavisë dhe çka ka ndodh për ndihmë e kam thirr zonjën Natasha Kandiç, duke mos ditur se i kanë

ekzekutuar menjëherë, e kam lutur dhe i kam thënë të lutem ti ke lidhje me botën, ke internetin, informoje e lajmëroje opinionin botëror çka ndodhi me avokatin e njohur dhe bijtë e tij dhe me familjen time në tërësi, por të gjitha këto do të jenë të vlefshme dhe të rëndësishme siç do të jetë i rëndësishëm zbulimi i së vërtetës nëse hapen arkivat shtetërore të ish-Jugosllavisë, ku kemi dokumentacion për përgatitjen e luftës, planin e luftës, urdhrat cilat vende të sulmohen, urdhrat cila popullatë të zhduket, urdhrat cila popullatë të depërtohet, urdhrat ku duhet bërë gjenocid dhe pikërisht ai gjenocid nuk tejkaloi as Kosovën edhe për fat të keq ai që e nisi luftën dhe e nënshkroi kapitullimin, vdiq dhe të vërtetën e la në gjysmë, e la në gjysmë sepse nga Tribunali për ish-Jugosllavinë nuk patën një vendim, cili do të ishte së paku satisfaksion për të gjithë ata që kanë pësua gjatë luftës, ndërkaq sa i përket drejtësisë mendoj se kjo drejtësi do të ndodh nëse të gjithë së bashku angazhohemi për zbulimin e të vërtetës, por unë personalisht angazhohem që gjykimet të mbahen aty ku ka ndodhur krimi sepse edhe opinioni dëshiron një satisfaksion, jo vetëm familjarët që kanë humbur më të dashurit e tyre dhe që nuk i dinë se ku i kanë. Për të mos e shëndërruar këtë fjalë përshëndetëse timen në një kumtesë timen unë e falënderoj Fondin për të Drejtën Humanitare në krye të së cilës është zonja Kandiç, të cilën e çmoj së tepërmi, e ka çmuar edhe bashkëshorti im, ka bashkëpunuar me të, bile bile ka pas guximin të shkoj edhe në Beograd e të flasë për të vërtetën çfarë po ndodh në Kosovë. E përgëzoj për këtë angazhim, për kurajën dhe qëndresën e saj për ta zbuluar të vërtetën sepse zbulimi i së vërtetës është zbulimi i Sizifit, është punë jashtëzakonisht e rëndë por dhashtë zoti që të ndihmohemi bashkërisht dhe faktet ti grumbullojmë dhe të vërtetën ta zbulojmë. Faleminderit!

Natasha Kandiç: Mes nesh ndodhet zotëri Werner Almhofër, i mirënjohur për ata që merren me çështjet e të drejtave të njeriut. Para se të vij në Prishtinë/Priştina, ai ishte në Sarajevë, ishte edhe në Beograd. Ai i ka përkrahur të gjitha aspektet që kanë të bëjnë me respektimin e të drejtave të njeriut dhe vendosjen e drejtësisë në të gjitha shtetet e ish Jugosllavisë, në një kohë shumë të rëndë. Është mirë për Kosovën, është mirë për sundimin e ligjit dhe për drejtësinë tranzicionale që zotëri Werner Almhofër sot gjendet në krye të Misionit të OSBE-së. Unë e ftoj dhe e lus atë që ta përkrahë këtë iniciativë rajonale, si dhe qasjen rajonale për ballafaqim me të kaluarën dhe shpresoj se mund të llogarisim gjithmonë në Misionin e OSBE-së për vendosjen e drejtësisë për rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut në të kaluarën, sepse ky edhe është vet misioni dhe një prej qëllimeve të OSBE-së. Urdhëroni.

Werner Almhofër: E dashura Natasha Kandiç, të nderuar mysafirë. Është vështirë të flasësh pas fjalimit impresiv të ministres. Unë u jam shumë mirënjohës që ia keni paraqitur publikut punën time në të kaluarën, gjatë viteve të vështira në ish Jugosllavi, por kam frikë se nuk e meritoj një duartrokitje të këtillë. Të nderuar zonja dhe zotërinj, me të vërtetë është kënaqësi të jesh këtu. Ashtu siç e ceku Natasha, ky nuk është rasti i parë, ngjarja e parë e këtij lloji ku unë po flas. Në cilësinë e ambasadorit të atëhershëm të Austrisë, e më pas të kryesisë së Unionit Evropian në Sarajevë, kam marrë pjesë në konferencën që mendoj se ka qenë e para e këtij lloji, ku është diskutuar për problemet e përcaktimit të së vërtetës dhe kur ka filluar për herë të parë lufta e këtyre shoqërive për t'u përballur me trashëgiminë e konflikteve, ashtu siç po diskutohet sot këtu. Por tani jam në situatë krejtësisht tjetër, jam në krye të Misionit të OSBE-së në Kosovë. Gjatë viteve të

kaluara kam pasur rastin t'i vështrojë nga perspektiva të ndryshme këto shoqëri të krijuara në rrethana të rënda të historisë më të re të rajonit. Ne kemi vërejtur se të gjitha vendet e dala nga ish Jugosllavia kanë bërë përparim në drejtim të implementimit të plotë të parimeve demokratike, respektimit të të drejtave të njeriut dhe sundimit të ligjit. Pra, pa dyshim se këtu ka pasur një përparim. Por në të gjitha këto shoqëri, gjyqësia efikase dhe vënia në vend e drejtësisë përmes mekanizmave jashtë gjyqësor dhe jashtë tribunaleve, ka pasur rolin kyç në normalizimin e raporteve në mes të komuniteteve lokale. Trashëgimia e konflikteve dhe shkelja e të drejtave të njeriut janë ndër sfidat më të vështira me të cilat duhet të ballafaqohet shoqëria. Kështu ishte rasti edhe me shoqëritë evropiane pas vitit 1945. Ballafaqimi i rajonit me të kaluarën dhe orientimi i tij kah e ardhmja prosperuese është elementi kyç në shoqëri. Nuk ka dyshim se procesi i pajtimit është proces i dhembshëm që duhet të realizohet përmes gjyqësisë së pavarur dhe të paanshme. OSBE-ja ka ndihmuar aktivisht në krijimin e kushteve për përparimin e këtij procesi. Si organizatë e pavarur ndërshtetërore me mandat për mbikëqyrjen e gjendjes së të drejtave të njeriut, OSBE-ja ndihmon në sigurimin e drejtësisë për procedimin e rasteve të krimeve të luftës, pa ndërhyrje të politikës, nxjerrjen e kryesve të krimeve para drejtësisë dhe përcaktimin e të vërtetës. OSBE-ja në Kosovë ka mbikëqyrur përmbushjen e standardeve për të drejtat e njeriut gjatë proceseve që kanë të bëjnë me krime të luftës, që nga viti 1999. Në vitin 2001, Misioni ka publikuar një raport gjithëpërfshirës mbi krimet e luftës dhe që atëherë vazhdon me mbikëqyrjen e proceseve kundër kriminelëve të luftës, duke filluar nga faza hetimore deri në procesin e gjykimit dhe paraqitjes së ankesave. Misioni ndihmon në tejkalimin e pengesave që paraqiten gjatë zbatimit të plotë të standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, përmes rekomandimeve të qarta për organet përkatëse. Dedikimi i OSBE-së ndaj proceseve të tilla nuk kufizohet vetëm në Kosovë. OSBE-ja e ka kuptuar rëndësinë që ka ofrimi i ndihmës dhe mbikëqyrjes së proceseve gjyqësore dhe proceseve për përcaktimin e të vërtetës që kanë të bëjë me konfliktet në gjithë rajonin. Për këtë arsye, misioni jonë në Kosovë bashkëpunon ngushtë me misionet tjera të OSBE-së në rajon, në lidhje me mbikëqyrjen e procedimit të krimeve të luftës para gjykatave. Siç e dini, TNPJ, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish Jugosllavinë, është kompetent edhe për rastet që kanë të bëjnë me ngjarjet në Kosovë gjatë vitit 1999. Pas skadimit të mandatit të tij, ekziston mundësia që TNPJ t'i transferojë kompetencat e veta dhe dokumentacionin hetues në Kosovë. Ky transferim bart me vete edhe përgjegjësi për gjykatat lokale. Në mënyrë që kjo të kalojë sa më lehtë që është e mundur, në maj të këtij viti, OSBE-ja dhe TNPJ kanë nënshkruar një marrëveshje. TNPJ dhe OSBE-ja do ta shqyrtojnë së bashku praktikën që është ndjekur në të kaluarën e që ka të bëjë me këshillimin e gjykatave, gjykatësve dhe prokurorëve, e cila është treguar efikase. OSBE-ja mbetet e përkushtuar për të ndihmuar procedimin e krimeve të luftës në rajon. Megjithatë, procesi i pajtimit nuk ka të bëjë vetëm me aspektin gjyqësor dhe kjo tregon për gjerësinë e këtij procesi. **Proceset jashtëgjyqësore mund të jenë të domosdoshme në rastet kur mungojnë dëshmitarët, provat apo të akuzuarit. Kujtimet ndryshojnë dhe me kalimin e kohës ato zbehen. Organet jashtëgjyqësore mund të ndihmojnë në përcaktimin e fakteve themelore ashtu që t'i bëjnë publike shkeljet, t'i rehabilitojnë dhe kompensojnë viktimat.** Natyrisht se ekziston një listë e gjatë e praktikave të tilla nga mbarë bota që janë shfrytëzuar në të kaluarën, por ka edhe disa shoqëri post-konfliktuale të cilat mund të shërbejnë si shembull. Duke shfletuar dokumentacionin që më ka përcjellë ekipi i Natashës, shoh se shumë takime në kuadër të

kësaj iniciative tashmë kanë treguar rezultate interesante. Dialogu i hapur me përfshirjen e të gjitha komuniteteve që jetojnë në Kosovë dhe jashtë saj, paraqet hapin e parë domethënës dhe të domosdoshëm për tejkalimin e trashëgimisë kosovare të konfliktit dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut, dhe kjo paraqet nxitje për ecje drejt një shoqërie stabile. Ky takim krijon hapësirë për një dialog të tillë të hapur dhe kjo është gjithashtu arsyeja pse Misioni i OSBE-së në Kosovë me kënaqësi e ka ndihmuar këtë iniciativë dhe mbështet fuqimisht takimet dhe qasjen rajonale. Zonja dhe zotërinj, me lejoni në fund t'ju falënderoj për sinjalin e rëndësishëm që po dërgoni përmes organizimit të kësaj konference. Përpjekjet tuaja të vazhdueshme për të ndihmuar pajtimin ndëretnik, jo vetëm në Kosovë, por edhe në gjithë rajonin, janë të rëndësishme edhe për procesin e integritetit të rajonit të Evropës Juglindore. OSBE-ja do të vazhdojë t'i përkrahë ndërmarrjet dhe iniciativat e këtilla. Ju falënderoj për pjesëmarrjen dhe ju dëshiroj suksese në punën tuaj.

Natasha Kandiç: Do të na duhet ta zgjasim pak sepse duket që Forumi Rajonal i shoqërisë civile ka zgjuar vëmendje të posaçme në Kosovë. Tash do ta lusja zonjushën Valdete Idrizi, nga Community Building Mitovica, që është në rrethin më të ngushtë të grupit operativ përmes të cilit përipiqemi që këtë iniciativë ta zgjerojmë sa më shumë, të zbresim sa më tepër në nivelin lokal, të fitojmë sa më shumë pjesëmarrës në proces, në mënyrë që i gjithë procesi të mos udhëhiqet nga disa organizata, por të formojmë një koalicion të gjerë në përkrahje të Komisionit Rajonal për përcaktimin e fakteve. Unë e ftoj Valdete Idrizin të na thotë disa fjalë për atë se çka paraqet iniciativa jonë dhe kah po shkon ajo.

Valdete Idrizi: Përsëritet të gjithëve, më vjen shumë mirë dhe me të vërtetë ndihem e privilegjuar që po ju drejtohem një audience kaq të gjerë, një audience kaq të rëndësishme do me thënë çfarë jeni ju të gjithë pa përjashtime. Të gjithëve sot në një numër kaq të madh na ka lidh një interes i përbashkët, ky interes është zbulimi i të vërtetës nuk ka dyshim do me thënë në askënd prej neve këtu, të gjendet e vërteta për të gjitha ato gjëra që kanë ndodhur në vendet tona dhe besoj që e vetmja mënyrë që të gjendet kjo e vërtetë është që të gjithë të punojmë bashkë, ne të gjithë që jemi këtu por po ashtu edhe të gjithë akterët tjerë të rëndësishëm të shoqërive tona, unë i jam bashkëngjitur kësaj iniciative do me thënë koalicionit të shoqërisë civile për themelimin e një komisioni rajonal të së vërtetës qysh nga viti i kaluar, nga gjysma e dytë e vitit të kaluar dhe në fillim i kam hyrë këtij procesi besom edhe ende e kam një entuziazëm bukur të madh sepse kam konsideruar dhe konsideroj ende se me të vërtetë është e nevojshme që të kemi një komision të tillë, një komision i cili do të vërtetojë faktet mbi krimet e luftës në ish Jugosllavi dhe se besoj që të gjithë e dimë se do me thënë inicimi, do me thënë starti është me të vërtetë që duhet të bëhet me një kujdes të veçantë. Do të flasim edhe pak më vonë sigurisht edhe panelistët këtu do me thënë ka më tepër se dy vite që ky proces i konsultimeve është duke ndodhur në rajon e njëra prej këtyre është sot që do të ndodh, duhet të përfshihen të gjithë aktorët këtu do me thënë shoqëritë, qeveritë, shoqatat e familjarëve të personave të zhdukur, organizata të të drejtave të njeriut do me thënë artistët, mediat, të rinjtë si partner bukur të rëndësishëm si dhe partnerët vendorë e ndërkombëtarë që janë marrë dhëmerren me këto çështje, besoj që në këto konsultime duhet të përfshihen do me thënë edhe në të gjitha proceset do me thënë edhe këto lloj

grupe njerëzish, edhe njerëzit të cilët na vijnë nga bota, të cilët do ti kemi edhe sot pasdite do me thënë siç është komisionerja nga Argjentina, e cila do të na njoftoj do me thënë qysh prej fillimit të nismës është komisionit atje do me thënë rreth punës sidomos kjo qasja e punës së tyre në fillim, ky përkushtimi që të involvohen të gjithë, ka zëra do me thënë në vazhden e këtyre proceseve deri sot që thonë se kjo iniciative është e vonuar dhe se është dashur të punohet më herët në këtë drejtim, ka zëra që thonë se është dashur që të merren institucionet pikësepari e po ashtu edhe ne shoqëria civile si dhe akterët tjerë. Konsideroj se janë këta zëra të arsyeshëm sepse vetë fakti do me thënë dihet se kemi ende persona të pagjetur, ende kemi njerëz të cilët kanë kryer krime e të cilët janë ende në liri, e të cilët nuk e kanë marrë dënimin e duhur. Këtë të gjithë e ndajmë besoj, ponjashtu e dimë se është një proces i dhembshëm dhe se nuk mundën vetëm asociacionet e familjarëve, nuk mundemi vetëm ne si organizata të drejtave të njeriut, nuk mundën vetëm institucionet pa punuar njëri m tjetrin, do me thënë fjala kyçe këtu fjala bashkëpunim, qasje e hapur besoj që është më se e nevojshme, shpresoj do me thënë që gjatë këtij forumi do ta shfrytëzojmë kohën në maksimum edhe të jemi sa më konstruktiv, të sjellim çështje, të sjellim pyetje, të cilat konsiderojmë se janë shumë të rëndësishme në këtë proces edhe sigurisht pasi që kemi mysafir nga rajoni po edhe nga bota që të shfrytëzojmë rastin të ndajmë informata, të ndajmë do me thënë ide dhe domethënë ti shkëmbejmë të gjithë ato përvojat të cilat i kemi përjetuar deri tash. Kuptohet që domethënë ka edhe dallime domethënë edhe organizatat në mes veti duhet të punojnë edhe shtet si shtete domethënë kemi ndoshta në shtete të veçanta kemi hapësira ku duhet të bashkëpunojnë domethënë flitet këtu ndoshta edhe për ato ndoshta strategjitë nacionale, mirëpo konsideroj se edhe njëherë unë e nënvizoj fjalën bashkëpunim që është më se e nevojshme. Unë në shkurt të këtij viti kam marrë pjesë në forumin e tretë rajonal që është mbajtur në Beograd edhe kam kaluar jashtëzakonisht mirë sepse ka mbretëruar një frymë arsyeje, frymë bashkëpunimi, një frymë mirëkuptimi, audienca ka qenë e ngjashme sikurse kjo këtu edhe pse nga Kosova ka pasur më pak pjesëmarrës po ja që jemi këtu në numër pak më të madh, shpresoj se edhe në këtë forum do të jemi domethënë frytdhënës jemi të hapur dhe më të lëmë pyetje që të na kalojnë, do me thënë ta shfrytëzojmë momentin që gjithë energjinë ta drejtojmë në një drejtim të duhur, në mënyrë që procesi të jetë më i lehtë, duke e ditur gjithëherë që është një proces shumë i dhembshëm, unë nuk do të flas pak më gjatë sepse panelistët, do ta moderoj edhe këtë panelin e parë, panelistët do të flasin domethënë rreth raportit të të gjitha këtyre konsultimeve që i përmenda pak më herët edhe pse kisha pas për të thënë shumë sepse kisha pas për ti ndarë të gjitha ato impresionet e mia, brengat e mia, frikat e mia, njëkohësisht edhe një energji pozitive të cilën e marrë nga të gjithë të tjerët me të cilët bashkëpunoj, por këtu besoj që do ta përfundoj duke ju dëshiruar juve, neve domethënë një bashkëpunim sa më të mirë dhe një frymë arsyeje le të na mbretërojë në këtë forum. Ju faleminderit edhe njëherë!

Natasha Kandiç: Falënderoj Valdeten për fjalët optimiste, miqësore, prirjen për mirësi, dhe në fakt, ky edhe duhet të jetë mesazhi i shoqërisë civile, mesazhi se ne presim shumë nga kjo iniciativë, duam ndërprerjen e armiqësive, duam përfundimin e raporteve të këqija, duam një klimë pozitive dhe do të bëjmë çmos që këtë ta arrijmë; kërkojmë të sqarohet fati i personave të zhdukur dhe që procesin në një moment ta marrin institucionet shtetërore të cilat janë në të vërtetë janë përgjegjëse për vendosjen e

drejtësisë. Ne si shoqëri civile mund të ndihmojmë në këtë drejtim, por ne nuk mund ta udhëheqim këtë proces. Tash ia lë Valdetes udhëheqjen e kësaj pjese të punës së Forumit.

Raporti për rrjedhën e konsultimeve të shoqërisë civile rreth Komisionit Regjional për vërtetimin e fakteve të krimeve të luftës në ish Jugosllavi

Valdete Idrizi: Faleminderit edhe njëherë! Siç e thashë edhe pak më herët domethënë i prezantoj edhe njëherë panelistët: zonja Natasha Kandiç nga Fondi për të Drejtën Humanitare, pastaj Vesna Tërsheliq njëra prej bashkorganizatorëve, që nga fillimi i nismës është organizata "Dokumenta" në Kroaci pastaj e kemi zotëriun nga Srebrenica nga shoqata domethënë "Shoqata e grave të Srebrenicës" nga Bosnja e Hercegovina Amir Kurlagiq, pastaj e kemi zotëri Hysni Berisha nga Shoqata "Shpresimi", kemi zonjën Tea Goernjanc-Preleviq e cila na vjen nga Mali i Zi "Aksioni për të Drejtat e Njeriut" nga Podgorica, pastaj kemi zotëri Marko Veliqkoviç "Qendra për zhvillim të burimeve civile" nga Serbia.

Unë do të ju lus fillimisht juve panelistët, fillimisht juve zonja Natasha Kandiç do me thënë që të na raportoni brenda gjithë procesit, unë e di që në audiencë ka njerëz që kanë marrë pjesë në disa prej konsultimeve, kanë qenë pjesë e procesit mirëpo një numër bukur i madh i tyre, apo nuk e di ndoshta në hollësi se çka ka ndodh, cilat kanë qenë ato domethënë rekomandimet të cilat kanë dal nga aktivitetet me grupe të ndryshme, kështu ju kisha lut që në mënyrë ndoshta kronologjike të na tregoni se çka ka ndodh domethënë kur është themeluar koalicioni dh në pika të shkurtra të gjitha këto aktivitete.

Natasha Kandiç: Ashtu siç tha Valdetja, ne në këtë tryezë, sikurse edhe në forumet paraprake, kemi për detyrë të raportojmë se çka po ngjan brenda shoqërisë civile në lidhje me iniciativën për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe rasteve tjera të shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut. Siç e përmendi Valdetja, mes nesh ka gjithashtu shumë pjesëmarrës nga forumet e mëparshme, por ka edhe individë dhe pjesëmarrës të rinj. Është praktikë jona që në çdo forum ta paraqesim raportin mbi ecurinë e procesit konsultativ. Vetë ideja për domosdoshmërinë e gjetjes së një mënyre për përcaktimin e fakteve në nivel rajonal, ka lindur gjatë bisedave në mes të tre organizatave për të drejtat e njeriut: Fondit për të Drejtën Humanitare, Qendrës Hulumtuese Dokumentuese nga Sarajeva dhe organizatës Dokumenta nga Kroacia. Në këto bisedime ne i kemi kushtuar rëndësi të madhe përcjelljes së gjykimeve për krime të luftës. Është vërtetuar se gjykimet për krime të luftës janë përgjigja më e mirë ligjore për krimet e kryera dhe kryesit, sepse vetëm gjykimet për krime të luftës mund të sigurojnë dënimin e atyre që kanë kryer krime luftime, por kemi vënë re se kapacitetet e gjykatave, duke përfshirë edhe Tribunalin e Hagës dhe gjithë gjykatat nacionale, janë të kufizuara, dhe është e natyrshme që është kështu. Kemi llogaritur se, nëse vazhdohet me këtë tempo, deri në fund të vitit 2020, në të gjitha gjykatat nuk do të mund të gjykohen më shumë se 1.500 kryes të krimeve të luftës. Prandaj jemi shumë... shumë vëmendje u kemi kushtuar përvojave të shoqërive tjera që kanë dalë nga konflikti apo sistemi totalitar. Kemi parë sa në qasjen e tyre ndaj të kaluarës ka shumë gjëra të mira, sepse përpos gjykimeve për krime të luftës ata kanë qenë të mendimit se duhet të krijohet edhe të ekzistojë një mekanizëm jashtë-gjyqësor, e që

është formimi i komisionit për të vërtetën me mandat për t'i përcaktuar faktet mbi krimet e luftës, shumë nga të cilat kishin të bëjnë me zgjidhjen e fatit të personave të zhdukur. Disa prej komisioneve të tilla ishin shumë të suksesshme dhe ndihmuan më së shumti në krijimin e një dokumentacioni zyrtar dhe të saktë për ngjarjet në të kaluarën. Kjo dëshmon se ne e kemi kuptuar prej fillimit se pa një qasje rajonale nuk është i mundur procesi i ballafaqimit me të vërtetën. Më tej, gjatë konsultimeve tona interne, kemi filluar të mendojmë për përvojat e shoqërive tjera të dala nga konflikti. Atëbotë, iniciativa jonë për qasje rajonale, që akoma ishte në fillimet e saja, mori disa kontura konkrete dhe filluam të angazhohemi dhe të mendojmë shumë intezivisht për një model specifik për ish Jugosllavinë, për formimin e një Komisioni Rajonal për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës. Pastaj kemi filluar të mendojmë se si ta forcojmë këtë iniciativë apo ide për qasje rajonale, duke krijuar një organ rajonal për përcaktimin e fakteve, si ta forcojmë atë, që ajo të jetë iniciativë aq e fortë sa parlamentet e shteteve që kanë dalë nga ish Jugosllavia të ballafaqohen me faktin se shoqëritë civile të rajonit qëndrojnë pas kësaj iniciative dhe atyre të mos u mbetet mundësi tjetër veçse t'i fillojnë diskutimet parlamentare dhe t'i sjellin vendimet për formimin e këtij organi rajonal. Jemi përcaktuar për dy mënyra të punës. Të organizojmë forume rajonale me një numër sa më të madh të pjesëmarrësve, aq sa mund të marrin pjesë në një konferencë, kurse në kohën në mes të forumeve të organizojmë konsultime me grupe të ndryshme të shoqërisë civile. Duke u nisur nga eksperiencat e shoqërive tjera të dala nga konflikti, kemi vlerësuar se këto iniciativa nuk mund të jenë të suksesshme nëse nuk e kemi përkrahjen e familjeve të viktimave, pra të atyre që janë dëmtuar, janë vrarë ose zhdukur. Ne vërtet kishim frikë nëse shoqatat e viktimave dhe shoqatat e familjeve të viktimave do të na përkrahnin në këtë iniciativë. Gjithashtu, ishim edhe të shqetësuar se si do të reagonin në këtë iniciativë organizatat e të rinjve. Por, sot, pas më shumë se dy vitesh nga Forumi i Parë Rajonal i mbajtur në Sarajevë, në maj të vitit 2006, ne mund të themi se jemi të kënaqur me rezultatet e arritura. Më e rëndësishmja është se ne kemi fituar përkrahjen e shoqatave të familjeve të viktimave. Familjet e viktimave, sikurse edhe vetë viktimat, e përkrahën fuqishëm iniciativën tonë e cila synon që të vërtetojë ato që kanë ndodhur, krimet që janë kryer gjatë luftës, që për të kaluarën të flitet me gjuhën e fakteve dhe të zbardhet fati i 17.000 personave të zhdukur në gjithë rajonin, gjë që për familjet e të zhdukurve paraqet prioritet. Si të arrihet deri te vendet e fshehta të pa publikuara të varrezave masive, si të sigurohet që familjet e viktimave, nënat, baballarët, familjet më të ngushta, të ndërpresin së kërkuari, të mos bredhin nga një vend në tjetrin, nga një institucion në tjetrin dhe që të mos i kalojnë vitet në pasiguri nëse do t'i gjejnë ose jo eshtrat e më të afërmeve të tyre. Kemi mbajtur më shumë se 15 mbledhje konsultative me shoqatat e familjeve të viktimave, organizatat e të rinjve, me gazetarë, kemi pasur takime me grupe të ndryshme që përbëjnë segmente të rëndësishme të shoqërisë civile dhe të cilët kanë interes të posaçëm që këto probleme nga e kaluara, ballafaqimi me të kaluarën të mos zhduket nga skena publike, që zbulimi i së vërtetës të jetë një aktivitet i rëndësishëm, jo vetëm i shoqërisë civile, por që këto probleme t'i kthejmë në rendin e ditës së parlamenteve dhe qeverive. Kemi pasur konsultime edhe në nivelin kombëtar edhe në atë lokal. Unë do t'i veçoja konsultimet me viktimat dhe familjet e tyre, të cilat janë zhvilluar në maj të vitit 2008, në Podgoricë. Mendoj se ajo ka qenë mbledhja më vendimtare me familjet e viktimave sepse, ne aktivistët për të drejtat e njeriut, kishim para vetes njerëzit që kanë jetuar dhe vazhdojnë të jetojnë me vite të tëra në vuajtje, për të cilët është me rëndësi ta

kuptojnë se ata janë të rëndësishëm për të tjerët, se është me rëndësi që ata të kenë hapësirë ku mund të flasin për fatkeqësitë që u kanë ndodhur, e jo të ftohen në ndonjë mbledhje përkujtimore. Ky ka qenë takimi vendimtar, pas të cilit të gjithë jemi ndier më mirë dhe më të sigurt. Por, ajo që është me rëndësi t'ua them, në të gjitha këto forume, si në Sarajevë, pastaj në Zagreb (në shkurt të vitit 2007), në Beograd (në shkurt të vitit 2008), të gjithë jemi pajtuar se gjykimet për krime të luftës, kudo që mbahen ato, paraqesin përgjigjen më të mirë ligjore për krimet masive të kryera gjatë luftës. Kjo është përgjigja zyrtare. Kjo është mënyra se si përgjigjet shteti në atë që ka ndodhur, e që është përgjegjësi e shtetit. Por, kemi thënë dhe vazhdimisht po e përsërisim, jemi të vetëdijshëm se kjo nuk është e mjaftueshme, sepse sot, 17 vite pas fillimit të luftës, ne kemi raste të shumta të cilat asnjëherë nuk janë bërë publike, kemi mijëra e mijëra viktima që asnjëherë nuk kanë thënë asnjë fjale publikisht, jo sepse kanë frikë të flasin, por ngase nuk ekziston ndonjë platformë publike ku do të mund të dëgjohej zëri i tyre. Duhet thënë se ky Forum i Prishtinës është me rëndësi sepse pas takimit në Podgoricë, asaj mbledhjeje impulsive me shoqatat e familjeve të viktimave, kemi ardhur në përfundim se parakusht për suksesin e iniciativës tonë është krijimi i një koalicioni, koalicionit të organizatave për të drejtat e njeriut, koalicionit ku do të jenë shoqatat e familjeve të viktimave, ku do të jenë individët që janë shumë të interesuar të angazhohen në implementimin e kësaj iniciative, koalicionin e organizatave të të rinjve, koalicionin e shoqatave dhe organizatave profesionale, do të thotë, të sigurojmë mbështetje të gjerë për këtë iniciativë dhe deri në fund të këtij viti dhe vitin e ardhshëm të marrim pjesë, të implementojmë dhe të organizojmë një numër të madh të konsultimeve dhe të përgatitemi për Forumin në Podgoricë. Por, në ndërkohë, duhet të përpiqemi që gjatë këtij procesi konsultues t'i përgatisim rekomandimet, në bazë të së cilave do të krijojmë një model të Komisionit për përcaktimin e fakteve, me të cilin do të dalim para qeverive dhe parlamenteve kombëtare dhe do të jemi shumë të sigurt, që ne si shoqëri civile, po propozojmë diçka që paraqet eksperiencën më të mirë të shoqërive tjera dhe diçka tek e cila kemi ardhur gjatë një procesi konsultativ. Gjatë procesit të ardhshëm konsultativ, ne do t'i kushtojmë shumë më tepër vëmendje diskutimit të mandatit, përbërjes së Komisionit, do të diskutojmë se si të arrijmë te procesi më i mirë i kandidimit të atyre që duhet të jenë në përbërje të Komisionit, të diskutojmë për mënyrën se si duhet të punojë ky Komision, si të organizohen zyrat nacionale në të gjitha shtetet, si të sigurohet qasja e Komisionit Rajonal në arkivin e Hagës dhe shërbimit që do ta ndihmojë atë, sepse arkivi është burimi më i rëndësishëm i informatave për gjithë atë që ka ndodhur në hapësirat e ish Jugosllavisë, duke filluar nga viti 1991. A do t'i hapim gjatë procesit konsultativ të gjitha pyetjet që mund të na ndihmojnë për përgatitjen e rekomandimeve precize dhe të qarta për modelin e Komisionit Rajonal dhe të shërbejnë si përvoja edhe për të tjerët. Në këtë moment ne kemi shumë nevojë për eksperiencat e të tjerëve. Për këtë arsye ne do të fillojmë t'i ftojme anëtarët e komisioneve nga Amerika Latine, nga Afrika Jugore, të na tregojnë, për shembull, se si i kanë organizuar ata dëgjimet publike. Ata që ishin mbrëmë këtu apo më herët dhe që e kanë parë filmin mbi komisionet e të vërtetës, mendoj se e kanë lëshuar sallën me bindje të thellë për faktin se dëgjimi i drejtpërdrejt i viktimave është pjesa më e fuqishme dhe më e dobishme e mandatit të cilitdo Komision për përcaktimin e të vërtetës. Të dëgjosh nënat, prindërit kur tregojnë se kur dhe në çfarë rrethanash i kanë parë për herë të fundit më të dashurit e tyre dhe çka ka ndodhur, është diçka shumë e vlefshme për kthimin e dinjitetit të viktimave dhe për të treguar se ne të

gjithë brengosemi për viktimat, se pa rivendosjen e dinjitetit të tyre, pa e ndjerë ata që shoqëria ka bërë gjithçka për ta zgjidhur fatin e të zhdukurve, është e vështirë të ndërtohet një shoqëri e shëndosh dhe të bindesh se krimet nuk do të përsëriten më kurrë. Me mua këtu janë Marko, Vesna, Hysniu, Tea, të gjithë ata që marrin pjesë në këto konsultime dhe unë do të doja që ne të gjithë të mbesim të vendosur dhe të këmbëngulim në këtë iniciativë, jo vetëm në implementimin e procesit konsultativ, por edhe atë që është më e rëndësishme, që të fitojmë përkrahjen dhe të jemi të gjithë së bashku pjesëmarrës në këtë koalicion dhe të jemi plotësisht të sigurt se do të kemi sukses. Dhe, me të vërtetë, do të kemi sukses nëse të gjithë e ndajmë këtë vizion të mundshëm dhe të dëshmojmë se kemi përgjegjësi për gjeneratat e ardhshme, të lëmë fakte, t'i pastrojmë llogaritë për atë që ka ndodhur dhe të sigurohemi në këtë mënyrë se krimet nuk do të përsëriten dhe se gjeneratat e ardhme do ta kenë të qartë se ne u kemi lënë një dokumentacion kompetent, të saktë, objektiv dhe zyrtar për të kaluarën, duke filluar nga viti 1991. Faleminderit.

Valdete Idrizi: faleminderit zonja Kandiq! Tash pa humbur kohë do të ia jap fjalën zonjës Vesna Tërsheliq nga Kroacia, e cila po ashtu do të na jap një raport rreth rrjedhës së këtyre konsultimeve gjatë gjithë procesit. Urdhëroni Vesna:

Vesna Tersheliq: Faleminderit, Valdete. Mirdita të gjithëve. Jam e gëzuar që jam sot në Kosovë. Më kujtohet sa e pafuqishme jam ndjerë kur kam ardhur këtu gjatë viteve të 80-ta, për t'i vizituar miqtë e mi, kur kam ecur nëpër Bjeshkët e Nemura dhe, më vonë, gjatë viteve të 90-ta, kur kam ardhur si aktiviste e të drejtave të njeriut, sepse kam parë shkeljet e këtyre të drejtave dhe nuk kam pasur asnjë propozim si t'u jepet fund atyre. Edhe po të kishim bërë ndonjë propozim së bashku me aktivistët tjerë, më duket se gjasat për të bërë diçka thelbësore ishin shumë të vogla. Jam e lumtur që kësaj here jam në Kosovë, në Prishtinë, në momentin kur po zyrtarizojmë koalicionin për këtë iniciativë rajonale, për Komisionin Rajonal, sepse besoj se kjo është rruga që do të na ndihmojë në përcaktimin e fakteve për krimet e luftës dhe në kërkimin e të zhdukurve. Posaçërisht më vjen mirë që po vijmë nga vendet e ndryshme të Kroacisë, nga Vukovari, Spliti, Pakraci, Osijeku, Zagrebi dhe po ju sjellim përshëndetjet e shokëve dhe shoqeve nga qytetet tjera, të cilët nuk kanë mundur të vijnë. Këto janë miqtë nga Berka, nga vendet më të vogla, të cilët e kanë vërejtur se ky mund të jetë një hap i përbashkët. Prapa nesh ka mbetur një varg i dialogjeve në forume dhe në konsultime, por ndoshta edhe dialogjet më të rëndësishme me miqtë tanë, në komunitetet tona, në shtëpitë tona dhe më duhet ta pranojë se disa nga këto bisedime për zgjedhjen e mekanizmit më të mirë rajonal, ishin mjaftë të vështira. Që nga koha e mbajtjes së forumit të parë në Sarajevë, në maj të vitit 2006, me të vërtetë kemi shpenzuar shumë energji duke diskutuar haptas se cili do të ishte hapi më i mirë për ta realizuar këtë. Gjatë forumeve në Sarajevë, Zagreb dhe Beograd, si dhe gjatë gjithë konsultimeve të bëra, janë kristalizuar dy mekanizma shumë të rëndësishëm të cilët tregojnë se si do të mund të funksiononte Komisioni rajonal në të ardhmen. Mekanizmi i parë është dokumentimi i fakteve për humbjet njerëzore. Këtë rrugë gjatë procesit të konsultimeve na e ka treguar Qendra Hulumtuese-Dokumentuese (QHD) nga Sarajeva, e cila i prezantoi rezultatet e punës së vet mbi hulumtimin e humbjeve njerëzore ne Bosnjë dhe Hercegovinë. Kjo qendër paraqiti herë të parë para publikut emrat e viktimave dhe të dhëna të besueshme mbi rrethanat e vrasjes apo zhdukjes së secilit person. Fondi për të Drejtën Humanitare, duke ndjekur rrugën e QHD, është duke përgatitur dokumentacionin

për humbjet njerëzore në Kosovë dhe shpresojmë se së shpejti, së bashku me organizatën Dokumenta, do të fillojmë të njëjtën iniciativë edhe në Kroaci. Kjo paraqet një ndihmesë të madhe që ka lindur gjatë procesit tonë të konsultimeve. **Mekanizmi i dytë, gjithashtu shumë i rëndësishëm, është dëgjimi publik i viktimave.** Kur kemi biseduar se si të krijojmë hapësirë që në forumet tona të dëgjohen zërat e viktimave, inspirimin e kemi gjetur në punën e një numri të madh të komisioneve të ngjashme në gjithë botën. Por kur në forumin e Beogradit kemi dëgjuar për herë të parë dëshmitë dhe eksperiencat e viktimave nga i gjithë rajoni, më duhet të pranojë se të gjithë ne kishim frikë para fillimit të dëshmimeve dhe e di se Fondi, i cili kishte investuar shumë energji në përgatitjen e kësaj, duke u përpjekur që t'i mbledh në të njëjtën tavolinë tetë persona nga gjithë rajoni, ftoi dymbëdhjetë, nga frika se dikush nga të ftuarit mund të mos paraqitej. Mirëpo, ata erdhën të gjithë dhe të gjithë i ndanë me ne eksperiencat e tyre, që ishte përvojë e rëndësishme për ne, sepse të gjithë ishim dëshmitarë të dhembjes dhe krimit. Mendoj se ai ishte një prej momenteve e rralla ku do të mund të flitej për katarzë **dhe mendoj se dëgjimet publike paraqesin atë pjesë të forumit e cila na ofron një fotografi për atë se si do të mund të dukej një ditë Komisioni Rajonal.** Për të gjithë ne, viktimat, të interesuarit nga familjet dhe organizatat për të drejtat e njeriut dhe të rinjve, është me rëndësi që një dëgjim i tillë të transmetohet në programet e televizioneve të gjithë rajonit, sepse është shumë më rëndësi t'i jepet hapësirë zërit të viktimave. Gjatë bisedimeve tona shpeshherë kishte zënka dhe mospajtime, në Forumin e mbajtur në Zagreb ka pasur edhe protestë sepse nuk i kemi dhënë hapësirë të mjaftueshme zërit të viktimave. Por sot, mund të flitet për një përkrahje të rëndësishme që kemi nga Kroacia dhe Bashkimi i shoqatave të familjeve të mbrojtësve kroatë të burgosur dhe të zhdukur dhe Shoqatave të familjeve të personave të zhdukur. Pra është me rëndësi fakti se a do ta ketë kjo iniciativë përkrahje nga të gjitha anët dhe në secilin shtet. Nuk mjafton përkrahja e vetëm një grupi të familjeve dhe viktimave. Gjithashtu, më duhet t'ju njoftoj se **një javë para ardhjes këtu kishim bisedime në Zagreb edhe me organizatat e veteranëve të luftës mbrojtëse, në tribunën e mbajtur në Vukovar, ku është bërë e qartë se veteranët e luftës - mbrojtësit në Kroaci nuk e mbështesin iniciativën tonë në këtë moment.** Nuk e kishim të lehtë ta dëgjojmë këtë, nuk është lehtë edhe ta pranosh këtë, kur e shihni se e ata ndihen keq kur dëgjojnë për këtë iniciativë, por kjo është mundësi për të mësuar dhe paraqet një sfidë për ne që në bisedimet e ardhshme të merremi vesh më mirë, t'i dëgjojmë edhe argumentet e tyre shtesë dhe të vazhdojmë më tej. Më duhet të them se jam inkurajuar jashtëzakonisht duke dëgjuar gatishmërinë për t'i përcaktuar faktet për krimet e luftës, të cilat i kanë pohuar edhe Kryetari Sejdiu, Ministria e Drejtësisë, Nekibe Keljmendi, dhe Valdete Idrizi, dhe mendoj se bashkëpunimi në mes të institucioneve qeveritare dhe shoqërisë civile është absolutisht i nevojshëm, nëse duam me të vërtetë që në të ardhmen e afërt iniciativa jonë të pranohet nga qeveria. Mendoj se momenti politik në të cilin po formalizojmë koalicionin tonë dhe vendosim të shkojmë para qeverive të shteteve të rajonit, si para kryetarëve të shteteve, ashtu edhe para kryeministrave dhe kryetarëve të parlamenteve, dallon dukshëm nga ajo që kishim në plan në maj të vitit 2006, por ndoshta ky moment është edhe më i volitshëm sepse tani është koha kur në Tribunalin e Hagës po flitet për strategjinë përfundimtare. Ndoshta nuk ka asnjë moment që shikuar nga aspekti politik do të ishte ideal, por duke pasur parasysh faktin se këtij koalicioni po i bashkohen njerëz të rinj, mendoj se kemi gjithnjë e më shumë forcë dhe përmes procesit të grumbullimit të nënshkrimeve do ta kemi shansin të kërkojmë mënyra që ta sigurojmë përkrahjen direkte

edhe të qytetarëve dhe qytetareve të cilët ndoshta nuk kanë dëgjuar për iniciativën tonë. Unë jam e trimëruar me gjithë këto përkrahje që kanë shprehur njerëzit këtu, jam e gëzuar me diskutimet tona këtu, posaçërisht me atë pjesë ku flitet për mandatin e mundshëm të Komisionit dhe duke i sqaruar vetvetes se çka duhet të përmbajë ai Komision, në mënyrë që ai t'i plotësojë pritjet tona të mëdha dhe të përbashkëta. Jam e inkurajuar edhe për realizimin e qëllimit që ia kemi parashtruar vetes për grumbullimin e një milion nënshkrimeve, që paraqet numër shumë të madh për Kroacinë, duke ditur realisht se... kur kemi mbledhur nënshkrimet për referendum, për referendumin për inkuadrim në NATO, nuk kemi arritur të grumbullojmë më shumë se 100.000 nënshkrime. Por, megjithatë, jam optimiste dhe e di se shumë njerëz që i kanë ndërë pasojat e luftës dhe jetojnë nën hijen e krimeve të kryera do t'i njohin vlerat e kësaj iniciative dhe kemi bërë mirë që emri i Komisionit parasheh përcaktimin e fakteve, e jo të vërtetës, siç kemi biseduar një kohë, sepse në shoqëritë tona ende vazhdojnë të vlejnjë të vërteta dhe tregime të ndryshme për të kaluarën, kurse mendoj se ajo që na nevojitet me të vërtetë është që të përcaktohen faktet, në mënyrë që të zvogëlohet hapësira për manipulime me fakte dhe hapësira për interpretime të cilat janë ofenduese për shumë njerëz, posaçërisht për viktimat. Me këtë po e përmbyll fjalimin tim, ju dëshiroj të gjithëve diskutime të mira si në sallën plenare, ashtu edhe gjatë pauzave, kur do të na jepet mundësia të njihemi më mirë. Faleminderit.

Valdete Idrizi: Faleminderit shumë Vesna! Tash kam nderin të ia jap fjalën zotit Amir Kurlagiq nga Srebrenica, i cili edhe vetë ka humb shumë gjatë luftës edhe domethënë në anëtarë të familjes edhe në forma të ndryshme, mirëpo i cili njeri ka gjet forcën edhe energjinë që të kërkoj të vërtetën, që të luftoj domethënë format më të mundshme që të ndriçohet rasti i të gjithë atyre domethënë që nuk janë gjetur i gjithë atyre që janë vranë, ju lutem urdhëroni zoti Amir, faleminderit!

Amir Kullaglliq: Zonja dhe zotërinj, të nderuar miq, sikurse dëgjuat, unë jam Amir Kulaglliq, vij nga Bosnja dhe Hercegovina, më saktësisht nga Srebrenica. Shfrytëzoj nga rasti që t'ju përshëndes të gjithëve në emrin tim dhe në emër të Shoqatës së viktimave nga Srebrenica. Që nga koha kur jam bërë pjesë e përpjekjeve për formimin e Komisionit Rajonal, e që atëherë kanë kaluar tre vite dhe marr pjesë në këto forume dhe konsultime, gjithnjë e më shpesh mendoj për fenomenin e njerëzve, të cilët edhe pse janë viktimat të dhunës dhe urrejtjes, rrezatojnë mirëkuptim, dashuri dhe sillen si misionarë të së mirës dhe humanizmit. Të gjithë ne që kemi eksperiencat e luftës së tmerrshme, i kemi përballuar në mënyrë stoike të gjitha vuajtjet dhe mizoritë e dhunës në lagjet, rrugët, fshatrat tona të shkatërruara dhe qytetet e bllokuara. Për çdo ditë kemi parë pamjet e vdekjes dhe ndëshkimeve të njerëzve të pambrojtur dhe të pafajshëm. Në luftë kemi humbur ato që janë më të rëndësishëm për çdo person, anëtarët e familjeve tona. Unë personalisht kam humbur të gjithë meshkujt e familjes time të gjerë, shtëpinë, firmën dhe gjithçka tjetër që kemi pasur. Por, megjithatë, nuk mund t'i urrej ata që më kanë shkaktuar gjithë këtë vuajtje dhe dhembje, edhe pse shumë nga ata i takoj vazhdimisht në Srebrenicë. Thjesht nuk mund t'u përngaj atyre, nuk mund ta pranoj vrasësin të jetë mësuesi im, nuk i lejoj urrejtjes të hyj tek unë dhe në shpirtin tim, sepse, sipas meje, urrejtja është e pakuptimtë. Edhe fëmijët e mi i edukoj në këtë frymë. Duke i dëgjuar diskutimet tuaja sot, e shoh se edhe shumë nga ju mendojnë në të njëjtën mënyrë, ndoshta kjo edhe është arsyeja që jemi së bashku gjatë gjithë kësaj kohe. Megjithatë, shpesh

pyetem, sikurse që besoj se pyeteni shumica nga ju, çka të bëhet me urrejtjen që po rritet te shumë njerëz si pasojë e dhunës. Nuk di çka të bëjmë me urrejtjen e akumuluar, por e di se dhembja është e thellë, tepër e thellë. Secili nga ne duhet t'i shfletojë faqet e pikëllimit të vet në vetmi dhe qetësi. Secili prej nesh duhet ta gjejë ilaçin për dhembjen e vet, por dua të besoj se me shpirtin që nuk urren, unë po i ndihmojë shëndetit mendor të familjes time si dhe gjithë rrethinës time. Urrejtja është ndjenjë që krijon te njeriu ankth dhe shkatërron gjithçka që është e shëndosh te ai. Urrejtja le pas vetes vetëm shkretim dhe kotësi. Mendoj se ai që nxit urrejtjen kultivon vrasësin e tij. Unë i respektoj njerëzit që edhe në fatkeqësi e ruajnë vetëpërbajtjen, bujarinë dhe mirësinë. I respektoj njerëzit që përkundër gjithë asaj që u ka ndodhur, vazhdojnë të jenë njerëz, njerëz normal, sepse edhe urrejtja, sikurse dashuria, ka nevojë për njerëz të gjallë. Respektimi i të drejtave të të tjerëve, të kuptuarit e dhembjes së tjetrit dhe dhembshuria me të tjerët janë format më të mira të rezistencës ndaj çfarëdo zemërimi apo tërbimi, por nuk mund të mos pyes: A mjafton kjo? A është kjo esenca? Sipas meje jo. Duhet bërë diçka, duhet bërë hapa konkret, duhet thënë (folur) në momentin e duhur dhe duhet vënë në shërbim të së vërtetës, drejtësisë dhe gjithë asaj që shpie përpara. Duhet që pas gjithë kësaj të mbetemi njerëz normal, por kjo është sfidë e madhe dhe tundim, sprovë për secilin prej nesh, sepse jetojmë në kohën kur janë të paktë ata që flasin të vërtetën, kur shumica e kanë të vështirë të jenë të sqartë dhe, me të vërtetë, të gjithë ata që e ndjekin të vërtetën janë të poshtëruar. Ajo me të cilën po ndeshemi për çdo ditë është heshtja dhe mohimi. Heshtja shfrytëzohet si mbrojtje ndaj çfarëdo forme të përgjegjësisë, kurse mohimi si metodë e arsyetimit për gjithë atë që kemi bërë keq. Frika është prezent në çdo hap, frika nga hakmarrja e nacionalistëve lokal të cilët janë instaluar në organet e pushtetit, por edhe frika ndaj kriminelëve të cilët sot po lëvizin lirisht nëpër qytet dhe rrethinë dhe përhapin një frikë të re. Të gjithë atyre u pengojnë të vërtetat e pakëndshme të luftës dhe pasluftës. Të gjithë ata që flasin publikisht për fakte të vërteta, e rikthejnë besimin dhe bashkëjetesën, por përderisa për njërin palë ata janë heronj, për tjetrën të pavlerë dhe tradhtarë. Këto fakte tregojnë vetvetiu ku jetojmë dhe më kënd jetojmë dhe çfarë fatkeqësie na ka gjetur. Kjo është një luftë e madhe në planin e brendshëm. Kjo është e vështirë por shumë nga ne me sjelljen e tanishme dhe paraqitjet e tyre kanë treguar se është e mundur. Ndodh që familjet e viktimave apo vet viktimat shpeshherë janë të kufizuara nga paragjykimet për të tjerët dhe atë që u përkasin të tjerëve dhe iluzionet për veten dhe "të tyren". Ata janë të ndarë në dysh në mes të standardeve morale, në të cilat besojnë, dhe ato që ua imponojnë regjimet politike, respektivisht elitat politike dhe fetare, të cilat na sundojnë, duke rënë shpesh në kurth. Këto kurthe janë heshtja, mohimi i krimit, minimizimi dhe nënvlerësimi i viktimave të të tjerëve, arsyetimi i krimeve "tona" dhe kriminelëve, e kështu me radhë. Kjo nuk është gjë e mirë, ajo duhet të tejkalohet. Pse ne e konsiderojmë viktimitë vetveten. A ka vendosur dikush nga ne vetë të jetë viktimitë, apo dikush tjetër na ka bërë viktimitë. Sepse që të ketë viktima, duhet të ketë krime por edhe dikush që e kryen krimet, pra personat e tillë i quajmë kriminelë. Më lejoni ju lutem të paraqes qëndrimin tim personale mbi termin krim dhe kriminel. Meqenëse unë jam mysliman dhe i takoj besimit islam, jam i dëshpëruar sepse krimet e kryera nga individët nga radhët e korpusit kombëtar boshnjak lidhen me islamin dhe termin mysliman. Nëse e kemi parasysh definicionin e termit mysliman dhe islam, të cilin i ka thënë shumë herë i dërguari i islamit, siç janë: "Myslman është ai që çdo ditë i dëshiron fqinjët të tij, atë që ia dëshiron vetes. Myslman është ai, gjuha dhe duart e të cilit ofrojnë siguri për njerëzit

tjerë". Ta përmendim këtu edhe paragrafin në Kuran ku thuhet se vrasja e padrejtë e vetëm një viktime të pafajshme barazohet me tragjedinë kozmike. Kjo e bënë të qartë se në islam nuk ka mbështetje për këto vepra të këqija, por termi islam dhe mysliman në kuptimin e vërtetë nuk mund dhe nuk guxojnë të lidhen me çfarëdo forme të aktit të palejueshëm kriminal. Përpos kësaj, në momentin kur dikush që e konsideron veten mysliman kryen vepra të ndaluara, siç janë vrasjet, plaçkitjet, dhunimet ose djegiet e shtëpive, prej atij momenti, ai ndalon së qenit mysliman dhe trashëgimtar të idesë së islamit njëherë e përgjithmonë. Me fjalë të tjera, në momentin kur vret, dhunon, plaçkit apo kryen ndonjë vepër tjetër të palejuar, ai e humb titullin por edhe substancën e myslimanizmit që e karakterizon atë. Do të thotë, kur dikush kryen një vepër të keqe, nuk ka më rëndësi se cilit religjion i përket kryesi, por ai bëhet kriminel. Krimi emërtohet qartë, kushdo që e kryen atë, prandaj asnjë llomotitje për t'i dhënë krimin pseudonimin mysliman, serb apo kroat, nuk mund ta ndryshojë fizionominë e tij të shëmtuar dhe pasojat të cilat i shkakton ajo. Krimineli që kryen krimin, atë e bën ekskluzivisht në emrin e vet, për arsyet që i di vetëm ai. Krimineli me të vërtetë nuk ka as fe e as komb, e as ngjyrimet nacionale, fetare, kulturore apo civilizuese. Mendoj se këtë e dinë të gjithë dhe ky është standard sipas të cilit definohet krimi dhe krimineli në çdo vend të botës. Të dashur miq, nuk kërkoj nga ju ta pranoni këtë definicion, por ju lus që secili nga ju të marrë qëndrim personal për këtë çështje. Fjalët që janë dëgjuar më së shpeshti në të gjitha takimet e deritanishme janë: e vërteta dhe drejtësia. Ne të gjithë kemi perceptimet tona për mënyrën e definimit të së vërtetës. Për disa njerëz e vërteta është njohuria se mbetet mortore të më të dashurve të tyre janë gjetur dhe identifikuar, për të tjerët e vërteta është informimi për rrethanave në të cilat ka pësuar dikush nga anëtarët e familjes, kurse për disa të tjerë e vërteta është emërtimi i kryesve të krimeve kundër më të dashurve të tyre. Por për të gjithë është e përbashkët dëshira apo nevoja që secili prej nesh ta marrë vesh të vërtetën e vet. Megjithatë, gjatë këtij procesi ne i kuptojmë në mënyrë të pashmangshme edhe të vërtetat e të tjerëve. Ajo që flasim të tjerët nuk është e thënë se është e vërteta, por mund të na ndihmojë neve që të vijmë deri te e vërteta jonë. Të gjithë ne jemi në kërkim për të vërtetën dhe gjendemi në rrugën ku po kërkohet e vërteta. Shumica prej nesh akoma nuk ka arritur në fund të rrugës. Unë personalisht e kam kërkuar të vërtetën për një kohë të gjatë, por kam kërkuar pa shpresë. Megjithatë, puna në iniciativën për formimin e Komisionit Rajonal më ka kthyer shpresën. Pa qasje rajonale për përcaktimin e fakteve për krime të luftës, është e pamundur të arrihet deri te e vërteta e plotë në hapësirat e ish Jugosllavisë. Më lejoni që të jap vetëm dy shembuj të shkurtër nga këndi im si srebrenicas. Një grup i fqinjëve të mi shkoi në nga Srebrenica në Ulqin, Mal të Zi, në fillim të prillit të vitit 1992, sepse nuk donin të merrnin pjesë në luftë, por në pikë të ditës, policia malaziase i arrestoi fqinjët e mi, i dorëzoi ata te kriminelët e Karaxhiqit dhe që atëherë atyre u humbet çdo gjurmë. Familje e tyre ende nuk dinë asgjë se çka ka ngjarë më ata njerëz. Shembulli i dytë i freskët janë Skorpionët. Një grup i Skorpionëve erdhi në Bosnjë, kreu një krim monstruoz ndaj një grupi të fëmijëve të mitur nga Srebrenica. Për më shumë, krimin e tyre e kanë xhiruar me kamerë. Pse po e përmend gjithë këtë? Pikërisht për faktin se nëse në këtë proces nuk marrin pjesë Serbia dhe Mali i Zi, familjet e srebrenicasve, sipas të gjitha gjasave, kurrë nuk do të arrijnë te e vërteta për më të dashurit e tyre. Drejtësia është fjalë që e dëgjojmë shpesh dhe për të cilën angazhohemi të gjithë. Sipas meje, ne të gjithë i kemi perceptimet tona për drejtësinë. Për disa kjo nënkupton ballafaqim me kriminelin dhe mundësinë që atij t'ia parashtrijmë pyetjen

"pse?!". Për të tjerët kjo do të ishte nxjerrja e kriminelëve para gjyqit dhe dënimi përkatës. Gjithë kjo ka të bëjë me qasjen individuale. Por ajo për të cilën do të duhej të pajtohemi të gjithë ne që marrim pjesë në këtë proces, janë faktet e mëposhtme. Miqtë më të mirë të së vërtetës janë koha, puna e përbashkët dhe durimi, kurse armiqtë më të mëdhenj janë paragjykimet dhe urrejtja ndaj tjetrit dhe të ndryshmes. Krimi nuk duhet të mbesë i pandëshkuar, në mënyrë që ai të mos përsëritet. Të gjitha faktet duhet të vërtetohen, dokumentohen, arkivohen dhe të mbahen në mend, me qëllim që e keqja të mos përsëritet. Por çdo viktimë ka të drejtë për satisfaksion, identitet dhe varrim dinjitoz, por edhe çdo kriminel meriton të dënohet përmes një procesi gjyqësor të drejtë dhe të paanshëm. Në fund, më lejoni të them vetëm disa fjalë për Komisionin Rajonal. **Iniciativën për formimin e Komisionit Rajonal e konsideroj nismë shumë të guximshme dhe trimëruese të cilën e kanë nisur tre organizata partnere: Qendra Identifikues Dokumentuese, Fondi për të Drejtën Humanitare dhe Dokumenta, kurse është përkrahur dhe pranuar nga një numër i shoqatave të viktimave, veteranëve, organizata të rinjve, gazetarëve, artistëve dhe organizatave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Sipas meje, kjo është një iniciativë e mirë sepse paraqet rrugë të mirë për përcaktimin e të vërtetës për krimet, vendosjen e drejtësisë dhe, në fund, kthimin e besimit në rajonin e ish Jugosllavisë. Por, për shkak të situatës përgjithësisht të rëndë politike, ajo ka ngecur. KOMRA akoma vazhdon të jetë projekt dialogues, ku përpiqemi që përmes dialogut të partnerëve të barabartë të gjejmë përgjigje përmbajtësore në pyetjen si duhet të krijohet një Komision i mirë për përcaktimin e fakteve për krimet e kryera gjatë luftës në hapësirat e ish Jugosllavisë.** Neve kemi nevojë për një Komision që do të punojë mirë, e jo Komisioni vetëm sa për të thënë. Prndaj e quajmë projekt dialogues sepse ka tre vite që po dialogojmë si dhe në çfarë mënyre të arrihet deri te zgjidhjet më të mira, të pranueshme për të gjithë. Secili nga pjesëmarrësit në periudhën e deritanishme është pranuar ashtu siç është. Kjo është me rëndësi të përmendet sepse tregon që njerëzit e kombeve dhe besimeve të ndryshme mundet dhe duhet të punojnë së bashku, në mënyrë që gjërat në rajon të fillojnë të ndryshojnë në favor të mirëqenies së përgjithshme, në të mirën tonë por edhe të fëmijëve tanë, të cilët pa marrë parasysh të gjitha këto duhet të jetojnë dhe bashkëpunojnë në këto hapësira. Nga perspektiva jonë - boshnjake dhe srebrenicase - përvojat e popullit tim pas gjenocidit të përjetuar, dialogu dhe puna jonë e përbashkët në të mirë të të gjithëve nuk është as hobi e as rekreacion, por imperativ në mënyrë që gjeneratave të reja t'ua lëmë mundësinë që ta përmirësojnë atë që ne e kemi prishur dhe rrënuar. Natyrisht se parakusht për diçka të këtillë është sqarimi i të vërtetës për krimet e luftës (të verifikuara me fakte të pamohueshme), thirrja në përgjegjësi dhe dënimi i drejtë për ata që i kanë përgjakur duart, sepse pa vepruar në këtë mënyrë, krijojmë hapësirë për luftëra dhe konflikte tjera, pas të cilave ka shumë të ngjarë që fëmijët tanë të jenë viktima të reja. Për këtë arsye, shfrytëzoj nga rasti që t'i ftoj të gjitha organizatat qeveritare dhe joqeveritare të rajonit dhe të gjithë njerëzit normal që të na bashkohen, sepse duke punuar në koalicionin për krijimin Komisionit Rajonal, ndihmojmë që ato fakte të zbulohen dhe përcaktohen sa më parë, sepse ky është parakusht për paqe dhe siguri në këto hapësira. Le të bëjmë të pamundurën që faktet për të cilat janë në dijeni disa njerëz, apo gjenden në arkivat e gjykatave ndërkombëtare dhe vendore për krime të luftës, në arkivat e qeverive, t'i nxjerrim në dritën e diellit dhe të hyjnë në qytetet, rrugët dhe zemrat tona. Ky është parakusht për një të ardhme më të mirë për ne dhe fëmijët tanë.

Nuk guxojmë ta lëshojmë këtë rast apo këtë shpresë. Në fund, të dashur miq, ju falemiderit për vëmendjen dhe durimin që treguat.

Valdete Idrizi: Faleminderit shumë zotit Amir për përvojën e tij dhe për fjalët ngushëlluese, fjalët shpresëdhënëse për një të ardhme më të mirë domethënë edhe të formimit të këtij komisioni por edhe në një të ardhme të të gjithë regjionit, folësi i radhës është Hysni Berisha, i cili është këtu nga Kosova është... e ndiej obligim me të vërtetë ta them që është një njeri me të vërtetë i palodhshëm, një njeri që nuk ka hezituat që të shkoj edhe në Tribunalin e Hagës disa herë por edhe këtu në rajon që të dëshmoj dhe të ofroj fakte për krime që kanë ndodhur në Kosovë, edhe që të mbetet përherë pozitiv dhe i palodhshëm, fjala është e juaja zotëri:

Hysni Berisha: Faleminderit Valdete! Meqenëse unë jam nikoqir dhe ky forum mbahet në Suharekë e shfrytëzohet këtë foltore që t'i përshëndes të gjithë mysafirët që janë nga regjioni dhe ju dëshiroj punë dhe sukses të mëtutjeshëm. Dua të cek se në luftat, luftën 1998 e 1999 popullata e Kosovës ka përjetuar krime të rënda të kryera nga policia dhe ushtria jugosllave siç kanë qenë vrasjet masive, dëbimet, dhunimet, fshehja e gjurmëve të krimet, të cilat janë transportuar në adresat e destinacioneve të ndryshme siç ka qenë Peruqaci, ka qenë Danubi, ka qenë Batajnica. E një pjesë e tyre kur neve edhe sot i kërkojmë mbi 2000 të zhdukur, akoma nuk e dimë se ku është destinacioni i tyre, ku janë ato eshtra, mbështes këto fakte nga rrethanat, hulumtimet që ne i kemi bërë qysh nga 13 qershori i vitit 1999, vazhdimisht me disa kolegë me të cilët e kemi pasur fatin e njëjtë jemi duke u ballafaquar me këto probleme që nëntë vite e sot jemi ndoshta, e kërkojmë ndonjë rrugëzgjdhje, ndoshta më të mirë se sa që ka qenë deri më tani. Fillimisht ne jemi bazuar në faktet, në të gjitha dëshmitë dhe kemi shpresuar se gjykatat qoftë Tribunali i Hagës qoftë gjykatat vendore do të jenë më efikase dhe do të nxjerrin të vërtetat se çfarë kanë ndodhur. Me ju thënë të drejtën unë personalisht po e ndaj mendimin edhe me shumë njerëz që kemi kontakte dhe po bashkëpunojmë e bisedojmë që gjykata e Tribunalit të Hagës nuk e ka kryer punën e vetë dhe ne nuk jemi të kënaqur me të gjitha ato lëndë që i ka proceduar, merreni me mend për nëntë vite në Gjykatën e Hagës për krimet e bëra ndaj popullatës shqiptare në Kosovë kanë qenë vetëm dy procese, për fat të keq prej të dyve vetëm njëri ka përfunduar që e përmendi zonja ministre pa e zbadhur të vërtetën kurse procesi i dytë është në proces e sipër, që është grupi i Millutinoviçit dhe të tjerët. Ne, duke u nisur nga ajo që të gjitha këto zhagjitje, neglizhenca në punën e organeve të drejtësisë, ne ndoshta na ka dhënë forcë edhe më tepër të angazhohemi dhe të punojmë për nxjerrjen e të vërtetës, mirëpo duke u nisur nga ajo që ne fillimisht kemi filluar ndoshta një grup prej 10-12 aktivistësh në të gjithë Kosovën edhe e kemi pa që ndoshta në mënyrë individuale nuk po mundemi me punuar, me shoqatat që e kemi formuar edhe Këshillin Koordinues të Asociacioneve të Familjarëve të Personave të Zhdukur që në njëfarë mënyre të jemi më të organizuar në zbardhjen e fatit të të zhdukurve. Meqenëse, nuk kemi lënë derë pa trokitur, nuk kemi lënë vend pa hyrë, nuk e kemi lënë pa e shprehur atë mllëfin tonë qoftë në rrugë qoftë me shkresa të ndryshme, mirëpo ne kemi ngel aty ku jemi, e duke u nisur nga fakti që të gjitha..., adresa e vetme për të nxjerrë të vërtetën është në Serbi është në Beograd. Të gjitha krimet të cilat janë bërë në Kosovë janë bërë në mënyrë të organizuar, të specifikuar shumë mirë nga organet e pushtetit të Serbisë. Edhe të gjitha dosjet nëse doni me ardhë te e vërteta për të

gjitha krimet që janë bërë në Kosovë, unë shpresoj nëse ka Serbia vullnet të mirë, ato mundemi me gjet, mirëpo e dimë që edhe pushteti, regjimi i sotëm nuk e ka atë vullnet nuk e ka atë dëshirë edhe me formimin, me iniciativën e forumit regjional, unë kur kam marrë pjesë në takimin e parë i cili është mbajtur në Sarajevë, me ju thënë të drejtën e kam shpreh atë dëshirën që duhet të jemi të bashkuar në një forum regjional, në një komision regjional sepse neve na lidh e vërteta me Serbinë, sepse ajo i ka bo krimet në Kosovë, të gjithë kryesit e krimit dhe dosjet e dokumentacionet janë në Serbi, e edhe unë e kam përkrah zonzjen Natasha e shpresojmë që do të hasim në mirëkuptim edhe te njerëzit e vullnetit të mirë në Serbi, të cilët ndoshta në atë formën e vet do ta bëjnë atë presionin e vet siç e përmendi edhe zonja Vesna, nënshkrimi i një milionë ëëëë, mbledhja e një milionë nënshkrimeve, ndoshta që ata pa dëshirën e tyre do të detyrohen që ti hapin dosjet dhe le të vijmë deri te e vërteta. Pa u organizuar, pa e dhënë kontributin edhe ne si shoqëri civile që sot na u kanë bashkëngjitë jo vetëm familjet e viktimave por unë shoh këtu edhe shoqata të të rinjve, gazetarë e shumë të tjerë që jemi më të fuqishëm ndoshta për ti shtyrë rezultatet për me ardh deri te e vërteta. **Gjithmonë ngelemi para asaj që e vërteta duhet të zbardhet edhe të gjithë ata kryes të krimit duhet të nxirren para organeve të drejtësisë dhe ti marrin dënimet e merituar sepse pa e zbardhur të vërtetën nuk ka kuptim as bashkëjetesa, as afërsia e për me ndërtuar një afërsi një bashkëpunim reciprok atëherë duhet që të zbardhet e vërteta e në bazë të asaj të shohim se ku qëndron ajo, duhet dikush që dikujt ti kërkoj falje për të gjitha ato krime që i kanë bo.** Valdete unë të falenderoj, kjo ishte në pika të shkurta.

Valdete Iderizi: Faleminderit! E tash fjalën do të ia jap zonzjes nga Mali i Zi, e cila po ashtu ka qenë bukur aktive dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në gjithë këtë proces, e posaçërisht nga shteti nga i cili vjen, nga Mali i Zi, urdhëroni fjala është e juaja!

Tea Gorjanc Preleviq: Mirdita. Faleminderit, Valdete, për këtë prezantim. Unë quhem Tea Gorjanc Preleviq, përfaqësoj Aksionin për të Drejtat e Njeriut, organizatë joqeveritare nga Mali i Zi, e cila pak kohë më parë ka organizuar konsultime me përfaqësuesit e shoqërisë civile. Më duhet të them edhe diçka për identitetin të cilin e përmendi zotëri Kulagliq. Unë jam përfaqësuese e drejtpërdrejt e 200 viktimave, anëtarë të familjeve të viktimave të krimeve të kryera nga pushteti malazias ndaj refugjatëve boshnjakë, në vitin 1992. Faktin që jam këtu sot, përderisa marr pjesë në një proces institucional gjyqësor para organeve përkatëse të Malit të Zi, fakti që është këtu me ne gjithashtu... a po më dëgjoni... edhe zotëri Velija Muriq, gjithashtu avokat i viktimave të një krimi tjetër të luftës, për të cilin po ashtu janë përgjegjës organet përkatëse të policisë dhe ushtrisë së Malit të Zi... a duhet të jem më e zëshme? Në rregull, mendoja se e kam mikrofonin... po nuk duhet. Mirë... dhe fakti se Shoqata e Juristëve të Malit të Zi, e cila është një formë e OJQ-së që ka ekzistuar edhe në vitin 1992, kur janë kryer krimet e luftës, e ka mbështetur iniciativën tonë për themelimin e Komisionit Rajonal për përcaktimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut në territoret e ish Jugosllavisë, tregon mjaft se sa i madh është numri i njerëzve që janë pjesë e gjyqësorit, avokaturës, me fjalë tjera njerëzve që marrin pjesë në procedurat institucionale për zbatimin e drejtësisë në Mal të Zi, të cilët janë të bindur se kjo thjesht nuk është e mjaftueshme dhe se **drejtësisë institucionale në Mal të Zi i duhet ndihma, dhe atë jo çfarëdo ndihme, por ndihma e një organi rajonal siç është ky.** E tash, atë që doja ta

them në fillim është se e kam mësuar shumë mirë atë që më ka thënë zotëri Mirko në Beograd, gjatë konsultimeve të kaluara mbi të drejtat e viktimave për zhdëmtim...Unë këtë e mbajta mend dhe do të përpiqem të jem shumë e shkurtër dhe konkrete. Në Mal të Zi janë mbajtur dy konsultime në temën e themelimit të KOMRA-s. Të parin e përmendi Natasha, u mbajt në maj të këtij viti me shoqatat e familjeve të viktimave, viktimat dhe shoqatat e veteranëve. Përpos koalicionit për KOMRA-n në organizimin e tyre morën pjesë edhe dy organizata joqeveritare të viktimave nga Mali i Zi, ato janë Bozhuri i Kuq, Shoqata e viktimave të vrara dhe të zhdukura në Kosova prej vitit 1998 deri në vitin 1999 dhe Shoqata e viktimave, shoqatë e formuar nga qytetarët e Bukovicës dhe Pljevaljës. Këto konsultime kanë qenë me rëndësi për shumë arsye. Është folur për arkivin, për nevojën e rrjetëzimit horizontal, është folur disa herë për gjithçka që kemi dëgjuar këtu dhe unë do të doja t'ju diçka që nuk keni dëgjuar, sepse nuk keni qenë të gjithë aty, atë që për mua personalisht ka qenë më e rëndësishmja. Derisa po fliste për konsultimet, Natasha tha një gjë shumë të rëndësishme, se shoqatat e viktimave dhe viktimat kishin rastin që për herë të parë ta përjetojnë faktin dhe të kuptojnë se ata janë të rëndësishëm për të tjerët. Unë marrë guximin ta plotësoj Natashën Kandiqin, se ata për herë të parë e kanë kuptuar se jo vetëm që janë të rëndësishme viktimat dhe shoqatat e viktimave, jo vetëm që janë të rëndësishëm për të tjerët, por janë të rëndësishëm edhe për njëri tjetrin. Në këto konsultime ngjau diçka që për të gjithë neve që ishim në cilësinë e vëzhguesve ishte shumë tronditëse. Kemi përjetuar skenat ku shoqatat e viktimave i kanë shprehur keqardhjen njëra tjetrës për shkak të krimeve që kanë ndodhur. Mendoj se ky ka qenë momenti vendimtar për të gjithë ne që kishin mundësinë ta përcjellim këtë ngjarje, të kuptojmë se çfarë vlere ka e gjithë kjo që ne po bëjmë. Ai moment më bëri të kuptoj se asnjë çast i kohës time profesionale dhe amësore që ia kam kushtuar krijimit të këtij koalicioni nuk është humbur, nuk ka shkuar kot, jam thëllësisht e bindur për këtë. Dhe e gjithë kjo për shkak të konsultimeve që kanë ndodhur të shtunën. Besoni apo jo, ditën e shtunë, që është ditë pushimi në Mal të Zi, janë mbajtur konsultime shumë të vizituara. Dyzetë përfaqësues të shoqërisë civile erdhën nga të gjitha pjesët e Malit të Zi, disa kanë udhëtuar me orë të tëra dhe të gjithë u pajtuan se fare nuk shtrohet pyetja nëse dhe pse duhet të themelohet ky koalicion, respektivisht Komision, Komision Rajonal, por pyetja e shtruar ishte si ta realizojmë këtë në mënyrën sa më efikase, sa më të shpejtë, sa më të plotë, kualitative dhe me sa më shumë gjasë për sukses. Ne jemi organizuar në atë mënyrë që anëtarësinë në koalicion e kanë vërtetuar përfaqësuesit e 15 organizatave joqeveritare në Mal të Zi dhe 20 individë, të cilët deri më tani, me punën e tyre, i kanë ndihmuar në mënyrë konkrete ballafaqimit të Malit të Zi me të kaluarën. Unë isha organizatore e konsultimeve me shoqërinë civile dhe kam inkuadruar në to, pa menduar shumë, edhe gazetarët, për arsye se gazetarët në Malin e Zi janë të rëndësishëm për ballafaqimin me të kaluarën, sepse ata nuk janë njerëz që kanë punuar sipas udhëzimeve të redaksive. Shpeshherë kanë punuar edhe kundër tyre. Ata janë njerëz me integritet, të cilët shumë ngjarje që lidhen me krimet e luftës i kanë kthyer në vëmendjen e publikut; mes nesh është edhe Sead Sadikoviç, i cili është pikërisht shembulli i gazetarit të këtitillë. Kur ra fjala se kë duhet ftuar nga shoqëria civile, nuk kishte aspak dyshim se gazetarët e meritojnë të marrin pjesë në konsultime në mënyrë të barabartë me aktivistët e organizatave. Me ne gjithashtu ishin edhe përfaqësuesit e shoqatave të viktimave, të cilat i përmenda në fillim. U fol për arkivin, për arkivin e Hagës, për rëndësinë që ka disponimi me këtë arkiv, është folur për faktin se organet shtetërore të Malit të Zi i kanë

shkatërruar shumë fakte. Kjo është e ditur, ekzistojnë fakte për shkatërrimin e fakteve, prandaj kemi konsideruar që është me rëndësi të punojmë me kohë edhe për ruajtjen e fakteve ekzistuese. Kemi rënë dakord që të mos pajtohemi me idenë, të paktën në rastin e Malit të Zi, se Komisionin Rajonal duhet ta themelojë Kryetari i shtetit me dekret, por për këtë çështje duhet gjithsesi të bëhet debat në Parlament, që iniciativa duhet të shkojë në Parlament. Gjatë konsultimeve rastisi ishte prezent edhe autori, prandaj edhe e ftova të na bashkohet. Bëhet fjalë për autorin e filmit dokumentar shumë kualitativ mbi sulmin në Dubrovnik, që u quajt "Lufta për paqen", që fati e deshi të jetë deputet i një partie në parlament, por jo vetëm kaq, ai është kryetar i Këshillit për liritë dhe të drejtat e njeriut. Është e kuptueshme që fillimisht ai ishte skeptik se si do të kalojë kjo iniciativë mes partive në pushtet, respektivisht në Koalicionin qeverisës në Mal të Zi. Siç e dini, Kryetar i Qeverisë është po i njëjti njeri që ishte në po të njëjtin post edhe në vitin 1992, gjatë sulmit mbi Dubrovnik, prandaj në rrethana të tilla unë nuk mund të jem plotësisht optimiste nëse do të pranohet nisma jonë, por, megjithatë, të gjithë jemi pajtuar se në vitin 1997 është bërë... si thuhet, shkëputje nga politika e Slobodan Milosheviqit, dhe se Mali i Zi, respektivisht udhëheqësit janë përcaktuar plotësisht për integrimet evropiane, sundimin e ligjit, respektimin e të drejtave të njeriut...Prandaj mendojmë se Qeveria nuk ka shumë argumente kundër krijimit të një organi të këtillë. Dhe, ashtu siç e thash në fillim, kthehem në kritikën serioze sa i përket efikasitetit të vendosjes së drejtësisë për viktimat nga ana e institucioneve të shtetit malazias. Puna e tyre e deritanishme u tregon të gjithëve se ata kanë nevojë për përkrahje dhe mendoj se kjo është mënyra më e mirë që ata të sigurojnë përkrahje. Ju faleminderit. Shpresoj se nuk ju kam marrë shumë kohë.

Valdete Idrizi: Tea, faleminderit shumë! Folësi i fundit, përpara se të ju jap fjalën juve për pyetje është zotëri Marko Velickoviç nga qendra për zhvillim të burimeve civile nga Serbia, i cili nga këndvështrimi i tij do të jep një prezantim gjegjësisht një raport rreth iniciativës. Urdhëroni!

Marko Veliçkoviç: Faleminderit, faleminderit për mundësinë e dhënë që të flas për pjesëmarrjen e të rinjve në procesin e konsultimeve për mekanizmat e përcaktimit dhe tregimit të së vërtetës. Nga konteksti i konsultimeve të deritanishme me të rinjtë, kanë lindur disa pyetje për të cilat kanë folur pothuajse të gjithë pjesëmarrësit e këtyre konsultimeve. Pyetja e parë që shtrohet këtu është: pse ka rëndësi që të rinjtë e rajonit të ballafaqohen me të kaluarën, kurse e dyta, cili është roli i të rinjve në procesin e ballafaqimit me ngjarjet e së shkuarës. Unë do t'i përcjell këtu disa nga qëndrimet që janë shprehur më shumë gjatë këtyre konsultimeve. Pra, të rinjtë kanë një përgjegjësi të veçantë në këtë proces, sepse ata janë gjenerata të cilës nuk mund t'u vishen krimet e së kaluarës. Megjithatë, të rinjtë janë përgjegjës për qëndrimin që mban shoqëria ku ata jetojnë ndaj personave të zhdukur. Viktimat e këtyre krimeve as sot nuk i kanë realizuar të drejtat e tyre për të vërtetë dhe drejtësi. Realizimi i këtyre të drejtave nënkupton përcaktimin e fakteve, dënimin e kryesve dhe ndërtimin e shoqërisë dhe institucioneve të atilla, që me sjelljet dhe qëndrimet që do të mbajnë ndaj këtyre fakteve do ta bëjnë të pamundur mohimin e tyre. Por, edhe atëherë kur institucionet nuk sillen në mënyrë të përgjegjshme, edhe atëherë kur refuzojnë të qëndrojnë pas fakteve, të rinjtë kanë detyrim personal dhe moral që qëndrimet e veta ndaj krimeve t'i ndërtojnë në bazë të fakteve. Ata duhet ta kërkojnë të vërtetën. Me këtë i marrin përgjegjësitë që i kanë ndaj viktimave, por

edhe në raport me të ardhmen e tyre, sepse kjo shoqëri me qëndrimin që mban ndaj krimeve nuk u garanton as viktimave e as të rinjve, e as qytetarëve të tjerë, se krimet nuk do të përsëriten në të ardhmen. Prandaj, në këtë aspekt, një politikë e përgjegjshme për të rinjtë e cila është e orientuar kah e ardhmja, assesi nuk duhet ta neglizhojë të kaluarën. Ashtu siç tha një nga pjesëmarrëset e Konsultimeve për të rinjtë në Nish, në të rinjtë i vuajmë pasojat e këtyre ngjarjeve. Pikërisht sepse nuk ishim përgjegjës për krimet në kohën kur ato janë kryer, kurse sot i vuajmë pasojat e tyre, të rinjtë kanë të drejtë ta shtrojnë pyetjen pse ka ndodhur kjo. Së pari këtë pyetje duhet t'ia parashtrojmë vetvetes, por kemi plotësisht të drejtë që këtë pyetje t'ua parashtrojmë edhe të tjerëve. Nga ana tjetër, gjeneratat e vjetra këtë pyetje së pari duhet t'ia parashtrojnë vetes. Pse kemi marrë pjesë në krime, pse nuk kemi bërë asnjëherë asgjë, pse nuk kemi bërë sa duhet? Të rinjtë sot kanë rastin dhe përgjegjësinë të bëjnë gjithë atë që është e duhur në mënyrë që shoqëria të ballafaqohet me të kaluarën dhe viktimat t'i realizojnë të drejtat e tyre. Prandaj, të rinjtë thonë se nuk kemi kohë për të humbur, duam të punojmë në mënyrë efikase dhe të organizuar sepse ky është momenti kur ne duhet të bëjmë aq sa duhet, që kjo shoqëri të ballafaqohet me të shkuarën. Duke marrë mbi vete edhe përgjegjësinë për përcaktimin e fakteve, të rinjtë kanë edhe të drejtë më të madhe morale që të kërkojnë nga institucionet ta bëjnë të njëjtën gjë. Institucionet që janë në kontakt të drejtpërdrejt me të rinjtë janë institucionet e sistemit arsimor dhe shpesh dëgjojmë se të rinjtë janë aktorë, se janë subjekt në procesin e arsimimit. Nëse ky është mesazhi zyrtar, i cili shpesh dëgjohet nga njerëzit e këtyre institucioneve zyrtare, atëherë kjo është mundësi që të rinjtë të veprojnë dhe të thonë: mirë, nëse ne jemi aktorë atëherë ne kemi të drejtë të krijojmë një qasje tjetër të sistemit arsimor në raport me temat e rëndësishme për ballafaqim me të kaluarën. Në të gjitha këto konsultime rajonale, të cilat janë zhvilluar gjatë periudhës që ka zgjatur një vit e gjysmë, të rinjtë kanë thënë vazhdimisht se është e nevojshme që ata të marrin pjesë aktive në procesin e ballafaqimit me të kaluarën dhe është e nevojshme që gjatë këtij procesi të bashkëpunojnë mes veti në nivel rajonal. Gjithashtu, ata janë të mendimit se duhet të bashkëpunojnë me organizatat e viktimave, organizatat e gazetarëve, artistëve, me të rinjtë tjerë nga partitë politike, por ata e konsiderojnë posaçërisht të rëndësishme bashkëpunimin me viktimat. Me fjalë tjera, ata duan që përmes punës së përbashkët të ndërtojnë raporte të simpatisë dhe përfundimisht janë të mendimit se dëgjimi i viktimave është shumë me rëndësi. Këto janë ato momente ku të rinjtë mund të japin kontributin e tyre. Të rinjtë përkrahin qasjen rajonale në procesin e ballafaqimit me të kaluarën, sepse përmes kësaj ngushtohet mundësia që faktet të vështrohen nga perspektiva kombëtare, kjo do të thotë zvogëlohet mundësia që ato të vlerësohen në mënyrë subjektive. Gjithashtu, ata janë të mendimit se aktivitetet e tyre të tanishme, do të thotë aktivitetet e organizatave të tyre në temën e të drejtave të njeriut, duhet të organizohen ashtu që ato përfshijnë dhe të përfaqësojnë nevojën për themelimin e Komisionit Rajonal për përcaktimin e fakteve. Të rinjtë janë të mendimit se ky Komision duhet patjetër të jetë organ zyrtar. Përpos këtyre konsultimeve rajonale në Serbi, Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut ka organizuar një seri të konsultimeve me të rinjtë, ku kanë marrë pjesë më shumë se 70 të rinj nga partitë e ndryshme politike dhe organizatat rinore, por edhe të rinjtë për të cilët kjo ngjarje ka shënuar hyrjen e tyre në një aktivitet të tillë; ky ishte një rast për ata që rinjtë të angazhohen dhe të shprehin gatishmërinë që të marrin pjesë në mënyrë aktive në këtë proces. Edhe të rinjtë e kanë theksuar shpeshherë se e shohin rolin e tyre në procesin e grumbullimit të nënshkrimeve,

në përkrahje të iniciativës për themelimin e Komisionit Rajonal. Do të thotë se të rinjtë që kanë marrë pjesë në konsultime kanë treguar, kanë shprehur gatishmërinë që t'i marrin përgjegjësitë e tyre dhe të punojnë në ndryshimin e qëndrimeve të tanishme të shoqërisë ndaj krimit. Ata janë të vetëdijshëm se pajtimi mes njerëzve nuk ndërtohet përmes heshtjes, por duke vërtetuar faktet dhe duhet të bëhen publike. Ata dëshirojnë që nevojën e tyre për t'i njohur faktet ta përcjellin edhe te pjesëtarët tjerë të gjeneratës së tyre. Pra, urrejtja mes kombeve do të zhduket vetëm duke mësuar të vërtetën për atë që ka ndodhur. Ju faleminderit.

Valdete Idrizi: Faleminderit shumë Marko! Para se ta hap domethënë para se t'ua jap mikrofoni juve gjegjësisht ta fillojmë seancën pyetjeve dhe përgjigjeve, Tea më luti që edhe një fjali për fund ta thotë e besoj që lejohet, apo?!

Tea Gorjanc Preleviq: Falënderoj Valdeten. Marko më kujtoi një informatë shumë të rëndësishme të cilën kisha harruar t'ua them. Lajmin për mbajtjen e konsultimeve kombëtare me shoqërinë civile, televizioni e publikoi në ditarin që te ne emitohet akoma në ora 19:30, me fjalë tjera, televizioni publik kombëtar atë e prezantuar si lajmin e parë. Më pas kam dëgjuar se redaktorja e re e Ditarit, ka dashur që në këtë mënyrë t'i dërgoj mesazh shoqërisë civile se gjërat në televizion po ndryshojnë. Mendoj se ky është një veprim inkurajues për të gjithë ne. Faleminderit.

Valdete Idrizi: Faleminderit shumë! Po të rinjtë, të rinjtë po bëjnë shumë! Në të gjitha këto konsultime me të vërtetë kam kaluar mirë sepse me të vërtetë kam fituar energji prej këtyre të rinjve edhe pse edhe vetë nuk jam aq e vjetër mirëpo kur i shoh këta të rinj aq entuziastë domethënë e një përkushtim mjaft të madh, ju kanë qas gjithë këtij procesi kaq të dhimbshëm, e më herët e tha edhe Natasha që duhetë punojmë për një të ardhme të tyre të mirë, të mos iu lëmë një barrë kaq të rëndë në kraharorin e tyre e që ti kemi këta krahas neve besoj që kjo është mrekullia e që besoj që sidomos rinia me një aplauzë shumë të mirë do ta meritoni, kështu disa gjëra teknik, me kohë qëndrojmë mjaft mirë, deri në ora 11: 15 do të kemi hapësirë për pyetje mirëpo ju kisha lut që të jeni të fokusuar edhe që i mbani mundësisht 3 minuta pasi që ka njerëz shumë të interesuar që të pyesin rreth rrjedhës gjegjësisht rreth prezantimeve, prandaj ju kisha lutur që të mos dalim jashtë kornizave domethënë kjo seancë, të gjitha pyetjet, të gjitha paqartësitë le të drejtohen në prezantimet e tyre e për çështje tjera do të jenë edhe seancat tjera, sigurisht veq i keni pa edhe në agjendë, kështu sa i mikrofonit i kemi në sallë, ju lutem veq dorën lartë që të ju shoh, zonja me të gjelbër

Pyetjet dhe përgjigjet:

Kada Hotiq: Më duhet të them se e përkrah diskutimin e tij, por më duhet të jem pak e njëanshme këtu. Amir Kulaghiq ka theksuar diçka që është me rëndësi thelbësore për të gjithë njerëzit. Me të vërtetë më pëlqeu. Amir, ju uroj dhe ju përkrah në tërësi dhe të gjithë do të duhet t'ju përkrahin. Para së gjithash i falënderoj të rinjtë, të cilët kanë shprehur dëshirën që një herë e mirë ta sqarojmë të kaluarën, jo ta harrojmë por ta themi ashtu siç është, ta pranojmë atë sidoqoftë, në mënyrë që të arrijmë te e vërteta, te drejtësia dhe të përgjigjen ata që janë fajtor. Por, më lejoni ju lutem të them diçka që më dhemb,

ka vite që mendoj për këtë...dhe kam folur për këtë edhe më parë. Po ashtu edhe Natasha. Në Beograd po zhvillohet procesi kundër personave nga Zvorniku, të përfshirë në krimet e kryera në këtë qytet. Është një e vërtetë të cilën nuk e përmend askush, unë ka vite që flas për të, por askush nuk po e pranon këtë të vërtetë. Le të hetohet gurrorja në Zvornikun e vogël dhe në gëlqerorja. Për tre ditë i kanë sjellë trupat me kiperë (kamiona që zbrasin mall) dhe i kanë djegur. Familjet e këtyre personave të djegur presin përgjigje për më të dashurit e tyre, t'i identifikojnë dhe t'i varrosin. Megjithatë, në atë gurrorë këto trupa janë kthyer në hi dhe gëlqerore. Të merren në pyetje ata që janë arrestuar dhe të pyeten banorët lokal...Ekziston fshati Borik. Një grua që ishte në spital në Loznicë me krushkën time tha se burri i saj u vetëvra...ai ishte prezent gjatë djegies së trupave dhe nuk mundi ta përballojë atë ngjarje, ai u vetëvra. Ajo grua i tregoi gjithë grupit të grave në spitalin e Loznicës. Kjo është e vërteta dhe mund të pyeten fshatarët dhe banorët vendas, sikurse edhe të dyshuarit për krime.

Valdete Idrizi: Më falni, a mund tju ndërprejë shkurt. E di që është shumë e rëndësishme dhe do të ketë hapësirë në seanca tjera të flasim për disa situata konkrete, por nëse është e mundur sa më shkurt dhe të fokusohemi në prezentimin të ciën e kemi sjellur në panel. Më falni ju lutem, por do të keni rastin....

Kada Hotiq: Ju faleminderit. Ndoshta dola pak nga konteksti, por unë e shfrytëzoj rastin sa herë që më jepet, ndoshta bëhem nga pak, si të them, jo e pasjellshme, por...kam dëshirë që për këtë rast të merret vesh diçka. Sepse edhe vet... akoma kërkoj ta gjej djalin tim diku. Ndoshta edhe në atë gëlqerore. Faleminderit.

Valdete Idrizi: Urdhëro zotëri, vetëm nëse ka mundësi që të gjithë folësit të prezantoheni së pari!

Shukri Aliu: Ju përsëndes të gjithë të pranishmit! Unë quhem Shukri Aliu, një dëshmitar i Hagës së bashku me Hysniun. Po më vjen shumë keq që është Natasha prej Serbisë dhe që duhet disa herë ca pyetje të ia parashtrojmë, të cilat me siguri ajo deri më tash nuk i ka cekur ose nuk i ka dëgjue, i përsëndes të gjithë diskutuesit e sidomos juve edhe Amirin për disa gjëra shumë konkrete që i dha. Dihet shumë mirë që Serbia në vitet e nëntëdhjeta ka kryer vepra shumë shumë kriminele në pjesët e Jugosllavisë, e kisha lut Natashën pasi që e kufizuat kohën e nuk kemi shumë kohë për diskutime Serbia më së pari duhet të përgjigjet për 86 ushtarët e vrarë në të gjitha kazernat e ish armatës jugosllave, prej viteve të 80-ta deri te ato të 90-ta, në qoftë se duhen emrat të gjitha emrat ia japi por gjithsesi të zbardhet fati i tyre dhe familjet e tyre të njoftohen, e lus komisioni që për këta ushtarë të kryhet ADN-ja në Tuzëll dhe të dihen shkaktarët se kush kanë qenë. Flitet vetëm për krimet e luftës 97-98 në Kosovë e përgatitjet e Serbisë për luftë në Kosovë kanë filluar prej 91-shës e këndeje, për krimet, ju lutem unë juve ju kam dëgjuar shumë mirë, për vitet 97 e 98 Natasha duhet ta dijë mirë, duhet ta dijë dhe të na tregoj këtyre njerëzve që janë në sallë, këtyre njerëzve që janë masakruar, që familjarët iu masakruan, djemtë , të gjindet Millomir Miniq ish kryetar i dhomave politiko-shoqërore të ish Jugosllavisë, ish drejtor i hekurudhave, a gjatë dy viteve të luftës kryeshef i shtabit të luftës për Kosovë

Valdete Idrizi: veq nëse ka mundësi me i rrumbullakësuar

Shukri Aliu: po po menjëherë, është m era me mbiemra ne do ti rrumbullakësojmë të gjithë,..... ju lutem unë juve ju kam dëgjuar shumë mirë,

Natasha Kandiç: Zotëri Aliu, menjëher do tju përgjigjem, ju lutem duhet të dëgjojmë.

Shukri Aliu: Ju lutem, unë ju dëgjova mirë.

Natasha Kandiç: Ju lutem, ekziston procedura të cilën e kemi bërë shumë të qartë. E kemi temën për të cilën duhet të flasim, kemi nevojë për një ton pozitiv, ju lutem, ky Forum nuk shërben për përcaktimin e fakteve, ky Forum duhet të shfrytëzohet për t'u diskutuar për një iniciativë e cila duhet të sjellë deri te formimi i Komisionit që do të merret me përcaktimin e krimeve të luftës. Ju lutem, ne të gjithë këtu kemi për detyrë t'i përmbahemi kësaj procedure. Ne si folës e kemi thënë shumë qartë se cili është qëllimi i këtyre konsultimeve. Unë e shoh se ju keni nevojë të flisni për ato ngjarje, por e kemi sesionin e Nevojave dhe pritjeve të shoqërisë kosovare dhe viktimave...por ju lutem, atë që ju po thoni është se po kërkonti të përcaktohen faktet. Edhe ne këtë duam, por nuk jemi kompetent, e as nuk na ka autorizuar dikush që në këtë Forum të merremi me përcaktimin e fakteve. Faktet do t'i përcaktojmë gjatë procedurës e cila do të precizohet qartë, e tash ju lus që të gjithë t'i përmbahemi rendit. Procedura se nuk do ta emërtojmë askënd, se këtu nuk do ta përcaktojmë përgjegjësinë e askujt, këtu jemi vetëm të marrim përkrahjen dhe që të gjithë të pajtohemi se përgjegjësinë do ta përcaktojmë në bazë të fakteve. Ju lutem, neve na duhet përkrahje për faktet, duam të themi ka ardhur një kohë kur ne të gjithë jemi të vetëdijshëm për përgjegjësitë tona, përgjegjësitë për të treguar saktë atë që ka ndodhur, këtë mund të bëjmë vetëm me anë të fakteve. Ne si organizatorë nuk do të lejojmë assesi kurrfarë përcaktimi të përgjegjësisë apo të fakteve në këto Forume, sepse duam që për herë të parë në histori, në këto hapësira, të përcaktohen faktet ashtu siç vërtetohen. Faktet duhet të vërtetohen sipas procedurës së përcaktuar... ju lutem të jemi...ju lutem, më lejoni...

Valdete Idrizi: Ju lutem a ka mundësi, më falni veq pak rolin e moderatores...

Shukri Aliu: Në qoftë se zonjës i dhemb shumë,

Valdete Idrizi: do të keni mundësi në seancën tjetër,

Shukri Aliu: Ju lutem dua me i përmend këtu le të ndihen, ju lutem unë ju kma dëgjuar shumë mirë, të gjithë i kam dëgjuar shumë mirë, asnjë serb i Kosovës nuk është dënuar për krimet e kryera në Kosovë.

Natasha Kandiç: Aliu, mos ndoshta ju do të... ju lutem zotëri Aliu, mos ndoshta ju doni të përfaqësoni shoqërinë kosovare duke treguar se askush nuk do t'i përmbahet procedurës.

Valdete Idrizi: A ka mundësi veq edhe njëherë të lutem,

Shukri Aliu: jo jo unë jam personalisht këtu, juve po ju dhemb kjo gjë, une po e di që po ju dhemb, ju duhet ti dëgjoni emrat dhe mbiemrat të cilat po i ruani në Serbi atje

Valdete Idrizi: zotëri

Shukri Aliu: Ju lutem Valdete, unë vetëm po i përmendi emrat

Valdete Idrizi: a më fal, a bën me më respektuar ju lutem ?

Shukri Aliu: Unë pe shoh që këtu , diçka po përfaqësoheni që nuk po folni konkretisht

Valdete Idrizi: Jo, jo veq po dëshiroj

Shukri Aliu: Ju lutem folni konkret me emra edhe mbiemra të cilët kanë kryer vepra kriminele në Kosovë

Valdete Idrizi: Më falni, a mendoni që në këtë forum mundeni të gjitha me i kry

Shukri Aliu: Jo jo unë vetëm po i ceku nuk po them me i ndërmarrë masat menjëherë, në Kosovë

Natasha Kandia: Ju lutem, po jap 15 minuta pauzë për kafe.

Pas pauzës

Valdete Idrizi: Siç thash më herët, e di që ekziston një nevojë e madhe për tu thënë shumë gjëra këtu. Më herët thash se ekzistojnë shumë probleme, por prapë i kisha lutur të gjithë pjesëmarrësit, të cilët e kërkojnë fjalën ta respektojnë kohën nga tre minuta, dhe ju lus të koncentrohemi në pyetjet dhe diskutimet lidhur me komisionin dhe iniciativën (për themelimin e KOMRA-s). E di që për disa nga ju edhe pyetjet tjera janë të rëndësishme, ndoshta të rëndësishme edhe për këtë proces, por mendoj se në këtë seancë nuk është as koha as vendi i duhur. Kështu që ju kisha lutur, siç thash edhe më herët, të mendojmë pak sepse të gjithë kemi ardhur këtu me qëllim të përbashkët, me vullnetin e mirë, në kërkimin dhe gjetjen e rrugës më të mirë për formimin e Komisionit për zbulimin e të vërtetës. Të tregojmë edhe një herë tolerancë dhe mirëkuptim ndaj të tjerëve. Ju falenderoj. E di se zotëri Mirko Kovaçiq e kërkoi fjalën. Urdhëroni zotëri Kovaçeviq.

Mirko Kovaçiq: Mirdita miq dhe bashkëpunëtorë të nderuar. Arsyja pse jemi ulur këtu... ne e pimë kafënë, mendoj se tani mund të vazhdojmë ndryshe. Unë si person i mërzitshëm dhe sipas të gjitha gjasave më i vjetri mes jush, sepse jam në prag të tetëdhjetave. Unë i kam shkruar tetë letra...unë jam për herë të dytë në Prishtinë. Kjo është hera e pestë që jam në Kosovë. Këtë ia kam shkruar vajzës time: "E dashura Nino,

përsëri këtu, por tash po shoh përparim, ndoshta kjo do të vlejë diçka, të do babi". Këtë ia kam shkruar asaj, kurse me këto tetë letrat në Lubjanë, Gjermani Kroaci dhe Serbi u lajmërohem miqve të mirë, sepse të humbësh një mik është turp dhe varfëri e madhe. Këtu janë mbledhur së bashku të krishterët, edhe romano-katolikët, greko-katolikët dhe ortodoksët, ka edhe myslimanë, islamistë, nuk di nëse ka hebrej, por tradita është kjo: Kur hyjnë në kishë apo xhami për t'u lutur apo falur, myslimani i pastron këmbët, katoliku dhe ortodoksi bëjnë kryq, kurse hebrejtë e vendosin kapelën në kokë. Kjo shpreh nderim, se në këto vende njerëzit hyjnë me ndërgjegje dhe shpirt të pastër dhe se do t'u binden atyre postulateve dhe mesazheve që jepen në liturgji. Prandaj do t'ju lusja juve që të gjithë t'i lëmë tragjeditë tona personale, për të cilat unë kam shumë se çka të them, edhe si i burgosur i llogoreve edhe si person, familja e të cilit ka pësuar që nga viti 1945, por edhe më vonë. Këtë e mbaj për vete, unë ua kam falur të gjithëve, të gjithëve ua kam falur, e tani duam që më këtë potez, përmes KOMRA-s, takimeve etj, të forcohem, të bashkohemi dhe të punojmë së bashku. Këtu e kam edhe fletoren ku kam mbajtur procesverbalin e takimit të fundit në Prishtinë, ku Çeda me ka thënë diçka...më ka thënë ta ruaj një koleg nga Sarajeva. Të gjithë jemi pajtuar të ecim përpara së bashku dhe t'i mposhtim vështirësitë, brengat dhe pikëllimet tona dhe të ecim drejt këtij qëllimi sot, në mënyrë që nesër nipat dhe stërnipat tanë të mos na nxjerrin nga varret dhe të na thonë "e çka keni bërë ju dhe përse e keni bërë ". Të nderuar miq, të nderuar bashkëpunëtorë, të punojmë në drejtim të forcimit të kësaj nisme për të cilën sot flasim dhe dëgjojmë. Ju faleminderit shumë.

Valdete Idrizi: Faleminderit zotëri Kovaçiq. Kush dëshiron ta merr fjalën?

Deli Avdiu: Unë quhem Deli Avdiu nga Prishtina, Shoqata për 'Hulumtimin në të pagjetur' pajtohem me të gjitha mendimet që i propozuat deri më tani, nëse janë reale dhe nga zemra e juaj, mirëpo edhe pse në moshë 66 vjeçare me 24 dajë të zhdukur po them që në këto raste duhet të ftohen dhe të marrin pjesë të gjithë ata të cilët me të vërtetë e kanë zemrën e lënduar dhe të mos shtijnë njerëz në mesin e këtyre njerëzve, të cilët janë të papërshtatshëm si për Kosovë si për regjionin e përgjithshëm të ish Jugosllavisë. Kam informata se këtu gjendet anëtari i Gardës së Car Llazarit, Simiqi, e më duket në qoftëse ai është këtu, ju lutem ju si përfaqësues i kryesisë atje, kush e ftoi atë shok, ne jse atë person? Ne jse dihet që garda e Car Llazarit çka ka kërkuar dhe çka kërkon për Kosovën, qe kaq!

Nataša Kandić: Faleminderit zotëri për këtë pyetje dhe tash do të doja t'ua sqaroj. Ju lutem, në veçanti ju lus juve nga Kosova, posaçërisht ju shqiptarëve, që të shihni se jashtë Kosovës janë fqinjët tuaj, se ka edhe njerëz të tjerë, se ka ndryshime, se ka edhe njerëz që bëjnë mirë. Unë e ftova Simo Spasiqin të vijë këtu dhe duke iu falënderuar atij sot ne e kemi këtë Forum rajonal. Po të mos ishte ai, Forumi që po mbahet sot do të ishte i pamundur dhe ja pse. Ju të gjithë e dini qëndrimin e Serbisë në raport me Kosovën. Qëndrimi zyrtar në Serbi ishte që asnjë nga shoqatat e familjeve të viktimave nuk duhet të vijë në Prishtinë. Nga Republika Serbe nuk ka ardhur asnjë përfaqësues, por pastaj në Shoqatën e familjeve të viktimave që udhëhiqet nga Simo Spasiq, kanë qenë të mendimit... ata ishin në muajin maj në Podgoricë, morën pjesë në të gjitha këshillimet,

natyrisht, ka pasur raste kur Simo Spasiq ka dashur të bëjë ndonjë problem. Atëherë kemi intervenuar ne, kemi biseduar me të dhe kemi arritur ta pengojmë në përpjekjen e tij që të krijojë probleme, por kësaj here, këtu në Prishtinë, ai ishte shumë konstruktiv, siç ishte edhe në konferencën e mbajtur në Podgoricë. Është pikëpyetje nëse sot do ta kishim këtë Forum, në qoftë se këtu nuk do të ishin përfaqësuesit e familjeve të viktimave nga të gjitha shtetet e ish Jugosllavisë, kurse ju në Kosovë besoj se e kuptoni këtë. Nuk do të kishte fare Forum po të mos ishin prezent përfaqësuesit e familjeve të viktimave nga të gjitha shtetet e ish Jugosllavisë. Po të mos kishte ardhur asnjë përfaqësues nga shoqatat e familjeve të viktimave të serbëve të Kosovës, nëse nuk vjen askush nga familjet e viktimave të serbëve të Bosnjës, atëherë do të kishim një problem të madh. Unë jam shumë e lumtur që kësaj here nuk fitoi ajo këshilla e keqe, veprimi i keq i Qeverisë së shtetit të Serbisë që askush të mos marrë pjesë në këtë forum. Unë mendoj që është mirë që familjet e viktimave të serbëve të Kosovës janë sot këtu me ju, me ne, me familjet nga Bosnja, Kroacia, Mali i Zi...dhe mendoj se kjo është mirë dhe e rëndësishme. Ju lutem, nuk ka kurrfarë iniciative, kurrfarë Komisioni për përcaktimin e të vërtetës për krimet e luftës nëse ne të gjithë, të gjitha shoqatat, të gjitha viktimat...dhe unë ju lus, posaçërisht ju që jeni nikoqir, të keni parasysh atë që është interes i përgjithshëm. Është interes i përgjithshëm të përpiqemi të ndërtojmë diçka, t'i lëmë anash armiqtë, nuk duhet të harrojmë, nuk duhet të mos e përmendim dhembjen dhe vuajtjen tonë, ju keni të drejtë ta bëni atë, ta dëgjojmë, ta dimë, duam ta dimë, duam ta mbajmë mend, por ka diçka që quhet procedurë, ekziston diçka që është interes i përgjithshëm dhe ne këtu udhëhiqemi pikërisht nga këto parime. Çka është interes i përgjithshëm? Interesi i përgjithshëm është që në këtë proces konsultativ të marrin pjesë të gjithë. Unë vetëm dua t'u rikujtoj. Pesë vite më parë askush nuk kishte mundësi që t'i mbledh në një vend familjet e shoqatave të viktimave nga Kosova, serbët dhe shqiptarët, nga Bosnja, që të gjithë të jenë së bashku dhe të bisedojnë për këtë. Ia kemi dalë mbanë duke iu falënderuar familjeve të viktimave nga Kroacia, nga Bosnja, nga Mali i Z. Ne ia kemi dalë mbanë. Prandaj, hajde ta ruajmë dhe ta zhvillojmë më tej atë që e kemi arritur, që e kemi ndërtuar, e jo të vazhdojmë me tonin që na kthen prapa. Të gjithë ne duhet të ecim përpara, duhet ta bëjmë këtë për shkak të gjeneratave të ardhshme. Sot e dëgjuat atë që tha Marko. Ai është i vetëdijshëm se nuk ka përgjegjësi për atë që ka ndodhur, por ai është gjithashtu i vetëdijshëm dhe kërkon përgjegjësinë e tij për qëndrimin që do të mbaj në lidhje me të kaluarën. Por ju lutem, mos i vështirësoni punët, mos të bëhemi aq armiqtësor ndaj të tjerëve, duam që ky Forum të jetë shpresëdhënës, me pritje reale se me të vërtetë do të bëjmë diçka në raport me të kaluarën, diçka të sigurt, diçka që do të jetë përshkrim kompetent dhe i besueshëm i asaj që ka ndodhur.

Valdete Idrizi: Fjalën e ka Shukrije Gashi, mikrofonin te kjo zonja, më fal kjo e ka qu dorën edhe para jush ju lutem, më falni unë duhet me i respektuar rregullat, ju lutem Shukria ka kërkuar fjalën edhe më herët se ju, mirëpo ëëëë , mikrofonin shkoi te dora e saj, ju lutem ta respektojme zonjën pastaj është Shabani e më vonë zotëriu. Urdhëro Shuki!

Shukrije Gashi: mirëdita të gjithëve, unë jam Shukrie Gashi, jam drejtoreshë e Qendrës për Administrimin e Konflikteve, fillimisht e përshëndes zonjën Natasha Kandiç dhe kryesuesit e këtij forumi për një iniciativë kaq të qëlluar, më vjen shumë mirë që shoh

këtu shumë qytetar të Kosovës dh nga ish Jugosllavia nga të gjitha Republikat e Jugosllavisë që kanë gjet kurajo për të marrë pjesë në një iniciativë të tillë, e cila ka qenë më se e domosdoshme, nuk është hera e parë që marr pjesë në një veprimtari të tillë domethënë kam qenë edhe dy herë tjera e kjo është hera e tretë, duke përfshirë këtu që kam qenë edhe jashtë Kosovës, në vende ku zhvillohen aktivitete të tilla, konsideroj që kjo është shumë e rëndësishme dhe jam shumë e kënaqur që ka shumë njerëz, unë gjithashtu i përshëndes edhe familjarët e të zhdukurve nga të gjitha rajonet e ish Jugosllavisë, më vjen keq për gjithë atë që ka ndodh, por më vjen mirë që ata kanë gjetur kurajën që të vijmë këtu dhe të bashkëndiejnë krejt atë çka ka ndodh në rajonin ish Jugosllavisë, unë dua të theksoj se për të nisë Kosova e jap përkrahjen e plotë këtij forumi dhe dëshiroj që të jemi pjesë përbërëse e kësaj iniciative dhe të ndihmojmë me të gjitha veprimtaritë që ne i bëjmë në qendër, nuk është hera parë që ne e bëjmë këtë do ta bëjmë përsëri. Pyetja ime drejtuar këtij forumi do të ishte se çka deri më tani ka arritur që të realizohet në këtë forum, duke përfshirë krejt rajonin pra duke i përfshirë Republikat e ish Jugosllavisë, pjesët e Jugosllavisë. Me qëllim që ne si qytetarë dhe si organizatë të dimë se çka më tutje po e them edhe njëherë se ne si qendër jemi të interesuar që të bashkëngjitemi këtij forumi dhe të bëjmë atë çka është më e mira për ta ndihmuar punën e këtij forumi, sa i përket disa deklarimeve të ndjeshme konsideroj se kanë të drejtë, por ashtu si tha zonja Natasha duhet përfillur procedurat e rregullta dhe besoj se do të ketë hapësirë gjatë kësaj konference për deklarime të tilla, për shprehje të shqetësimeve de vullnetit andaj dhe besoj se për këtë arsye edhe jemi këtu, pra edhe njëherë faleminderit dhe pres që do të gjej përgjigje përkatëse në pyetjen time, faleminderit!

Valdete Idizi: Faleminderit Shuki ! A do të përgjigjeni njëherë e pastaj pyetjet?

Vesna Tersheliq: E arritura më e madhe e kësaj konference është se kemi ndërtuar koalicionin i cili për momentin është ende jozyrtar, kurse do të zyrtarizohet nesër. Tashmë është e qartë se në çdo vend kemi organizata që i janë bashkangjitur kësaj nisme dhe kjo paraqet një forcë të respektueshme që përfshinë organizatat e viktimave, organizatat për të drejtat e njeriut, organizatat e të rinjve, organizatat e femrave, kurse sa i përket paraqitjes në publik kjo vende-vende tashmë ka filluar Diku tjetër ajo po përgatitet dhe jam e mendimit se muajt e parë pas këtij Forumi janë shumë të rëndësishëm. Mua më vjen posaçërisht mirë që pikërisht Prishtina e kishte nderin të shënojë këtë kthesë. Koalicionin tonë, të cilin e kemi ndërtuar me durim dhe kujdes, duke i sqaruar qëllimet tona për disa vite, prej këtu po e shndërrojmë në Koalicion zyrtar me të cilin do të dalim para publikut dhe institucioneve të pushtetit.

Valdete Idrizi: Faleminderit! Shaban e pastaj Numan Baliq e pastaj Spasiq më vonë. Veç ju kisha lut të gjithëve edhe njëherë ato fjalë që mos ti përsërisë prapë, të jemi në fokus, ta respektojmë kohën

Shaban Terziu: Une nuk do ta tejkaloj 3 minutëshin

Valdete Idrizi: për të gjithë është jo veç për juve

Shaban Terziu: quhem Shaban Terziu, vij nga shoqata profesionale Lansdowne nga Gjilani. Unë e përsërisht këtë iniciativë të rrjetit regional për zbulimin e së vërtetës dhe organizata ime që i ka 2138 anëtarë e përkrahë këtë iniciativë e cila është shumë e nevojshme dhe e dobishme, pavarësisht siç tha Valdetja se ka disa zëra që është vonë, por më mirë vonë se kurrë se i ka gjërat pozitive. Pyetja ime është kështu, ku është , si të lindë një dëshirë, një shqiptare, kosovare si Natasha Kandiqi, e cila m të vërtetë me të vërtetë ka bë gjëra shumë të mëdha, shumë të guximshme, shumë trimëreshë, kjo ka punuar më herët me Nora Ahmetin, Valdete Idrizin e tani edhe me Nekibe Kelmendin, të cilat me të vërtetë kanë dhënë shumë, unë me vete po them ku të lind një Natashë, fatmirësisht nuk është likuiduar nga vetë pushtetarët, nga vetë kombi i vet, unë kam një respekt ndaj saj se rasti i Paraqinit kur është vra Aziz Kelmendi. Riza Gjaklin unë e kam burrë të ..., e kam nip

Valdete Idrizi: veq ju kisha lut të jeni të fokusuar, ju lutem!

Shaban Terziu: vetëm desha një falënderim, Riza Gjaklin kjo ka ndikuar e kanë lëshuar prej burgut, rasti i Paraqinit dhe ka qenë i dënuar 20 vjet e 14.5 vjet i ka mbajt në Pozharevc, na e kemi pas po dua edhe një pyetje me ia bë, siç dialogun kjo me kishën serbe, ne kemi probleme me kishën , ne e kemi pas një projekt toleranca ndëretnike dhe ndërftare, në mënyrë individuale shumë priftë të kishave kemi kontaktuar, jo të qëllimit të mirë po a atë hierarkinë e vet nuk guxojnë me shku përtej pragut për dialogim në Kosovë, është një thënie kriminale e kurrë mos e harro, por duhet me falë për me shku përpara.

Valdete Idrizi: Faleminderit shumë!

Shaban Terzi: S'pe zgjati më shumë.

Valdete Idrizi: Faleminderit! Zonja Natasha do të përgjigjet pastaj zoti Baliq

Natasha Kandiq: Kemi arritur në përfundim se gjatë procesit të konsultimeve duhet të përfshihen edhe bashkësitë fetare, por ende nuk e kemi përgjigjen e saktë se kur dhe në çfarë mënyre ta realizojmë këtë. Duke ditur se ekzistojnë shumë probleme në marrëdhëniet mes religjioneve të ndryshme, unë propozoj që kjo të diskutohet gjatë konsultimeve dhe secili që ka ndonjë propozim të mirë në lidhje me këtë të lajmërohet. Ne si shoqëri civile, do të thotë si organizata dhe shoqata, duhet të jemi plotësisht të sigurt dhe duhet të kemi një pasqyrë të qartë për mënyrën se si do t'i udhëheqim konsultimet dhe me cilat grupe. Akoma nuk i kemi përfshirë grupet e femrave, nuk i kemi përfshirë femrat liderë, nuk kemi inkuadruar..., në Zagreb, në nëntor të këtij viti do të mbahet takimi i historianëve, sociologëve, psikologëve. Kjo do të jetë hera e parë që njerëzit e profesioneve të caktuara do të takohen dhe do të bisedojnë për këtë problem. Vitin e kaluar kemi mbajtur konsultime me artistët dhe shkrimtarët, dhe kjo shkoi shumë mirë. Në konsultime kishte pjesëmarrës nga të gjitha shtetet e ish Jugosllavisë; këto forume shërbejnë që ne të përpiqemi të bëjmë një orar, plan, se çka do të bëjmë dhe kur ta bëjmë atë dhe të shohim se cilat do mund të jenë detyrat e secilit në këtë organizatë.

Valdete Idrizi: Faleminderit! Fjalën e keni ju zoti Baliq

NUMAN BALIQ: Numan Baliq: Ju faleminderit zonja Idrizi! Falënderoj edhe të tjerët, përsëritet të gjithëve. Si njeri që jam marrë për shumë vite me këtë problem, më lejoni të them vetëm disa fjalë. Pak kohë pas përfundimit të luftës isha në situatë.... për këtë do të flas edhe në diskutimin tim të pasdites, ku do të inkuadrohem drejtpërdrejt në shumë çështje që kanë të bëjnë me vrasjet, dhunën, përndjekjet e të gjitha bashkësive. Më tepër jam i interesuar për komunitetin boshnjak. Mendoj se një prej konkluzioneve, i cili është i rëndësishëm për të gjithë ne, e të cilin do të mund t'ia propozonim këtij Komisioni, do të ishte si më poshtë: së pari duhet ta përkrahim pa mëdyshje këtë iniciativë të guximshme dhe punën e madhe që po bëhet nga zonjat Kandiç, Idrizi, Berisha, zotëri Kulagliqi dhe gjithë të tjerët nga republikat tjera të ish Jugosllavisë dhe natyrisht se duhet t'i mbështesim ata në përpjekjet që po bëjnë, në mënyrë që ky aktivitet të jap rezultate konkrete. Me fjale të tjera, duhet t'i kemi informacionet se çka dhe si ka ndodhur dhe duhet të anojmë nga një e vërtetë. Dëgjova këtu njerëz që thanë se "gjithkush e ka të vërtetën e vet". Është e vërtetë se gjithkush e ka të vërtetën e vet, por ka vetëm një të vërtetë, vetëm një të vërtetë e cila duhet të jetë e plotë. Pastaj u fol se ka mendime të ndryshme për drejtësinë dhe fajin. Por, gjithashtu, ka vetëm një drejtësi. Prandaj, unë mendoj se porosia për të gjithë ne është se duhet të jemi të bashkuar, ta përkrahim këtë iniciativë, që kjo Konferencë, që ky komitet të kërkojë rezultate dhe që gjithsesi të përfundojë me thirrjen drejtuar pushtetit të kaluar dhe të tanishëm. Pushtet-mbajtësit e kanë çelësin e zgjidhjes së problemit. Së pari pushtetit në Beograd, por edhe ai në Prishtinë. Të mos i u bëjmë thirrje vetëm serbëve në Beograd dhe qeverisë në Beograd. T'u bëjmë thirrje edhe tanëve, që janë shqiptarët, boshnjakët dhe të tjerët që jetojnë këtu. Dihet se në Bosnjë kanë vdekur mes 120.000 dhe 150.000 boshnjakë dhe nuk ka pësuar vetëm Srebrenica, siç janë disa tendenca që kjo të paraqitet vetëm si tragjedi e Srebrenicës, por kanë pësuar edhe Zvorniku, Foça, Trebinja, e kështu me radhë, shumë vende. Sot, gjysma e Bosnjës është, të them ashtu, e spastruar etnikisht, por edhe në gjysmën tjetër të Bosnjës është ndryshuar struktura etnike. Nuk ka më serbë në Sarajevë dhe ky është fakt, nuk ka serbë edhe në shumë vende tjera. Ndryshimi i baraspeshës etnike ka ndodhur edhe te ne, prandaj në 90 për qind të Kosovës jetojmë vetëm ne, kurse në 15 për qindëshin tjetër të Kosovës jetojnë vetëm ata të tjerët. Duhet të gjejmë përgjigje në një pyetje historike dhe pyetja që kam unë është se sa mund të ndikojë Komisioni, që para së gjithash me punën e vet, të sjellë një mesazh të vendosur dhe të guximshëm, që përpos fakteve që kemi, duhet dërguar thirrje autoriteteve në Beograd, autoriteteve të organizatave ndërkombëtare. Evropa dhe Amerika në masë të madhe janë sponsor të gjithë kësaj që ka ndodhur, në këtë e dimë fare mirë, prandaj ato kanë përgjegjësi shumë të madhe në gjithë këtë. Duhet të përcaktohet përgjegjësia. Drejtësia mund të jetë ndjenjë subjektive, por njeriu dhe populli i thjeshtë e dinë se drejtësia e vetme është ajo që bënë me gisht se fajtor është Numan Baliqi sepse e ka vrarë filan fistekun, fajtor është ky dhe ai sepse kanë vrarë këtë dhe atë. Pra, Tribunali Ndërkombëtar në Hagë nuk duhet të vazhdojë të jetë vend i cirkusit, por vendi ku do të vendoset përfundimisht për fajtorët për mijëra të vrarë. Më së shumti kishte serbë, por kishte edhe boshnjakë, kishte edhe shqiptar dhe ky duhet të jetë mesazhi i qartë i të gjithëve. Kjo është mënyra e vetme që të tejkalohen këto probleme. Unë mendoj se ne të gjithë duhet ta përkrahim këtë Komision,

unë për këtë do të flas edhe pasdite. Uroj që nëse do Zoti, ky Komision të jetë fillimi që do t'u dërgojë mesazh të qartë dhe autoritetet... Të mos harroj, këta njerëz që kanë ardhur këtu, këta janë baballarët, vëllezërit, motrat e atyre që janë vrarë apo zhdukur. Atyre para së gjithash u intereson çka ka ndodhur me personat e zhdukur. Ne duhet të japim përgjigje në pyetjen se çka ka ndodhur me të zhdukurit, shumë shqiptarë, serbë, boshnjakë dhe shumë të tjerë. Unë e di se janë vrarë 100 boshnjakë, e di se ata njerëz kishin emra dhe mbiemra dhe ne i dimë kush janë vrasësit. Pse autoritet në Kosovë nuk i dënojnë ata njerëz që vranë 100 boshnjakë, pse autoritetet e Beogradit nuk dënojnë ata që kanë vrarë 8.000 ose 10.000 shqiptarë, nuk e di sa kanë qenë, nuk po hyj në këtë. Nuk mund të jemi të qetë derisa nuk dënohen kriminelët. Natyrisht se do të ketë pajtim dhe paqe. Në fund të mos e harrojmë këtë, po përfundoj. Populli kurrë nuk ka qenë problem. Populli gjithmonë ka jetuar në paqe dhe njerëzit gjithmonë mund... dhe tregimet që qarkullojnë në Perëndim se në Ballkan jetojnë disa fise të armiqësuar, janë rrena. Ne kemi jetuar së bashku për 40 vite dhe e dimë si kemi jetuar. Pra, autoritetet në Beograd dhe, natyrisht, ato në Prishtinë, në Sarajevë, në Bruksel, në Nju Jork, në qendrat e vendimmarrjes që vendosin për fatet tona...ju lutem, le t'u dërgoj Komiteti një thirrje të fuqishme, le t'i gjejnë vrasësit, le t'i dënojnë, ne do të qetësohemi. Ju faleminderit.

Valdete Idrizi: Faleminderit Baliq, fjalën e radhës e ka, i km në listë domethënë edhe pesë persona, veç ju kisha lut me qenë të shkurtë dhe konkretë, dhe ju kisha lut t'i përmbaheni temës.

SIMO SPASIQ: Mirdita të gjithëve, për atë që nuk e dinë, unë jam Simo Spasiq, meqenëse kjo është dërguar personalisht në adresën e familjes time, mua më duhet që para të gjithë juve, para Zotit dhe para Allahut, para të gjithëve, duke e mbajtur dorën në zemër, se këtë që do t'ua them tani është e vërteta dhe vetëm e vërteta. Nuk ka asgjë më të ndershme sesa kur Simo Simiq iu drejtohet familjeve të viktimave shqiptare, boshnjake, kroate, serbe, rome dhe të tjerëve. Unë jam kryetar i Shoqatës së familjeve të të kidnapuarve dhe të vrarëve në Kosovë dhe Metohi, përpos serbëve dhe malazezëve, unë kam në evidencë edhe një numër të madh të romëve, goranëve, myslimanëve, boshnjakëve, ashkalinjëve dhe 24 familjeve shqiptare. Ky nuk është sulmi i parë ndaj familjes time, e din Natasha Kandiq, dy vite më parë ajo kishte organizuar konferencë në po këtë hotel, kur një shqiptar, që me sa më kujtohet mua e kishte mbiemrin Pllana, kishte një kasetë, kinse në atë kasetë babai im... kinse ai kishte vrarë 26 shqiptarë. Për fat të keq edhe sot e kësaj dite nuk e di çka ka në atë kasetë, prandaj edhe shfrytëzoj rastin, që përmes Natasha Kandiqit të marr vesh se çka ka në atë kasetë dhe nëse është e vërtetë që babai im ka vrarë dikënd, sidomos ndonjë shqiptar...unë e di që ai nuk ka lëvizur që nga viti 1998, kur i është kidnapuar djali, më 14 maj të vitit 1998, se shumë serbë janë distancuar dhe na kanë urrejtur sepse kemi jetuar mirë me shqiptarët. Megjithatë babai im ka thënë, e kam thënë edhe unë, kam thënë se kur neve na digjet kashta, nëse presim që derisa dikush prej serbëve të vie nga Çaçaku dhe Uzhica neve do të na digjet edhe ahri dhe kashta, prandaj fqinji im shqiptar vlenë. Nuk është me rëndësi, e them me përgjegjësi, jam i thirrur nga dikush që përmendi njëfarë Garde të Car Lazarit... Zoti është dëshmitar: që nga 14 maji i vitit 1998, kurrë në jetë askujt nuk i kam bërë keq, aq më pak shqiptarëve. Përkundrazi, unë i kam mbrojtur shumë prej tyre. E dinë këtë Karsniqët, Zhilivodët që janë në Obiliq, u kam thënë mos u shpërngulni, mosni, do të bëni keq nëse

largoheni nga vatrat tuaja. Zoti është dëshmitar. Madje edhe kur hypën në atë trenin për Maqedoni, Shqipëri, në shitoren e një Gorani në Obiliq mora 10 bukë, dy, tre qese qumësht dhe ia dhashë Krasniqit, Zhilivodës që ka një çajtoje në Obiliq. Spasiqin nuk do ta harroj për një milion vjet. Prej vitit 1998 e më pas, nuk kam qenë asnjëherë pjesëtar i asnjë njësie ushtarake, paraushtarake apo policore. Sa i përket Gardës së Car Lazarit...babai im ka vdekur pasi ka shikuar kasetat ku pjesëtarët e të ashtuquajturës UÇK në Lapushnik e marrin në pyetje dhe e torturojnë vëllain e tij. Nuk kam mundur ta varros në Sibovc sepse varreza është rrafshuar, shtëpitë na janë djegur, kurse janë rrënuar që në vitin 1998. Nëna ime jeton në Obiliq, kurse vajza nga martesë e parë në kontejnerët ku janë telat me gjemba. Po të kisha bërë diçka, kurrë për jetë nuk do të kisha ardhur në këtë vend, e sidomos jo para familjeve të shqiptarëve të vrarë. Sa i përket kësaj Garde, unë e kam varrosur babanë në Krushevc, nuk shkova atje si kryetar i Shoqatës, shkova si Simo Spasiq, i mora dy fëmijët, shkova te varri, ndeza qirinj, shkova në kishë, isha në kishën e Lazarit, e jo të car Lazarit...te dera e kishës në atë moment ndodheshin disa njerëz që paraqiteshin si njëfarë garde...po mbanin mbledhje. Unë qëllova aty. Interesant, të gjitha mediat ishin përreth meje, prandaj edhe jam vërejtur në atë vend. Si kryetar i Shoqatës, sapo dëgjova qëllimet e tyre, që të mos lënë asnjë shqiptar gjallë nëse shpallet pavarësia, që thanë se do t'i vrasin të gjithë të gjallët, gratë dhe fëmijët, menjëherë e mora fjalën si përfaqësues i Shoqatës dhe kërkova që kjo organizatë të ndalohet dhe udhëheqësit e saj të dënohen me burg. Na kanë përkrahur dhjetë organizata joqeveritare, duke përfshirë edhe Fondin për të Drejtën Humanitare nga Vojvodina, sikurse edhe Biljana dhe Sonja Biserko, si dhe të gjitha organizatat për të drejtat e njeriut. Prandaj, ju lutem, shqiptarë, fqinjë, mos më përzini mua dhe familjen time se i kemi bërë keq dikujt. Edhe zotëriu e di, e din edhe Muniri, e din edhe Shubashiqi... unë kërkoi falje, jam serbi i parë nga Shoqata që ka shkuar në Potoçar të Srebrenicës. Shumë serbë, të ashtuquajtur patriotë në Beograd dhe në Serbi e kanë kritikuar vendimin tim, thonë se ti ke shkuar te turqit. Jo te turqit, isha te familjet e viktimave, do të thotë i kam dëgjuar viktimat e tyre, por na kanë mundësuar të flasim edhe për viktimat serbe, sepse po të mos kishim shkuar ne dhe po të mos vinim këtu, e shumë serbë nuk kanë dashur që ne të vijmë, atëherë në këtë konferencë do të dëgjoheshin vetëm viktimat shqiptare. Ne vijmë këtu në emër të viktimave për të treguar se edhe serbët ishin ata që pësuan në hapësirat e Kosovës dhe Metohisë. Po flas me përgjegjësi, u drejtohet shqiptarëve që kanë humbur më të dashurit e tyre, pasha kryqin, pasha kishën, kurrë në jetë nuk i kam bërë keq asnjë shqiptari. Ata serbë që kanë bashkëjetuar mirë me shqiptarët kanë pësuar tragjedi më të madhe sesa ata që kanë kryer krime. Ai që ka kryer krim nuk do të vinte kurrë këtu para jush. Prandaj unë ju lus, mos bëni mëkat të madh, më vjen shumë keq për viktimat tuaja, por pres që edhe dikush nga ju të thotë: "na vjen keq për viktimat tuaja". Faleminderit shumë.

Valdete Idrizi: Fjalën e ka Ana Kresiq.

ANA KVESIĆ: Unë jam sot e lumtur që dëgjova këto fjalë të rëndësishme nga Amiri, të cilat do të jenë motiv shtesë për mua që të veprojnë mënyrë më të fuqishme në bashkësinë time lokale, por do të doja që edhe bashkëkombësit e mi nga bashkësia ime lokale ta kuptojnë rëndësinë e këtij mesazhi se ne jemi misionarë të së mirës dhe humanitetit. Më vjen shumë mirë që kolegja nga Mali i Zi sapo ka plotësuar këtë që po

them unë dhe u shpreh se viktimat janë me rëndësi për njëri tjetrin. Unë në Vukovar takoj viktima si të nacionalitetit kroat ashtu edhe atij serb, ata nuk dëgjohej mes vete, nuk duan të takohen. Nëse ndodh të takohen, ata nuk njihen. Madje edhe ky kontakt këtu nuk po ndihmon në këtë drejtim, po pyes kolegen nga Berka si ndihet...nuk ekziston ai kontakt i duhur. Mendoj se duhet të ndryshojmë sepse ky projekt dialogues paraqet versionin anglez, për ne është me rëndësi të bashkë-ndejmë për njëri tjetrin. Do ta forcojmë këtë projekt nëse e tejkalojmë këtë dhembje; të mos ndejmë dhembje vetëm për viktimën tonë por dhembje të përgjithshme, për të gjitha viktimat. Dhe më vjen shumë mirë që po dëgjoj të thuhet se duhet të vihemi në shërbim të së vërtetës. Kjo është me rëndësi dhe unë ju falënderoj që e keni shkurtuar gjithë këtë projekt vetëm në disa mesazhe të vërteta. E shoh se problemin më të madh e kemi me heshtjen dhe mohimin, por edhe paragjykimet dhe iluzionet janë pengesa të mëdha. Unë ju falënderoj shumë që më keni rikujtuar këto dhe nuk dua ta zgjas më shumë. Ju falënderoj shumë dhe shpresoj se bashkëkombësit e mi, vukovarasit si dhe të gjithë të tjerët, nga të gjitha republikat tjera, do të dimë t'i kuptojmë këto dhembje dhe nevojat për dhembshuri dhe të vazhdojmë drejt qëllimit tonë: drejtësisë dhe të vërtetës, që janë krejt ato që neve na duhen. Ju faleminderit shumë.

Valdete Idrizi: Faleminderit! Kërkoj falje pikësëpari prej të gjithë atyre që janë lajmëruar por s'do të mund të ua jap fjalën ngase duhet ta respektojmë sepse zonja na ka ardhë nga Argjentina zonja Rosa Graciela Kostanjola De Fernandez Mehide mezi ia thashë emrin dhe besoj që duhet ta shfrytëzojmë prezencën e saj dhe të marrim sa më shumë prej saj edhe nëse është e mundshme këto duartrokitje të kursejmë sa më shumë në kohë, s'kemi duartrokitje domethënë që sa më shpejtë të kalojmë prej folësit tek folësi tjetër, kështu që unë pikësëpari do t'i falënderoj panelistët, të cilët kanë qenë shumë të mirë në prezantimin e punëve të tyre e do të ju falënderoja edhe të gjithë juve për durimin që keni patur edhe për mirëkuptimin, edhe të gjitha këto pakënaqësi që shprehen këtu, edhe këto pyetje janë besoj të natyrshme sepse shumë prej juve ndoshta nuk keni pas hapësirë që ti shtroni çështjet në këtë përbërje kaq të kombinuar, kështu që edhe njëherë ju kërkoj falje që ju ndërpreva fjalën juve që deshtët të flisni, unë do ta përfundoj këtë sesion dhe do të vazhdojmë pa pauzë fare, do ta ftojme zonjën Rosa Graciela, kështu që ju të tjerët domethënë, ndoshta patët dëshirë që të shtroni pyetje ose komente, do të keni sesionin e pasdites, e pasdrekes ku do të jenë nevojat e viktimave, mos i harroni pyetjet dhe mundemi me vazhdu në atë sesion, ju faleminderit shumë edhe njëherë për durimin, me të mira!

MUNGON SESIONI :PERVOJAT E TE TJEREVE

Nevojat e viktimave dhe shoqërisë në Kosovë

Nora Ahmetaj: Mirëdita dhe mirë se keni ardh, besoj që së shpejti të gjithë do të jeni prezent dhe ju që jeni në holl jashtë dhe ju që jeni brenda, më lejoni që ta bëj hapjen ea mundemi me ju sugjeroj që të gjithë ti keni dëgjueset për shkak të përkthimit Më lejoni ta bëj hapjen e panelit të quajtur nevojat e viktimave dhe të shoqërisë, më lejoni që ta falënderoj zotin zëvendës kryeministër z. Ramë Manaj për prezencën këtu, zotërit deputet, të cilët kanë gjetur kohën me ardh këtu, përfaqësuesit e organizatave dhe institucioneve të shoqërisë civile dhe të gjithë ju pjesëmarrësit tjerë, unë jam Nora Ahmetaj, jam anëtare e Këshillit Drejtues të Fondit për të Drejtën Humanitare, meqenëse kemi përfaqësues të organeve shtetërore dhe të shoqërisë civile ndoshta është shumë mirë që të shohim se cilat janë mendimet dhe pikëpamjet apo qëndrimet e këtyre institucioneve në lidhje me një iniciativë të mundshme për, iniciativë rajonale për të vërtetën dhe ballafaqimin, unë ia jap fjalën panelistit të parë z. Ramë Manaj që ti shpreh mendimet e veta në emër të qeverisë së Kosovës, z. Manaj urdhëroni

Ramë Manaj: Ju faleminderit! Mirëdita të gjithëve, të nderuar pjesëmarrës të këtij forumi të katërt rajonal, jam vërtetë i nderuar që në emër të qeverisë së Kosovës, fillimisht duke ju përshëndetur të gjithëve të ju uroj për punime të suksesshme të forumit dhe të shpreh falënderimet për gjithë aktivitetin tuaj dhe për organizimin edhe të punimeve të sotme në këtë temë sa të ndjeshme po kaq edhe të rëndësishme dhe të nevojshme që vazhdon të mbetet si temë brengë jo vetëm e shoqërisë kosovare por edhe e gjithë rajonit madje edhe për një kohë të gjatë. Koordinimi i përpjekjeve dhe të përkushtimit të më shumë faktorëve institucional e të shoqërisë civile në përmasa edhe rajonale është një demonstrim i fuqishëm i vullnetit dhe i ndërgjegjes për faktimin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, të cilat në të kaluarën jo të largët në rajonin tonë kishin eskaluar deri në shkallë të krimeve madje të krimeve të rënda. Lufta nuk është një raport i njeriut me njeriun por një raport në mes të shteteve në të cilin individët vetëm aksidentalisht bëhen armiq thoshte Ruso. Por ata, individët pra, janë ata që pësojnë dhe pësojnë rëndë, kurse pasojat e tyre mbeten në shtrirje për një kohë të gjatë. Kosovën për shkaqe të diskriminimit, dhunës, terrorit të ushtruar, mbarimi i luftës e gjeti me pasoja tepër të rënda. Krimet e rënda si masakrat, vrasjet, plagosjet, varrezat masive, persekutimet, djegiet madje në shkallë karbonizimesh, torturat, burgosjet, zhdukjet, dhunimet e të tjera lanë gjurmë, pasoja e trauma e gjendje të rënda psikologjike dhe psiko-sociale. **Ndër pasojat më të rënda që pasojnë ta preokupojnë shoqërinë kosovare gjithë këto vite të pasluftës edhe sot siç u theksua tanimë disa herë është moszbulimi i fatit të të kidnapuarve, ende të pagjetur mbase edhe të zhdukur dhe padrejtësia më e madhe është ajo që vazhdon, është ajo që nuk ka fund sikur që është dhembja e pafundme se sa fundi i dhembshëm natyrisht. Megjithatë, kapitulli i dhembjes së gjatë do të duhej të mbyllej, sa më shpejtë aq më mirë. Unë mendoj se do të duhej së paku zyrtarisht të dihej se nuk do të dihet kurrë për atë numër, i cili ka mbetur ende i paidentifikuar, ende të pagjetur, mirëpo kjo do të ishte ajo që më së paku dëshirojnë familjarët, Kosova, qytetarët e saj por edhe institucionet e saj. Del prandaj kërkesë imediate e nevojë kryesore, që shteti serb tek i cili adresohet zbulimi i fatit të rreth 2000 personave të demonstroj vullnetin e mirë dhe të jep informacione dhe të ndriçojë errësirën pllakosëse e të mundimshme, këtë duhet ta bëjë nëse dëshiron të dëshmoj qasjen për marrëdhënie të**

mira ndër fqinjësore në mes dy vendeve tona dhe popujve tanë, nëse dëshiron stabilitetin e përgjithshëm të rajonit dhe orientimet integruese rajonale dhe euro-evropiane. Ne e thërrasim publikisht qeverinë serbe për hapa konkretë dhe përfundimtar për mbylljen e kësaj kaptine tragjike të luftës e për të iu kthyer të ardhmes dhe ndërtimit të marrëdhënieve ndër fqinjësore sepse padyshim është në interesin e dyanshëm. Megjithatë do të nxjerrja një mendim, duket se problemet e natyrës politike është vështirë të zgjidhen me qasje humanitare, megjithatë përpjekjet që duhet të bëjnë institucionet, shoqëria civile, organizma të ndryshme janë të rëndësishme, mbesin të rëndësishme jo vetëm deri më tani por edhe në të ardhmen, që me punën e tyre pandërprerë, me përkushtimet e tyre të pandërprera të qojnë më tutje përpjekjet për një përkushtim më serioz, të rëndësishëm, humanitar por edhe politik gjithsesi. Përndryshe fshehja apo heshtja e krimit është ushqim i krimit gjë që fatkeqësisht edhe më tutje reflekton negativisht. Shumë kallëzime penale, akuza e padi kundër shumë kryerësve juridikisht do të thoja të supozuar të krimeve të luftës që para sa vitesh janë depozituar në organet përkatëse të drejtësisë, kanë mbetur të mbyllura nëpër sirtare. Ne besojmë se me fillimin e punës së EULEX-it këto raste do të fillojnë të procedohen dhe të dalin në dritën e drejtësisë. **Dënimi i krimeve nga shoqëria dhe identifikimi e dënimi kriminelëve të luftës është pra së gjithash obligim ligjor por edhe moral natyrisht dhe në të njëjtën kohë edhe satisfaksion për viktimat, familjarët e tyre dhe shoqërinë si tërësi. Për viktimat përcaktimi i fakteve përkatësisht të vërteta, procedimi i përgjegjësve drejtpërdrejtë për krime lufte janë jo vetëm satisfaksion por edhe forcim i ndjenjës për jetë por edhe i ndjenjës për drejtësi dhe rehabilitim në shoqëri.** Megjithatë, padyshim ende ka mbetur shumë për tu bërë drejtë synimeve të mësipërme. A është manifestuar mjaftueshëm një kooperim dhe bashkëpunim i faktorëve të domosdoshëm deri tani i vullnetit të mirë të faktorëve relevant, përkushtimi dhe mbështetjes së mekanizmave veprues në kuptim organizativ të veprimit financiar në objektivat e ndërthurura që aq kuptueshëm ngërthen tematikën shqyrtuese, analitike të këtij forumi të sotëm, është pyetje që unë mendoj që do përgjigje të matur. Qeveria e Kosovës dhe institucionet tjera demokratike të vendit me shumë seriozitet kanë demonstruar gatishmërinë dhe përkushtimet e tyre për tretman institucional të viktimave përfshirë aspektet shëndetësore, arsimore, psikologjike, sociologjike dhe humane në funksion të arritjes së të shkallës më të lartë të rehabilitimit të tyre sa më të plotë. Ka ekzistuar dhe vazhdon të funksionojë një bashkëpunim i institucioneve tona nga fusha që mbi bazën e eksperiencave të vendeve tjera nga këto fusha që mbi bazën e eksperiencave të vendeve tjera, arritjeve shkencore dhe profesionale, mbi bazën e mbështetjes së mundshme financiare programore e vepruese, rehabilitimi të bëhet i mundshëm, i arritshëm dhe i realizueshëm. Por koncepti dhe procesi i rehabilitimit padyshim kërkon një përkushtim më afatgjatë çka domosdoshmërisht do ti krijojmë të gjitha mundësitë dhe në këtë kontekst identifikimi dhe përkufizimi i saktë, i plotë, i qartë dhe shumëdimensional i rehabilitimi qoftë edhe në faza të zhvillimit të shoqërisë jo vetëm në Kosovë por edhe në gjithë rajonin është kusht i domosdoshëm i orientimit të duhur të veprimeve të organizuara më tej. Organizimi i këtillë i shqyrtimit të nevojave të viktimave dhe të shoqërisë domosdoshmërisht parashtron objektiva të mëtejme edhe institucionale me qëllim të një trajtimi më të plotë dhe më adekuat. Panorama e nevojave të viktimave, si perceptohen ato nga përmasat dhe shkaqet, cilat janë faktorët që ndikojnë në procesin e rehabilitimit, përmbushjes së kërkesave dhe nevojave të viktimave mbeten përkushtim i vazhdueshëm i gjithë institucioneve të vendit. Institucionet vendore dhe ato

ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë që nga pas lufta e këndeje, organizata joqeveritare vendore dhe të huaja kanë ndërtuar kapacitete dhe vazhdojnë të punojnë me qëllim të trajtimit të nevojave të viktimave të luftës e ato janë të shumta dhe të shumëfishta nga të gjitha aspektet tashmë të përmendura. Rehabilitimi i viktimave përfshirë këtu ndihmën mjekësore, vlerësimin dhe mbështetjen psikologjike, individuale, grupe dhe familjare e cila përballet edhe me pasoja edhe traumatike në humbjen ose zvogëlimin e aftësisë vepruese e kontribut dhënëse në familje e shoqëri me alternim psiko-social apo në tejkalimin e pozitës së viktimës deri në mbështetje të sistemit familjar për përpjekje në ngritje profesionale dhe në punësim, riintegrim e risocializim në shoqëri të viktimave dhe familjarëve të tyre, imponojnë gjithsesi synime dhe kontinuitet të institucioneve të vendit, të Kosovës dhe shoqërisë në përgjithësi padyshim edhe të vendeve të rajonit. Ndonëse eliminimi i shkaqeve që shkaktojnë vdekjen, maltretimin dhunën e persekutimin ndonjëherë ose është tepër i vështirë ose edhe i pamundshëm, eliminimi i pasojave të këtyre fenomeneve vije e bëhet domosdoshmëri pavarësisht nga çmimi, madje ky çmim nuk duhet të vihet para asnjë lloj pikëpyetjeje, para asnjë lloj dileme. Lufta është një ndër shkaqet e vdekjes dhe shumë pasojave tjera por gjeneratat e kanë e kanë obligim që duke zbardhur gjithë dimensionet dhe pasojat e saj të reflektojnë koshiencën kolektive se paqja është shpëtimi dhe synimi i njerëzimit. Të nderuar pjesëmarrës dëshiroj ti inkurajoj organizatorët e këtij forumi për të vazhduar me konsultimet rajonale mbi iniciativat, bashkëpunimin dhe aranzhmanet dhe perspektivat për plotësimin e të vërtetës. Për më tepër pjesëmarrës të nderuar kujtoj që **qasja rajonale në përcaktimin e argumenteve dhe përgjegjësi është e domosdoshme dhe kjo argumenton nevojën për forcimin e bashkëpunimit rajonal në të gjitha sferat e në veçanti lidhur me gjykimet për krimet e luftës në njërin anë si dhe për rehabilitimin sa më efikas të të gjitha viktimave në anën tjetër. Të mos e harrojmë të kaluarën jo për hakmarrje, jo për revansh dhe jo për armiqësi por për të mos e lejuar kthimin e saj dhe për të krijuar një botë më të mirë në paqe, mirëqenie e prosperitet njerëzor.** Përkushtimi për ti zvogëluar, përkufizuar dhe eliminuar dëmet dhe pasojat e dëmeve të shaktuara nga luftërat mund të thuhet se është përkushtim, të mbrohet thelbi i të drejtave të njeriut dhe që të sigurohet dhe garantohet ardhmëria në paqë për të gjithë. Të nderuar të pranishëm, duke përfunduar theksoj se vazhdimësia e këtij përkushtimi përmes bashkëpunimit të pandërprerë të të gjithë faktorëve të hapësirës sonë mbetet jo vetëm përgjegjësi e përbashkët por edhe kontribut i përbashkët. Me këtë preokupim madhor si dhe vlerë e dëshmi e dominimit të njerëzores mbi absurdin, drejtësisë mbi padrejtësinë, miqësisë mbi armiqësinë dhe njëherë ju faleminderit dhe ju uroj suksese të mëtejme.

Nora Ahmetaj: Faleminderit zoti Manaj! Para se të vazhdojmë me panelistët tjerë harrova me e tërheq vërejtjen edhe njëherë, e di se jeni lodh tuj e tërheq vërejtjen sot por për arsye se kemi me pas debat, i kemi diku dy deri dy orë e gjysmë ose dy orë e njëzet minuta kohë dhe për arsye se kemi shume panelistë, kemi dhjetë panelistë, nuk kemi mundësi me dhënë më shumë se pesë deri gjashtë minuta kohë për secilin panelist me fol, me dhënë mendimin e vet dh mandej do të kemi një orë ose një orë e diçka kohë për debat, pyetjet e juaja, komentet e juaja dhe zgjerimet e juaja. Edhe njëherë ti përmbahemi temës mirëpo tash i kisha lut panelistët që ti përmbahen këtij, këtij afati kohor prej pesë apo gjashtë minutave. Ndërkohë ia jap fjalën zotit Numan Baliq nga partia SDA dhe njëherit deputet i parlamentit të Kosovës, zoti Baliq urdhëroni:

Numan Baliq: Ju faleminderit zonja kryesuese! Kam kënaqësinë e veçantë që mund të flas para jush për këto probleme shumë të rëndësishme. Do të më lejoni që për gjërat që dua t'î them, dhe të cilat i konsideroj shumë të rëndësishme, të flas në gjuhën time. Tema është: Nevojat e viktimave dhe shoqërisë në Kosova dhe unë do t'î përmbahem asaj, nëse do Zoti. Pra, në një rën anë kemi viktimat, kurse në anën tjetër (apo në të njëjtën anë) kemi shoqërinë në Kosovë. Natyrisht se problemi apo qëllimi më i rëndësishëm është çështja e viktimave në Kosovë dhe duhet të merremi me të. Vlerësimi i përgjithshëm që mund të shprehet me një fjalë është se ne nuk i kemi përmbushur të drejtat e viktimave të dhunës në Kosovë. Viktimave të dhunës në Kosovë u është mohuar e drejta të dinë se kush janë vrasësit e më të dashurve të tyre, cila dorë e ka bërë atë. Me fjalë tjera, atyre u është mohuar drejtësia, e këto janë vendimet e drejta gjyqësore, që ata njerëz të dënohen ashtu siç e meritojnë. Do të them një gjë shumë të rëndësishme në lidhje me këtë problem, ajo ka të bëjë me problemin e të vërtetës dhe drejtësisë e cila është përmendur shumë herë këtu dhe për të cilën unë do t'î them disa qëndrime të mia nga ajo që kam thënë paradite. Njëri prej folësve, i cili mbase i ka fituar zemrat e disa prej pjesëmarrësve këtu me fjalimin e tij emocional, më irritoi paksa me qëndrimet e tij kur tha se secili ka të drejtë në të vërtetën e vet dhe se të gjithë kemi të drejtë të gjykojmë nëse diçka është e drejtë apo e padrejtë. Më duhet ta përsëris këtë. E thash edhe më parë, po e përsëris edhe tani. Mund të ketë njëqind të vërteta, mund të ketë njëqind vendime, por ka vetëm një të vërtetë të drejtë dhe vetëm një vendim apo gjykim të drejtë, e ky është ai i cili i dënon kryesit dhe paraqet satisfaksion për viktimat. Ne në Kosovë kemi shumë viktima, kemi me mijëra të vrarë, kemi mijëra të zhdukur, por gjithashtu kemi edhe qindra dhe mijëra njerëz ndaj të cilëve janë ushtruar forma të dhunës nga më të ndryshmet. Tortura, keqtrajtime, dhunime, përndjekje dhe kështu me radhë. Natyrisht, ekziston një kategori e posaçme e njerëzve, e këta janë të përndjekurit ose shpërngulurit. Shumë pak po flitet për këtë kategori. Më duhet të jem vetëkritik, janë pikërisht njerëzit tanë nga institucionet e Kosovës dhe Qeveria e Kosovës që flasin shumë pak për kthimin e të shpërngulurve. Kthimi është temë pothuajse e harruar. Natyrisht, bëhet fjalë për kthimin e vërtetë. Për kthimin e të shpërngulurve flitet vetëm kur ata janë të detyruar apo të shtrënguar nga zyrtarët ndërkombëtar, por shumë pak për këtë temë flitet në mënyrë të sinqertë dhe të drejtë. Duhet të ketë kthim të gjithë të shpërngulurve në pronat e tyre, është e drejtë e secilit që të kthehet në shtëpinë e tij, është e drejtë e secilit të gëzojë pronën e tij. Pikërisht për shkak të moszbatimit të këtij parimi sot e kemi gjendjen e ndarjes *de facto* në veri, mbi lumin Ibër, ku populli serb përbën shumicën e popullsisë apo e ka kontrollin, për dallim nga pjesa jugore ku pushtetin e mban shumica shqiptare. Ekziston edhe një kategori e njerëzve, ata të cilët janë përndjekur ose shpërngulur. Ky problem ekziston tani në këtë pjesë të botës, në masë më të madhe në Bosnjë, por edhe në Kosovë, ndonëse, për fat të mirë, në masë më të vogël. Këto paraqesin ndryshime të strukturës etnike ose spastrime etnike. Një problem i veçantë. Asnjë faktor politik në botë nuk ka ofruar përgjigje në këto pyetje, respektivisht nuk ka dhënë ide për mënyrën e sanimit të këtij problemi. Nuk ka dhënë përgjigje në pyetjen se si të kthehen të gjithë në vendet e tyre, që njerëzit të jetojnë atje ku kanë jetuar më parë dhe të mos ketë ndryshime të strukturës etnike, kufij të rinj etnik dhe enklava. Më duhet ta them edhe këtë se ne, shqiptarët, serbët, boshnjakët dhe të tjerët, kemi jetuar këtu me shekuj së bashku. Asnjëherë gjatë historisë nuk e kemi ditur se çka janë enklavat. Enklavat nuk janë krijesa të kohës tonë, të

epokës tonë, të këtyre njerëzve, këtyre... ata e dinë mirë kush i krijoi enklavat. Pra, ato nuk janë krijesa të kohës, e as të traditës, fesë apo moralit tonë. Këto janë probleme të importuara dhe ata që i studiojnë këto çështje le t'i gjejnë përgjigjet në këto pyetje dhe të tregojnë nga vijnë këto skema dhe le të përgatisin propozime për zgjidhjen e problemeve, ku e kanë burimin ato, e kështu me radhë, e kështu me radhë. Problemi tjetër për të cilin desha të flas këtu...është se unë flas prej përvojës së njeriut që ka qenë pjesëmarrës i drejtpërdrejt në këto ngjarje, respektivisht pjesëmarrës në zgjidhjen e tyre. Pas luftës, në vitin 1999, isha në situatë të ballafaqohem me vendet ku kishte dhunë. Isha në familjet ku njerëzit ishin vrarë. Familja e parë që e vizitova në korrik të vitit 1999, ishte familja e një ish polici të MPB-së, i nacionalitetit boshnjak, i cili shërbente në atë polici. Por, për fat të keq, kishin pësuar prindërit e tij pleq, babai dhe nëna, Murat dhe Xhemile Hasiq. Të dy mbi 80 vite. Pra, njerëzit që nuk kanë menduar me kokën e tyre, njerëzit të cilët lirisht mund t'i quajmë ekstremistë kryen krimin e vrasjes së këtyre pleqve dhe në vend se të pësoj njeriu që ishte përgjegjës për keqtrajtimin e shumë shqiptarëve, boshnjakëve dhe të tjerëve, pësojnë prindërit e tij dhe njerëzit tjerë. Kështu që viktimat të dhunës që pasoi më vonë, nga korriku deri në fund të atij viti, ishin në shumë raste njerëzit që nuk kishin asnjë përgjegjësi për krimet apo keqtrajtimet e kryera gjatë luftës. Ajo që është në veçanti e rëndësishme të thuhet, e që dua ta ritheksoj sepse jam mirë i njoftuar me shumë... kërkoj falje por...kjo që dua ta them është shumë me rëndësi. Pra, viktimat e dhunës që pasoi gjatë atyre gjashtë muajve, të paktën me aq sa di unë, janë vrarë rreth njëqind njerëz, besoni se ka raste kur po atë ditë apo pas disa ditësh njerëzit kanë marrë vesh se kush i ka kryer vrasjet. Aty ishin përfaqësuesit e pushtetit të përkohshëm në Kosovë, përfaqësuesit e UNMIK-ut dhe autoritetet e OSBE-së, bashkësia ndërkombëtare dhe KFOR-i. Njerëzit i kanë paraqitur rastet, kanë ofruar të dhëna, kryesit nuk janë dënuar asnjëherë, nuk janë gjetur, nuk janë arrestuar dhe nuk është përfunduar puna. Kjo është pyetje e madhe për ne. Pra nuk është çështja vetëm që në të diskutojmë, që të flasim për diçka, por është detyrë e kësaj tryeze, tryeze të rrumbullakët, pastaj e organizatave të këtij lloji, që ta ngrisin zërin fuqishëm dhe të kërkojnë nga autoritetet në Beograd përgjegjësit kryesor, njerëzit që kanë kryer krime, të përcaktohen ekspeditat që kanë kryer masakra dhe përndjekjen e qindra, respektivisht mijëra njerëzve, gjatë viteve 1998 dhe 1999, kur janë përndjekur më shumë se 800.000 njerëz, dhe flitet ndoshta për 8.000, 10.000 apo 11.000 të vrarë. Duhet ta dimë se sa njerëz janë vrarë, cilat janë duart që i kanë kryer vrasjet. Kjo është mënyra e vetme. Nuk mjafton që ne këtu tash të gjithë të pajtohemi dhe t'ia themi këngës, nuk mjafton vetëm të themi se neve nuk na duhet urrejtja, por na duhet dashuria. Ky popull do të jetojë edhe me edhe pa dashuri. E thash më parë në fjalën time hyrëse, po e them edhe tani. Me qindra vite njerëzit jetojnë njëri pranë tjetrit në këto hapësira dhe askush nuk i mësoi çka është bashkëjetesa. Kishte këtu mysliman, katolik, ortodoks dhe të tjerë. Kanë jetuar së bashku me qindra vite dhe askush nuk i ka mësuar se çka është bashkëjetesa, ata e dinë këtë vetë. Por kur bëhet fjalë për drejtësinë, drejtësi nuk do të ketë derisa nuk dënohen kriminelët, e nëse duam që kriminelët të dënohen, atëherë ata duhet t'i kërkojmë aty ku janë më të shumtë. Qeveria e kaluar, qeveria e tanishme dhe të gjithë të tjerët, edhe Tribunali i Hagës, sikurse edhe faktorët ndërkombëtar të cilët kanë përgjegjësi shumë, shumë të madhe, sepse ata janë në mesin e sponsorëve kryesorë të gjitha këtyre ngjarjeve që u zhvilluan këtu...tash po e përfundoj, vetëm edhe pak ju lutem. Kjo është me rëndësi. Kam gjithë ditën që pres për ta thënë këtë. Unë jam dëshmitar i këtyre ngjarjeve dhe kam qenë në oborret e njerëzve që janë vrarë dhe unë kam mbrojtur

me qindra njerëz, kurse ju këtë nuk e keni bërë. Dhe më duhet t'u them se nuk është njësoj nëse dikush qëndron në karrige dhe flet, dhe nëse pas dhjetë vitesh viziton këto njerëz, duke i përkrahur që ta fitojnë drejtësinë që e meritojnë...tash do ta përfundoj. Prandaj, askush nuk ka të drejtë për monopol mbi të vërtetën, por ju lutem, e vërteta është kjo. Shqiptarët e Kosovës nuk mund të thonë se fajtor janë vetëm serbët, se fajtor është vetëm Beogradi dhe askush tjetër. Nuk është e vërtetë. Beogradi ndoshta është fajtor 90 për qind, por 10 për qind apo 15 për qind, 20 për qind, faji është te ne. Sepse këtu tek ne, pas luftës së vitit 1999 janë vrarë 700 apo 1.000 njerëz, ndoshta edhe më tepër, nuk e di saktësisht sa. Edhe një po të jetë vrarë është keq. E di se janë vrarë rreth njëqind boshnjakë, e di se në 80 për qind të rasteve dihet se kush janë vrasësit. Ligji nuk vepron, ministritë nuk reagojnë, Qeveria nuk reagon, zotëriu që është zëvendës kryeministër, i cili është ulur pranë meje, përpos mesazheve që i ka dërguar është dashur të tregoj, më lejoni ta them, më duhet të flas si njeri, duhet të tregoj se cilët janë mekanizmat për dënimin e krimin. **Ne do t'i dënojmë krimet tona në Kosovë, serbët le t'i dënojnë krimet e tyre në Beograd, bashkësia ndërkombëtare duhet të na ndihmojë në këtë drejtim,** e jo të na mësojë se çka është bashkëjetesa. Ne e dimë çka është bashkëjetesa. Le të na ndihmojnë, ju lutem... po e përfundoj, nuk keni të drejtë të më ndërprisni. Kam vetëm edhe një fjali. Ju lutem. Prandaj, le të na ndihmojnë që të dënohen kriminelët dhe le të na ndihmojnë për atë që na ka mbledhur më së shumti këtu. Ku janë vrasësit, xhelatët e këtyre njerëzve që janë zhdukur dhe ku janë njerëzit e zhdukur. Nëse nuk mund t'i zgjidhim shumë çështje, nëse ende nuk mund ta zgjidhim statusin e Kosovës, kufijtë, doganat e kështu me radhë, e kështu me radhë, atëherë duhet ta zgjidhim problemin e personave të zhdukur. Unë shoh këtu se kanë ardhur shumë njerëz, edhe shqiptarë edhe serbë, por edhe të tjerë... dhe të cilëve u intereson fati i të zhdukurve të tyre. **Detyra jonë sot është, me këtë edhe po e përfundoj, që të dërgojmë një mesazh të fortë, e ky takim nuk do të ketë kurrfarë kuptimi nëse nuk dërgon një mesazh të fuqishëm, që të dënohen kryesit, të gjenden të zhdukurit, të vihet në vend drejtësia. Vetëm atëherë do të ketë edhe bashkëjetesë, edhe dashuri, edhe sevda dhe gjithçka tjetër.** Shumë faleminderit.

Nora Ahmetaj: Faleminderit shumë! Faleminderit! Ky edhe është qëllimi i këtij takimi zoti Baliq dhe të tjerët që ne të shohim sa ka gatishmëri jo vetëm nga organet shtetërore por edhe nga shoqëria civile që të fillojmë të iniciojmë një dialog dhe rajonal dhe të shohim se çka na thonë edhe panelistët tjerë, edhe njëherë më duhet patjetër me e cek që nuk do ta kenë luksin që të flasin nga dhjetë minuta s kemi shumë të interesuar këtu që do të dëshironi ti shprehni mendimet e veta , në ndërkohë do të ia jepja fjalën zotit Rafael Neigjel, i cili është Udhëheqës i Departamentit në marrëdhënie me komunitetin pranë ICO-s në Prishtinë.

Raphael Naegeli: Zonja kryesuese, zonja dhe zotërinjë. Në emër të Zyrës Civile Ndërkombëtare, dua t'i përgëzoj organizatorët e këtij takimi për këtë iniciativë të madhe. Fillimi si i tillë paraqet një sfidë logjistike – grumbullimi i 400 pjesëmarrësve nga gjithë rajoni i Evropës Juglindore. Posaçërisht më gëzon fakti që mbledhje e katërt po mbahet në Prishtinë. Ky dërgon një mesazh të fuqishëm. Kosova është e pjesë dhe e pandashme nga cilado strategji rajonale që ka të bëjë me të kaluarën në ish Jugosllavi. Ajo është qenësore për ecjen kah e ardhmja e gjithë rajonit dhe kjo e ardhme për të gjitha shtetet e

dala nga rrënojat e ish Jugosllavisë qëndron në Unionin Evropian. Zyra Civile Ndërkombëtare (ZCN) përcjellë me interesim të madh aktivitetet e koalicioneve rajonale dhe jam posaçërisht i gëzuar që Qeveria dhe Parlamenti i Kosovës janë të përfaqësuar gjerësisht në këtë takim. Këtë mëngjes këtu ishin Kryetari dhe Ministri e Drejtësisë, kurse sot këtu janë zëvendës kryeministri dhe disa anëtarë të Kuvendit. Kur Kosova shpalli pavarësinë, më 17 shkurt të këtij viti, është zotuar të zbatojë propozimet gjithëpërfshirëse për statusin, në formën siç është hartuar nën udhëheqjen e Kryetarit Marti Ahtisari. Ai parashih maturi gjatë hulumtimit të së kaluarës, që nënkupton përfshirjen e një vargu të gjerë të iniciativave që kanë të bëjnë me drejtësinë tranzicionale. Për më shumë, propozimi për statusin parashih që Kosova dhe Republika e Serbisë të ndër marrin të gjitha masat për sigurimin dhe vërtetimin e informatave në lidhje me identitetin, vendndodhjen dhe fatin e personave të zhdukur. Kosova do të bashkëpunojë plotësisht me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq për realizimin e këtyre qëllimeve dhe do të vazhdojë që në mënyrë konstruktive, efikase dhe pa vonesa të marrë pjesë në grupet për persona të zhdukur. ZCN përkrah pjesëmarrjen e qeverisë së Kosovës në këtë grup punues, mbledhja e ardhshme e së cilës është paraparë më 7 nëntor. Përfaqësuesi Civil Ndërkombëtar, Pieter Faith e ka potencuar këtë me rastin e ditës ndërkombëtare të personave të zhdukur, më 30 gusht, kur u takua me përfaqësuesit e Këshillit Koordinues të Shoqatave të Familjeve të Personave të Zhdukur në Kosovë. Krimeve të luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut duhet kundërvënë në mënyrë të gjithanshme, pa marrë parasysh se kur dhe ku kanë ndodhur dhe kush i ka kryer ato. ZCN-ja përkrah institucionet kosovare në hapat që i kanë ndër marrë në lidhje me këtë çështje. Pranimi i të kaluarës vetanake nganjëherë është i dhembshëm, por njëkohësisht edhe hap vendimtar. Ky është hap drejt pajtimit dhe ardhmërisë së qëndrueshme paqësore. Këtë hap ua kemi borxh gjeneratave të ardhshme. Ju faleminderit për vëmendje dhe ju uroj konferencë të frytshme. Pres me padurim diskutimin e më tutjeshëm. Faleminderit.

Nora Ahmetaj: Faleminderit zoti Rafael, faleminderit për kontributin tuaj dhe që e respektuat kohën. Ia jap fjalën tani zonjës Klaudia Kulub nga Komisioni Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur në Bosnje e Hercegovinë.

Klaudija Kuljuh: Do të mundohem që diskutimi im të jetë sa më i shkurtër që është e mundur. Komisioni Ndërkombëtar është themeluar në vitin 1996 dhe kishte për detyrë kryesore të sigurojë ndihmë politike për qeveritë e rajonit në gjetjen e zgjidhjeve për familjet e personave të zhdukur, respektivisht përgjigje për fatin e më të dashurve të tyre, të zhdukur gjatë konflikteve. Kur është fjala për Kosovën, ende ka rreth 2.000, përkatësisht mes 1.900 dhe 2.000 të zhdukur, për fatin e të cilëve nuk dihet asgjë. Zbardhja e fatit të personave të zhdukur nuk është me rëndësi vetëm për familjet e personave të zhdukur, por është një çështje e rëndësishme për gjithë shoqërinë. Ky konstatim vlen si për Kosovën ashtu edhe për gjithë rajonin. Nga viti 1999, Komisioni Ndërkombëtar u ka ofruar ndihmë qeverive në gjetjen e të zhdukurve, sikurse edhe asistencë teknike. Kur them asistencë teknike në rastin e Kosovës, e cila ka specifika të ndryshme nga pjesët tjera të rajonit, kam parasysh në asistencën që konsiston në analizën e ADN-së. Do të flas pak në gjuhën e shifrave, ndoshta kjo do t'u jap një pasqyrë rreth asaj se sa është bërë deri më tani në Kosovë sa u përket analizave të ADN-së. Deri më tani janë mbledhur 14.339 mostra gjaku, që paraqesin 4.198 persona. Ekziston nga një

tregim për secilin person të zhdukur, të cilin shoqëria duhet ta dëgjojë. Sa u përket mostrave nga skeletet, deri më tani kemi grumbulluar profilet nga 3.947 mostra skeletore. Kjo shifër i përgjigjet numrit prej 2.139 personave. Dallimi në numra vjen si pasojë e marrjes së më shumë mostrave nga i njëjti skelet, në rastet kur kockat janë të përziera... pardon, kur mbetjet mortore janë të përziera në varreza masive, ashtu që mjekët ligjorë përpiqen t'i bashkojnë mbetjet mortore të një personi duke marrë më shumë analiza të ADN-së. Flas me shifra meqenëse kjo ju krijon një pasqyrë më të mirë për numrin e personave të zhdukur për të cilët flitet këtu, sepse nëse ju them se kemi më shumë se 4.000 mostra të gjakut për personat e zhdukur, këtë numër duhet ta shumëzoni me të paktën 10 anëtarë të familjes, të afërm, të cilët duan të kuptojnë se çka ka ndodhur. Unë besoj se ky numër është shumë më i madh, por ne jse, le të themi se është të paktën dhjetë. Mendoj se të gjitha anëtarët e familjes, si dhe shoqëria në tërësi në Kosovë dhe rajon, duhet ta dinë çka ka ndodhur, duhet t'i dëgjojnë edhe tregimet e familjeve, por edhe të viktimave, sepse secili ka tregimin e vet. Sa i përket ngritjes së kapaciteteve të institucioneve në rajon, sikurse edhe në Kosovë, ne jemi përpjekur t'u ndihmojmë qeverive gjatë formimit të komisioneve - në Bosnjë dhe Hercegovinë ky është Instituti për persona të zhdukur, kurse detyra e tij është grumbullimi i informatave për vendndodhjet e mundshme të varrezave masive dhe koordinimi në terren. Siç thash, ne ofrojmë ndihmë forenzike në të gjitha shtetet, me përjashtim të Kosovës, sepse kjo nuk është kërkuar nga ne. Po ju jap një shembull se çka do të thotë kur ekziston vullneti i qeverisë për t'u bërë disa gjëra, respektivisht kur qeveria është e gatshme të jap përgjigje. Shumica nga ju besoj se e dini që gjatë vitit 2001 dhe 2002 janë kryer ekskumime në Batajnicë. Ne ishim prezent aty për mbështetje forenzike për ekipin e ekspertëve që është marrë me trupat e zhvarrosur, e të cilët janë identifikuar përmes metodës së ADN-së dhe janë dorëzuar në Kosovë. Flas për rastin e personave të zhdukur në Kosovës. Ky është një shembull se çka mund të bëhet kur qeveria ka dëshirë të flasë dhe është e gatshme t'i hap dosjet e veta që kanë të bëjnë me personat e zhdukur. Unë mendoj se në rajon do të vazhdojë një tendencë e tillë, sepse kjo është mënyra e vetme për të ardhur deri te përgjigja. Përpos këtyre dy aspekteve, ICMP-ja merret edhe me një aspekt të tretë, që është ndërtimi, përkatësisht freskimi i shoqërisë civile. Nga viti 1998 deri më tani janë mbajtur 10 konferenca rajonale, që në fakt ishin forume ku familjet e personave të zhdukur kishin mundësinë të ulen së bashku dhe të bisedojnë. Në fund të nëntorit të këtij viti, në Beograd do të mbahet konferenca e XI dhe unë besoj se shumë nga ju do të merrni pjesë në të. Por është dëshpërues fakti se në secilën prej këtyre konferencave shoqatat i sjellin përfundimet e veta dhe, me aq sa jam unë e njoftuar, vetëm një numër i vogël i këtyre konkluzioneve implementohen, përkatësisht jetësohen nga qeveritë. Problemi vazhdon të qëndrojë përsëri para shoqërisë dhe familjeve, dhe ne duhet të merremi me atë; tendenca jonë është që të inkuadrohen edhe organizatat tjera joqeveritare dhe të njoftohen me problemin e të zhdukurve, sepse sado që duket se njerëzit janë të vetëdijshëm për problemin e të zhdukurve, e vërteta është krejt ndryshe. Nuk po dëgjohet zëri i familjeve të personave të zhdukur. Mendojmë se ata duhet të jenë shumë më të zëshëm. Një prej mënyrave si të jemi të zëshëm, respektivisht të dëgjohet ajo që juve ju mundon, është përmes inkuadrimit të organizatave tjera joqeveritare. Vetëm më lejoni të përmend, sa i përket Kosovës, ne marrim pjesë edhe në përgatitjen e projekt-ligjit për personat e zhdukur. Një ligj i tillë tashmë ekziston në Bosnjë dhe Hercegovinë. Thonë se ai është model shumë i mirë, për fat të keq implemetimi i Ligjit për Personat e Zhdukur

në Bosnjë dhe Hercegovinë po shkon shumë keq. Shpresoj se një situatë e ngjashme nuk do të përsëritet edhe këtu dhe ky ligj do të aprovohet sa më parë. Faleminderit.

Nora Ahmetaj: Faleminderit zonja Klaudia Kulub, kishim shkuar me rend ashtu sipas agjendës Bekim Blakaj nga Fondi për të Drejtën Humanitare do të na thotë diçka për punën konkrete të organizatës në lidhje me temën.

Bekim Blakaj: Faleminderit Nora! Për shkak se parafolësit e mi, një pjesë e tyre e zgjatën pak më shumë në fakt unë do të jem shumë i shkurtër. Unë do të doja të ju përsërisja të gjithëve që keni ardhur sot në këtë forum por në veçanti dua ti përsërisja familjarët e viktimave. Ata që kanë ardhur nga Kosova, ata që kanë ardhur nga rajoni kanë udhëtuar me mbi dhjetë orë. Po ndihe pak keq, flas për nevojat e viktimave, t'ju flas viktimave, në fakt unë ndiej një nevojë që ndoshta unë kishte qenë më mirë me i dëgjuar viktimat se sa të ju flas atyre, megjithatë edhe pse është shumë jofalënderues me fol për nevojat e viktimave në këtë moment, megjithatë unë dua ti them disa fjalë, nuk dua të tingëllojë si kritikë i institucioneve mirëpo megjithatë institucioneve të cilat janë kompetente për trajtimin e viktimave dhe familjeve të tyre, megjithatë në mesin tonë sot janë përfaqësuesit e familjeve të viktimave dhe shumë individë të cilët kanë viktima në familjet e tyre dhe duhet të ndalemi në disa probleme evidente që kanë të bëjnë me problematikën, me këtë problematikë që po e shqyrtojmë sot, në fakt meqenëse mbi 1900 persona nga Kosova konsiderohen si të zhdukur, ne ende nuk kemi një ligj i cili do të rregullonte çështjen e këtyre personave , statusin e këtyre personave më duket që edhe zëvendës kryeministri e përmendi këtë çështje por për fat të keq ne nuk kemi një ligj të tillë. Gjatë punës tonë në terren shumë shpesh na ka ndodhur që që familjarët e viktimave janë ankuar edhe në pamundësinë e nxjerrjes së dokumentacionit personal, atyre i është dashur që të shkojnë me nga dy dëshmitarë në komunë me e nxjerr një dokument dhe me ata dy dëshmitarë me e vërtetuar me e dëshmuar se kanë të humbur nga familja e tyre, çka mendoj që nuk është shumë dinjitoze për viktimat. Gjithashtu familjet e viktimave ëëë civile kanë të diskriminuar edhe me ligjin mbi statusin dhe të drejtat e familjeve të dëshmorëve, invalidëve dhe veteranëve të UÇK-së, familjeve të viktimave civile të luftës. Përderisa për dy kategoritë e para ligji ka filluar të implementohet qysh në fillim të vitit 2007 për kategorinë e tretë ky ligj ka filluar të implementohet vetëm në fillim të këtij viti, në janar të vitit 2008. Ne kemi hasur në raste të tilla ku edhe është abuzuar me këtë ligj, persona, familje të cilët nuk kanë pasur viktima nga familjet e tyre e gëzojnë të drejtë për një asistencë sociale ndërsa numri i madh i familjeve të viktimave ende nuk e kanë rregulluar këtë çështje, mirëpo këto probleme unë nuk mendoj që janë më të mëdhatat për familjarët e viktimave, në mesin tonë sot këtu është një zotëri i cili ka shitur krejt pasurinë e tij e atë pasuri ia kanë marrë profiterët e luftës, duke e bindur se me ato para do ta gjejnë fëmijun e tij të gjallë, nuk është rasti i vetëm ka me qindra raste, për fat të keq edhe në këtë mënyrë është abuzuar me viktima, sigurisht pajtoheni të gjithë që në këtë mënyrë nuk u kthehet dinjiteti viktimave, çka dua të them edhe pse shumë shpesh hasim në terren në raste ku familjarët nuk duan të japin deklaratat për atë se çka ju ka ndodhur, në fakt jo që ata nuk dojnë por ata janë lodhur duke dhënë deklaratat e duke mos pas asnjë përfitim nga ato, në këtë rast nuk e kam fjalën për përfitim material, në fakt viktimat kanë nevojë të flasin për atë çka ju ka ndodhur mirëpo në shumicën e rasteve ata hasin në vesh të shurdhër edhe asgjë nuk ndodh pastaj, viktimat kanë të drejtë ta dinjë të vërtetën,

viktimat kanë të drejtë të kërkojnë përgjegjësi për atë se çka ju ka ndodhur, sigurisht që kanë të drejtë edhe të kërkojnë dëmshpërblim, mandej mund të flasim për pajtim, në fakt vetëm edhe këtë edhe do ta përfundoj Nora, në fakt jam prekur shumë në një rast, më falni ë jam kaq direkt dhe po flas prej përvojës time në terren, shumë shpesh flitet se familjarët e viktimave janë hakmarrë ndaj komuniteteve tjera, unë nuk e ndaj atë mendim, kam qenë në një fshat para disa viteve afër Pejës ku një zotëri i ka humbur katër djemtë e tij, i ka pa të vramë trupat e pastaj janë zhduk, katër ditë pas kësaj ai ka intervenuar me i shpëtuar dy gra të vjetra, të komunitetit tjetër, të cilat kanë dashur me i kidnapuar mirëpo ai k reaguat dhe i ka shpëtuar edhe kishte vetëm fjalë të mira për to, kështu që unë nuk e ndaj atë mendim që familjarët e viktimave mund të shëndrrohen në agresorë, më falni ndoshta edhe pak fola me emocione por sidoqoftë edhe njëherë do të ju falënderohem për pjesëmarrje në këtë forum. Faleminderit Nora!

Nora Ahmetaj: Faleminderit Bekim! Para se ne të kalojmë tek përfaqësuesit e organizatave të familjarëve të të zhdukurve apo të kidnapuar të cilët do të na sjellin përvojat e tyre dhe meqë Bekimi i preku disa tema që kanë të bëjnë edhe me trajtimin e personave të zhdukur edhe prej institucioneve qeveritare apo edhe parlamentit mosprurjen e ligjeve apo rregulloreve, meqenëse zoti zëvendës kryeministër duhet të shkoj patjetër shumë shpejtë në kisha me e pyet nëse është i gatshëm me u përgjigj në lidhje me se çka ka ndërmarrë qeveria e Kosovës apo si qëndron në lidhje me pozitën e personave të zhdukur apo dhe viktimave të luftës, për arsye se zëvendës kryeministri duhet me shku, ok mundeni me u përgjigj dhe mundeni me shku.

Ramë Manaj: Mirë unë po përgjigjem dhe po mbetem edhe nja dhjetë minuta më vonë. Zonjusha Nora faleminderit për pyetjen! Është me rëndësi që nga ky forum dhe forumet e këtilla të nxirren përfundime të qarta që orientojnë veprime të mëtutjeshme në një preokupim dhe përkushtim të përbashkët, ky preokupim dhe përkushtim i përbashkët mund të zërthehet ndoshta në më shumë pika ose nënpika por del se tretmani i viktimave të luftës, trajtimi më meritohet i tyre është një përkushtim i përbashkët, unë nuk do ti ndaja, më vjen keq që këtë e them jashtë pranisë së zotit Baliq, qytetarët dhe institucionet në një vijë të demarkacionit sepse ky është problem i përbashkët dhe nuk mund të jetë i ndarë dhe natyrisht që secili ka për obligim të jep kontributin e vet në vazhdimësi, pra preokupimi institucional i viktimave është një preokupim madhor i institucioneve dhe i familjarëve dhe i gjithë qytetarëve të Kosovës dhe jashtë Kosovës, është dhe mbetet më tutje zbulimi i fatit të atyre të pagjeturve, të cilët përveçse nuk janë vetë fizikisht kanë krijuar viktima dhe pasoja edhe te familjarët e tyre dhe në këtë pjesë institucionet vendore, qytetarët e Kosovës, familjarët fatkeqësisht kanë qenë dhe mbesin akoma shumë të pamundshëm, tepër të pamundshëm për faktin se adresa siç dihet tashmë qartë, siç është thënë disa herë deri më tani është Serbia, shteti i Serbisë si shkaktarë i luftës, si ajo që kidnapoi njerëzit tanë nga kolonat e përndjekjes, nga rrugët, nga shkollat, nga oborret dhe ka adresë të qartë dhe dikush përmendi këtu se tashmë pritojnë të japin deklarata familjarët, po natyrisht edhe duhet kuptuar sepse shumë herë janë përsëritur të njëjta deklarata dhe nuk ka pasur efekte. Me gjithë përpjekjet e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq edhe të shumë faktorëve të tjerë ndërkombëtarë në Kosovë që të shfrytëzojnë të gjitha kapacitetet e tyre, të gjitha mundësitë e tyre të ndikimit, problemi të pagjeturve në Kosovë, flas për numrin më të madh të tyre, flas për ata të cilët, adresa,

gjurmet i adresojne në Serbi, është krijuar dhe mbetet politik. Megjithatë, unë do ti kthehem më drejtpërdrejtë përgjigjes në pyetje, çka kanë bërë institucionet e Kosovës deri tani? Unë më me ëndje do të thoja për atë çka po bëhet sot sepse nuk i jap vetes të drejtë të flas për periudhën e kaluar, në veçanti para shtatëmbëdhjetë shkurtit kur dihet se udhëheqja, qeverisja e Kosovës ka qenë e përbashkët, po them kushtimisht e përbashkët sepse përgjegjësitë kryesore i ka pasur faktori ndërkombëtarë, faktori civil në këtë kontekst UNMIK-u ka pas kompetenca të rezervuara në të cilat fatkeqësisht nuk kemi mundur të kemi qasje madje do të thoja se edhe sot kemi vështirësi ta zëmë për bartjen e të dhënave nga zyra e UNMIK-ut për të zhdukurit. Por qeveria e Kosovës, kjo përbërje ka vazhduar të funksionalizoj, ka vazhduar ta mbaj funksional komisionin qeveritar i cili ka bërë dhe bën atë çka është e mundshme, atë çka kërkohet prej tij dhe çka mund të bëj. Në këtë moment jemi në përpjekje bashkë me komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq që t ngrisin kapacitetet e këtij komisioni për të vazhduar punë do të thoja edhe me më sukses, natyrisht edhe në hulumtimin e varrezave masive por edhe në mbështetje logjistike të familjarëve. Tjetër, unë nuk e di kur kanë filluar përpjekjet për përpilimin e një ligji, një draft ligji për të pagjeturit, këtu u përmendën shumë aspekte të kësaj problematike që lidhet drejtpërdrejtë me viktimat civile, me ligjin e mëhershëm pra me fillimin e kësaj pjese të tretmanit të familjarëve të ë pagjeturve pak më vonë se sa me të tjerët, por aktualisht jemi në përfundim të draftimit të ligjit për të pagjeturit, i cili besojmë fuqishëm dhe unë besoj se ka participim, ka pjesëmarrje në draftimin e këtij edhe shoqëria civile edhe pra Asociacioni i Shoqatave të Familjarëve të të Pagjeturve, për ta bërë një ligj sa më përfshirës, sa më funksional, sa më të realizueshëm dhe sa më kualitativ do të thoja në kuptim të mbulimit të kërkesave dhe të nevojave, por ju lutem besoj se nuk them asgjë të të re në qoftë se them se çdo pjesë e shoqërisë së Kosovës është pjesë e sotme e saj, nuk mund të ketë ndryshime radikale në mes të një kategorie prej kategorisë tjetër, sepse ne kemi këtë gjendje që e kemi edhe ekonomike edhe fillimi i ndërtimit të një shteti të ri ballafaqohet me sfida të shumta, me probleme të shumta, para së gjithash të natyrës ekonomike dhe kjo reflekton në këtë kategori por edhe në tretmanin institucional të kërkesave të kësaj kategorie që mbetet kategori e dhimbshme, të cilën e mundon dhimbja kaq gjatë. E sido që të jetë , ne si institucione do të vazhdojmë bashkëpunimin edhe me organizata vendore edhe me ato ndërkombëtare për të bërë gjithçka që është e mundshme, në radhë të parë për mbulimin e kapitullit të të pagjeturve, paralel me këtë tretman më meritë, më kuptimplotë , më të shumanshëm të viktimave dhe për tretman më efikas në kuptim të rehabilitimit të plotë të tyre në kuptim të plotë të fjalës për tu shëndrruar në faktor kontributdhënës të shoqërisë dhe ne qytetarët që duam ta harrojmë sa më shpejtë të kaluarën. Nuk është fjala këtu të themi fjalë të mëdha dhe fjalë pajtuese por ne duhet të ballafaqohemi me realitetin dhe realiteti është ky që është, është jemi sjellë, jemi në këtë fazë, në këto momente në të cilat jemi por ne duhet të shkojmë më tutje me gjithë problemet, natyrisht duke i bashkuar forcat, shpresojmë se do ti ngushtojmë vështirësitë dhe problemet sepse e ardhmja është e pandalshme. Ne, të mos kaloj në pjesën fragmentalisht politike por nuk mund ta shohim bashkëpunimin të barrikaduar bashkëpunimin në mes të serbëve dhe shqiptarëve edhe brenda Kosovës edhe të Kosovës e Serbisë. E kemi thënë sa herë është faktorë, është moment i rëndësishëm për qeverinë serbe, për popullin serb që duke kontribuar drejtpërdrejtë në zbulimin e fatit të të pagjeturve ta kapërcej një anatemë, ta kapërcej një barrierë fortë të madhe në rrugën

riafrimit, të bashkëpunimit edhe të koekzistencës paqësore në këtë rajon. Faleminderit, unë më duket se prapë e kam zgjatë shumë!

Nora Ahmetaj: Faleminderit! Ia jap fjalën zonjës Snezhana Zravkovi nga Shoqata e Familjarëve të Personave të Rrëmbyer dhe të Vrarë në Kosovë.

Snezhana Zdravkoviq: Të nderuar zotërinj, të nderuara familje të personave të viktimave që keni ardhur nga Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi. Po u drejtohem si përfaqësuese e Shoqatës së familjeve të kidnapuara dhe të vrara gjatë viteve 1998, 1999 dhe 2000 në Kosovë dhe Metohi. Së pari, do të doja që në emër të Shoqatës të falënderoj organizatorin e këtij takimi, Fondin për të Drejtën Humanitar dhe të gjitha ata që i kanë mbledhur përsëri së bashku përfaqësuesit e viktimave nga hapësirat e ish Jugosllavisë. Këtu u ngritën edhe disa prej çështjeve për të cilat shpresoj se Komisioni i ardhshëm do të jetë në gjendje të japë përgjigje. Shoqata e familjeve të personave të kidnapuar dhe të vrarë në vitin 1998 dhe 1999 në Kosovë dhe Metohi, ka grumbulluar të dhënat për 2.500 viktima serbë, romë, turq, goranë, shqiptarë dhe të tjerë që kanë pësuar në hapësirat e Kosovës dhe Metohisë, në periudhën e paraluftës, prej majit të vitit 1998, 1999, 2000 e më pas. Se serbët ishin viktimat e para të këtij konflikti flet fakti i kidnapimit të 10 minatorëve të mihjes në Bellaqevc, si dhe civilëve, banorë të Oterushës, Rahovecit e Suharekës, që janë kidnapuar gjatë periudhës prej majit deri në korrik të vitit 1998. Prej atëherë për çdo ditë kanë vazhduar rrëmbimet, kidnapimet, vrasjet, si të civilëve të pafajshëm, ashtu edhe të ushtarëve dhe policëve. Vitet 1998, 1999 dhe periudha 2000 deri 2004, janë vitet e vuajtjeve më të mëdha të popullit serb në Kosovë dhe Metohi. **Ka dhjetë vite që familjet kërkojnë të vërtetën për anëtarët e tyre të rrëmbyer dhe të vrarë. Gjatë kërkimeve tona marrim informata të ndryshme dhe gjysmëinformata** se në fshatin Zhilivodë, në disa shpella aty pranë, janë vrarë dhe janë hedhur minatorët e mihjes së Bellaqevcit, se llogoret me serbët e kidnapuar gjendeshin në Matiçan, Dragobil, Drenovc, Lapushnik, Likovc, Ruhot, Ljubiçevë, Malishevë, Sopi, fshatin Zlash, Plane, Mushtisht, Kojlovicë, Junik, Kërpime dhe në Batllavë. Kurse llogore të tilla janë formuar në shumë objekte në qytetet e mëdha anekënd Kosovës dhe Metohisë. Në favor të kësaj flasin një numër i madh i të dhënave dhe zbulimeve, si dhe një numër fare i vogël i atyre që kanë arritur të ikin nga këto llogore dhe burgjet sekrete të së ashtuquajturës UÇK. Për ekzistencën e llogoreve ku janë mbajtur civilët e robëruar ka dëgjuar jo vetëm opinioni vendas por edhe ai botëror. Këtë e kanë dëshmuar përfaqësuesit e Misionit Verifikues të OSBE-së dhe Komitetit të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar, kurse kemi edhe deklaratat e dëshmitarëve se përfaqësuesit e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq i kanë vizituar llogoret e së ashtuquajturës UÇK, në të cilat mbaheshin serbët, romët dhe personat tjerë të zënë robër. Prandaj kërkojmë të dhënat që i kanë grumbulluar ata në atë kohë, sepse si familje të viktimave kemi të drejtën ta dimë të vërtetën, të cilën po e presim një dekadë. Prej vitit 1998 e më pas, familjet tona pandërprerë kanë kërkuar ndihmë dhe veprime konkrete nga OSBE-ja dhe Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq që t'i lirojnë më të dashurit tanë, por për fat të keq askush nuk ka ndërmarrë diçka që të paktën një i kidnapuar të lirohet, kurse kriminelët të dënohen. Për fat të keq, kjo po vazhdon edhe pas ardhjes në terren të forcave paqeruajtëse të KFOR-it, UNMIK-ut. Për këtë arsye, përgjegjësia bie jo vetëm mbi komandantët dhe kryerësit e drejtpërdrejt të së ashtuquajturës UÇK, por edhe mbi

gjeneralët e KFOR-it, NATO-s dhe UNMIK-u. Se disa nga viktimat kanë qenë gjallë tregon edhe kasetta ku shihen katër serbët e kidnapuar derisa po merren në pyetje nga personat e kombësisë shqiptare. Në atë kasetë është edhe Zharko Spasiq, i cili është rrëmbyer më 14 maj të vitit 1998, e që është viktimë e parë civile në Kosovë dhe Metohi. Kasetën e kanë gjetur pjesëtarët e MPB-së në territorin e Likovcit dhe Llapushnikut, në llogoret të cilat i kanë qenë nën kontroll të së ashtuquajturës UÇK. Kjo kaste i është dorëzuar Gjykatës për Krime të Luftës, hetuesve të Hagës, ish Prokurores së Tribunalit të Hagës, Karla Delpontes, kurse u është treguar edhe shefave të UNMIK-ut. KFOR-i dhe UNMIK-u i kanë vështruar pa fjalë krimet dhe rrëmbimet që janë zhvilluar para syve të tyre dhe nuk kanë ndërmarrë asgjë që ta pengojnë atë, kurse sipas Rezolutës 1244 të gjitha përgjegjësitë për siguri i marrin ushtarët e NATO-s dhe KFOR-it. Ata gjithashtu nuk kanë ndërmarrë asgjë për ndriçimin e krimeve dhe arrestimin e kryesve të veprave penale. Fakti më i tmerrshëm është se pas ardhjes së KFOR-it dhe UNMIK-ut është shtuar numri i burgjeve dhe llogoreve ilegale të UÇK-së. Në takimin që kishim në Mitrovicë, këtë na e ka pohuar ish pjesëtari i policisë së UNMIK-ut CCAU, Malkolm Stark, i cili tha se në Kosovë ka pasur 144 llogore të kontrolluara nga e ashtuquajtura UÇK, për të cilat UNMIK-u dhe KFOR-i kanë pasur informacione të sigurta. Çka ka ndodhur me ato llogore, çka ka ndodhur me njerëzit që janë mbajtur aty? Po pyes publikisht, a është bërë identifikimi dhe përcaktimi i identitetit të vërtetë të viktimave në mënyrë profesionale nga patologët e Tribunalit të Hagës, sepse kemi informacion nga vet patologët e Hagës se më tepër se në 30 për qind të rasteve, viktimat janë identifikuar gabimisht. Dëshirojmë të dimë nëse është bërë identifikim shtesë përmes analizës së ADN-së dhe nëse është përcaktuar identiteti i këtyre viktimave. Nëse jo, kërkojmë që kjo të bëhet sa më parë, për shkak të mundësisë se disa familje i kanë marrë mbetjet mortore të personave të tjerë dhe shumë familje do të mbesin pa trupat e më të dashurve të tyre. Këtë e mbështet e dhëna se 500 trupa të identifikuara pozitivisht, ende ndodhen në morgun e Prishtinës. Meqenëse nuk dihet fati i 540 viktimave, dyshojmë se këto janë eshtrat e më të dashurve tanë dhe është e pakuptimtë që me vite të tëra nuk mund të përcaktohet se të kujt janë këto eshtra. Pjesëtarët e KFOR-it dispononin me të dhënat për të gjitha krimet, video incizime, fotografi, raporte etj, por gjithë këtë dokumentacion që do të na hynte në punë për zbulimin e të vërtetës e kanë marrë me vete në shtetet e tyre amë. Apelojmë që i gjithë dokumentacioni i marrë të kthehet dhe t'i lihet në dispozicion Gjykatës për Krime të Luftës në Beograd, sepse sipas pohimeve të Tribunalit të Hagës, kompetente për zgjidhjen e rasteve të tilla janë gjykatat speciale. Prokurorja e Hagës, Karla Delponte, ka pohuar se të gjithë serbët, romët dhe të tjerët janë vrarë. Po pyes këtu pse fshihet kjo nga familjet dhe opinioni. Prokurorja e Hagës, Karla Delponte, dhe shefi i njësive hetuese të Tribunalit, Marti Atikenen, kanë marrë zarin e mbyllur me vullë me dyllë, me emrat e 300 kidnapuesve dhe vrasësve, prej vitit 2001, por asnjë nga ato nuk është proceduar, madje, as në bazë të përgjegjësisë komanduese. Pohimet se të gjithë të kidnapuarit janë vrarë mbështeten edhe me faktin e ekshumimeve të përditshme. Familjeve tona, por edhe neve si përfaqësues, për fat të keq nuk na mundësohet qasja në vendndodhjen e varrezave masive të serbëve të vrarë, në Dragodan 1,2 dhe 3, varrezën masive në fshatin Uglare, Volujak, liqenin e Radoniqit, në Kleçkë dhe në vendet tjera, nëpër varrezat ortodokse anekënd Kosovës dhe Metohisë. U drejtohem publikisht përfaqësuesve të viktimave shqiptare, na ndihmoni që të lirohen më dashurit tanë dhe të kthehen nëpër familjet e tyre, nëse janë akoma gjallë. Kërkojmë përgjigje nga dëshmitarët

e këtyre kidnapimeve, të cilët janë pjesë e institucioneve të Kosovës. Familjet shqiptare e dinë se çka do të thotë lirimi i 2.108 robërve të tyre. Shumë nga të liruarit ishin terroristë të dëshmuar dhe kriminelë të gjykuar me aktgjykime të plotfuqishme gjyqësore. Për shkak të gjithë kësaj, pyetem pse nuk ka drejtësi edhe për viktimat serbe, pse të gjithë heshtin kur bëhet fjalë për viktimat e tyre? Për ç'arsye grupet e punës për persona të zhdukur mbahen prapa dyerve të mbyllura? Vetëm edhe këtë për fund. Duam t'u themi fqinjëve tanë shqiptarë. Na keni marrë të gjitha: banesat, arat dhe shtëpitë, kopshtet dhe livadhet, duam vetëm që më të dashurit tanë të kthehen nëpër familjet e tyre. Për ne është shumë me rëndësi të zbulohet e vërteta e plotë për të gjitha viktimat dhe ju lutem të mos e karakterizoni këtë si fjalim politik. Ky është fjalimi i të gjitha viktimave që grumbullon Shoqata jonë: fjalimi i vajzës babai i së cilës është torturuar dhe vrarë, fjalimi i motrës vëllai i së cilës është rrëmbyer, kurse për fatin e të cilit akoma nuk dihet asgjë.

Nora Ahmetaj: Faleminderit Snezhana! Ju lus të gjithëve edhe njëherë edhe panelistët dhe pjesëmarrësit të jemi më tolerant, ta respektojmë njëri tjetrin dhe ta dëgjojmë njëri tjetrin, ta pranojmë identitetin e të tjerëve, viktimat është viktimë pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike dhe religjioze apo racore, nëse disa i dëgjuam për nga dhjetë minuta atëherë nuk është fer që tjerëve të ju marrim atë mundësi, edhe njëherë po e cekim panelistët që kanë mbetur, panelistët... ju lutem, ju lutem unë jam moderatore nuk jeni ju, e juaja është me qenë tolerant dhe me dëgju aty mandej e keni një orë ku mundeni me i dhënë komentet tuaja, ju lutem vazhdojmë me panelistët tjerë zoti Haki Kasumi, Koordinator i Shoqatave të të Zhdukurve në Kosovë, ju lutem panelistëve që keni mbet mos ta zgjasim për një dhjetë minuta se si duket ka me pas për çka të flitet më vonë, urdhëroni.

Haki Kasumi: Përshëndetje auditor i nderuar, unë jam përfaqësues i 12 shoqatave , të cilët me vite janë në kërkim të më të dashurve. Unë do të ndalem në tri çështje. Do ta prezentoj qëndrimin e mbeldhjes së fundit të Këshillit koordinues, e cila është mbajtur më 25 tetor të këtij viti (2008). Qëndrimi i parë i Këshillit Koordinues është se ideja apo iniciativa e FDH, e përkrahur nga shoqëria civile dhe individët, shihet si ide pozitive e cila vlerësohet dhe është plotësisht e pranueshme. Nëse e marrim parasysh situatën specifike e cila dominon në shoqërinë civile të Kosovës, me një shqyrtim të veçantë në shumicën e popullatës së Kosovës, me gjithë respektin ndaj kësaj iniciative me ndikim, me karakter human dhe me qëllime të mira, ne mendojmë se ende është herët për te. Kjo iniciativë e tillë në Kosovë e cila po ballafaqohet me vështërsi të komplikuar dhe të shumta, e cila po ballafaqohet me një çështje shumë të rëndësishme, e kjo është më shumë se gjysma e të zhdukurve, të cilët në këtë momentin kur unë po flas, unë nuk do ta emërtoj fajtorin për zhdukjen e tyre. Jam pothuajse i sigurtë, se ata të cilët janë të kyçur në këtë proces dhe ata të cilët janë të interesuar ta dijnë të vërtetën që do të thotë që shumica sigurisht e dinë. Këshilli Koordinues ka vendosur që mos ta pengojë këtë iniciativë, dhe në një far mënyre të kyçet dhe ta përshëndes, por në këtë moment asesi nuk mund të bëhet pjesë e saj. Është e nevojshme që në mënyrë të pjekur të shtjellojmë dhe analizojmë.

Duhet të kemi edhe pëlqimin e anëtarëve të familjarëve të viktimave, të cilët janë të lënduara dhe janë kryesorët që duhet të japin vizën, pëlqimin, nëse është koha ti bashkangjitemi iniciativës të cilës nëse jo sot, nesër do ti bashkangjitemi. Shumica e parafoësve të mi duke përfshirë edhe zonjën e respektuar Natasha Kandiçin, kanë thënë se kësaj iniciative iu kanë bashkangjitur shoqatat e viktimave të luftës dhe të zhdukurve të Kosovës. Unë deklaroj se deri sot asnjë shoqatë përveç një individi, nga i cili shoqata e tij është distancuar, nuk janë bashkangjitur kësaj iniciative. Ende duhet të mendohet në mënyre të pjekur, me e tretë dhe me e analizu idenë për iniciativë. Do të vie momenti kur do ta përkrahim . Nëse me të vërtetë zonja Kandiç dhe bashkëpunëtorët e saj, që do të thotë shumica diku rreth 50%, me të vërtetë e respektojnë punën e saj, por neve me të vërtetë na vie keq që ajo vie nga një shoqëri e cila në vazhdimësi ka bërë krime, jo dy vjet sië e tha parafolesja por një dekadë e tërë mbi popullin tonë.

Popullatë shumicë, si popullatë viktimë jemi në gjendje të ulemi, jemi ulur edhe më parë dhe do të ulemi, do të bisedojmë dhe jemi shumë të interesuar që e vërteta të del në shesh dhe kryesit e krimeve, kushdo qofshin ata të nxirren para drejtësisë dhe të marrin dënimin e merituar, kjo ishte pjesa e parë dhe çështja e parë me të cilën thashë se kam borxh, kam obligim ndaj këshillit dhe aktivistëve dhe familjarëve të Këshillit Koordinues që prezantoi para këtij auditoriumi të respektuar. Çështja e dytë është ajo tema konkrete për të cilën jemi të thirrur të flasim nevojat e familjarëve gjegjësisht e viktimave, unë do të ndalem konkretisht në nevojat e konkrete të një pjese të viktimave të familjarëve të të zhdukurve dh do të thoja që kjo është kategoria më e dhimbshme, më e goditur e shoqërisë jo vetëm në Kosovë, por meqë është fjala për Kosovë po flas për të por në tërë rruzullin tokësor dhe ne që përballemi me këtë dhembje nuk ia dëshirojmë që nga ky moment askujt në rruzullin tokësor të përballet me mungesën e anëtarëve të familjes me ankthin i cili e përcjellë në çdo moment, në çdo hap të jetës së tij. Kërkesat e këtyre familjarëve nga parafolesit e mi u përmendën një pjesë e tyre dhe ato janë njohura, ato janë universale për të gjithë njerëzit e goditur. Unë nëse ka nevojë do ti përmend disa prej tyre: nevojë dhe kërkesë esenciale është të dijnë për fatin e më të dashurve të tyre, të marrin informacionin për ta, këtë qeveritë, institucionet e vendit ju lutem janë të obliguar, janë të obliguar jo që duhet ta bëjnë nga mëshira ose të presin që ne të bëjmë presion te ta, me konventa ndërkombëtare, me ligje vendore të cilat për fat të keq deri më tash ato ligjet autentike i kanë munguar Kosovës, ndërsa tash muajve të fundit në Kosovën shtet, që e pretendojmë që do të jetë shteti më demokratik në botë dh jemi shumë të bindur shumë shpejtë edhe pjesa e qytetarëve të Kosovës, serbë për të cilët ndajmë dhimbjen dhe konsiderojmë se me instrumentalizimin e tyre dhe me largimin e tyre, mosangazhimin e tyre për të pranuar realitetin e ri ata shumë shpejtë do të pendohen dhe do të shohin se ndoshta...

Nora Ahmetaj: Zotëri Kosumi ju lutem më falni vazhdoni në pikën tretë

Haki Kosumi: me plotë të drejtë, më lejoni ta kry mendimin

Nora Ahmetaj: keni veq edhe dy minuta!

Haki Kosumi: ta përfundoj mendimin të lutem, nëse ka mundësi, nëse ka mirëkuptim ju lutem nuk kam dal prej temës, s'ma merr mendja, ju lutem do ta shohin, do ta kuptojnë,

do ta pranojnë realitetin dhe ndoshta sigurisht do të pendohen se nuk kanë bo përpjekje me e kuptuar realitetin e ri, me e pa shtetin e ri të Kosovës, një krijesë e kohës, një krijesë e domosdoshme, një paralajmërim i mirë, me të cilin bota demokratike në gjithë rruzullin tokësor është e njohur që nga vitet e pesëdhjeta, se koha e kolonializmit ka përfunduar njëherë e përgjithmonë dhe të drejtat gjegjësisht kërkesat e familjarëve tjera unë nuk po i përsëris janë informacioni, është rivarrimi i atyre që gjinden në përputhje me normat dh kërkesat e komunitetit, të cilat për fat të mirë në Kosovë janë respektuar deri më tash në mënyrë të përpiktë, formimi i institucioneve reale në Kosovë dhe funksionale, të cilat do të punojnë më tepër në këtë drejtim që të përmbushen kërkesat e këtyre familjarëve si dhe participimi në vendimmarrje kolektive, të cilat janë të një interesi të përgjithshëm, ngase megjithatë këta familjarë të goditur i dhanë kësaj shoqërie dhe këtij ndryshimi ose kësaj sajese e cila po themi se ka pretendime të jetë shembull i mirë në botë dhe çështja, po kaloj tash te çështja e tretë e domosdoshme ndoshta nuk është fort e përshtatshme që të thuhet ngase del nga rendi i ditës por gjithsesi mund të nënkuptohet nga kjo që e thashë dhe e porosis kolegen time, bashkëvuajtësen time, për dhimbjen e familjarit të cilin e kërkon si e kërkojmë edhe ne se adresa e vetme dhe adresa kryesore për të dalur nga ankthi dhe për të gjetur të vërtetën për familjarin e saj dh për familjarët tonë të shumtë shqiptarë në Kosovë është pikërisht në qendrën, në kryeqendrën e ish shtetit të saj nacional në Beograd dhe ju lutem bëj thirrje, apel që bashkarisht të bëjmë përpjekje dhe të kërkojmë ndihmën e Bashkësisë Ndërkombëtare të ushtrojnë rysinë e duhur në qeverinë aktuale të Beogradit ngase ajo mban të vërtetën, ajo mban realitetin dhe gjithë atë çka u ka ndodhur edhe serbëve edhe shqiptarëve në Kosovë gjatë periudhës së luftës dhe më duhet vetëm të ia kujtoj se deri më 12 qershor të vitit 1999 kontrollin absolut mbi popullatën dhe mbi territorin e tërësishëm të Kosovës e kishte pushteti ushtarako-polikor i Beogradit dhe ai me urdhëra dhe me qëndrime politike ka vepruar dhe e dinë ku është vëllau yt, miku im, djali i Axhës Bajram dhe i secilit prej neve këtu. Faleminderit, e zgjata pak kërkoj falje.

Nora Ahmetaj: Faleminderit Haki! Unë nuk po komentoj tani asgjë po i kryejmë krejt panelistët ose nuk po bëj asnjë pyetje për arsye se besoj që kemi me fol më vonë me shtjellu shumë gjëra, vetëm dëshiroj që fjalimet të mos marrin ton politik, ne jemi këtu për me e thënë mendimin tonë, me e dëgjuar njëri tjetrin, secili e ka të drejtën për të vërtetën e vet. Ia jap fjalën zonjës Shukrije Gashi nga organizata ‘Partners Kosova’ ju lutem!

Shukrije Gashi: Unë fillimisht kërkoj falje prej familjarëve të të zhdukurve dhe viktimave që kam marrë këtë të drejtë, këtë kredibilitet të i bashkangjitem kësaj iniciative, por besoj që këtë e kam bërë me qëllimin më të mirë, asesi dhe asnjë moment nuk kam konsideruar dhe konsideroj dhe as që pretendoj se unë nuk mund të jem në lëkurë tuaj, këtu në mesin tuaj ka shumë njerëz të cilët kanë punuar gjatë në këtë çështje dhe në mënyrë meritore do të thotë më së miri ata e njohin këtë fushë dhe mundësitë për ti realizuar synimet e tyre. Mirëpo unë këtu kam ardhur vetëm për shkak të vullnetit të mirë dhe për faktin se për një kohë të gjatë jam aktiviste e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive të njeriut domethënë e vetmja arsye është kjo. Gjatë punës sime shumëvjeçare është që mund të them që para viteve të nëntëdhjeta gjithmonë kam qenë ithtarë e të së drejtë njerëzore dhe jam përpjekur që qasjen time të baraspeshuar mirë, të paanshme gjithmonë

ta aplikoj gjithkund në praktikë, këtë e kam bërë edhe pas luftës edhe në punën ku sot jam e angazhuar në Qendrën për Administrimin e Konfliktëve dhe konsideroj që kam bërë mirë. Në panelin në të cilin ndodhem aktualisht, nevojat e viktimave konsideroj se është një formulim i qëlluar. Nevojat e viktimave janë të shumta dhe ato po të synojmë edhe me ditë të tëra nuk do të mund ti rrumbullakojmë por konsideroj që nevojë imediate, më se e domosdoshme është krijimi i hapësirës kredibile për familjarët, që ata të mund të rrëfehen, që ata ta kenë të drejtën, të vetmen mundësi që ata të shfryhen, të rrëfehen, ta thonë atë që e kanë në shpirt dhe të mos ju merret asnjë sekondë, asnjë sekondë, ata nuk do të mund ti kthejnë familjarët, anëtarët e familjes të cilët i humbën, bile të iu krijohet një mundësi e tillë, tjetra nevojë është që kryesit e akteve kriminale që të dënohen të identifikohen dhe të dënohen, në mënyrë që shpirtat e atyre që u zhdukën të qetësohen e gjithashtu të gjejnë prehje shpirtërore e edhe familjarët e tyre. Nevojë tjetër shumë e rëndësishme është që të gjithë pa dallim, pa dallim, familjarët nga krejt vendet e ish Jugosllavisë të përpiqen që të tregojnë eupati ose bashkëndjesi për atë çka u ndodhi atyre, gjithë atyre pa dallim, gjithë atyre, për arsye e se kudo qoftë që të jetë krimi është njësoj krim dhe ka peshën e njëjtë dhe ka peshën njëjtë. Një nevojë tjetër gjithashtu është edhe pasja e ligjit dhe mbrojtja ligjore, e cila për arsye të shumta nuk ka ndodh në Kosovë dhe nuk besoj që as tash nuk do të ndodh për arsye se të gjithë ne e dimë se para 17 shkurtit Kosova as juridikisht as tani nuk e menaxhon Kosovën domethënë qeveria Kosovës nuk e menaxhon Kosovën. Pushteti në Kosovë është i shpërndarë në disa qeveri prandaj do të ishte absurde me mendu që brenda ditës do të mund ti qasemi kësaj problematike, ky është vetëm një proces i cili kërkon vullnet të mirë, të baraspeshuar mirë dhe paanshmëri, jo subjektivitet, vetëm kështu do të mund të bëjmë diçka, unë kuptoj mllëfin e parafolësit tim, e kuptoj mllëfin, po e them edhe njëherë nuk kam të drejtë kredibile që e kam marrë këtë vend këtu karshi familjarëve dhe aktivistëve që janë angazhuar në vazhdimësi por konsideroj që çdo shmangie dhe çdo mungesë aty ku zhvillohen ngjarjet i ka pasojat, i ka pasojat, pasojat e mëdha. Ne duhet të përgatitemi mirë, të mbajmë shumë shënime, të kemi informacione dhe ti ofrojmë ato, ti ofrojmë ato. Sa i përket shoqërisë, pjesës domethënë se çka shoqëria në Kosovë duhet të ofroj po ashtu mund të bëhet në shumë rrafshe edhe në aspektin e qeverisë do me thënë nga pikëpamja e qeverisë, institucioneve qeveritare që ti ipet hapësirë trajtimit të kësaj çështjeje, një hapësirë e merituar, një hapësirë e merituar po them domethënë që qeveria të ketë vesh për të dëgjuar në lidhje me këtë çështje, qeveria duhet të ketë vesh për të dëgjuar në lidhje me këtë çështje kur po them qeveria po mendoj edhe në vendorët edhe në ndërkombëtarët. Edhe po ashtu edhe shoqëria civile duhet të angazhohet seriozisht, ta marrë me shumë seriozitet edhe pse më duhet ta them që shoqëria civile vazhdimisht ka bërë përpjekje maksimale të i dal borxhit të gjitha çështjeve që janë ngritur në Kosovë mirëpo vazhdimisht ka has në vesh të shurdhër për shkak të arsyeve që i theksova më herët domethënë qeveria në Kosovë ka qenë e shkapërderdhur kemi pas disa qeveri dhe kuptohet ai që e ka pushtetin ai mundet edhe me ta limituar ose kufizuar të drejtën edhe me ta krijuar hapësirën, në fakt vendorët në Kosovë gati asnjëherë nuk e kanë patur këtë mundësi kështu që po shpresoj që tash e tutje pas pavarësisë, pas shpalljes së pavarësisë ne do të kemi hapësirë edhe mundësi dhe edhe njëherë nga kjo foltore pres që iniciativës ekzistuese t'i bashkëngjiteni, se në një të them aheng ose në një fushëbetejë apo në një mundësi tjetër ku nuk do të jeni të pranishëm, ku nuk do ta keni informacionin e nevojshëm dhe çka duhet ndërmarrë më

tutje për ti parandaluar gjërat për të krijuar paqe dhe qetësi në Kosovë dhe realizim të të drejtave për të gjithë qytetarët, faleminderit!

Nora Ahmetaj: Faleminderit Shukrije, veq desha me të pyet vetëm shkurtimisht në lidhje me koordinimin meqë ti e ceke në mes të organizatave, shoqëria civile, qeveria që e ka, e ndan bashkë pushtetin me bashkësinë ndërkombëtare dhe shoqatat e familjarëve të zhdukur, a ka apo nuk ka koordinime në mes këtyre tri entiteteve? Vetëm pyetje shumë e shkurtër para se të fillojmë në debat se i kemi edhe dy panelista tjerë

Shukrije Gashi: Unë duhet të përgjigjem në këtë ? Unë po them që konsideroj që kjo është bërë në mënyrë të shkapërderdhur nuk ka pas, ka pas iniciative, ato kanë qenë shoqata e të zhdukurve ka bërë shumë dhe atë nuk duhet ta mohoj askush mirëpo asnjëherë nuk ka pasur vesh për të dëgjuar shoqatat e të zhdukurve dhe familjarëve kurse pjesa tjetër e shoqërisë civil këtë e ka bërë përmes konferencave, organizimin tryezave qoftë prej tyre, qoftë prej organizatave të huaja, siç ka qenë një ndër to UNDP-ja e ngjashëm brenda dhe jashtë vendit. Thash edhe njëherë dhe po e them që qeveria nuk k mundur të bëjë kushedi se çfarë për arsye që i theksova më herët, kaq.

Nora Ahmetaj: Faleminderit! Ia japi fjalën zotit Ahmet Grajqevci nga Asociacioni "Shpresa dhe kujtimi ", ju lutem Ahmet

Ahmet Grajqevci: Faleminderit Nora! I përshëndes të gjithë të pranishmit e përshëndes edhe koordinatorë për mbajtjen e këtij takimi, i përshëndes të gjithë familjarët që janë prezent këtu. Jam Ahmet Grajqevci, vij nga Fushë Kosova, nga një Srebrenicë e dytë të them në Kosovë, në atë vend ku nuk kishte Ushtri Çlirimtare të Kosovës por u kryen masakra, djegie nëpër shtëpitë e tyre, përdhunime e gjithçka. Sa i përket konferencës e cila mbahet sot për Komisionin e së vërtetës është mirë që për këtë komision të flitet, të pritët dhe të organizohemi aq më mirë sepse e them këtë se duhet një komision për të vërtetën, për të gjitha gjërat që kanë ndodhur , e vërteta duhet të jetë vetëm një e vërtetë dhe ka vetëm një emër e vërteta e jo e vërteta ma konfuzitet, sa për ilustrim do të ua them disa nga këto për shembull një zyrtar i qeverisë së Beogradit vjen dhe në raportin e tij me rastin A1 068 faqe 2 data 26.03.1999 thotë bombardohet shtëpia e Rexhep Breznicës në fshatin Dobrevë dhe aty thotë janë të vrarë gjashtë persona, në fakt aty nuk është asnjë person i vrarë civil por janë të vrarë në rrugë dhe të varrosur dhe unë i bëj pyetje zotit zyrtar a kishte ushtri aty a kishte civil, jo civil, në fakt e vërteta qëndron ndryshe dhe juve do të ju argumentojë me foto dhe ju familjarët serb mendoni se çdo gjë është e kryer në mënyrë komanduese dhe administrative se ata ushtarë kanë pas eprorë, kanë pas komandant, shumë bukur e dinë se çka ka ndodhur, kjo është e vërteta që duhet të dihet, a janë civil shqiptarë apo janë ushtarak apo policë. Unë do të ua ilustroj me fotografi që në këtë shtëpi ishin të vendosur radarët ushtarakë serb dhe aty ishin të vendosur ushtria dhe pas granatimit të NATO-s në këtë vend nuk u bë një hulumtim i tillë se a ka pasur trupa apo nuk ka pasur, ndërsa komandantët tyre nëse donë ta dinë se këta radar dikush i ka vendos se nga qielli nuk kanë pikë dhe nga shqiptarët jo sepse nuk kemi pasur, dhe këtu me siguri se janë vrarë shumë ushtarë dhe këtu është vetëm një rast, vetëm një rast do ta përmend sepse shumë raste janë granatuar nga NATO, ka pas shumë ushtarë dhe policë dhe as që janë hulumtuar, as që ka kërkuar ndonjëherë shteti serb që në ato pjesë ku kanë

qenë të vendosur policë dhe ushtarë serbë që të hulumtohet dhe të verifikohet se a ka nën ato germadha trupa të atyre njerëzve do të thotë përgjegjësinë e mban pikërisht qeveria e Beogradit sepse këtë ka mundur ta bëjë Bashkësia Ndërkombëtare, zyra e MPF-së, Komisioni që ishte për hulumtimin e krimeve, ndërsa sa i përket trupave të shqiptarëve në Kosovë a është zbuluar e vërteta dhe e kërkojmë të vërtetën dhe përmes këtij dialogu mund të kërkojmë të vërtetën, është manipuluar shumë raste që nuk dua të marrë kohë se do të ia jap zonjës Natasha Kandiç me shkrim që ta ketë, do të thotë ka raste ku një familje të tërë bëhet një manipulim, që nuk guxojmë të lejojmë të bëhet ai që është shqiptarë të jetë shqiptarë, ai që është serb të jetë serb, ai që është romë të jetë romë dhe ai që është ashkali të jetë ashkali, vetëm një rast sa për ilustrim do të ju tregoj rasti A1 280 qershor 1999, faqe 24 thotë në Breznicë thotë u vranë katër persona romë, nuk e cek se nga kush u vranë nga UÇK-ja apo nga policia serbe, por fakti qëndron ndryshe, këta persona të cilët eksitojnë në këtë faqe është Nebih Islam Krasniqi, Agron Nebih Krasniqi Skender Nebih Krasniqi dh Fatmir Nebih Krasniqi do të thotë shkruan romë, ndërsa janë shqiptarë dhe kështu nuk guxojmë të manipulojmë se po manipulojmë një me viktimën dhe dy po manipulojmë me familjen, ky është vetëm një rast sa për ilustrim, këtu duhet të jemi syçelë dhe të punojmë, ndërsa ata të cilët kryejnë krimet në mënyrë komanduese dhe administrative fakt se duhet një e vërtetë, duhet një e drejtë dhe krimi ka vetëm një emër krim! Gjenocidi ka vetëm një emër gjenocid dhe ata ushtarë të cilët në një kohë i bekonte kisha dhe prifti që të shkojnë në luftë dhe të zbatojnë urdhrat dhe komandën e asaj ushtrie u kërstitën(kryquan) në luftë prapë kërstitën në paqë dhe kjo është mirë që të gjithë të jemi të bashkuar dhe të luftojmë për të vërtetën, të luftojmë për komisionin për të vërtetën dhe atëherë ti zbulojmë mendoj se të gjitha, e kaq kisha unë, nuk do të marr kohë më shumë, materiali do ti dorëzohet Natashës komplet kështu si është e ju lë fjalën të tjerëve që të vazhdojnë, ju faleminderit të gjithëve!

Nora Ahmetaj: Faleminderit Ahmet! Besoj që nëse tregohet vullneti i mirë i gjithë pjesëmarrësve këtu si dhe pjesëmarrësve të rajoneve të ish Jugosllavisë do të vie ndoshta edhe deri te formimi i Komisionit, u edhe ju do të keni mundësi që, ju edhe të tjerët me parashtruar të dhënat, dokumentacionin dhe faktet. Dhe në fund më lejoni të ia jap fjalën zotit Aleksandër Stojanoviq, Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile nga Kosova

Aleksandar Stojanoviq: Quhem Aleksandar Stojanoviq, jam përfaqësues i Qendrës për Zhvillimin e Shoqërisë Civile – organizatë joqeveritare nga Mitrovica. Përshtendes të gjithë pjesëmarrësit e kësaj Konference Rajonale dhe u dëshiroje sukses në punën e tyre. Kjo është një temë shumë e rëndësishme por edhe proces nëpër të cilin duhet të kalojnë të gjitha shtetet e ish Jugosllavisë, nëse jemi të sigurtë në synimet tona për të realizuar pajtimin dhe bashkëjetesën e vërtetë. Kosova sot është shoqëri e kontrasteve. Në njërin anë kemi popullsinë e re, me gjithë forcën e vet rinore, arsimimin dhe potencialet, që mund të shërbejnë si masë kritike që mund ta ndihmojë gjithë regjionin në rrugën e tij kah e ardhmja më e mirë. Megjithatë, kjo po shkon shumë ngadalë. Të rinjtë ende po luftojnë me sistemin e vjetër të vlerave dhe janë në kërkim të vendit të tyre në shoqëri, kurse nga ana tjetër, gjeneratat më të vjetra, të cilat aktualisht po udhëheqin me shoqërinë, nuk janë shumë të disponuar që të sjellin ndryshime të shpejta në rajon. Proceset e reformave në Kosovë po zhvillohen shumë ngadalë, ato janë joefikase dhe nganjëherë duket se janë të paorganizuara. Mbretëron shkallë e lartë e papunësisë prej më

shumë se 80 për qind, ka probleme me sistemin elektro-energjetik, të cilat nuk janë zgjidhur akoma edhe nëntë vjet pas luftës, përkundër mjeteve të shumta të investuara, prandaj edhe këtë dimër shtrihet çështja e furnizimit me energji elektrike dhe kushteve elementare për jetë. Shoqëria është në udhëkryq në mes të sundimit të ligjit kundrejt anarkisë, progresit kundrejt radikalizmit, dhe po lufton me problemet e korrupsionit në gjirin e vet. Shoqëria është përplot dualizma të shumtë që lajmërohen në të gjitha sferat e jetës, e përkundër kësaj, nuk ka zgjidhje të përhershme për pjesën dërmuese të çështjeve politike, zgjidhje këto që sigurojnë stabilitet rajonal afatgjatë. Problemet me të cilat ballafaqohet Kosova, nga njëra anë janë të ngjashme me ato në pjesët tjera të ish Jugosllavisë dhe kryesisht kanë natyrë tranzitore, kurse nga ana tjetër, disa çështje, siç janë ekshumimi i viktimave të luftës së fundit, identifikimi i tyre, ballafaqimi i gjithë shoqërisë me të kaluarën, nxjerrja e kryesve të krimeve të luftës para gjykatave, janë të veçanta dhe shumë pak nga këto janë realizuar, kurse vet procesi është në fillim. Fatkeqësisht, akoma nuk ekziston vullneti i vërtetë politik që procesi të vendoset në binarë normal. Vetë procesi... më falni. Nga njëra anë jam në presion të kohës, kurse nga ana tjetër, nëse flas shpejt nuk do të më kuptoni. Prandaj, më mirë është të flas ngadalë në mënyrë që të kuptohemi dhe të kuptoni kontekstin e asaj që po them. Do të thotë, procesi për **iniciativën rajonale për përcaktimin e fakteve për krimet e luftës të kryera në ish Jugosllavi, duhet që me punën dhe faktet që do t'i ofrojë të ndihmojë në vendosjen e drejtësisë e cila duhet të shërbejë si pikënisje për proceset e mëtejme të pajtimit, re-integrimit dhe prosperitetit.** Gjatë këtij procesi të katarzës, është e domosdoshme të mundësohet krijimi i bazës për zhvillimin e vlerave kulturore dhe civilizuese, të cilat në të ardhmen duhet të rrënohen në qenien e shoqërisë së kësaj pjese të Ballkanit, përdërisa hapësira e Kosovës, që në të kaluarën kanë kaluar nëpër shumë vuajtje dhe vështirësi, të bëhet vend normal për jetë, që nga vendi i jo stabilitetit të vazhdueshëm të shndërrohet në vend stabil, pjesë integrale e Evropës, aty ku vlerat evropiane promovohen në vepër, kurse energjia dhe temperamentit i banorëve të saj të paraqesin forcën që e tërheqin Evropën kah Jugu dhe Lindja, duke përhapur idetë e paqes, stabilitetit dhe zhvillimit. U shtrua pyetja nëse çështja e serbëve të zhvendosur do të hapet në këtë Konferencë dhe, me të vërtetë, e falënderoj Simën për guximin që ka treguar kur ka ardhur këtu dhe në këtë mënyrë ka treguar në radhë të parë vullnetin e mirë që të dëgjohet e vërteta e të dy palëve, në përpjekje për të kërkuar zgjidhje serioze. Megjithatë, në bisedimet që kemi pasur me një pjesë të përfaqësuesve të personave të zhdukur, ata sot nuk janë këtu, morëm shumë të dhëna dëshpëruese dhe alarmuese. **Edhe 10 vite pas lufte, problemi i personave të kidnapuar dhe të zhdukur në Kosovë dhe Metohi, që ka filluar me kidnapimin e civilëve para lufte, e që ka zgjatur gjatë dhe ka përfunduar pas lufte, në kohën e prezencës bashkësisë ndërkombëtare, nuk është sqaruar ende. Snezhana foli diçka në lidhje me këtë. Kjo do të thotë se të dhënat mbi personat e zhdukur dhe të kidnapuar, së bashku me dëshmitë e dëshmitarëve, pjesërisht janë zhdukur.** Me fjale tjera kinse janë ngatërruar diku. Ky është versioni zyrtar i disa përfaqësuesve të KFOR-it të cilët janë marrë me këto raste. Kjo është thjesht tmerruese. Sipas njohurive të përfaqësuesve të viktimave, kjo ka ndodhur meqenëse përfaqësuesit e vendeve që kanë punuar në këto raste, pas përfundimit të misioneve të tyre e kanë bartur dokumentacionin me vete, përkundër faktit se këto informacione janë ndarë me përfaqësuesit e UNMIK-it dhe organizatat ndërkombëtare. Sot, disa organizata ndërkombëtare nuk po ua përcjellin informacionet përfaqësuesve të personave të kidnapuar dhe të zhdukur, kinse për shkak të

ruajtjes së sekretit zyrtar. Thuhet se hetimet ndaj personave që kanë kryer krime të luftës dhe krime kundër humanitetit ndaj popullsisë serbe dhe joshqiptare në Kosovë, janë duke u zhvilluar, por në praktikë ato po nuk po lëvizin. Kjo ka sjellë në situatë të tillë ku njerëzit që jetojnë në këto hapësira i takojnë çdo ditë kryesit e krimeve që lëvizin dhe jetojnë të lirë në shoqërinë kosovare. Më duhet ta pranoj se e njëjta gjendje mbretëron edhe në rajon. Shembull i posaçëm është Staro Gracka, ku janë vrarë korrësit në arat e tyre, në vitin 1999. Kryesit e krimit akoma jetojnë dhe lëvizin lirisht në afërsi të Stara Grackës, gjë që ngjall frikë dhe panik mes banorëve të fshatit, përderisa rastet e tilla ndikojnë në humbjen e besimit në gjyqësinë kosovare dhe ndërkombëtare, sikurse edhe besimin në parimet e drejtësisë universale. Procesi i ekshumimit nuk po përfundon, edhe pse dëshmitarët shqiptarë në disa raste kanë dhënë të dhëna të sakta se ku ndodhen varrezat me trupat e viktimave. Anëtarët e familjeve të personave të kidnapuar janë të gatshëm që, me ndihmën e miqve të tyre, ta kryejnë zhvarrimin e viktimave dhe t'i japin fund kësaj vuajtje, në mënyrë që më të dashurit e tyre të varrosen me dinjitet dhe në mënyrë civilizuese. Për fat të keq, për shkak të asaj që u tha këtu, përfaqësuesit e personave të rrëmbyer dhe kidnapuar besojnë se me ata po manipulohet për arsye politike, sepse nuk dikush nuk do që të përfundojë procesi i ekskumimit dhe identifikimit, pasi që pas kësaj do të hapej çështja e kryesve të krimeve të luftës, që nënkupton thirrjen në përgjithësi edhe të njerëzve që tani ndodhen në pozita shumë të larta në shoqërinë kosovare. Prandaj edhe procesi i ekskumimit po zhvillohet në mënyrë fëlliqur dhe të çuditshme. Familjarët e viktimave janë të mendimit se këta njerëz po mbrohen edhe nga përfaqësuesit e institucioneve ndërkombëtare, kurse gjithë kjo ndikon që përfaqësuesit e personave të kidnapuar dhe të rrëmbyer ta humbin besimin në drejtësinë dhe vendime të drejta, prandaj ata demoralizohen, mbyllen në vetvete dhe nuk dëshirojnë të marrin pjesë në iniciativat rajonale dhe të jenë pjesë e procesit. Mungesa e tyre, mungesa e përfaqësuesve të personave të kidnapuar mund të jetë me të vërtetë fatale për procesin të cilin po e ndihmojmë. Pa ata, procesi nuk do të jetë i plotë, kurse si pasojë e tërheqjes së njërës pale nga procesi mund të prishen themelet e procesit në rajon, përderisa vet projekti në të cilin po punojmë, në fund nuk do të jap rezultatet e duhura dhe nuk do të paraqes esencën e asaj për të cilën ne angazhohemi. Është e pamundur të shkojmë drejt të ardhmes, është e pamundur të hedhim hapa të tjerë të integritetit dhe pajtimit të vërtetë dhe afatgjatë mes kombeve që jetojnë në këto hapësira të përvuajtura, nëse kriminelët nuk i nxjerrim para gjyqit. Prandaj ekziston një frikë e arsyeshme. Për këtë arsye Qendra për zhvillimin e shoqërisë në tranzicion insiston që nga kjo Konferencë Rajonale t'u dërgohet apel dhe mesazh i fuqishëm qeverive të rajonit dhe përfaqësuesve të komunitetit ndërkombëtar, i cili duhet të ushtrojë presion në mënyrë që procesi i ekshumimit dhe identifikimit të personave të zhdukur të kryhet dhe të përfundojë shpejt dhe kryesit e krimeve monstruoze të sillen para drejtësisë, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre kombëtare. Pa u ofruar familjeve të viktimave informata për fatin e më të afërmeve të tyre, është e vështirë që të përmbillet procesi i pajtimit mes komuniteteve. Nga përfaqësuesit e komunitetit ndërkombëtar në Kosovë, gjatë gjithë këtyre viteve kemi dëgjuar shumë premtime në lidhje me këtë problematikë. Për fat të keq, ka pasur shumë pak rezultate. Njerëzit në terren përsëri po dëgjojnë premtime nga misioni i Eulex-it, i cili sapo ka filluar me punë. Por përvojat negative me premtimet e dhëna shumë lehtë në të kaluarën, por që asnjëherë nuk janë plotësuar, me të vërtetë janë shqetësuese. Prandaj, porosia jonë për këtë Misionin i cili ka mandatin ta vendos sundimin e ligjit, është se duam të shohim

vepra në terren, e jo fjalë dhe premtime boshe. Zëri dhe nevojat e përfaqësuesve të personave të zhdukur duhet të respektohen, përderisa zgjidhjet e qëndrueshme duhet të gjenden në kuadër të përpjekjeve të përbashkëta, brenda të cilave përfaqësuesit e viktimave do të konsiderohen partnerë, e jo grupe të caktuar. Nëse ne të gjithë së bashku jemi partnerë në këtë proces, pa marrë parasysh përkatësinë tonë nacionale, bindjet politike, apo çfarëdo përkatësie tjetër, nuk shoh arsye që kërkesat tona të mos përmbushen. Pse të mos vijmë këtu edhe Komisionet për personat e zhdukur të Republikës së Serbisë, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq apo përfaqësuesit e Gjykatës Specialë për Krime të Luftës. Ja, po e përfundoj. U bë fjalë për shoqërinë civile. Shoqëria civile mund të jetë faktor shumë i rëndësishëm në inicimin e këtij procesi, por edhe proceseve tjera të pajtimit dhe përmirësimit të marrëdhënieve në mes të popullit shumicë dhe pakicave. Për këtë qëllim duhet të punojmë për çdo ditë, pa marrë parasysh se ka disa çështje të pazgjidhura politike që krijojnë dallime dhe përçarje. Raportet jetësore duhet të ngadhënjë, e nëse kjo ndodh, zgjidhjet do të vijnë vet. Shoqëria civile, me të vërtetë, nuk ka fe, komb dhe gjini, ajo është e njëjtë gjithkund. Parimet e saj universale janë të njëjta për gjithë njerëzimin. Megjithatë, gjendja në terren tregon se pjesa shqiptare e shoqërisë civile është më mirë e organizuar, disponon me kapacitete të ndërtuara më mirë dhe thjesht ka investuar më shumë në vetvete gjatë gjithë këtyre viteve. Shoqëria civile brenda komunitetit serb, për fat të keq, nuk është e organizuar mirë, që pjesërisht është për fajin tonë, sepse kapacitetet janë në nivel shumë të ulët dhe është investuar pak në lidhjen, organizimin dhe krijimin e rrjetave mes tyre. Shoqëria civile e komunitetit serb ka qenë pjesë e rrjetave multietnike, por që disa çështje nuk kanë mundur të zgjidhen brenda këtyre rrjeteve nga individët në to, nëse paraprakisht nuk kanë pasur qëndrimin e komunitetit të tyre në lidhje me këto çështje. Prandaj, sot është më se e nevojshme që të punohet në ndërtimin e rrjetit të organizatave të pakicave, ku do të bëhet arsimimi i tyre, ngritja e kapaciteteve etj. Në këtë përpjekje mund të ndihmojnë edhe organizatat joqeveritare nga Serbia dhe rajoni, të cilat kanë përvojë të madhe në këtë punë. Rrjeti i organizuar i komuniteteve pakicë mund të jetë urë e fuqishme dhe e besueshme bashkëpunimi me të gjithë përfaqësuesit kosovar dhe ndërkombëtar, kurse vetë rrjeti, i cili për fat të keq akoma nuk ekziston, mund të jetë partner konstruktiv në kërkimin e zgjidhjeve për problemet e përmendura. Më duhet të them se në Serbi janë shtruar pyetje se a po zhvillohen procese gjyqësore kundër kryesve në vendet tjera. Në Serbi janë duke u zhvilluar gjykime për një numër të krimeve të cilat janë kryer kundër shqiptarëve të Kosovës Tashmë janë shqiptuar aktgjykimet e para dhe një numër i caktuar i njerëzve janë dënuar. Prosesi po vazhdon ende. Unë jam i ri dhe nuk kam marrë pjesë në luftë. Unë në atë kohë isha student. Nuk kam ndonjë përjetim të keq individual, por si i ri që jam, me të vërtetë mendoj se njerëzit e rinj, të gjithë ata që sot jetojnë në territorin e këtij rajoni, duhet të mbajnë përgjegjësi politike edhe për të kaluarën edhe për të ardhmen, në mënyrë që disa gjëra të mos përsëriten më. Për këtë arsye, ne duhet të krijojmë mekanizma dhe institucione stabile dhe shoqëri stabile afatgjate. Në të kaluarën i kemi shkaktuar shumë të këqija njëri tjetrit. Edhe një herë e përsëris, njerëzit të cilët i kanë kryer këto vepra duhet të përgjigjen, pa marrë parasysh cilit komb i përkasin. Unë jam i mendimit se ky Komision Rajonal mund të ndihmojë me të vërtetë, mund t'i lëviz gjërat përpara dhe për këtë arsye duhet t'i jepet mbështetje. Brezave të ardhshëm duhet t'ua lëmë hesapet e pastra, në mënyrë që ata t'i organizojnë jetët e tyre më mirë dhe të jenë më të lumtur se ne. Faleminderit.

Nora Ahmetaj: Faleminderit Aleksandër! Ju falënderoj të gjithëve për durimin, vëmendjen dhe aty këtu edhe komentet që i keni pas.

Tash ne panelistët mundemi me kontribuar, nëse keni pyetje, nëse doni me debatuar apo shprehni mendimet tuaja, të shkojmë me rend, vetëm po ia jap fjalën, Natasha e para e qoi dorën e pastaj shkojmë tek zotëriu atje, po... më falni prezantoheni kur e merrni mikrofonin, kush jeni dhe prej cilit institucion , organizatë vini, faleminderit!

Pyetjet dhe përgjigjet:

Natasha Kandiç: Ngadalë po i afrohem fundit të ditës së parë dhe më duhet të them se jam shumë, shumë e kënaqur me që ia kemi dalë mbanë këtë ditë. Pas nëntorit të vitit 2005, kur për herë të parë kemi provuar të diskutojmë për problemin e të zhdukurve, për zbardhjen e fatit të personave të zhdukur dhe për krimet e luftës, nuk kemi mundur të bisedojmë as për një orë të vetme, e pastaj biseda është ndërprerë. Sot ekzistonte frika se diçka e ngjashme mund të përsëritet, por kemi arritur që megjithatë procedura të mbizotërojë ndaj emocioneve dhe ia dolëm që me të vërtetë ta përmbyllim këtë ditë. Mendoj se kjo është e arritur e madhe. Për herë të kemi arritur të diskutojmë për problemin e të zhdukurve, krimet e luftës, zbardhjen e fakteve për krimet e kryera dhe atë e kemi bërë këtu, në Prishtinë. Shumëçka kam pritur nga ky sesion. Nevojat dhe pritjet e viktimave dhe shoqërisë. Nuk e di... e kam përcjellë me shumë vëmendje diskutimin e zëvendës kryeministrit të Kosovës, më bëri përshtypje që së paku 30 herë e ka përsëritur fjalën rehabilitimin e viktimave. Ai ka folur pikërisht për temën, ai foli për temën dhe përmendi elementet shumë të rëndësishme të procesit të zhdëmtimit të viktimave të krimeve të luftës. Por atë që e dëgjuam sot nga përfaqësuesit e shoqatave të viktimave të luftës, kam frikë se nuk kishte shumë të bëjë me temën mbi Nevojat dhe pritjet e viktimave dhe shoqërisë. Më vjen keq që këtu mbizotëruan fjalimet politike, që kishte fjalime të parapërgatitura, që nuk iu kushtua rëndësi faktit se në këtë sallë janë të ulur njerëzit që kanë vuajtur shumë. Unë shoh dhembje në fytyrat e tyre, të cilët edhe sot e kësaj dite vuajnë, sepse siç theksoi sot komisarja e Argentinës, kjo është dhembje që vazhdon gjatë gjithë jetës. Këta njerëz që ishin sot të ulur dhe dëgjuan tonin tonë të komunikimit kanë të drejtë të mendojnë se ne nuk po flasim për ata, për nevojat e tyre, pritjet e tyre, për atë se çka duhet bërë, por për gjëra tjera. Unë ju lus që në diskutimet të cilat po fillojnë tani ta keni parasysh këtë. Neve nuk kemi nevojë për fjalime të parapërgatitura, këtu nuk ka detyra politike, këtu ka vetëm përkushtim për atë që ne diskutojmë, nëse dikush ka dëshirë që të investoj, siç tha Tea sot, atë që është amësore, kohën e vet të avokimit, përfaqësimit të viktimave. Një ditë ky mund të bëhet projekt shtetëror, por askush nga ne nuk ka të drejtë që këtë ta trajtoj si projekt, por të gjithë e kemi për detyrë të kujtojmë se në esencë të gjithë kësaj qëndron diçka që është shumë e tmerrshme, është fjala për jetën e qenieve njerëzore. Zotëri Haki Kosumi vuri në pah diçka që të gjithë ne duhet ta kemi parasysh. Ai tha se ndoshta nuk është koha, se nuk mjafton vetëm të flasim, por do të ishte mirë që edhe ai të jetë më preciz kur flet. Në shtator ai e përkrahu fuqishëm iniciativën. Sot mendon pak më ndryshe. Unë jam dakord dhe mendoj se është absolutisht e vlefshme të rishikojmë atë që është e mirë, çka mund të jetë më mirë, çka mund të pritjet që të jetë zgjidhje e mirë për të ardhmen. Por gjithmonë nisemi nga ajo se gjithçka që flasim, gjithçka që bëjmë, gjithçka që iniciojmë, ka të bëjë

me mijëra e mijëra familje të cilat bien dhe zgjohen nga gjumi me një mendim: çka u ka ndodhur atyre, a kanë të tjerët ndjenja solidariteti për ata, a i bënë përshtypje dikujt ajo që u ka ndodhur atyre. Dhe, ju lutem, nuk është koha për fjalime politike. Ne nuk jemi politikanë, nuk jemi politikane, duam ta ndihmojnë edhe atë elitë që merret me politikë në mënyrë që ta ketë më të lehtë t'i marrë disa vendime, të ndihmojmë në krijimin e kushteve që të mos ketë më armiqësi, por të flasim ekskluzivisht në bazë të fakteve dhe të mos përdorim më fjalë të rënda, të mos sjellim këtu fjalime të përgatitura para disa viteve, të cilat po i përsërisim vazhdimisht prej asaj kohe. Faleminderit.

Miroslav Varga: Ju përsërites të gjithëve. Ashtu siç e tha moderatorja, unë jam Miroslav Varga nga Osjeku. Mund t'u them një mendim që më lindi duke dëgjuar gjithë këto diskutime: jam i sigurt se asnjëherë nuk do të zgjidhen të gjitha problemet. E di se në Kroaci ka pasur një presion të madh institucional dhe jashtë-institucional që të zgjidhen të gjitha rastet e krimeve që serbët kanë kryer kundër kroatëve, por ato nuk janë zgjidhur. Gjithashtu, nuk është për të besuar se do të zgjidhen rastet ku kroatët u kanë bërë keq serbëve; jam i bindur se këto nuk do të zgjidhen kurrë. Por ka dy gjëra për të cilat jam i sigurt se duhet bërë. **Të përkrahet kjo iniciativë që po shkon në drejtimin e duhur, e cila nuk mund të bëjë shumë pa ndihmën dhe përkrahjen institucionale, por si koalicioni i shoqërisë civile mund të hedh hapin e parë,** dhe e dyta, mendoj se... dhe ky ishte propozim që u bë në Podgoricë, kurse sot këtu as që u përmend, por mendoj se duhet të insistohet akoma që në këtë koalicion të bashkohen edhe shoqatat tjera që janë shfaqur si organizata të veteranëve, ushtarakëve apo mbrojtësve dhe kështu me radhë. Ja për shembull, unë jam anëtarë i disa shoqatave, por këtu jam si individ, nuk përfaqësoj asnjë prej këtyre organizatave. Mendoj se të gjithë ne kemi një detyrë, një dëshirë të madhe. Unë nuk dua ta marrë përgjegjësinë për veprat e shëmtuara që kanë kryer të tjerët. Mendoj se pajtohen me mua edhe njerëzit tjerë në të gjitha vendet dhe nga të gjitha kombet. Thjesht, është koha që të identifikohen kush janë ata në mesin tonë, e nëse ka të tillë, pse të vazhdojnë të jenë në mesin tonë...ata nuk i takojnë rrethit tonë, nuk janë miqtë e mi, nuk janë fqinjët e mi. Ata janë njerëz të tjerë. Dua të shtoj në fund edhe diçka tjetër që u përmend në Podgoricë dhe unë e propozoj edhe këtu të vazhdohet të flitet për ato. Çdo viktimitë ka të dhëna, ekziston dëshira që të zbulohet diçka për këto të dhëna dhe këto viktima Mendoj se është ide e mirë që ato të publikohen në internet, me pëlqimin e atyre njerëzve. Pse t'i lejojmë ndonjë teveqeli, të shprehem ashtu, nga cilido formacion ndërkombëtar ushtarak, t'i marrë dosjet, nëse ato mund të jenë në internet gjithë kohën. Jam i sigurt se këta njerëz që flasin këtu publikisht për problemet e tyre, janë dakord që lëndët e tyre të gjenden në internet. Do të ishte dëm që gjithë ato të mos mund të shihen nga të tjerët që jetojnë në këto hapësira dhe që njerëzit ta krijojnë vet të vërtetën në bazë të fakteve të cilat publikohen në internet...ato nuk do të duhej të verifikohen. Unë nuk besoj se dikush është i gatshëm ta paraqes vetveten rrejshëm si viktimitë. Jam i sigurt se këta njerëz duan t'i zgjidhin problemet e tyre, çështjen e familjarëve të zhdukur, të vvarë, e kështu me radhë. Ju faleminderit shumë.

Nora Ahmetaj: Faleminderit edhe nga ju . Zonja lartë.

Ruzhica Spasiq: Mirdita të gjithëve...apo është bërë mirëmbërë. Unë jam Ruzhica Spasiq, jam anëtare e Shoqatës së familjeve të personave të zhdukur apo të marrë me

forcë, nga Vukovari. Unë kryesisht i përfaqësoj problemet e serbëve të zhdukur në Republikën e Kroacisë. Nuk do të doja të komentoj deklaratimet e panelistëve të deritashëm, por dua të them diçka në lidhje me temën e paradites, mbi iniciativën për themelimin e Komisionit Rajonal për përcaktimin e fakteve pas konflikteve të armatosura. Mendoj se në forumet kaq të mëdha është e vështirë të diskutohet për një temë të caktuar, në rastin konkret për nevojën e themelimit të Komisionit për përcaktimin e fakteve. Që në konferencën e parë kishte shumë rezistencë, prandaj sot, në këtë konferencë, të katërtën me radhë, këtyre tre organizatave u ka lindur ideja që të krijojnë një komision të këtillë, të grumbullohet një numër i caktuar i nënshkrimeve në mënyrë që të detyrohen qeveritë për të formuar komisione të caktuara, për të përcaktuar njëfarë gjendje që kishte ekzistuar gjatë dhe pas luftës, do të thotë në kohë paqeje. **Mendoj se duhet kushtuar më shumë vëmendje dhe më tepër bisedime, punëtori, konsultime me grupet e shoqatave të personave të zhdukur, të vvarë, veteranëve dhe të tjerëve, siç e përmendi zotëri Varga.** Do t'ju tregoj vetëm një detaj. Një muaj më parë kishim takimin Koordinues Rajonal të Shoqatave të Personave të Zhdukur nga territori i ish Jugosllavisë, ku nuk merrnin pjesë vetëm shoqatat shqiptare të familjeve të personave të zhdukur, sepse ato nuk donin të ishin pjesëmarrës në Koalicion sipas modelit që ne, të gjitha kombësitë tjera nga ish Jugosllavia, e kishim organizuar, meqë ato mbronin një parim të tyrin për numrin e personave që duhet të kenë...por nuk do të doja të flas për ato tani...dhe kemi marrë vendim se asnjë nga shoqatat e familjeve të personave të zhdukur, serbe, kroate dhe boshnjake nuk do t'i bashkohen këtij koalicioni, respektivisht nuk do ta nënshkruajnë atë para Konferencës Rajonale e cila do të mbahet në fund të nëntorit në Beograd, në lidhje me problemin e të zhdukurve, përderisa dikush nga këto organizata nuk vjen të na shpjegojë se cili është qëllimi i tyre, cili është në të vërtetë qëllimi i Komisionit, çfarë përfitimi nga kjo do të kenë ato që do të punojnë dhe do t'u ndihmojnë atyre për t'i mbledhur një milion nënshkrimeve. Supozoj se kjo është arsyeja që asnjë prej shoqatave të familjeve të personave të zhdukur nga ish Jugosllavia nuk e ka nënshkruar këtë koalicion, megjithëse nga qëndrimi që kanë anëtarët e shoqatës tonë unë mund të them se ne e përkrahim këtë iniciativë. Por, do t'ju them edhe diçka tjetër. Popujt shumicë në Kroaci, Bosnjë dhe Serbi, kryesisht janë kundër kësaj iniciative dhe këtij organizimi. Popujt pakicë, siç janë serbët në Kroaci, apo kroatët në Bosnjë, respektivisht organizatat e tyre, janë në favor të themelimit të ndonjë forme të komisionit, sepse ata nuk mund t'i zgjidhin problemet e tyre brenda shteteve ekzistuese për ekskumimin, identifikimin, për faktet mbi vrasjet, për procedimin e krimeve të luftës, për të treguar çfarëdo forme të së vërtetës.

Nora Ahmetaj: Më falni, nuk e thash, secili i keni nga tre minuta. Nuk mundemi nga pesë, dhjetë minuta të flasim, më falni ju lutem.

Ruzhica Spasiq: Unë u lajmërova për fjalë para dite. Më vjen shumë keq ta them këtë, por po humbim shumë kohë në këto forume. Pikërisht këtë e thash edhe në diskutimet që i dëgjuam në Sarajevë, në Zagreb, në Beograd dhe ja, edhe sot kemi të njëjtin model. Sot është dashur të flitet për atë iniciativë, që njerëzit ta kenë të qartë se për çka bëhet fjalë, e jo të merremi me shqyrtimin e 10 ose 15 temave të ndryshme. Ja pra, nuk do të flas më. Më lejoni ju lutem vetëm edhe një pyetje. Paradite dikush e ka marrë folderin tim dhe e ka lënë të vetën. Në folderin time është ftesa që është bërë në emrin tim, në të ka fletë që

nuk janë shpërndarë këtu, prandaj do t'ju lusja t'i shikoni folderët dhe të ma ktheni. Kam një bllok tjetër nga ai...kam bllokun ku shkruan ICMP, prandaj shikoni ju lutem dhe ma ktheni, letrat që kam brenda janë me rëndësi për mua. Ju faleminderit shumë.

Prenk Gjetaj: Ju përshëndes të gjithëve, e përshëndes këtë iniciativë, unë jam Prenk Gjetaj , Kryetar i Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur. Më parë këtë iniciativë dhe çdo iniciativë që ka për qëllim zbulimin dhe zbardhjen e fatit të të pagjeturve e përshëndesim sepse edhe për atë jemi të thirrur, normalisht se nuk mund të bëjmë hapa pa i konceptuar gjërat por pa i nda. Shumëkush flet në emër të viktimave, në emër të familjeve, vetë zëvendës kryeministri është pjesë së familjes së të zhdukurve sepse ka shtatë anëtarë të familjes së ngushtë dhe të gjerë të zhdukur dhe sot e asaj dite nuk din për fatin e tyre dhe të gjithë janë zënë në një vend në Kralanin famëkeq me po mendoj në prill të vitit 1999 dhe nga ata njerëz ende rreth 60 janë të pagjetur, ndërsa një pjesë e vogël prej 86 –ve janë gjetur, do të thotë të gjithë e kemi këtë brengë dikush direkt, dikush indirekt, mirëpo me hipotekime, me paragjykime plotësisht pajtohëm me zonjën Natasha kur thotë me përgatitje paraprake politike sigurisht se nuk mund të bëjmë zgjedhje dhe të ndihmojmë procesin, nuk mund të ndihmojmë procesin, kur me paragjykime Kosovë e Metohi e ashtuquajtur UÇK e tjera e tjera sigurisht se irritojmë dhe duhet të kemi kujdes në këto se këtu jemi të thirrur për një çështje humane, njerëzore normalisht se edhe në shumë aspekte edhe ndonjëherë mund të kemi edhe konotacione edhe prapavijë politike sepse tash unë edhe në Komision edhe në grupin tjetër punues që e udhëheq pala e Beogradit sigurisht se e prezantojmë qëndrimet e institucioneve që i përfaqësojmë por e kemi një qëllim zbardhjen e fatit të të pagjeturve, rreth 2000 veta janë të pagjetur, hajde ti përkushtohemi të gjithë zbardhjes së fatit pa marrë parasysh dhe jo si Baliqi me përqindje po mendoj kaq janë fajtor shqiptarët e kaq serbët, unë s'ndaj përqindje dhe s'mendoj të bëj përqindje por kush është fajtor ai të mban përgjegjësinë dhe të gjykohet dhe mandej unë e respektoj atë zonjën që ishte nga Argjentina që na bëri një ekspozitë shumë të rëndësishëm mbi ngjarjet dhe zhvillime por dallime lufta në Argjentinë nga lufta çlirimtare shekullore në Kosovë dhe padrejtësitë do të thotë që edhe këtu ka konotacione dhe refleksione prandaj këto segment duhet me qenë fleksibile nëse duam me e ndihmuar procesin, një është zbardhja e fatit të të pagjeturve, dy është zbulimi i të vërtetës që është shumë e rëndësishme dhe tre është përgjegjësia, është edhe satisfaksion që e mundëson ecjen më tutje, çlirim nga ai ankth, nga ai presion në mënyrë që të ecim edhe më tutje, prandaj këto tri çështje duhet ti ndajmë thotë së pari të angazhohemi të gjithë ti lirojmë familjet dhe njerëzit nga ankthi, e dyta të shtrojmë të dimë të vërtetën që shumë është e ditur për shembull mua më shqetëson kur përmenden vendet dhe momentet normalisht kur në mënyrë një etnike ose vetëm përmenden serbët sepse nëse doni na kemi me qindra mija Mejën, Krushën e Vogël, Izbicën e tjera e tjera të gjitha i kemi por s'kemi nevojë ti përmendim, janë të njohura, janë të njohura bile janë të njohur edhe bartësit e atyre veprimeve kriminale dihen edhe me emra edhe njerëzit që kanë komanduar në ato momente, prandaj familjarët na pyesin sigurisht se zonja Natasha pa të keq po e them ç'është bë me majorin Grujiq në Kralan a i ka dhënë llogari ndokujt? Pastaj ekziston një mendim shumë i kuartë dhe qartë që në të vërtetë krimet që janë bë në Kosovë, të bëhen gjykimet në Kosovë, ka instalim të strukturave ushtarake, policore, civil, gjyqësore, ndërkombëtare dhe siguri të plotë që mund të bëhen gjykimet aty ku është bë krimi, vetë atëherë mund të qetësoj për të menduar për ndërtimin e të ardhmes,

por prapë po them së fundi çdo iniciativë që ndihmon procesin e paqes e tejkalimit të vështirësive edhe ankthit ne e përshëndesim. Faleminderit!

Nora Ahmetaj: Faleminderit zoti Prenk. Madej zotëria këtu, mandej Lushi, mandej ju, këtu, këtu ...

Velija Muriq: Të nderuar miq. Zagrebi, Merkala, Srebrenica, Reçaku, Kalugjerski Laz në Rozhajë. Të gjithë jemi mbledhur këtu për të njëjtën temë, për të njëjtat probleme, për dhembjen e përbashkët. A nuk ju duket se ne tashmë e kemi krijuar koalicionin? Unë jam i sigurt se këtë e kemi arritur, e ndoshta nuk jemi të vetëdijshëm. Unë vij nga Rozhaja. Quhem Veli Muriq, dikur kam qenë prokuror publik, pastaj për shumë vite gjykatës i Gjykatës së Lartë. Aktualisht jam avokat dhe jetoj nga kjo punë, kurse pothuajse gjithë jetën time ia kam kushtuar çështjes së të drejtave të njeriut. Jam nga Rozhaja, nga qyteti i cili gjatë kohës së luftërave shpesh ka pasur më shumë të ikur dhe të ardhur nga Bosnja dhe Kosova, sesa banorë vendas, natyrisht, pjesëtarë të të gjitha kombësive dhe konfeksioneve. Këtu nuk jam as në cilësinë e prokurorit shumëvjeçar, as të gjykatësit të Gjykatës së Qarkut, megjithëse edhe në këto detyra kam luftuar kundër atyre të cilët për shkak të veprave të këqija kanë humbur edhe besimin edhe fenë. Jam këtu mes jush, krah për krah me Natashën, Teon dhe me ju të tjerët, sepse ka 15 vite që në takohem me kriminelët dhe viktimat në sallat e gjyqit. Kam përcjellë dhe vazhdoj të përcjell gjykimet për krime lufte. Unë jam i angazhuar si profesionist në raste të ndryshme, në rastin e Shtërpces, ku janë kidnapuar dhe vrarë 18 boshnjakë në vitin 1993, mes të cilëve edhe një kroat, trupat nuk janë dorëzuar, kurse 30 kriminelë vazhdojnë të jenë të lirë në Serbi. Është gjykuar vetëm një person. Ngjarja e Kalugjerski Laz-it e vitit 1999, kur Ushtria e Jugosllavisë vrau 23 civilë shqiptarë, mes të cilëve edhe një fëmijë 12 vjeçar në mes të gjashtë motrave, Labinot Kastratin. Kjo ndodhi në rrethinën e Rozhajës. Ngjarjen e kam denoncuar në vitin 2005, hetimi është kryer në vitin 2007, padia u ngrit para dy muajsh, në paraburgim po mbahen shtatë persona, ndërsa një oficer ka gjetur strehim në Beograd. Murino, viti 1999, janë vrarë gjashtë civilë serb të pafajshëm, gjykimi është duke u zhvilluar në Podgoricë. Në këto raste viktimat janë shqiptarë, boshnjakë dhe serbë. Kryerësit e krimeve, në hapësirën të cilën unë e mbuloj, janë të po këtyre përkatësive etnike të cilat i përmenda. I kam takuar të gjitha familjet e viktimave të këtyre tre konfeksioneve, prandaj unë kam legjitimitet të bëj apel njerëzor këtu në Prishtinë, se ne i kuptojmë të gjitha viktimat, kurse po përpiqemi ta kuptojmë dhembjen e të tjerëve. Vrasësit e të gjitha ngjyrimeve ne nuk i quajmë heronj, qofshin ata njerëzit tanë më të shtrenjtë, baballarët ose vëllezërit tanë. Ta ngremë zërin kundër regjimeve që llobojnë për krimin dhe kriminelin, ta përkrahim idenë e heroinës Natasha Kandiç dhe idenë e shumicës prej nesh që jemi mbledhur këtu. Faleminderit.

Nora Ahmetaj: Po ia jap Lushit mandej zotërisë këtu, mandej shkojmë atje

Lush Krasniqi: Përshëndetje të gjithë të pranishmëve quhem Lush Krasniqi, jam familjar me dy vëllezër me status të zhdukur prej 6 vitesh dhe me axhën e vrarë të gjetur Batajnicën 5, në Serbi në prill të vitit 2006. Pasi që është tema edhe unë kisha menduar ose propozuar që ne së paku si pjesëmarrës të themi vetëm, sot po flasim për të vërtetën jo siç janë atje, pasi që është tema për të vërtetën unë them se të luftosh për të vërtetën

është një luftë shumë e vështirë. Lufta në Bosnje ka zgjatë 5 vite, 6 vite por lufta për të vërtetën zgjatë me shekuj andaj po mendoj që jemi duke u frikuar që të nisemi në këtë rrugë, por e kam thënë edhe në të kaluarën se të vërtetës nuk duhet ti frikohet askush përveçse ata kriminelë të cilët presin se me çfarë rezultatesh do të dalim ne sot nga ky takim. Ata vërtetë kanë dëshirë që ne të dështojmë sepse ata janë duke e fshehur të vërtetën me decenie. Është shumë më lehtë të thuash, të thuhet jo për një punë se sa të thuhet po, por arsyeja është shumë e thjeshtë, kur thua jo është kryer puna, me kaq kryhet. Kur thua po, merr angazhim, merr përgjegjësi dhe në këtë realizim të detyrës që e merr duhet edhe qëndrueshmëri, duhet shpenzime emocionale, psikike, materiale dhe fizike. Unë nuk mendoj as që ju mendoni, shumica nga ne që do të vijnë kriminelët para nesh pa i thirru fare dhe të na tregojnë krejt të vërtetën pa ua kërkuar ne. Kjo është diçka utopike, unë në fillim me 27 prill të 1999-ës kërkoja ose pasi që u kidnapuan familja në prani të familjes, gjithmonë dëshiroja ta dija se kush i mori, ç'u bë me ta, pastaj mendoja se një ditë do të ktheheshin pastaj mendoja se e vërteta është se ata janë në burgjet e Serbisë dikund dhe do të liroheshin me grupet të cilat u liruan më vonë, të gjithë nga ne deshëm apo s'deshëm ne e fshehim të vërtetën nga vetvetja. Kemi tentuar që të depërtojmë në çdo vrimë në Serbi që t dimë për fatin e të zhdukurve aq më keq u kemi besuar kriminelëve, u kemi dhënë edhe të holla, u kemi dhënë edhe beneficione të ndryshme, pastaj vdiq shpresa për të gjallë dhe i kërkuam kufomat, kërkuam shumë por edhe kjo ishte një kërkim për të vërtetën, për kufomën e njeriut, fatmirësisht disa i gjetëm, por ata që i gjetëm kemi harruar ti kuptojmë ata që akoma nuk i kanë gjetur. Po harrojmë shumë shpejtë, i gjetëm kufomat disa, po them për veti po flas në njëjës tash dua ta di kush i ka vra, tash dua ta di a ka mbet edhe ndonjë laps ose shkrepës apo një para apo një gjësend apo diçka, po thuhet se gjësendet personale të kufomës janë në Beograd dhe e dimë që janë, dua ta di të vërtetën edhe për to, dua ta di të vërtetën se edhe kush i ka vra, unë personalisht nuk dua të kërkoj në emër të kombit, vetëm i kërkoj në emër të familjes time, jam në gjendje të fal, nëse ai kriminel që i ka vra më vjen ballë për ballë dhe më thotë i kam vra dhe kërkoj falje, këtë mund ta bëj sepse nuk i frikohem të vërtetës sepse është dikush më i madh që dënon se sa ne duke u munduar ta dënojmë njeriu njeriun, bëhen gjithë këto luftëra duke e marrë ligjin ose detyrën e zotit mbi vete dhe çdonjëri u paraqitet zot ndaj dikujt tjetër dhe erdhëm te gjithë këto krime, duke e marrë rolin e gjykatësit, duke e marrë rolin e perëndisë. Unë mendoj që është një maratonë shumë e gjatë, një maratonë pa kufi dhe po them që nëse ne nuk do ta kërkojmë mos të presim që ta kërkojnë as të tjerët. Dhe po them, edhe njëherë të mos i frikohemi të vërtetës, ne çdo ditë e mashtrojmë vetveten ngapak në jetën e përditshme, unë ju përsëndes të gjithëve, ju uroj sukses të gjithëve atyre që kanë qëllime të mira, qëllime që rrjedhin nga zemra, nga shpirti dhe nga dhembja dhe dëshiroj që sanimet shpirtërore ti gëzojë çdo familjarë që është i prekur nga pasojat dhe krimet e luftës. Faleminderit!

Nora Ahmetaj: Mixhës e mandej shkojmë atje, po....

Bajram Qerkini: Unë jam Bajram Qerkini vij nga Mitrovica, edhe pse janë dy përfaqësues nga Mitrovica, folën ku mua nuk më pëlqeu aspak e do të jem shumë i shkurtë, mua më mungon me të vërtetë djali, mixha më është kallë me 6 anëtarë, me Nurien dhe me 4 fëmijë dhe e vetmja që mund të them se ka thënë diçka për neve është

Shukrije Gashi dhe një i ri i cili thotë për ligj. Do të ndalem veq pak të mendoni një minutë, një sekondë ose sa i çelni e mbyllni sytë në emër të prindit kur folet jo veq politikë por kur folet edhe thirret prindi me u qu e me thënë dilni përjashta se po folni përalla me miza. Ju lutem, aq shumë e keni qu punën politike të familjarëve të pagjetur që po doni me na lënë pa mend, kemi artefakte që po i shtini në dhe, e dini të gjithë çka na pengon asnjëri s'e keni thënë, të gjithë që jeni qaty në karrige artefaktet e gjalla në Kosovë hyn në dhe për me u fsheh, jo që na i kanë ik familjet e nuk e dimë ku i kemi por edhe ata që i kemi gjet artefaktet hyn në dhe. Asnjëri s'dini me e thënë këtë, pse s'dini? Pse s'dini a? Pse s'mundemi me na ndihmue? Po ju ka kap një politikë e interesit personale që po doni me na tranu! Unë ju them me fakte, profesori jonë s'ka pas çare pa ju thënë se për neve është herët për me fal krimin që është bë ndaj neve, herët është me e formuar një komision që na bjem deri te zgjatja e dorës së faljes. Ne e kemi patur të shtunën mbledhje, kanë qenë 19 shoqata edhe është përcaktuar shoqatat t'i themi komisioni regjional është herët të formohet me ata që e kanë bë krimin te ne. Ne i kemi dy komisione të cilat nuk punojnë fare për të pagjeturit, nuk i len shteti me punuar, s'i ka lënë shteti, të cilën e thanë edhe këtu se kemi qenë të përzier jo UNMIK-u, jo EULEX-i jo s'di kush e s'kanë mujt kurgjo me punu as për mua, as për shqiptarë as për serbë as për kërkend, po as tash s'ka me mujt ai komision. Ne do ta studiojmë si familjar nëpër shoqata e atëherë do të dalim në një mbledhje dhe do të themi qe ky komision është i mirë në regjion për shkak se e kemi kuptuar e tash nuk e kuptoj une, a thua pse Bajrami s'po e kupton? A është budallë ? nuk kam shkollë sa ju? Komisioni qeveritar te na nuk ka punuar, komisioni parlamentar nuk ka punuar e tash një pjesë humane do me punuar, tash kërkohet me e përqafuar një ide, një komision, në nivel të regjionit, bile bile na përmendët nga zonja edhe se edhe në Maroko edhe në Siri edhe në s'di ku edhe sot në Argjentinë edhe s'di ku ka komisione, oj zonjë e kemi lexuar, na kanë pru atë material, e kemi në shoqatë por ne ende duhet ta studiojmë çka jeni kah thoni, çka jeni kah punoni. As familjarët edhe atë dokumentacion që e kemi është turp me e përmend këtu, duhet dokumentacioni që ne kemi, dokumentacionin që ne e kemi fotografuar Ahmet Grajqevci s'ka vy këtu me i qit, le të pret edhe pak e qaj komision kur të vendos të thuhet në këshill e atëherë i vendosim, ne i kemi gjashtëqind e diçka dosje në shoqatë, 650 fotografi, nuk e di sa filma. Ne e kemi bë një padi njerëzve që e udhëheqin sot Serbinë, nuk na është kthyer për shkak të politikës, s'don politika me të lënë përpara, e din komisioni, e din zonja, e dini edhe ju shoqatat civile që s'të len politika me shku përpara, as për Bajramin në past bë krim, është një zonjë që i kam bë pyetje, unë jam në gjendje me fol me familjarë, me cilindo në është serb, në është kroat çkado qoftë që ka të humbur le të urnon le të bisedon, unë e kam thirrë zonjën prej Gulije e kam thirr zonjën prej Ostraçës hajde rrimë bashkë dhe të kallëzojmë ku i kemi fëmijët, 150 krushq i ke pas kur e ke qu djalin në Obri të Ultë me bo krime, e une ia di emrin e mbiemrin kush ma mori djalin por edhe kush ma mori nipin 5 vjeçar, ia di emrin e mbiemrin dhe skam mundur kurrë me marr përgjigje, hajde bashkë të ulemi se i njohim të gjithë edhe ata kaptera edhe atë. Mendoj se propozimi i shoqatave të Kosovës është me vend zonjë se herët s'jemi të përgatitur për me e formuar në komision, se komisionet tona në vend nuk janë kah e punojnë punën që duhet me e punu edhe me dal në ballë me ty, as në regjion as jashtë regjionit, ju keni marrë pjesë edhe në çdo vend të Evropës, ju faleminderit, kërkoi falje!

Nora Ahmetaj: Faleminderit! Haki e di që keni ... OK kemi edhe dy ztëri që po presin, tre në të vërtetë,

Haki Kasumi: Vetëm një minutë zonjës Ruzhica Spasiq me të cilën njihemi, iniciativa Këshillit Regjional Koordinues nuk është refuzuar nga Këshilli Koordinues i Kosovës, ne si koordinues kemi kërkuar paritet, le ta shiqon dokumentacionin, përgjigjen me shkrim që ju kemi dërguar udhëheqjes së Këshillit Regjional Koordinues dhe le ti kujtohet zonjës Ruzhica takimi në Banja Llukë në shkurt të vitit 2006 kur ne gjithashtu m gojë kemi kërkuar paritet, po ia kujtoj zonjës Ruzhica se ai pariteti diskriminues për shqiptarët në ish Jugosllavi ka vdekur njëherë e përgjithmonë prandaj s’jemi pajtuar dhe s’do të pajtohemi asesi që të jemi të diskriminuar. Ne edhe për Konferencën e XI-të Regjionale do të parashtrijmë me shkrim shkresën dhe kërkesën njëjtë, të barabartë, do të jemi të gatshëm që të vazhdojmë rrugëtimin tonë drejt progresit, faleminderit!

Nora Ahmetaj: kush ka qenë këtu, aha

Amir Taliq: Unë quhem Amir Taliq, jam nga Sanski Most i Bosnjë dhe Hercegovinës. Kam kaluar 13 muaj në burg si punëtor humanitar dhe gazetar. Nuk do të flas për tragjedinë time personale, nuk do të flas as për tragjedinë e Krainës së Bosnjës, shumica nga ju me siguri e dini se çka ka ndodhur në Krainën e Bosnjës, por do të përpiqem të flas për atë që është me rëndësi në lidhje me idenë për themelimin e Komisionit. Në esencë, unë e përkrah gjithë atë që duhet të bëjë Komisioni, por natyrisht, deri sa të arrijmë aty duhet bërë edhe shumë punë. Këtë do të mundohem ta shpjegoj me një shembull nga natyra. Në Sanski Most ekziston një deponi e hedhurinave e cila i ka kontaminuar të gjitha burimet e ujit kualitativ. Në mënyrë që këto burime të pastrohen, që nga ato të rrjedhë ujë i kthjellët, është e qartë se deponia duhet të largohet. Ajo që ka ngjarë në hapësirat e ish Jugosllavisë është pikërisht prishja e harmonisë që ka ekzistuar në mes të popujve. Mua më kujtohet se në ceremonitë e varrimit në qytetet e Bosnjës, ku njerëzit jetonin në mënyrë tolerante, merrnin pjesë njerëzit e të gjitha konfeksioneve dhe nuk kishte asnjë problem në jetën e tyre të përbashkët. Ajo që ndodhi më pas e çrregulloi jetën, pikërisht ashtu siç e përshkrova me shembullin e burimit të ujit. Nuk dua të flas këtu për viktimat e Krainës së Bosnjës, do të flas për diçka që shkon në favor të kësaj nisme, që ka të bëjë me krijimin e koalicionit, për diçka që ka të bëjë me fenomenin e festimit të krimit. Unë shpesh kam folur dhe kam shkruar për gjithë këtë dhe kam thënë se nëse luhet ndonjë ndeshje, në ndeshje merr pjesë edhe publiku. Ne nuk mund të merremi vetëm me krimet individuale, por duhet hyrë në gjenezën e krimeve dhe prapavijën e asaj që e ka transformuar fshatarin e rëndomtë në monstrum, i cili ka kryer krime gjatë luftës dhe i cili tani po gjykohet. Ata të cilët i njohin dhe i kanë përcjellë krimet e kryera kudo në botë, e dinë se, për shembull në Kinë, në regjionin e Manxhurisë, japonezët kanë kryer krime monstruoze ndaj kinezëve. Dhe kur janë përpjekur të bisedojnë me një ushtar japonez që kishte fituar të gjitha mirënjohjet për krimet e kryera, do të thotë ishte glorifikuar si hero, ai për fat të keq nuk dinte as si t’i shpjegojë ato. Ai ka thënë vetëm se mendon se ajo që u ka bërë atyre fshatarëve dhe fshatrave të Manxhurisë është plotësisht normale dhe morale. Për ne është shumë me rëndësi që ta arrijmë harmoninë ku do të identifikohen kriminelët e dëshmuar të luftës, siç është thënë edhe në diskutimet paraprake, si njerëz pa komb, pa fe... do të thotë se ata njerëz do të cilësohen

si monstruma, të cilët do të duhej të të konsiderohen të tillë nga çdo qenie njerëzore dhe në atë kuptim edhe duhet gjykuar. Kur zonja në sesionin paraprak foli për amnistimin e krimit, juve ju kujtohet që kjo në njëfarë mënyre edhe po ndodh në gjykatat e ndryshme, por edhe në Gjykatën e Hagës, sepse gjatë gjykimit të kriminelëve të luftës, ata që shprehin keqardhje dhe i pranojnë krimet, sikurse edhe ata që në njëfarë mënyre bashkëpunojnë dhe bëhen dëshmitarë të krimit të cilin vet e kanë kryer, marrin dënime të zbutura. Natyrisht se gjykatat nuk bisedojnë me viktimat dhe nuk kanë legjitimitet që ta zhvillojnë gjykimin në këtë mënyrë, por mendoj se për hir të viktimave, me rëndësi është dënimi moral. Prandaj kur gjykohen kriminelët në gjykatat, natyrisht se ato mund t'i dënojnë për veprat e kryera për aq sa është e paraparë me ligj. Por në këtë rast mund të amnistohet një pjesë e dënimit të tyre, nëse ata bashkëpunojnë. Gjatë punës në Sanski Most dhe në hapësirat e Krainës së Bosnjës, derisa po punoja në hulumtimin dhe kërkimin e të zhdukurve nëpër shpellat në gjithë territorin e Bosnjës dhe Hercegovinës, natyrisht se ishim në kërkim edhe të dëshmitarëve, njerëzve me vullnet të mirë për të folur për atë që ka ndodhur. Në të shumtën e rasteve njerëzit që na kanë dhënë informata për varrezat masive apo për krimet e luftës, këtë e kanë bërë për para, rrallëherë njerëzit... rrallëherë kemi marrë informata për arsye morale, për shkak të pendimit, rrallë ka qenë ndërgjegjja ajo që i ka shtyrë ata njerëz të flasin. Sidoqoftë, përsëri kthehem te ideja e krijimit të harmonisë mes njerëzve. Nëse e mbyllim këtë qark, kurse informatat kualitative, informatat e vërteta, pa marrë parasysh se çfarë janë ato, depërtojnë në të gjitha shtëpitë e këtij territori, ku jetojnë njerëzit e rëndomtë, e këta njerëz me siguri se nuk janë kriminelë, ata vetëm janë ndotur nga ajo që ka ndodhur, atëherë mund të themi se kemi arritur diçka. Prandaj është me rëndësi që pas përfundimit të kësaj Konference të merremi vesh për themelimin e gazetës, e cila është shumë e rëndësishme për krijimin e komunikimit sa më cilësor me njerëzit e rëndomtë dhe të jeni të sigurt se si rezultat do të kemi një numër gjithnjë e më të madh të atyre që do ta përkrahin iniciativën tonë. Prandaj, nëse konsiderojmë se ne, në njëfarë mënyre, jemi misionarë të paqes, atëherë është detyrë e secilit prej nesh që pas kësaj konference të flasë për ato që kemi dëgjuar në këto konferenca të vogla në komunitetet tona. Faleminderit.

Ramadan Asllani: Faleminderit zonjë për fjalën, jam Ramadan Asllani nga Ferizaji. Unë së pari dua ta përshëndes këtë takim me pjesëmarrësit nga komunitetet e ndryshme të ish Jugosllavisë, të cilët në një mënyre janë edhe pjesëtarët e luftëravë në ish Jugosllavi, dhe janë dëshmitarë të rënies së saj. Do të përsërisë edhe një herë, pasi që nuk kishte përkthim më herët. Nuk pajtohem me të gjithë parafolësit e mi, e veçanërisht me fjalimin e fundit të zonjës Kandiq. E vërtetë është se ne nuk jemi politikanë por duhet të merremi me politikën, sepse..... Do ta pyes publikun: A mundet dikush nga ju të pranishmit të më thotë se cilin nga ju nuk e ka sjellur këtu politika? A nuk është politika shkaktare pse jemi ne këtu, për pasojat që i ka shkaktuar ajo? Si është me të vrrarit, viktimat, të zhdukurit. Të shkatëruarit dhe gjithë të tjerët që nuk dua ti njehi këtu... A nuk jemi ne ata të cilët jemi mbledhur këtu, pasojë e saj? Politika është ajo e cila ka shkatërruar një sistem të tërë populli, e veçanërisht shqipëtarët në Kosovë, e cila i ka dëbuar 1 000 000 njerëz jashtë vatrave të tyre, të tjerët i ka shkatërrua në mënyza dhe forma të tjera. Deri në vitin 1999 kemi patur mbi 5 000 të zhdukur me dhunë, dhe të vrrarë pa dallime dhe ku ta dij unë, e tash kemi ardhur deri në një situatë ku politikën duhet ta shtyjme dhe mos ta lejojmë të mirret me këto çështje, që ne mos të mbledhemi më këtu. Nëse politika kthehet në

mënyrën e drejtë, sinqerisht edhe në kontekstin e parimit humanitar në kërkimin e këtyre fakteve tani, që do të thotë në kërkim të zhdukurve. Të paktën një pjesë e identifikimit, në një mënyrë do të lehtësonte pjesëtarët e familjes së viktimave, edhe pse jo në tërësi, atëherë ne nuk ishim mbledhë këtu. Pastaj ndoshta do të vie koha e faljes, do të thotë kush duhet të kërkoj falje.

Nora Ahmetaj: Faleminderit, urdhëroni zonjë.

Bakira Haseçiq: Unë po flas në emër të Shoqatës së grave – viktime të luftës, e cila siç e përmenda mbledh rreth vetes gratë dhe burrat e dhunuar dhe të keqtrajtuar seksualisht gjatë agresionit ndaj Bosnjës dhe Hercegovinës, të të gjitha përkatësive kombëtare: serbe, kroate dhe boshnjake. Nëse në Kosovë ekziston ndonjë shoqatë e grave që merret me torturën e ushtruar ndaj burrave dhe grave, ne jemi të interesuar të kontaktojmë me ata, apo të paktën të njoftohemi. Nëse nuk ka organizata të ngjashme këtu, atëherë na njoftoni. E tani, mos ma merrni për të madhe por më besoni...kur po kaloja nëpër Serbi mendova se kurrë në jetë... unë jam nga Vishegradi, vendi ku ishte fronti i luftës të Bosnjë dhe Hercegovinës. Pikërisht aty ku ai ushtari serb me shajkaçë, nga Lufta e Dytë Botërore qëndron në atë tunel të errët. Ndoshta e kanë dërguar që ta pastrojnë pak. E kam pasur shumë të vështirë gjatë këtyre viteve të vendos të vij këtu nga frika e gjithë asaj që kam përjetuar gjatë tre muajve në Vishegradin tim. Kur një zonjë nga Sarajeva, që po qëndronte në anën tjetër të rrugës, e përmendi disa herë Vranjën, më bëri të dridhem. Unë e lus zotëri Simën, të cilit ia dhashë vizit kartën dhe i cili më thotë të shkoj në Beograd, dhe zotëri Aleksandrin... një kriminel lufte, Milan Lukiqi, i cili ndodhet tani në Hagë, është banor i Hagës sepse ka dalë para drejtësisë, drejtësisë së Zotit, ju lus, që pas pauzës t'ua jap emrat dhe mbiemrat e kryesve të krimeve të luftës, sepse mua më thonë se ata janë të paarritshëm për organet e drejtësisë. Ata janë zyrtarë të lartë të ish Armatës Popullore të Jugosllavisë, njëri nga ata është në Vranjë, kurse një tjetër në Beograd. Dua që t'i fotografoni ata për mua dhe banesën ku banojnë, nëse dikush kërkon të holla jepjani lirisht, unë do të paguaj, mos pyetni për çmimin. Unë i njoh, një nga ata e përcolli Ojdaniqin, i cili na priti në Vishegrad. Për fat të keq ai nuk është gjykuar për krimet në Bosnjë dhe Hercegovinë, për Vishegradin tim të përgjakur. Shkoi bashkë me të në Hagë. Po të ekzistonte ndonjë mundësi unë do ta bëja atë vetë, por meqenëse ju u lajmëruat për të ndihmuar, ja pra, unë po ju ofroj mundësinë që, të paktën, të ma lehtësoni dhembjen mua, vajzave të mia, familjes time...qindra vajzave 12 vjeçare janë gra në Vishegrad, kurse këtë zotëriu nga Priboji, për ku tha...për Shterpce, do t'i them se brenda disa ditëve do të gjejmë një varr ku prehet një njeri, ndoshta ky është varri i njeriut që është nxjerrë nga treni që po udhëtonte për në Shterpce. Është vranë dhe groposur.

Nora Ahmetaj: Vetëm pak, tash është 5:15, ka kaluar koha e planifikuar, në 5:30 fillon diskutimi plenar. Mua më vie keq, por nuk kemi kohë të mjaftueshme, vetëm edhe dy veta, Feridja, zotëriu, dhe zotëriu Sima Spasiq. Keni vetëm nga një minut për të thënë atë që dëshironi, dhe pastaj vazhdojmë me diskutimin plenar dhe nuk na mbetet kohë për ti nxjerrë konkludimet. Ok, atëherë do të vazhdojmë nesër. Zotëri a ka mundësi ta mbaroni më shpejtë. Çfarë thatë? Ok shumë shkurt atëherë.

Ymer Melaku: Unë jam Ymer Merlaku, jam anëtar i familjes së viktimave, vëllaun e kam në mesin e të zhdukurve, djalin e vëllaut që është i zhdukur, i cili i ka pasur 16 vjet, dy djemtë e mixhës, djalin e vëllaut, djalin e motrës.

Të gjithë që janë të evidentuar si të zhdukur..., djali i motrës ende nuk është gjetur. I ka pasur vetëm 16 vjet, nuk dua të hy në këtë, vetëm deshta në pika të shkurtra të them se iniciativa për themelimin e komisionit nga ana e shoqërisë civile Unë vetëm mund të them , se secili anëtar i familjes i cili ka të zhdukur në familje ka dëshirë ti gjejë të zhdukurit. Iniciativa si e tillë është e mirë, pavarësisht nga cila anë vjen. Megjithatë unë mendoj se kjo përpjekje e juaj është pak e përsheptuar, dhe është herët për ne të cilët... unë qëe 9 vjet ballafaqohem me shoqata dhe ende nuk e kemi marrë pëlqimin e anëtarëve të familjarëve të viktimave për një iniciativë të tillë.

Iniciativa është në rregull por mendoj se është ende herët, ndërsa në anën tjetër ppo frigohej se Komisioni Rajonal, unë me të vërtetë jam skeptik, sepse me serbet nuk mund të flasim, nuk mund të arrijmë asgjë, nuk mund të gjejmë gjuhë të përbahskët. Në çdo minut ata mund të ndryshojnë çdo gjë, çdo aspekt, dhe rezultati do të jetë zero. Faleminderit.

Nora Ahmetaj: Shumë shkurt.

Sima Spasiq: Shumë shkurt. Pasi dëgjova tragjedinë e saj tronditëse, unë ia dhashë zonjës vizitë-kartën, sikur motrës time...kjo është sikur dikush ta kishte dhunuar motrën time, apo ndonjë kushërirë. Këtë që ju e thatë para 200 njerëzve, gjithë kjo është duke u xhiruar. Ja, Natasha Kandiç e dëgjoi këtë, më vjen keq që keni pritur gjithë këto vite që të dëshmoni. Unë po ju them me përgjegjësi, ne kemi disa kontakte me Prokurorinë për krime të luftës, Vukçevićin, edhe me Bruno Vekeriçin, pas kësaj do të ulemi së bashku me Natasha Kandiçin, do të më jepni të dhënat tuaja... unë po ju them publikisht këtu, ju premtoj para të gjithëve se Prokuroria do t'ju kontaktojë, do të ma jepni adresën dhe ata kriminelë, ata fundërrina do të marrin dënimin e merituar, atë që e kanë kërkuar. Prandaj, unë do t'ju lus që pas kësaj mbledhje, konference, të takohemi unë, ju dhe zonja Natasha, ajo mund të ndihmojë shumë në raste të tilla, në mënyrë që ata të marrin dënimin e merituar. Faleminderit shumë.

Nora Ahmetaj: Me të vërtetë ju falenderoj shumë për pjesëmarrjen, angazhimin dhe durimin tuaj. Nuk dua të marrë më shumë kohë nga konkluzioni i këtij diskutimi të hapur, do ti dorëzoj me shkrim. Unë e mbyll këtë diskutim publik. Tani në rend është diskutimi i hapur me të rinjë, ndërsa me pyetjet tjera mund të vazhdojmë gjatë ditës së nesërme. Faleminderit edhe një herë.

Jelena Simiq: Ju lutem vetëm tju tregoj se pas një pauze të shkurtër 10 deri 15 minuta, programi do të vazhdoj dhe në kuadër të programit përcjellës i kemi të gjitha seancat të cilat mbahen në vende të ndara. Në këtë sallë do të jetë Graciella, e cila sot na ka prezentuar përvojat në Argjentinë, në kërkim të fakteve për krimet e bëra në atë vend dhe ju nëse keni dëshirë, mund ti shtroni pyetje shtesë të cilat nuk keni arritur ti bëni gjatë seancës. Poashtu e kisha lutur edhe Hauardin, nëse ka mundësi të na bashkangjitet në këtë bisedë. Seanca e dytë ka të bëjë me qëndrimet e të rinjëve ndaj të kaluarës, kjo do të

mbahet në sallën matan rrugës, të ashtuquajtur salla e mesme, drejtë në këtë holl, kështu që mund të zgjedhni ku do të merrni pjesë.

29.10. 2008.

Pas seancës Dëgjimi publik i viktimave

Diskutim plenar

Debati mbi karakterin dhe mandatin e Komisionit rajonal për përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të të drejtave të njeriut në ish Jugosllavi (KOMRA).

Veprimtaria e Koalicionit për KOMRA dhe përzgjedhja e anëtarëve të Grupit koordinues (trupi operativ i Koalicionit)

Vesna Teršelić: Edhe njëher ju dëshiroj ditë të mbarë në këtë pjesë të rëndësishme të diskutimit në të cilën jemi duke e përgatitur formalizimin e Koalicionit për Komision Rajonal. Më kanë thënë që disa nga mediat e kanë publikuar informacionin që që tani e kemi formuar Komisionin. Ju të gjithë këtu e dini, se nuk e kemi formuar dhe as që do ta kishim bërë at sepse Komisionin mund ta formoj vetëm qeveria. Ne mundemi vetëm të propozojmë iniciativën tonë, të negociojmë me qeverinë, mundemi të kërkojmë dhe të bëjmë presion nëpërmes mbledhjeve të nëshkrimeve të qytetarëve, mund të bisedojmë për nevojat e viktimave dhe shoqërisë, të na tregojnë se çfarë ka ndodhur, por asesi nuk mundemi, e as nuk do të deshironim që ne vetë ta formojm Komisionin, sepse atëherë nuk do të kishte mundësi krijimi hapësirë të dedikuar zërit të viktimës. Atë çka sot dëshirojm është ta zyrtarizojmë Koalicionin, i cili është duke u krijuar sepse ju kanë bashkangjitur organizata të shumta nga vendet që ne vimë. Unë në këtë çast i ftoj të gjithë ata të cilët nuk e kanë dorzuar deklaratën, t'ia dorzojnë njërit nga ne, kjo vlenë për ata që do të deshironin bashkangjitime, por mos të bëjmë ndonjë lëshim me ata të cilët kanë vendosur, paraprakisht kanë diskutuar me organizatat e tyre, apo ndoshta si individ e përkrahin këtë Koalicion, të na dorzojnë deklaratën sepse në fillim të diskutimit plenar do t'iu informojm cilat janë organizatat dhe individët të cilët e mbështesin iniciativën dhe e formojnë Koalicionin. Dëshiroj të shtoj se në program janë paralajmëruar bisedimet rreth mandatit, pastaj ne grupi Koordinues kemi vrëjtur që është e rëndësishme të bisedohet rreth detyrave të Koalicionit, mënyrën e organizimit të Koalicionit, përgjegjësit dhe detyrat të cilat do ti kenë organizatat e ndryshme sepse jashtëzakonisht na duhen bisedimet rreth Koalicionit, çka, kush dhe sa ka mundësi të kontribuojnë në Koalicion. Në pjesën e parë do të bisedohet rreth përgjegjësisë, unë shpresoj se do të kemi kohë sepse mendoj se është e rëndësishme të bisedohet rreth mandatit. Disa nga ju janë deklarur që i'u nevojitet kohë, rreth kësaj do të bisedohet pas pushimit të shkurtër. Në hyrje të sallës gjinden deklaratat e zbrazura për bashkangjitime, në gjuhën serbe, shqipe, boshnjake, kroate, në gjuhën malazeze, dhe ja po më korigjojn, fatmirësisht puna e moderatorit është punë ekipore ... ka edhe në gjuhën maqedonase. Ja po e shoh arritjen të edhe disa deklaratave, gjithashtu shoh disa duar të ngritura lartë. Abdullah.

Abdullah Ferizi: Veç desha një vërejtje të vogël para se njerëzit me e nënshkruar së paku në versionin shqip, po shkruan që me këtë nënshkrim emri dhe mbiemri i bashkangjitet komisionit rajonal ndoshta ky është problemi se edhe në media ka dal që po formohet komisioni rajonal, po ma merr mendja që është gabim shtypi se kishte dashtë me qenë që po i bashkangjitet iniciativës koalicionit për formimin e komisionit rajonal kështu që mos të nënshkruhen kopje me gabim teknik, faleminderit!

Valdete Idrizi: Faleminderit Abdullah, mendoj që ke plotësisht të drejtë edhe nëse mundem me ndërhy Vesna, ndoshta nuk është aq e rëndësishme në këtë moment me nënshkruar, me vrapuar por me e rëndësishme është me diskutuar rreth koalicionit të gjitha këto çështje prej të parës këto teknike që është lëshuar e deri të gjërat tjera e ndoshta në fund të këtij sesi kur të qartësohen disa pyetje atëherë kishim me mujt edhe me i nënshkruar, e ka kërkuar fjalën Sheremeti mirëpo para se të ia jap fjalën vetëm të shikoj a ka edhe diçka me shtu domethënë paneli.

Vesna Teršelić: Propozimi im ka qenë ti lexoj organizatat, këtë punë do ta përfundojm me forcat e perbashkëta për mos tu dëgjuar vetëm zëri im dhe ta zyrtarizojm Koalicionin, do të shihni dhe vetë se kemi një koalicion të gjerë, koalicion të gjerë dhe variabël, pastaj do fillojm me diskutime rreth rolit të Koalicionit dhe rolin e organizatave tona të ndryshme në prezantimin publik të idesë për Komision Rajonal dhe tani në atë pjesë të krijojm hapësirë për diskutim. A është kjo në rregull? Po. A keni të shtoni diçka para se të fillojm. Ju lutem.

Sheremet Ademi: Faleminderit! Unë jam Sheremet Ademi, vij nga Fondacioni ‘Kujtimi’ në Mitrovicë dhe njëherit jam anëtarë i Këshillit Koordinues të Asociacionit të Familjarëve të Kosovës. Kam një vërejtje shumë serioze me këtë çka po bëhet tani, ju po merrni pëlqimin për krijimin e Koalicionit akoma pa e ditur mandatin, funksionin, kompetencat dhe çështjet e tjera, kjo është një vërejtje imja serioze, e dyta është se po e bëni këtë si akt të kryer dhe ne akoma nuk jemi deklaruar por shumë çështje substanciale dhe kjo na bën të dyshojmë ne sinqeritetin e të gjithë kësaj që ka ndodh që nga atëherë e deri më tani. Ju lutem këtë që po e bëni për mua nuk është e kuptueshme, nuk është e kuptueshme edhe më se përmbi 50 ose 90 % të njerëzve që janë këtu, kishit për borxh në radhë të parë ta shpjegonit, të tregoni çka është koalicioni, cili është mandati i tij, çfarë mendoni të pretendoni me mandatin e tij se mandatin ne nuk ia japim ashtu bllanko dhe para se të sillen ato lista me të nënshkruara, madje tani edhe për komision që doli si gabim teknik të cilin unë po e pranoj, të bisedohet për çështje tjera serioze edhe nëse është nevoja të rrimë edhe deri në ora një të natës edhe në dy të natës sepse ka disa vërejtje serioze në radhë të parë juve fasilitatorëve, organizatorëve ju fajësoj për faktin se, për faktin se është përmend e vërteta po nuk tregohet se çfarë është qëllimi final e ai është pajtimi, këtë e keni mësueh që nga fillimi i këtij takimi deri më tani, akti final i të gjithë kësaj është intenca dhe përpjekja për pajtim prandaj ju lutem që proceduralisht të ktheheni prapa, të shpjegoni se cili është mandati i asaj që po pretendoni ta bëni këtu, ti konsideroni ato fletë të dorëzuara si të padorëzuara, ti qaseni sqarimeve të nevojshme, leni kohë dhe hapësirë të mjaftueshme që ne ta analizojmë, ta studiojmë dhe mos mendoni që ad hoc me një nënshkrim keni arritur që të krijoni një koalicion sepse ai

koalicion faktikisht do të injorohet nga viktimat e luftës, nga shoqatat e nëse juve këtu, nëse për juve këto nuk kanë peshë atëherë urdhëroni pa neve gjeni faktet, krimet mbroni vetveten edhe vazhdoni avazin e vjetër, faleminderit!

Vesna Teršelić: Unë do t'iu tërheq vëmendjen se programi i dokumentit është dokument përcjellës, i bashkangjitur deklaratës, dokumenti është në dy faqe dhe gjithashtu është në të gjitha gjuhët, i cili flet për atë se në këtë rajon janë të vrarë më shumë se 120.000 njerëz dhe ne e dimë se gjykimet për krime të luftës janë më të rëndësishëm, mënyra më e dukshme të procesimit të këtyre krimeve por gjithashtu jemi të vetëdijëshëm se Gjykata Ndërkombetare në Hagë me kapacitete të kufizuara dhe gjykatat vendore me keqardhje nuk do të kenë mundësinë të shqyrtojnë të gjithë autorët e krimit, deri tani janë të akuzuar 250 njerëz dhe për atë kemi nevojë për mekanizma të cilat do të plotësojnë gjykimet për krime të luftës, e nxitojmë inicijativën për Komisionin Regjional për të krijuar hapsirën e dedikuar zërit të viktimës, jemi të vetëdijëshëm se në shoqërinë tonë vlerësohen llojshmëria e së vërtetave për parafytyrimin të së kaluarës dhe që në një numër të madh të rasteve ato bazohen sikur opinion politik me interpretim, dhe jo në fakte për këtë ne insistojmë në fakte. Është me rëndësi përcaktimi i fakteve, është me rëndësi përcaktimi i bazës të përbashkët, për interpretime të ndryshme të mundshme, e ndjenja e frikës për shkak të hakmarrjes dhe përsëritjes të krimit i largon viktimat nga pjesëmarrja në gjykimet për krime të luftës dhe kjo është inicijativa të cilën në fillim e ka nxitur Fondi për të drejtën humanitare, Qendra kërkimore dokumentuese dhe Dokumenta por pas saj na janë bashkangjitur organizata të shumta dhe individë, si organizatat për të drejtat e njeriut ashtu dhe organizata e femrave, organizatat e viktimave, individët dhe artistët, shumica të interesuar dhe të shqetësuar. Dëshirojmë t'iu themi se kush është bashkangjitur kësaj inicijative. Unë e di se ky tekst mund të avancohet, mund të qartësohet dhe aty ndihma juaj do të ishte e mirëseardhur, në veçanti ndihma e kolegëve tanë gazetarëve, të cilët kanë njohuri të mënyrës më të përshtatshme si ta plasojnë çështjen në opinion, por ato janë gjëra të cilat janë në dispozicion të të gjithëve, të cilat i keni tani, disa ndoshta shumë muaj më parë, disa në këtë Forum dhe mendoj se është mjaft qartë çka është thelbi i inicijativës tonë. Natasa Kandić është lajmëruar për fjalë.

Nataša Kandić: Unë vetëm desha të sqaroj. Zotëri Sheremet, ne dje shumë me vëmendje e kemi dëgjuar zotëri Haki Kasumin, e kemi dëgjuar dhe tri herë këtë verë dhe kemi vërejtur se për kohë kanë nevojë si individët ashtu dhe organizatat, për t'ia ofruar vetëvetës një ide për bashkangjitje rajonale. Bashkëpunim rajonal me fakte dhe si ta ndërtoj një lloj ure nga e kalura në të ardhmen. Ne nuk i kemi filluar sot bisedimet me këtë koalicion, bisedimet në nivelin regjional janë në vazhdimësi nga maji 2006. Disa kanë qenë pjesëmarrës qysh nga maji 2006. Nuk keni marrë pjesë ju, por ka pasur mënyra të përcillet, egziston informacioni në ëeb sajtat të organizatave të shumta për këtë proces konsultativ. Nuk keni pse të shqetësoheni. Ne kemi kuptuar se ju keni njëfar lloj frike, se ju keni ... se keni nevojë për kohë, ne kemi kuptuar se zotëri Haki Kasumi nga një takim mund të shpreh mendimin e tij, ndërkohë mendohet dhe vjen deri në perfundim se ende ka nevojë për kohë, pak më shumë kohë dhe ne atë shumë mirë e kuptojmë. Ne nga askush nuk kërkojmë të vendos kundër mendimit të vet, jashtë asaj çka ai mendon se është e

dobishme, por egziston diçka çka askush nuk mund ta mohoj, rëndësia e fakteve, rëndësia që shoqëria civile të provon në nivelin rajonal të vie deri tek disa konkludime të përbashkëta për atë si duhen të jenë raportet në fakte. Askush nuk mund të mohoj ketë të cilën e kemi dëgjuar sot, që i kemi dëgjuar viktimat, që nuk ka rëndësi, ne duhet të përqijemi që dëgjimi i viktimave mos të mbet vetëm në këtë sallë, por të transmetohet nëpërmes mediave dhe të jetë një çast politik i rëndësishëm i gjithë shoqërisë. Unë vetëm dëshiroj t'iu liroj juve të cilët jeni të shqetsuar, juve zotëri Sheremet, juve zotëri Kasumi dhe ndonjë tjetër... juve zotëri, ndoshta e dhe disa tjerë të shqetësuar. Mos u shqetësoni, ju lutem. Ne nuk jemi duke bërë asgjë të gabuar. Nuk mund të ndodh se një numër kaq i madh i oragnizatave për të drejtat e njeriut dhe viktimave nga të gjitha këto shtete punojn diçka kundër juve. Ne të gjithë kemi shumë dijeni se çfarë ka ndodhur këtu, kemi dëshirë që faktet të mblidhen dhe që të gjithë ti kuptojnë këto fakte. Nuk kemi hezitur me formimin e Koalicionit, ne dëshirojm edhe pse tri organizata kanë nxitur këtë iniciativë, ne dëshirojmë që të gjitha organizatat dhe individët të cilët mendojnë që procesi i përcaktimit të fakteve është i nevojshëm, dëshirojm të jeni në të. Nuk dëshirojm raporte elite rreth kësaj, dëshirojm të gjithë të marrin pjesë ashtu si të shtunën e kaluar në Podgoricë, kur një organizat e vogel për të drejtat e njeriut Human Rights Action në emër te Koalicionit i ka organizuar konsultimet, sikur dhe të dielen e kaluar Shoqata e nënave te Vukovarit, sikur shoqata e gazetarëve nga Vojvodina para dy jave kanë organizuar konsultime në Novi Sad, nëse dëshironi të jeni të lirë, kur mendoni se keni mundësi, dhe kur i keni të gjitha të qarta, jeni të gatshëm për bashkëpunim, që mendoni se ajo është e rëndësishme, nëse dëshironi, ne në Koalicion jemi të gatshëm t'iu mundësojmë organizimin e konsultimeve, si ne që i kemi mbajtur tri herë këtë verë. Për shembull organizata për të drejtat e njeriut Integra ka organizuar konsultime. Shumë herë kemi përmendur se është e nevojshme pjesëmarrja e të gjithëve jo për të sjell ndonjë anash dhe kisha thënë nëse atë e kuptojm, nëse e kuptoni, ju lus të merrni pjesë pa obligime për ta nënshkruar atë, të jeni mendimarrësit, vetëinicijator, propozoni, ndihmoni dhe nëse në këtë moment nuk jeni të gatshëm të jeni pjesë e Koalicionit, por pasi gjindenit sot këtu unë e marr se jeni të interesuar. Këtu shoh njerëz të cilët që dy ditë janë duke na dëgjuar me përkushtim, ndonjëherë janë të pajtimit, ndonjëherë jo por e gjithë kjo është pjesë e procesit konsultativ. Unë shpresoj që në vazdim do të kemi më pak keqkuptime, e më shumë qasje konsruktive rreth asaj që është ... Disa janë këtu ... për disa ky është Forumi i katërt, ata kanë aritur në një nivel që tani ata të mendojnë, në rregull, eja të rishqyrtojmë ... e kemi dëgjuar edhe eksperiencen e Argjntines, dhe unë mbrëm kam dëgjuar shumicën duke thënë: Po pritni, ne kemi arritur më shumë se Argjentina. Është mirë të dimë për eksperiencën e dikujt për të parë se ku kemi arritur ne. Të gjithë kemi pasur mundësi të mahnitemi me Argjntinasen, pas asaj çfarë na ka tregur, si ka vepruar, por e kemi vrejtur se ne jemi të ndryshëm, neve na duhet pak ma shumë kohë për konsultime, ata nuk kanë pasur këto konsultime të cilat i kemi ne, sipas saj kanë pasur një koalicion të përbërë nga 9 organizata per të drejtat e njeriut, ne tani kemi një Koalicion me më shumë se 100 organizata. Kështu ju ftoj të gjithëve, i kemi degjuar sot këtu të gjithë këta njerëz dhe ka qenë qetësi absolute, ka pasur respekt të lart për të gjithë atë që kanë folur, dhe kjo na vërteton sa sa është rëndësishme të dëgjohet zëri i viktimave në këto hapsira. Ne të gjithë jemi në atë pozitë që të ndihemi përgjegjës ndaj të së kaluarës dhe lidhur me këtë do të provojm t'iu përgjigjemi. Në nuk jemi institucion, nuk jemi ushtri, nuk jemi polici, nuk jemi as shërbim sekret. Ne i takojm, shoqërisë civile e

cila mund të jetë e fuqishme nëqoftë se ka ide, e cila mund të realizohet në qoftë se ka gatishmëri dhe vendosshmëri për të përfaqësuar dhe të shkoj tek përfundimi idesë, vizionit apo inicijatives.

Valdete Idrizi: Pasi e kam mikrofonin kisha pas qef veq dy tri fjalë e mendoj që me të vërtetë, pikërisht është tash koha kur duhet të hapen diskutimet e për atë s'po flasim për mandat të komisionit sepse është herët dhe është një proces bukur i gjatë mirëpo nëpërmes këtij koalicioni i cili veq është nis domethënë organizatat kanë marrë pjesë në konsultime, jo të gjitha, jo të gjitha e dinë qartë, për atë është shumë me rëndësi që të shfrytëzohet kjo kohë edhe të gjitha ato ide të cilat i kemi, të gjitha ato çështjet të cilat i kemi brenat, i thatë disa prej tyre por edhe disa të tjera të qartësojmë, për atë disa sigurisht që me nguti kanë nënshkruar, kanë marrë pjesë në aktivitete edhe i kanë pas gjërat më të qarta, ndoshta ende i kanë të paqarta mirëpo konsideroj që ndoshta tash është më mirë me e hap diskutimin, ju kisha lut që me e ngrit dorën që të ju shohim dhe një nga një me qenë sa më konstruktiv domethënë pikërisht për atë është ky koalicion se rruga më e mirë për me domethënë me e inicuar atë komision për të cilin po flasim tërë kohën. Po Sheremet,

Sheremet Ademi: Unë pjesën kryesore të diskutimit që e kam përgatitë nuk kam arrit ta them për shkak të çështjes paraprake që e thashë, do të thotë po e përsëris diskutimin përmbajtësor për të cilin kam menduar nuk e thashë për faktin se më është dukur e nevojshme të them disa fjalë për atë çështje paraprake dhe nuk u tha dhe nuk e mora shpjegimin e koalicionit të them përsëri për komisionin, mundem edhe të kem gabuar, sidoqoftë, u tha në emrin tim se po frikësohem nga ky proces apo ndoshta në forumin tjetër, unë detyrimisht më duhet ti them disa fakte të cilat vërtetë më frikësojnë për atë çfarë ka ndodhur deri sot, kam marrë pjesë në këtë forum për të shprehur mendimin tim, qëndrimet e mia dhe të asaj pjese të familjeve me të cilat kontaktoj shumë shpesh dhe duke u bazuar në këto qëndrime që i njoh, i di dhe që i marr nga burimi, e kam pas të nevojshme që duhet të jem këtu për të thënë atë çka mendojnë të tjerët dhe çka mendoj unë. Paraprakisht këtu më vjen mirë që kanë ardh familjet serbe, kanë ardh aktivistë serb, kanë mundur të flasin në mënyrë shumë tolerante të thonë atë çfarë të duan dhe pa pas frikë dhe madje fjalë fyese por ne përsëri kemi qenë tolerant, u vërtetuan se ka liri të lëvizjes dhe më vjen shumë mirë dhe kjo është Prishtina, kjo është Kosova dhe janë gjithmonë të mirëseardhur dhe gjithmonë kur janë konstruktiv, ky takim na mundësoi për të diskutuar për të pa mendimet edhe në këtë sallë edhe jashtë kësaj salle. Unë me vëmendje dhe emocione kam dëgjuar familjarët sot të cilët u rrëfyan, të them të drejtën përveç emocioneve kam pa edhe diçka të defektshme, jo profesionale, flas për rastin e familjes Bogujevci,, ne juristët fort mirë e dimë se gjykimi i kryesve të krimin duhet të bëhet në vendin ku është kryer krimi dhe marrja e qarja e viktimave në Beograd për të dëshmuar në një gjykatë ku nuk ka drejtësi po ka cirkus është edhe një shkelje e rëndë e të drejtës së asaj viktime, a e keni logjikuar këtë? E dinë këtë juristët shkëlqyeshëm dhe unë nuk mund të them se është bënë një mrekulli nëse ata kanë shkuar atje dhe në mënyrë laike besojnë se ka drejtësi në Beograd. Kush nga ne prej shoqatave të familjarëve dhe individëve kemi marrë mandatin për të formuar komisionin e së vërtetës? asnjëri! Edhe ju shoqëria civile nuk keni një rreth të gjerë të njerëzve të cilët ju kanë dhënë këtë mandat, absolut ne nuk kemi as mandat e as kredibilitet për këto çështje kaq të mëdhaja. Neve na

duhet një konsultim i gjerë në radhë të parë me familjet që janë viktime, akoma është dhimbja shumë e freskët për të fol për të vërtetën dhe pajtimin. Unë e pyes veten a jam ndërgjegjësuar deri në atë shkallë që ta them të vërtetën, shumë herë e shoh veten nga prizmi tjetër si familjarë tjetër. Ne kemi problem në radhë të parë me vetveten se nuk i pranojmë listat e personave të zhdukur ato që janë pranuar publikisht nga institucionet ndërkombëtare dhe kolegja ime familjare dha një shifër që asnjëherë nuk e kam dëgjuar, a po i flasim na , a po i flasim na familjarët të vërtetën, jo atëherë po e gënjejme veten e po i gënjejme edhe të tjerët. Ne në shoqata kemi biseduar dhe nëse është nevoja, ju lutem për mua është kjo çështja ma kapitale, unë po e shoh më se të domosdoshme përndryshe unë e mbyll diskutimin dhe ju urdhëroni vazhdoni me të tjerët, gjeni partner, individ, ata të cilët nuk janë të viktimizuar edhe sot bëjnë biznese, lëvizin lirshëm pa asnjë lloj problemi, unë jam i lumtur pse ndodh ajo, por jo të drejtën që të ndodh në emër timin dhe asociacioneve të familjarëve, sepse ne jemi grumbulluar në asociacionin e familjarëve, ne si asociacione të familjarëve kemi probleme edhe sa i përket rajoni edhe sa i përket Kosovës. Shoqatat familjare të serbëve asnjëherë nuk kanë marrë pjesë në një këshill koordinues se e kemi të përbashkët, këtu e kanë derën hapur, aty jemi tubuar 18 shoqata, shoqata familjare nuk janë regjistruar në Kosovë kur është në mandatin e UNMIK-ut, unë s'flas tani për Republikën e Kosovës. Shoqata familjare serbe edhe sot e kësaj dite quhen që janë shoqata familjare të serbëve të Kosovës, të gjithë ne të pranishmit përveç ndërkombëtarëve besoj që edhe ata e dinë, e dinë mirë kush e ktheu nocionin e Kosovës në Kosovë e Metohi dhe kjo për ne dhe kjo për neve është fyese. Unë po e ndërpres dhe nuk e keni parimin im dhe qëndrimin që edhe të formoni koalicionë, flas në emër të Fondacionit, edhe koalicionë edhe në të ardhmen do të ju bojkotojmë. Faleminderit!

Vesna Teršelić: Një shqarim, e kemi listën e gjatë dhe secili do ta ketë fjalën, secili qytetar dhe qytetare. Çdo njeri e ka të drejtën për të shprehur mendimin e tij. Këtë na garanton deklarata për të drejtat e njeriut, sipas kushtetutës sonë shtetasit kanë të drejtë të shprehin mendimin e tyre si qytetar. Ne mund ti vëm në veprim të gjitha iniciativat pas të cilave qëndrojmë, qka na lejon ndërgjegjja jonë, mendoj që kjo është një iniciativë shumë e rëndësishme dhe nuk kemi nevojë për asnjë legjitimitet tjetër për veq se ne jemi qëndrueshmërisht pas asaj dhe ata të cilët nga muaji Maj 2006 bisedojnë rreth kësaj iniciative, fuqishëm qëndrojnë pas saj. Kjo është një forcë e madhe, dhe kur ju shoh të gjithë këtu dhe i dëgjoj këto diskutime që vite me rradhë por dhe ata që për të parën herë i kam takuar dje, thjeshtë shoh një fuqi të jashtëzakonshme. Radhazi është lajmëruar...zotëri...urëdhoni. Valdetja si moderatore deshiron të shtoj diçka.

Valdete Idrizi: Veç edhe diçka kam nevojë të them, e kam thënë edhe dje në mëngjes e kam thënë që as ju familjarët, shoqata nuk mundeni kurrësi pa neve as ne nuk mundemi kurrësi pa juve, por as qeveria nuk mundet pa neve, kryesisht pa shoqërinë civile edhe thamë që më jep edhe si civil edhe si aktivist e kam marrë atë drejtë, e kam ndarë me juve arsyen pse iu kam përkushtua këtij procesi shumë të dhimbshëm, mirëpo e vetmja formë që mundemi me i vërtetuar qeto fakte për krime të luftës është kjo, edhe e thamë që të gjithëve neve na ka mbledh ai vullnet i mirë, të gjithëve neve këtu na ka mbledh qaj vullneti i mirë që të formohet një komision, hajt tash s'po folim për mandatin, kemi thënë komision rajonal, disa kanë thënë që idenë mirë e përkrahim ose nuk e bojkotojmë mirëpo nuk jemi gati që është shumë e arsyeshme, i kemi edhe disa gjëra të brendshme që

i diskutojmë, disa analiza, domethënë e shumë shumë gjëra tjera që janë përmendur, mirëpo mos të harrojmë që të gjithë këtu e ndajmë të njëjtën brengë edhe ne si organizata e të drejtave të njeriut edhe si individ pikësëpari edhe si familjarë, veq kisha pas qef edhe njëherë qysh e thash në mëngjes domethënë që kjo frymë le të mbretëroj te na për atë edhe po shpresoj dh po pres prej të gjithëve neve që të jemi sa më konstruktiv, mirë ndoshta nuk e dimë këtë koalicion okej, kush është në këtë koalicion deri tash dhe emrat e organizatave po i thojmë, unë mundem ti them organizatat të cilat deri tash kanë marrë pjesë në Kosovë, që deklarativisht nuk e kanë nënshkruar, as unë nuk e kam nënshkruar por qetsh e nënshkruaj se unë e di se idenë e kam qartë, disa organizata që kanë marrë pjesë në konsultime në Mitrovicë që disa prej tyre janë këtu edhe janë shumë të gatshëm me nënshkruar, normal një vërejtje m vend që erdhi prej Abdullahut se ndodhin këto gjëra po për këtë arsye jemi këtu dhe thashë ta ndihmojmë njëri tjetrin se të gjithë e kemi një qëllim shumë të mirë, kisha pas qef që, e dimë që ka qenë një ditë shumë e dhimbshme, e patëm sesionin e paraditës, domethënë kemi dëgjuar gjëra të tmerrshme të cilat kanë ndodh veq mos të lejojmë që qato të na e humbin arsyen të gjithëve neve domethënë pa i dallu grupacione apo individ të ndryshëm. Faleminderit! Më fal se kjo është duke e mbajtur listën e njerëzve.

Zvonimir Kubinek: Mirëdita, unë jam Zvonimir Kubinek, vijë nga Tuzla, nga Bosna & Hercegovina dhe kisha dashur të them disa fjalë rreth këtij Koalicioni për themelimin e Komisionit Rajonal. Faktet janë këtu të qarta se ky është Koalicion, e jo Komision. Më falni se e thash këshu, nuk do të thotë se këto janë apo nuk janë opsione. Dëshiroj të them disa fjalë rreth shoqatave, asociacioneve, frika është e arsyeshme, një mosbesim të cilin e shprehi zotëri Sheremeti, poashtu dhe zotëri Kasumi. Në njihemi sepse së bashku kemi punuar në disa akcione në rajon. Unë dëshiroj të shtoj diçka në vijim: Unë jam antarë i Këshilit konsultativ Institutit të Bosnes dhe Hercegovines, njëri nga gjashtë antarët, në Bosnë dhe Hercegovina egziston insititucioni, Instituti për të zhdukurit në kornizë të shtetit, atë zonja Natasha e di, në bord të këtij Këshilli kushtetues janë thuaj se të përfshira të gjitha shoqatat e familjarëve të personave të zhdukur nga Bosna dhe Hercegovina, Republika Sërpskes, Distriktit Brcko dhe Federacionit. Antarët e këtij keshilli konsultativ janë të përfshirë nga dy persona nga çdo komb, boshnjak, serb,dhe kroat.Unë dje kam vërejtur por edhe sot kemi diskutime të ndryshme. Zonja Vesna në diskutim ka thënë, vetëm t’iu përkujtoj, ‘Inicijativa nuk ka mbështetje në Kroaci’ ne e dimë kush është në krye Ivan Pshenica, ju me atë keni mbajtur takim, çka do të thotë se pjesëmarrja e shoqatave ka rëndësi themelore. Përbërja e këtij koalicioni nuk dua ta teproj do të jetë më shumë se 80 % nga shoqatat, asociacionet për persona të zhdukur të cilët janë dhe viktimat e krimeve të luftës. Çka dëshiroj të them në vazhdim është se dje kemi dëgjuar nga zotëri Haki Kasumi i cili është drejtor apo kryetar i 19 shoqatave në Kosovë se e ka shprehur një mosbesim dhe për atë nuk e mbështesin këtë koalicion.Unë këtë dëshiroj ta përcjellë dhe nga Bosna dhe Hercegovina.Ne vijim dëshiroj t’iu them se ne jemi të përgatitur për këtë takim.Këshilli konsultativ në këtë mënyrë nuk e përkrah këtë iniciativ për personat e zhdukur, askush nuk e ka mandatin dhe të drejtën e nënshkrimit, asnjë shoqatë nga Bosna dhe Hercegovina, këtë e them publikisht dhe me përgjegjësi të plotë. Por si qytetar i rëndomt kam te drejtë. Nëse me pyet dikush mua si një qytetar i këtij planeti, i cili është viktimë dhe merr pjesë në këtë, unë do të përgjigjesha jam pro.

Por shoqatat, pas të cilave është një numër i madh i popullsisë , atëherë përgjigjja ime do të ishte Jo. Për këtë shtrohet pyetja, unë e di se ky është një projekt i madh, projekt ambicioz, një projekt me rëndësi te veçantë në tërë rajonin. Në këtë çast shumica e tyre të cilët janë pjesa më e madhe e tij, dëshiroj t'iu tërheq vëmendjen se duhet zgjidhur një tjetër qasje, një afrim më të ndryshëm, mund t'iu them... nga kjo del që ky koalicion është vetëm për Kosovën dhe Serbinë. Sipas diskutimit të Kosovarëve po del që as ata nuk dëshirojnë të qasen në këtë mënyrë. Unë këtu e kam dëgjuar deklaratën e Haki Kasumit, çka do të thotë se ata kanë një mosbesim. Të jam i sinqert edhe unë kisha dashur të më degjojnë pa komente dhe pasi të përfundoj mund të komentoni. Të jem i sinqert mbizotëron mosbesimi, këtë mosbesim duhet ndërtuar, që do të thotë, unë i dëshiroj punë të mbarrë kësaj Konference, të realizoj synimet, sipas asaj që jam duke parë unë ,shumica janë persona të zhdukur dhe shoqatat dhe nuk besoj që do të shkoj aq thjeshtë. Nëse ju e keni për qëllim që deklaratën ta nëshkruajnë qytetarët të cilët nuk janë përfshirë në këtë proces, sikur shkrimtarët, artistët dhe të tjerët, tani e gjithë kjo punë është e karakterit human dhe unë si një qytetar i këtij planeti jam Për. Të nderuar ne duhemi të luftojmë për ata që janë viktima. Në këtë moment nuk besoj që qeveritë e Kroacisë dhe Bosnes dhe Hercegovines, nuk di për Sërbi por gjithashtu nuk besoj se edhe qeverija e Kosovës do ta miratoj pajtimin pa bisedë paraprake me shoqatat e veta. Sepse, vëni re , kjo është e rregulluar nga ana ligjore në çdo shtet. Ka fundi jam zonja Vesna! Domethënë nuk jam duke i shprehur dyshimet vetëm thjeshtë jam duke ju parashtruar pyetje:„ Si do ta afroni shumicën e tyre të cilët janë viktima ?” Unë ju falemnderoj.

Vesna Teršelić: Ju falemnderit. Edin Ramuliq atje pas.

Edin Ramulić: Unë mendoj pasi vij nga shoqata në emër të cilës ka folur zotëriu para meje, duhet të cekë se interesimi Shoqatës familjare për persona të zhdukur nga Bosna dhe Hercegovina për këtë iniciativë është shumë i madh . Atë që e tha zotëriu paraprak është gënjeshër që e dinë të gjithë, e gjitha është nëdertuar në Sarajevë, pak para arritjes këtu, e gjitha është e paralajmëruar, kjo deklaratë është e paralajmëruar në medijat e Bosnës, këtë e di, mund të emëroj, ka ardhur nga njerëzit nga Instituti, bordi drejtues, konkretisht nga Amur Mashoviq dhe të tjerët. Ata kanë udhëruar se në këtë mënyrë të prezentohet fakti se kjo iniciativë nuk ka mbështetje në Bosnë dhe Hercegovin. Nuk besoj që egziston asnjë familje, shoqatë, të cilës në mënyrë të duhur i shpegohen të gjithat çështjet, dhe efektin e kësaj dhe pastaj të mos të jetë e gatshme ta pranon inicijativën. Të kundërt janë vetëm ata të cilët janë ndjerë që nuk janë mjaft të inkuadruar. Zotëriu është antar i Këshillit konsultativ që nuk e ka perkrashjen e shumicës të shoqatave familjare të zhdukurve edhe mëtutje mbijeton në këtë këshill konsultativ sepse dikush i ka pozicionuar aty, dikush nga Ministrija i ka emëruar aty dhe këta tani pa kurfar konsultime vijnë këtu dhe marrin drejtën të flasin në emër tim dhe shoqatës time e cila gjatë tërë kohës është e interesuar për këtë. Kisha pasur dëshirë t'iu them vetëm një detal të vogël, interesimi në Bosne dhe Hercegovin egziston dhe ju lus te vazhdoni me punë, kurse këtyre qëndrimeve mos t'iu japim rëndësi. Kjo ishte e tëra, ju falemnderi.

Vesna Teršelić: Rradhazi do të flasin: Mirko Kovaciq, Haki Kasumi, Ruzhica Spasiq, pastaj Sima.

Andrej Nosov: Ju lutem, egziston lista të cilës duhemi ti përmbahemi. Vesna i ka lexuar tre emra të parë, pastaj do t'u japim fjalën të gjithëve. Mirko urdhëroni, Mirko e ka fjalën.

Mirko Kovačić: Miredita te gjithëve, unë nuk e kam tabelen me udhëzime të gabuara, kam dashur ta ngris lartë por nuk vlen. Te ne në parlament kur dikush flet gabimisht, thojnë udhëzimet e gabuara. I nderuari zotëri, Këshilli i Shoqatave të Familjarve për Persona të Zhdukur dhe Burgosur, ka qenë e pari në Kroaci që ju ka bashkangjitur inicijatives. E zonja Spasic do të flet per vete. Unë jam horr apo mi i vjetër . Sot në mëngjes jam zgjuar heret për të shkuar ne kioskë për të blerë shtypin. Gjuhën shqipe nuk e di por gazetat i kam përzgjedhur sipas fotove dhe titujve, duke shpresuar se pastaj dikush do të ma përkthej. Më besoni se i kam shfletuar shtatë botime të shtypit por vetëm në njërën kam gjetur shumë pak. Dhe mos të kishte qenë presidenti dhe atë nuk e kishin shkruar. Te ne, kur ndodh një ngjarje e till dy ditë më herët ne e kemi informacionin në TV. Dje prap kam ikur në dhomë dhe kam shikur programin televiziv të Prishtinës. Diku rreth 15 min është emituar një emision mjaft i bukur, por ka qenë bashkëpuntorja e shtypit të Bosnës. Ti kthehemi zotëri dilemës tuaj. Dje dhe sot jam duke ju folur te gjithëve por duke i'u drejtuar vetëm juve, keni dëgjuar çështjet të cilat janë shumë të vështira për një njeri, shumë e vështirë për një nënë, dhe më besoni 17 vjet në kërkim pas të afërmeve të mi, këto dy ditë kanë qenë më të rënda në jetën time. Nëse këto nuk i'a kanë prekur shpirtin askujt, zemrën, gjuhën pra unë nuk di çfarë tjetër të bëjë. Kjo është numër një. Dje, keni pasur mundësi, por nëse nuk keni pasur mundësi të dëgjoni, keni pasur mundësi ta shiqoni gruan e cila pas abuzimit seksual e ka lindur fëmiun të cilin prap se prap e ka dashur. Kjo është puna që na pret dhe zbulimi i së vërtetës. Keni shikuar për Marokon, është një shtet i vogël ku janë lajmëruar një përqindje e madhe e viktimave, si pasojë e kësaj është arritur vendimi i dëmshpërblimit të tyre në anën materiale dhe morale. Do të thotë, këto janë hapa të cilat janë të rënda dhe për ta dhe për ne. Është shumë mirë se e kemi filluar diskutimin në këtë mënyrë, sepse duhet ti pastrojmë mendimet tona, dhe të nisemi...më besoni, unë me këtë punën tonë dy-tri ditore besoj se do ta realizojmë me sukses. Ju falemnderit.

Vesna Teršelić: Falemnderit. Haki Kasumi, urdhëroni.

Sheremet Ademi: Falemnderit! Këtë zotëriun nga Kroacia, unë njoh shumë njerëz të Kroacisë, të shoqatave veq kështu kroat takue nuk kam që jep autorizime blanko pa e përfill bazën po do të sqarohmi me kolegët tuaj atje në shoqatë një, e dyta sa i përket veshëve edhe syve nëse mëtanë shurdhuar më kanë shurdhu të dashurit e mi që s'e di ku i kam e ti pasi po ndeshe aq mirë atëherë s'paske pas dhembshuri për të dashurin tënd. Unë do ta jap veq një shembull në Kosovë ka ndodh që nanën e kanë detyruar që ta haj mishin e fëmiut të vet dhe nëse ka bir none që të thotë në këto momente pa pas miratimin e të tillëve për pajtim, urdhëroni zotrore e keni derën hapur, unë nuk do të flas. Falemnderit!

Valdete Idrizi: Më falni veq pak, mendoj që Feridja ka të drejtë, ndoshta Vesna ta caktojme një kohë të caktuar për të gjithë folësit, në mënyrë që me i dhënë të gjithëve fjalën se interesimi është shumë i madh

Haki Kasumi: Unë dje e kam prezentu, e kam shpreh opinionin tim, vlerësimin tim për këtë iniciativë pranë të cilit qëndroj, të cilin e kam thënë edhe në konsultën e 4 tetorit të vitit 2008 dhe po e përsëris nëse ka nevojë, kjo iniciativë është në interes të përgjithshëm dhe si të tillë mendoj se duhet ta marrim dhe ta vlerësojmë lart, por mbështetje për këtë iniciativë, atëherë dje dhe sot po them se më duhet të marr pëlqimin e njerëzve dhe familjarëve dhe përfaqësuesve të shoqatave në emër të të cilëve unë dje kam folur dhe mund ta jap pëlqimin, e lus zonjën Natasha Kandiç të mos luaj me fjalë ngase nuk jam femi, nuk jam njeri joserioz dhe nuk jam përfaqësues i shoqatave joserioze. Të ketë kujdes në të ardhmen kur vlerëson ose kur kualifikon fjalët, fjalët e mia e sidomos fjalët e përfaqësuesve të shoqatave shumë të goditura nga lufta e fundit. Faleminderit!

Vesna Teršelič: Falemnderit. Haki Kasumi, urdhëroni.

Vesna Teršelič: Ruzhica Spasiq.

Ruzhica Spasić: Pakëz qetësi ju lutem! Mirë që nuk e keni caktuar kohën e tre minutave sikur dje, kemi dashur të themi diçka shumë të rëndësishme lidhur me këtë çështje por nuk kemi pasur kohë. Këtë çfarë tani ka përjetuar zotëri Kubinek tani është shumë e pakëndshme sepse unë dje e kam përmendur Koordinacionin Rajonal të Shoqatave të Familjarëve të Personave të Zhdukur e cila ka qenë në muajin e kaluar në Brčko dhe kanë biseduar rreth kësaj teme, a do të bashkangjiten Shoqatat këtij Koalicioni, dhe cili është interesi jonë. Per atë kemi ardhur deri tek përfundimi se kishte qenë mirë që përfaqësuesit e këtyre organizatave ti dërgojmë në Konferencën Rajonale, ashtu edhe kemi vepruar, me përgjegjësi të plotë them se të gjitha Shoqatat nga Bosna kanë qenë kundër kësaj inicijative, të gjitha Shoqatat nga Kroacia, të gjitha Shoqatat nga Republika Sërpska ose Bosna dhe Hercegovina, për atë sot jam e befasuar kur dëgjoj se Këshilli i Shoqatave Familjare për Persona të Zhdukur e ka nënshkruar Koalicionin, e kryetari i Këshillit ka qenë decidivisht kundër inicijativës, kundër asaj ta ftojme dikë nga Dokumenta a po nga ndonjë organizatë tjetër dhe me të vërtetë kam qenë e befasuar, këtë nuk kam dashur ta them dje por sot gjithësesi do ta them se Këshilli i Shoqatave Familjare dhe të Burgosurve ka qenë partner të barabartë me Dokumenta dhe organizatat tjera në konsultime. Ja lejoj vetës drejtën për të thënë se disa njerëz kanë mosbesim ndaj këtij koalicioni dhe sa më duket kanë të drejtë, se qëllimet ndoshta nuk janë të sinqerta, apo ndoshta janë vetëm për përfitime financiare në çka dyshojnë një numër i madh i Shoqatave të Familjarëve të Zhdukurve. Ju jeni organizatë e madhe juve do t'iu takojnë projekte të mëdha, e ne të vegjëlët do të mirremi vetëm me grumbullimin e nënshkrimeve. Ky nuk është qëndrimi im, tani jam duke e përcjellur atë çka kemi mundur të konkludojm nga ky diskutim. Do të thotë se edhe Këshilli Koordinues i Shoqatave të Familjarëve për Persona të Zhdukur e ka shkelur marrëveshjen të cilën e kemi miratuar në Koordinacionin Rajonal. Këtë deklaratë ma kanë dërguar para dy muaj për ta nënshkruar, dhe Vesna shumë mirë e di sepse e kam thirrur për të marrë informata më të hollësishme sikur se çka duhet të bëjmë dhe etj. Por këtë unë e kam shtuar deri tek Brcko dhe e kam respektuar

marrëveshjen e 15 antarëve të Koordinacionit Rajonal, duke mos e nënshkruar këtë deklaratë dhe nuk do ta nënshkruaj deri sa të përfundoj Konferenca Rajonale dhe deri sa Kuvendi në Konferencën Rajonale nuk i paraqet përfundimet e veta rreth kësaj qështje. Kisha shtuar edhe diçka, askush këtu, as nuk do t'ia ndaloj askujt këtë siç e cekti Vesna, për të nisur cilën do inicijativë. Unë ju kam pyetur juve të cilët jeni viktimë nga çka jeni duke u frikësuar. A po frikësoheni se qeveritë nuk do ta themelojnë komisionin i cili do të provoj ti përcaktoj faktet rreth krimeve të kryera, abuzimeve seksuale, zhdukjeve, vrasjeve, shkatërimeve, djegieve, keqtrajttimeve dhe të gjitha të këqijat të cilat kanë ndodhur. Unë nuk frikësohem as nga Kroacia, as nga Serbia kur e bëjë atë. Dikush e ka vrarë birin tim. Këtë film të cilin e kam parë sot , aty e kam parë birin tim. Nuk ka qenë në atë film por mënyra e peshimit është e njëjtë. Mendoj se askush nuk mundet të marr atë guxim dhe të ndaloj diçka të themelohet dhe diçka të lëviz lidhur me njerëz të vegjël. Ne zotëri nuk do të diskutojmë rreth themelimit të Komisionit, nuk do të diskutojnë parlamentet, as qeverija nuk do të na pyes neve a e dëshirojmë Komisionin apo jo. Ju në Kosovë mund të mbani protestë sepse jeni një shtet i sapoformuar, dhe ju mbështet Hasa dhe Hysa, kush duhet e kush sduhet, kush ka dhe kush ska interes. Njësoj ashtu dhe në Kroaci veteranët i kanë të gjitha të drejtat financiare, dhe drejtat e tjera, e gjithë kjo do të zgjat deri një ditë, deri sa të hyjm në Bashkësinë Europiane, deri tek aj çast kur të mbyllin rubinetet financiare, kur sdo të ketë më para për ata. Ju do të përmbaheni asaj që vetëm mundeni të shkoni në konsultime sikurse perfaqësuesit e qeverive tuaja dhe nga ato të vijnë në takime të ndryshme dhe të futeni...

Vesna Teršelič: Ju lus të mos u ngrindni me njëri tjetrin.

Ružica Spasić:... ju futni shqetësime në njerëz të cilët sinqerisht kanë ardhur ketu për të ...

Vesna Teršelič: Ju lutem mos ngacmoni njëri tjetrin, vazhdojmë me temën.

Ružica Spasić: Unë kam udhëtuar 15 orë për të mbështetur këtë Inicijativë, për çka , për të dëgjuar si jeni duke e gjykur njëri tjetrin tërë ditën, dy ditë të plota. Dhe në nuk jemi të sinqertë njëri me tjetrin, kjo është gjëja më e keqe.

Vesna Teršelič: Ndërpreni duke e akuzuar njëri tjetrin, mos dilni nga tema e diskutimit . Simo Spasiqi, pastaj Feridja.

Ivan Zvonimir Čičak: Unë do të ngritem, me plot vështersi, unë jam Ivan Zvonimir Qiqak dhe vijë nga Zagrepi. I takoj veteranëve, atyre të cilët kanë luftuar kundër krimeve të luftës të cilat pastaj i kanë hulumtuar pa marrë parasysh cilës anë ju takojnë. Ndërkohë kanë kaluar 18 vite. Përdallim nga shumica këtu unë jam plak i sëmurë për atë këtu do të flas pa emocione dhe ju sugjeroj ti ruani emocionet për një çast tjetër të jetës sepse do ju duhet. Qeveritë tona po flas për Qeverinë e Republikës së Kroacisë, por mendoj edhe për atë të Serbis, kanë arritur më shumë se ne. Këtë e shoh nga ky diskutim sepse nëse nuk kemi asgjë tjetër përveç koalicion Qeveritar në të cilin e kanë vendin përfaqësuesit e kombit serb, pra në disa gjëra duhet të merrni shembuj nga ta. Të paktën si nga arsyet

politike dhe sjelljes e tolerancës ndërmes vete. Nga kjo rrjedh edhe pse këto qeveri janë në bashkëbisedime, nuk do të vendosin ta themelojnë këtë Komision, i cili do të hulumtonte nëpër tërë kaluaren e tyre dhe duke shhaktuar dëme fragjile në marëdhëniet. Por në hapsirat tona, nëse fillojmë me diskutime çka është e vërteta, as tërë historia e filozofisë deri tani nuk ka mundur të jep përgjigje, do të thotë nuk do të japim as ne. Nëse dëshirojmë të flasim për pajtime, pritja do të jetë afatgjate. Me atë me çka duhemi të mirremi ne është përckatimi i fakteve, e dikush tjetër nga ata të mirret me qështje tjera. Të themi historianët, antropologët, aktivistët për të drejtat e njeriut. Dje kanë lexuar një intervistë të Noem Qomski, ku aj flet për botën moderne e cila është me defekt sepse nga ajo është zhdukur aktiviteti. Kjo është vërtetë për këtë ne ju lusim juve, të mbeturat e fundit një botë për një besim në aktivitet, për këtë jemi dhe ne këtu. Aktivitetet tona kishim duhur ti drejtojmë kah njëfarë ideje konstruktive dhe të provojmë të gjejmë minimumin e gjysmës të përbashkët nëse mundemi pa frikë ne mes vete dhe pa akuzime. Mua më mundon një gjë. Ne jemi duke provuar të themelojmë „Koalicinin ndërlufëtar” në nivel të shteteve të ish-Jugosllavisë nga pjesët e ish Jugosllavisë, e koalicioni kësi soji nuk kemi mundur të themelojmë as në shtetet tona të sapo formuara. Që do të thotë, nevoja për fakte, nevojën për barazimin e viktimave kishte qenë mire t’ia fillojmë në shtetin tonë. Kjo në Kroaci sot nuk është e mundur. Atmosfera shoqërore është asi soji unë nuk e di se si është në Bosnë dhe Hercegovinë sepse sa herë që të vi në Mostar e shoh se bota aty është ndarë me një murr të urrejtjes i cili është i prekshëm me dorë. Kur shkoj në Sarajevë nuk e kam atë ndjenjë, por në Mostar më duket se kjo ndjenjë e urrejtjes del nga murri dhe ju përfshin dhe juve. Kur të shkoni nga Mostari, pas saj dy ditë radhazi do të jeni të sëmuar. Nëse shkoni në darkë në bisedë me njërin grup, pastaj me tjetrin, si ta kapërcejmë si ta thejmë atë murr të urrejtjes. Ajo është njëra nga çështjet të cilën ne si individ, si një nukleus, si njeri me vullnet të mirë kishte qenë e dëshirushme ta bëjmë. Dhe duhet ta bëjmë atë prej përvojës personale. Sot disa herë e kam përsëritur përvojën timë nga burgu, kam kaluar disa vjet në vetmi. Mos e harroni vuajtjet e njeriut janë individuale dhe pa të ndara me askënd. Askush përpos juve nuk mund të shërohet nga sëmundja e dhembjes përshkak të humbjes të më të afermit juaj. Duhet të nisemi prej kësaj se vuajtjet dhe viktimat njerëzore janë individuale. E dyta kjo është një mësim të cilin e kam mësuar duke biseduar me viktimat nga të gjitha vendet. Secili që ka qenë viktim mund që dhimbjen e vet ta përdorë sikur se një energji të re potenciale për të mirë apo për një urrejtje të re. Urrejtja kurrë nuk e shkatëron atë të cilin e urren, por i shkatëron ata që urrejnë. Ju shkatërohet shpirti. Kur jam duke biseduar me zonjën nga Vukovari apo me ndonjë mashkull shumë herë më befasojnë njerëzit me bujari, dhe me qëndrim stojik në vuajtje. Këtë ndjenjë kishte qenë mirë ta përhapim në të gjitha ata të cilët dhe sot dëshirojnë të hakmirren. Kësi lloj njerëz ka më shumë se ne. Këtë energji të cilin e mbajmë në shpirtërat dhe duart tona nuk di si ta shpërndajmë nëpër këto hapsira por një gjë e di jam apo nuk jam me Koalicinin, a jam për Komision, komisionin mund ta themeloj vetëm qeveria, gjithëmonë dhe në çdo mënyrë unë jam për mbështetjen e kësaj iniciativash. Me vite kam menduar se si në Kroaci të nxis iniciativën për themelimin e njëfarë komisioni për përcaktimin e fakteve. E pakontestueshme është se pas „Ollujes” për pesë ditë janë të mbytur 930 njerëz, ky është informacion zyrtar i autoriteteve, dhe pas saj edhe 900 vetë. Nëse i mbytni 900 njerëz në një hapsirë ku mundet të zë 10.000 njerëz është përafërsisht 10%. Në aktvednime të cilat i ka miratuar gjykata Kroate janë të përshkruara tekstualisht krimet të cilat kanë ndodhur në Gjep të Megjakut, mënyra e

kryerjes të krimeve, është një aktakuzë... ku përshkruan një plakë serbe të cilën e kanë varur në një degë edhe se dy fëmijët e saj kanë qenë në ushtri Kroate ndër sa njëri nga djemt ka vdekur si veteran i ushtrisë Kroate. Pytja ime është: "Si është e mundur që njerëzit të cilët kanë kryer krime brendshme, sot shetisin lirë sepse nuk janë në pyetje vetëm problemet e krimeve të lufës, por është problemi se ata vazhdojnë të jetojnë paralel me neve dhe me strukturat, psikopatët janë duke kërcënuar të tjerët, ata jetojnë në mesin tonë. Të mos befasonemi nga gjakëftohtësia e vrasjeve në rrugët e Zagrebit, me revole apo me mjete shpërthyes. Keto janë si rezultat të një situatë, këtë situatë të gjithë e kemi përjetuar. Situata në të cilën krimi ka qenë akt heroik. Si ta bëjmë atë ndryshim në kokat e njerëzve që krimi më nuk është akt heroik por është vetëm krim. Ne të gjithë këtu jemi njerëz të vullnetit të mirë të provojmë ti gjejmë përgjegjësit e krimin. Mënyra e organizimit prap se prap mvarret nga vetë ne. Frika është gjithëmonë pjesë e këtyre akteve, edhe tash egziston frika e disa njerëzve që mund të jenë të manipuluar, që kanë mundësi të mbesin pa mjete, për të gjithë këtë duhet të kemi kujdes dhe të kujdesemi që diçka të mbetet nga ajo iniciativë për të mundësuar një numër më të madh të individëve të marr pjesë në të dhe sa me shumë organizata në mënyrë që dëshirojnë ata, por nëse nuk dëshirojnë mos t'iu marrim për të madhe. Falënderit shumë.

Vesna Teršelić: Falënderit, Simo Spasiq.

Simo Spasić: Unë do të provoj të jam shumë shkurt, të provoj a do të mund. Dëshiroj të kemi pakëz më shumë respekt për familjarët., ndaj përjetimeve të tyre. Atë çka thonë përfaqësuesit shqiptarë të familjarëve, Sheremeti dhe të tjerët, në njihemi që shumë vite, kemi pasur rast të takohemi disa herë. Nuk janë ata keqdashës dhe kanë të drejtë të dyshojnë në shumë çka. Unë kam të drejtën të shpreh paknaqësin në emër të familjarëve të cilët i kanë të humbur të afërmit dhe që kanë besim tek unë që të luftojm për drejtësi dhe të vërtetën. Dikush përmendi se nuk kemi të drejtë të themlojm Komisionin, këtë punë e kryen qeverija apo parlamenti, nuk e di, a po shteti. Ej, vllëzër dhe motra po të kishin dashur që qeverija dhe parlamenti të themelojnë këtë Komision, ai do të egzistonte për një kohë të gjatë. Por ne kërkojm, sikur OJQ të cilat janë në Koalicion, unë Natashes i kam treguar, ne pranë shoqatës e kemi formuar qendrën e dokumentacionit që do të kujdeset për të gjitha ngjarjet të cilat kanë ndodhur në territorin e Serbis. Disa nga qeverija e Serbis, nga Komisioni, jam duke i zbuluar sekretet por është në pyetje paturpësia e tyre jo e imja, ata kanë provuar ti bindin njerëzit nga shoqatat dhe nëpër zyra të ndryshme për të bojkotuar këtë ftesë të organizuar në Prishtinë, me argumente se këtu do pranojm një shtet, një president apo premier, e kanë përmendur EULEX-sin. Ej, njerëz a jeni duke ditur kujt jeni duke iu drejtuar. Ne jemi familjarët e viktimave, ne shkojm atje ku mund të dëgjohet zëri i tyre, ku do të jenë familjarët nga vendet e ish Jugosllavisë për këtë arsye jemi ardhur një numër të familjarëve, për të qenë present. Për këto qeveritë të cilat e keqpërdorin tragjedin tonë, ne gjindemi këtu. Ne kemi percjellur punën e këtyre njerëzve të cilët kanë qenë në bashkëpunim me Koalicionin. Unë mendoj se kjo është positive, për ndonjë arsye. Nëse veçanarisht unë dëshiroj të më premtoj dikush se në këtë Koalicion prioritet do të jenë interesat e familjarëve të viktimave. Normal ne, unë, këtë punë nuk do të kisha mundur ta kryej sepse nuk jam kompetent, në mesin tonë ka jurista, njerëz me edukim të lart, të cilët mund ta kryejn këtë punë por duhet të jenë më aktiv të përfshirë në Shoqatat e Familjarëve në Komision.

Nëse të gjithë të cilët përfaqësojnë familjarët e viktimave, pa dallim përkatësie etnike apo fetare, dëshirojmë të vertetën, sa ka të ndjerë, sa të vrarë, sa të dëbuar, sa kriminel të luftës janë në burgje, sa ndër dhe, sa me keqardhje ende në liri. Ky Komision duhet të ngjallërohet. Me përgjegjësi të plot po flas, se nuk do të jetë ashtu. Kjo çka jam duke folur unë është shumë më e rrezikshme, dhash zoti që sonte ta kapërcej Merdarën. Shumicës së qeverive në hapsirat e ish Jugosllavis, ndoshta nuk ju konvenon që ky Komision të ngjallërohet, për ata shumëçka, shumëçfarë, ndoshta për disa të vërteta të cilat nuk ju konvenojnë. Apeloj, që ne si një shoqatë familjare do të mbështesim dhe do të propozojmë, përfaqësuesve të familjeve dhe shoqatave të perkatësis së ndryshme etnike dhe fetare, ta pranojnë Komisionin por me një kusht që shoqatat të cilat do të marrin pjesë duhen të jenë aktive në bashkpunim me të gjithë të tjerët. Te jem i sinqert nuk dyshoj në këtë por dëshiroj që të gjithë të jenë aktiv në Komision, që të na jipet siguria që përfaqësuesit tanë do jenë aktiv në menyrë që vetëm familjarët të kenë përfitime, për shkaqe të drejtësis dhe të vërtetës. Ata të cilët janë në qeveri, banesat, atuomobilat, paratë, ahengjet, ata jetojnë, shumica e organizatave ne të gjitha shtetet jetojnë në eshtrat e të vrarëve tonë. Ju faleminderit shumë.

Vesna Teršelič: Faleminderit. Feride Rushiti.

Feride Rushiti: Përshëndetje, unë jam Feride Rushiti nga Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës. Fillimisht, kisha dashtë me ju përgëzuar për iniciativën që e keni marrë juve panelistë të nderuar, njëkohësisht me ju përshëndet të gjithë të pranishmit, paraprakisht me ju treguar që këto emocione të cilat po rrjedhin në komunikim janë gjë normale dhe natyrshme në një takim të kësaj natyre të këtillë, mirëpo paraprakisht këto ngjarje të cilat u dëgjuan deri më tani të shumica prej neve ngjallën vuajtje, ngjallën trishtime, janë më se normale, duke e patur parasysh që edhe Kosova por edhe shtetet në rajon me siguri se kanë kaluar në ngjarje më të tmerrshme, mirëpo mendoj që ky forum paraprakisht nuk e përgatitur sa duhet audiencën dhe nuk ka pasur debate të mirëfillta nëpër vendet nëpër të cilat ka kaluar. Mendoj që për të marrë ashtu një kahje si të duhet mendoj që njerëzit kanë prur, dolën edhe me propozime, pashë që edhe në vendet tjera në Bosnjë e Hercegovinë kishte keqkuptime po ashtu edhe në Kroaci nuk e di si është në Serbi, po ashtu edhe për Kosovë besoj që ka mosinformime, besoj që paraprakisht për të ardhur të iniciativat konkrete duhet të bëjë debate brenda shoqërore do të thotë brenda një shteti, debate të cilat do të përfshinin të gjitha zërat e viktimave, debate që do të përfshiheshin akademik, shoqëri të civile, artistë, qeveritar dhe këto debate pastaj të delnin me strategji konkrete që do të adresoheshin iniciativës rajonale. Për vetë faktin që shumica e aktorëve këtu nuk e kanë të qartë se çka është ky komision, çfarë do të jetë mandati i tij, mendoj që ky ka qenë një hap i ngutshëm dhe them që nuk është përpunuar paraprakisht audiencia apo shoqëria në tërësi apo vendet e ish Jugosllavisë para se të vinin dhe të debatonim kështu dhe mendoj që paraprakisht të jetë si rekomandim, është rekomandim imi personal, unë nuk kam të drejtë të thirrrem në emër të viktimave, mirëpo të organizohen debate brendapërbrenda shteteve, të cilat do të kishin dal me qëndrime, pozicione, orientime të caktuara dhe pastaj këto qëndrim dhe orientime do të ishin tubuar dhe diskutuar në nivel rajonal. Faleminderit!

Vesna Teršelić: Faleminderit, për këtë arsye dëshirojm të formalizojm Koalicionin , që të gjitha organizatat në emër të Koalicionit në vende te tyre, ne qytete të tyre dhe fshatrat e tyre të kenë mundësi të debatojnë për shkaqet e informimit masovik, të kenë një vision të tyre dhe aty ku kanë mundësi ti shprehin propozimet e tyre. Kjo është një qështje me të vërtetë shumë delikate dhe e ndieshme, shumë njerëz kanë mendim e tyre rreth Koalicionit, informata ndoshta ende nuk ka arritur deri tek ata, ndoshta informata ka arritur por nuk është e sakt, për atë arsye është e nevojshme të krijojmë një hapsir ku do të shprehen mendimet e tyre dhe të deklarohen se a janë të gatshëm për ta mbështetur apo jo.. Në radhë është Prenke Gjetaj.

Prenc Gjetaj: Shfrytëzoj rastin edhe njëherë të ju përshëndes edhe këtë iniciativë për ti ofru njerëzit për ti dëgjuar rrëfimet e tmerrshme dhe të llahtarshme mbi ngjarjet e viteve të nëntëdhjeta për krimet që janë bë, pasojat e të cilave krime ne si qytetarë ende i bartim në supet tona dhe sigurisht, normalisht nuk jemi të lirë për shkak se drejtësia ende nuk e ka dhënë fjalën e fundit, fjalën përfundimtare në tërësi për arsye se dëgjohen rrëfim që në të vërtetë çdokund edhe atje ku ka shpërthyer lufta më parë edhe në Kroaci, Bosnje edhe kriminelët ose ata që kanë bërë krime ende lirë dhe nuk e kanë marrë dënimin e merituar që normalisht do të ishte satisfakison dhe lehtësim të gjithë atyre që kanë pësuar, unë do të prezantoj një fakt, që u përmend edhe nga zoti Sheremet se është me rëndësi që këtu njerëzit u panë, u dëgjuan, ka mundësi secili shllirë ta prezantoj mendimin e vet dhe ta thotë të vërtetën e vet mirëpo organet kompetent gjithnjë duhet ta thonë fjalën e vet sepse shoqatat nuk e kanë atë fuqi, nuk e kanë atë kompetencë, për shembull dosjet për krimet e bëra në Kosovë, dihet arsyet pse janë mbyll dhe derisa ato dosje të hapen dhe njerëzit të japin llogari dhe përgjegjësi për veprimet e bëra sigurisht se nuk do të jenë të qetë edhe njerëzit e gjallë por edhe shpirtat apo eshtrat e atyre që e dim ku janë. Por tani shqetësimi më i madh, ankthi më i madh është për ata që nuk e dimë ku janë, nuk dinë familjari të derdh një pikë lot, nuk din ku ta qoj një tufë lule e tjera dhe kjo është dhembje e përgjithshme dhe kjo e ka një përkatësi etnike një përkatësi dhembja prandaj në këtë aspekt sigurisht të gjithë duhet me e shpreh dhe në atë mënyrë ta kalojmë vetveten. Me shoqatat normalisht se mund të bashkëpunohet në pikat për të cilat mund të jenë të përbashkëta, institucionet une kam mandat dhe kompetencë të them se do të bashkëpunoj me të gjithë ata faktorët të cilët do ta ndihmojnë procesin dhe zbardhjen e fatit të të pagjeturve ndërsa në aspektin tjetër e them prej asaj kompetencës që e kam si qytetar, po nuk bë më për zbulimin e së vërtetës dhe gjykimi dhe dënimet meritorë sigurisht se edhe pajtueshmëria është e hershme edhe e pamundshme. Kështu që normalisht qeveria, po them tash unë nuk kam ardhur ta përfaqësoj ose ta prezantoj qëndrimin e qeverisë por shoqatat e ruajnë autonominë e vet në mënyrë të pavarur vendosin, në mënyrë të pavarur integrohen, në mënyrë të pavarur dalin, prandaj ne bashkëpunojmë me shoqatat normalisht me Këshillin Koordinues të Shoqatave të Viktimave gjegjësisht personave të zhdukur. Mirëpo ka shoqatat të cilat e ruajnë autonominë dh bashkëpunojnë me ato shoqata të cilat në kuadër të .. si shoqatë që e përfaqëson një komunitet ose një fshat apo një bashkësi familjesh por edhe individët si përfaqësues të familjes dhe normalisht kjo edhe në nivel lokal, në nivel të Kosovës por edhe në nivel Regjional. Çdokush që jep informata dhe ndihmon në këtë proces është prapë po them i mirëseardhur por shoqata duhet ta ruaj autonominë e vet dhe pavarësinë e vet dhe ndoshta kur shoqata të them edhe

kjo është konteksti i kësaj për ti dhënë kujt këshillë ose për të ia imponuar , për të ia diktuar nëse thuhet është pak herët duhet vërtetë njerëzit ti lënë të

Vesna Teršelić: Ashtu pra, e gjitha në kohën e duhur. Çdo kush ka nevojë për kohë aq sa ka nevojë. Gordan Bodog.

Gordan Bodog: Faleminderit. Mirëmbërëma. Unë kam kërkuar fjalën për ty kthyer në temën e diskutimit. Disa fjali hyrëse. Në procesin i cili është duke vazhduar tash e disa vite, para gjashtë muajve grupet e formuara dhe punuese ku organizatat dhe individët, të cilët janë në proces që shumë kohë, kanë pasur mundësinë të mendojnë tërë atë që unë kërkoj nga ju, te punojmë së bashku dhe te mendojmë fazat dhe hapat dhe pjesët e asaj perspektive që do të punojmë. Është menduar që në këtë proces të bëhen bisedimet dhe afirmimet për komisionin e ardhshëm regjional KOMRA, ku merr pjesë koalicioni i organizatave joqeveritare nga i tërë regjioni, ku në atë koalicion hyn edhe pranimi për tu marrur me bisedime dhe afirmime për themelimin e komisionit rajonal, pranon një numër të obligimeve dhe pranon që në të ardhmen të bëhet partner i cili do të ndihmojë në themelimin tij në implementimin e mandatit, kështu shkruan në ftesën për bashkangjitime. Disa nga organizatat vetëm se kanë vendosur të mbajnë përgjegjësi në përputhshmëri me proceset demokratike, shpresoj që mes vete në mënyrë të organizuar kanë marrë pjesë në Koalicion. Disa nga organizatat kanë nevojë për më shumë kohë, jo vetëm për procedurat demokratike në miratimin të vendimeve në bashkangjitime por edhe në lidhje me statusin dhe pjesëmarrjen në Koalicion të vendosur nën pyetjet të cilat ndoshta nuk janë të qarta rreth mandatit të komisionit rajonal që në të vërtetë është një ndër temat, apo një ndër temat kryesore të diskutimit të tanishëm. Unë kisha thënë që kjo mbrëmje nuk është i vetmi vend që mund të marrësh pjesë në Koalicion. Pra ky është një proces që zgjat. Ata që nesër apo ndonjëherë do të dëshirojnë të marrin pjesë në Koalicion nuk mund të themi që nuk do të kenë pozicion të pavolitshëm krahas atyre që kanë qenë themeluesit e parë. Këtu mënyrë të shtoj që ata që dëshirojnë të formojnë Koalicionin atëherë duhen të marrin dhe të kenë të gjitha elementet e atij Koalicioni. Do të thotë sa i përket strukturës udhëheqëse, mënyrës së marrjeve të vendimeve, ndryshimit të përgjegjësisë dhe detyrave e këtu me rradhë. Kështu duhet të nxitet, mirëpo nevojitet ende shumë punë. Bashkangjijtja e shumë organizatave në Koalicionin rajonal për shkaqe të ndryshme si kujdesi, shkatërimi, paqartësitë që duhet ti pranojmë, këto të gjitha ndodhin sepse nuk i kemi rishqyrtuar cili është mandati i komisionit rajonal në të ardhmën. Do të cekë vetëm disa gjëra sepse ka shumë, pastaj do të kthehem asaj, ku ajo do të jete e mbyllur, çfarë vlere do të kishte ajo ndaj arkivës, mënyrën në të cilën kjo ose ajo, për këtë do të kthehem më vonë, jo, kjo do të thotë... unë mendoj që është koha t'iu nënshtohemi njëfarë rregulli, ti dëgjojmë ato organizata të cilat thonë që kanë pranuar dhe eventualisht edhe ato të cilat dëshirojnë të tregojnë se pse nuk kanë dëshiruar bashkangjitime, te tregojnë se cilën gjë në mandat nuk e dinë, paqartësitë apo çfarëdo, në këto mënyre kjo do të jetë bazë e diskutimit rreth mandatit. Ju faleminderit.

Narcis Mišanović: Unë do të isha kthyer në çështjen boshnjake. Kisha dashur t'iu them te gjitëve në këtë tubim që askush nuk ka të drejtë, përpara neve nga BIH të thotë ekskluzivisht, më mënyrë diktatori nuk guxojn të nënshtrohen, një nga këto shoqëri nga BIH. Secila shoqëri, bile në këtë shoqëri demokratike ka të drejtë për mendimin e lirë të

tij,në qëndrimin e tij dhe në formimin e koalicionit.Unë jam nga organizata veterane dhe që tani do të nënshkruaj atë koalicion atë marrëveshje,edhe nëse e kam të ndaluar nga ndokush,por kisha pasur dëshirë të di nga kush,le të lajmërohen dhe me shumë kënaqësi do të mirresha vesh më te në vendin tim.Ndaj kësaj,ndaj kësaj, le të më lajmërohen,ju lus,njëmend ju lus që të lajmëroheni,qe të më ndaloni atë.Diktatori më mduket të ka përfunduar në burg, nuk ka më diktatorë ne Europe, ka vdekur.Me diktatorë ka përfunduar.E lus kolegun tim qe mos e bëj keqpërdorim, vetëm ta mbajë qëndrimin e tij.Pak sa dhe i kuptojë miqët e mi nga Kosova. Plagët janë të freskta,edhe une në zemer i kam dy plagë, shumë të rënda dhe i kuptoj që duhet të kaloj pak kohë, bile këto plagë pak të shërohen ose të sanohen për të pasur më lehtë që marrim pjesë në Koalicion. Për t'i gjetur më lehtë viktimat dhe për të gjetë qetësinë shpirtrore. Shtetet njëra pas tjetrës duhej të duhej t'i bashkangjiten Koalicionit sepse është në interesin e tyre. Ne sot nuk jemi mledhur këtu për asgjë. Nuk ka pasur interesim të mjaftueshëm prandaj jemi këtu. Inkurajoj dhe përshëndes edhe një herë tubimin.

Vesna Teršelić: Gazivoda.

Tin Gazivoda:Mirëdita të gjithëve.Kam problem me të pamurit, për këtë arsye do të rri ulur, i lus të nderuarit që mos t'ma marrin për të madhe. Së pari mendoj që kjo temë e diskutimit në një mënyrë nuk guxon të jetë befasi. Mendoj që është normale që njerëzit të frikësohen, të durojnë dhe të jenë të frikësuar këtë e kuptoj që tema e diskutimit ka qenë çfarë ka qenë.Në anën tjetër njerëzit mund të ndryshojnë mendjen.Mund që me anë të ndonjë konsultimi që ka ndodhur para një muaj,e gjatë kësaj kohe të vërej vlerën e një Koalicioni si ky,por ndodh edhe për dy apo tri muaj.Unë në të vërtetë dëshiroj ti them tri gjëra.Së pari përkrahë qasjen të cilën e keni përfolur qysh dje,në fjalët hyrëse Natasha Kandiq,e tani edhe Vesna Terseliq që shkojm në rrugën e zgjerimit të koalicionit.Për këtë është e rëndësishme të marrin pjesë shumë shoqëri të viktimave dhe shoqëri tjera,unë kisha thënë që edhe organizatat më të mëdha edhe mediat,e disa gjëra të ngjajshme.Sa më e zgjerë aq më e madhe është fuqia,është mundësi më e madhe që me anë të shtypjes të vijë deri ne atë masë një ditë,por kjo ditë nuk është afër ,për këtë të gjithë jemi të vetëdijëshëm ndaj qeverisë,ndoshta edhe në parlament marrin parasysh idean në themelimin e Komisionit regjiional.Së dyti mendoj që do ta kisha venë në pah një fjalë e cila është fjale kyçe e cila deri më tani nuk ka qenë e thënë,e që ka një rëndesi të madhe të bashkpunimit mes këtyre tri organizatave qe kanë filluar punën para tri viteve.Tani janë të kyçur më shumë persona përmes Fondit për të drejtat humanitare.Qendra hulumtuese,dokumentuse nga Sarajeva dhe Dokumenta nga Zagrebi.Unë kam marrur pjesë me datën 6 Mars të vitit 2006 në Sarajevë kur në një mënyrë ky Koalicion është formalizuar në një ditë të rëndësishme simbolike dhe me këtë rast shreh shpresën qe do të përfundojm në pikën e nisjes, procesi nuk do të përfundoj por do të formalizoj në një menyrë atë iniciativë kur do të jetë e qartë se cili do të jetë mandati i komisionit që propozon dhe që në Sarajevë te jetë një mbledhje përfundimtare,e që ndërkohë të organizohen sa më shumë organizata që është e mundur si në nivelin nacional ashtu edhe në atë regional.Theksoj rëndësinë e bashkëpunimit mes këtyre tri organizatave të cilat janë motor në tërë këtë dhe në zgjerimin e koalicionit.Pajtohem me shumë gjëra që ka thënë kolegu Cicak dhe Gordan Bodog nga Kroacia.Një njërën kam një mendim të

ndryshëm. Mendoj që bashkëpunimi në nivel nacional nevoja për konsultimet e plotësuara në nivel nacional, unë në kohët e fundit kam parë shumë levizje dhe hapa në Kroaci, mos i përjashtëoni dhe nuk guxon të përjashtëoni bashkëpunimit në nivelin regional. Këto dy procese duhen të shkojnë në mënyrë paralele, kjo është shumë e rëndësishme. Dhe e perfundoj më këtë që mund të them në këtë çast, në emrin tim personal jap përkrahjen Koalicionit, dhe besoj që për tri javë apo për një kohë këtë do ta bëjë e tërë organizata ime, Qendra për të drejtat e njeriut nga Zagrebi. Ju faleminderit.

Vesna Teršelić: Faleminderit Tin. Urdhëroni.

Marija Radoman: Mirëdita të gjithëve, unë jam Marija Radoman, ju përsërisht në emër të Bordit për të Drejtat e Njeriut të Helsinkut në Serbi. Për mua ka qenë shumë interesante diskutimi i djeshëm ashtu sikur edhe sot sepse është hapur një diskutim mjaft i rëndësishëm që ka zgjuar interesimin tim, e kjo është qëndrimi themelor, rreth së cilit nuk jemi koncentruar, e ky është karakteri dhe mandati i Komisionit Rajonal. Këtu flitet për mënyrën si ta zgjerojmë Komisionin Rajonal, dhe mendoj që ... Koalicionin, më falni, gabim, dhe nuk po flitet për karakterin e Koalicionit, çka më të vërtetë do të bëjë ajo. Ok, kam arritur në përfundim që egzistojnë dy ..., unë i kisha quajtur rryma ideologjike të kundërta. Njëra është ajo e cila është jozyrtarisht themeluar e kjo... është themeluar vetëm nga emri. Komisioni rajonal është ai të cili do të dokumenton krimet si fakte, e dyta është kjo, zërat të ndryshëm që kemi dëgjuar dhe sot, që të kërkohet dënimi për autorët të krimit, dhe dënimi të krimit. E tani isha kthyer se sa e gjithë kjo ka lidhje me karakterin dhe mandatin e Koalicionit Rajonal. Përse? Mandati dhe karakteri janë të lidhur ngushtë. Në këtë më ka inspiruar shumë fjalimi i zotëri Amir Kulagiq në Forumin Rajonal të dytë kur ai e ka vënë në pah qëndrimin e tij dhe kur njeriu ka thënë që ai është i frustruar. Përsë? Sepse a'i ka qenë më datën 8 dhe 9 Shkurt të vitit 2007 kur në Srebrenicë janë identifikuar 2 400 viktimat, më korrigjoni nëse gaboj dhe ai ka vënë në pah që kapaciteti i laboratorit ka qenë 400 deri 500 njerëz të cilët janë identifikuar në vit, pastaj ai ka bërë llogaritje të përkohëshme që nevojiten 10 vite vetëm për identifikimin e viktimave plus minimum 10 vite për inicim të procedurës penale kundër krim bërësit dhe ai pastaj mundësisht e ka përfunduar më një fjalë që për mua prezenton ashtu edhe siç e ka thënë, shumica nga ne nuk do të arrijmë satisfacionin. E tani këtë e kisha krahasuar, në pyetje është vetëm Srebrenica. Mund të themi diçka edhe për Kosovën. Do të thotë sa njerëz janë të identifikuar. E çfarë të bëjmë më Bosnën, çfarë të bëjmë më të dhëna, Mirsad Tokaçi na ka paraqitur të dhëna për 96.000 njerëz të mbytur, e prej tyre 60.000 boshnjakë e boshnjake. Deri kur, deri kur do të prisni që të dokumentojmë faktet për këta viktimat, dhe çka më të vërtetë do të thotë, çfarë lidhje ka më konceptin e drejtësisë. E jani pak këtë ta problematizojmë. Ky Forum mban titullin vendosja e drejtësisë në vendet e ish shoqërisë Jugosllave. Ok, konceptin e drejtësisë mund ta problematizojmë, mund ta vendosim në mënyrë abstrakte por nëse dëshirojmë mund ta definojmë konkretisht. Drejtësi, do të thotë ajo që viktimat thonë që është e drejtë, e ne dhe sot kemi dëgjuar mjaft zëra këtu në Kosovë, njerëz të cilët jetojnë më atë që deri në pajtim, e vërteta dhe përgjegjësia nuk do të vië deri sa nuk gjenden kriminelët. Mendoj që në Kosovë është e qartë së çfarë ka ndodhur, është e qartë së në pyetje ka qenë terror shtetëror në kohë të bombardimeve të NATO-s. Ai ka qenë terror shtetëror sepse ajo është krijuar nga maja, do të thotë e ka krijuar ushtria, MPB në anën tjetër kemi pasur diçka në lidhje më

terrorizëm, lëvizje të mëdha shqiptare. Në themel të kësaj nuk ka pasur vepra penale nga shteti Serb. As ligji për ilustrim as që u zbatuar, edhe nëse kemi një tjetër ligj. Si përfundim dua të them që në qoftë se Komisioni përpiket të mbetet vetëm në dokumentimin e fakteve, në do të shëndrohemi në atë çfarë Hajnrih Belt tha, llogaritarë të ligë dhe në nuk do të kontribojm në atë së çfarë është drejtësia, apo çfarë viktima kërkon. Viktimat kërkojnë që krimet të paguhen. Ju falminderit.

Vesna Teršelič: Faleminderit. Andrej Nosov.

Andrej Nosov: Unë do të flas shumë shkurt. Kemi 15 të lajmëruar dhe kemi një orë e gjysmë për diskutim për këtë arsye pata dëshirë që këtë diskutim ta udhëzojmë në drejtim të Koalicionit, t'i qartësojm tri terme për të cilat duhet të bisedojmë. Tani Marija ka përmendur Koalicionin i cili do të dokumenton faktet. Ky Koalicion i cili sot do të formohet, i cili po formohet, nuk do të dokumentoj fakte. Ky Koalicion ka një synim të qartë që është vendosja e mekanizmit rajonal për përcaktimin e fakteve për krime të luftës, hetimin e krimeve, që do të thotë duhet të krijohet një hapësirë publike për viktimat, ashtu si edhe sot pasdite dëshmi publike në diskutim plenar. Gjthashtu ky Koalicion nuk do të mirret më shumë qështje të rëndësishme. Shiqoni kemi edukim, kemi shumë çka, statusin social, të themi disa kategori njerëz të cilët kanë dalur nga lufta. Këto janë gjërat të cilat në një moment do të jenë subjekt i disa koalicioneve të tjera .Ky Koalicion ka një detyrë shumë të qartë, që në këtë proces konsultativ që do të thotë më participimin të njerëzve, më tëra shqetësimet, po secili nga ne është shqetësuar, si do të mbledhim njëqind nënshkrime, pastaj çfarë do të na thotë qeveria. A mund ta imagjinoni sa shqetësime mund ti numërojmë tani? Mendoj që kemi nevojë për një qasje pozitive të cilës do ti themi po, ne jemi të gatshëm qysh sot të fillojmë bisedimet rreth këtij mekanizmi. Në këtë moment po flas për KOMRA si komision rajonal për vërtëtimin e krimeve të luftës. Unë vetëm ju lus që në orën pasuse, në një orë e gjysme, të mos kemi pauzë, po shoh që shumë njerëz po dalin e po hyjnë, po flas për atë si dhe në çfarë menyrë mund ta vazhdojmë procesin konsultativ, çfarë çdo organizate mund të bëjë për organizimin e Koalicionit. Dikush e ka përmendur menyrën e vendosjes, dikush ka përmendur menyrën e koordinimit. Këtu janë të gjitha pyetjet rreth të cilave duhet të diskutojmë. Të mos hyjmë në këtë moment në vet mandatin dhe karakterin e Komisionit, të ardhmën, mekanizmat e komisionit rajonal. Do të egzistoj i pesti apo i gjashti ndoshta edhe Forumi i shtatë, dhe do egzistojnë grupë ekspertesh, ndoshta edhe ekperienca tjera, të cilët do të ulen dhe bisedojnë. Normalisht, gjithmonë dhe këtë mund t'u garantoj në emër të këtyre organizatave që janë këtu, më konsultimin e shoqërisë së viktimave, me konsultimin e tërë njerëzve që janë sot në këtë Forum. Por ne kemi pasur mundësi në qoftë se e kemi menduar ashtu siq kanë thënë disa të tjerë, vetem të formojm Koalicionin, pro form Koalicion. Por sot të gjithë jemi këtu, ejani pakëz që në fund të këtij Forumi, të paktën organizatave të cilat janë në grupë të organizatave themeluse, të mbetet diçka, çka janë detyrat për ndonjë Forum tjetër dhe të mbetet diçka nga ky Forum për të mirën e koordinimit dhe komunikimit tonë.

Vesna Teršelič: Pyetjet dhe dilemat të cilat janë relative vetëm i shënoni dhe i mbani në mend, e gjitha na nevojitet, e tëra është e vlerëshme. Urdhëroni zonjë, në rradhë është Manda Patko, pastaj Deli Avdiu. Urdhëroni Manda.

Manda Patko: Pasi Shoqata e nënave të Vukovarit dhe Asociacioni i Shoqatave Familjarëve të Zdukurve dhe të Burgosurve, i përmendur nga zotëri Pshenica, unë do të flas si zëvendës-presidente e Asociacionit por edhe si presidente e shoqates. Ne të premtën kemi pasur mbledhje para këtij Koalicioni, le të themi asgjë, mledhja e koalicionit në Vukovar dhe shoqata janë kemi vendosur të nënshkruajmë këtë koalicion, present ka qenë dhe zotëri Pshenica, drejtori i Asociacionit të Shoqatave sepse edhe ai është pjesëtar i shoqatës tonë, me atë që të dy kemi thënë të njëjtën gjë, ne do të bashkangjitemi Koalicionit, por nëse shohim se ky Koalicion i bënë dëm shoqatave dhe Asociacionit të shoqatave ne mund të largohemi. Kjo është e tëra unë do të kisha shtuar edhe diçka drejtuar zonjushës Ruzhica Spasiq se këto vende nuk janë për atë çfarë

ka thënë ajo... gjithashtu nuk janë temat për mbrojtës kroat, as për të ardhurat e tyre dhe heqjen e tyre nëse Kroacia hyn në Bashkësin Europiane. Ju faleminderit.

Vesna Terseliq: Ju faleminderit. Urdhëroni.

Ymer Merlaku: Unë juve ju kamë dëgjuar dje dhe sot, dhe shumë herë folësit e mëparshëm nuk kamë mundur ti kuptoj, ndoshta i kamë kuptuar gabimisht, por as panelist i këtij auditoriumi nuk kamë mundur ti kuptoj, apo i kamë kuptuar gabimisht. Familjet, të gjithë anëtarët e familjes që ende i kanë të pazbuluar anëtarët të tjerë, ata kanë dëshirë për të ditur se ku i kanë të afërmit e tyre. Siç dëshiroj dhe unë, dhe unë kam dëshirë për të mësuar ku gjinden, vëllain e gjeta, por djalin e vëllait të cilin policia e mori nga duart e nënës, dhe ia humben gjurmët. Dhe unë dëshiroj, dhe të gjithë të tjerët, por si përfaqësues të shoqatës nga qyteti i Klinës në Kosovë me 60 000 banorë, me 321 të vrarë, 135 persona të zhdukur, 135 prej këtyre janë 60 të identifikuar, ndërsa të tjerët janë ende të pidentifikuar. Në mesin e tyre gjinden dhe vëllai dhe djali i Zëvendës kryeministrit i cili sot ka qenë në mesin tonë. Unë dhe dje në fjalimin tim ju thash se mos të ndërmarrim disa masa krejtësisht të tjera, në kemi gjykatat, e kemi mundësin dhe mënyrën që secili nga ne të shkon në gjykatë dhe ta dorëzon akt padinë. Këto drejtime tjera, nuk ka asgjë të keqe në formimin e këtij Komisioni, por tani për tani më duhet të them se është një veprim i hershem, sepse në Kosovë ka ndodhur lufta, gjenocid, janë të vrarë më shumë se 12.000 njerëz, më shumë se 1.000.000 njerëz janë dëbuar nga Kosova, shumë prej tyre ende të pagjetur, diku më shumë se 4000. Unë mendoj se është ende herët për arsye se duhet ende të diskutonim, secili prej nesh veçmas nëpër shoqata, në komuna, në bashkëpunim me qeverinë tonë, secili me qeverinë e vet. Nuk e di se sa veçmas individ e kanë kuptuar rolin e këtij Komisioni, të cilin duhet ta formon qeveria dhe jo shoqëria civile, dhe jo në shoqatat. Ne jemi OJQ, duhet ta dimë dhe rolin tonë, se çfarë mund dhe çfarë nuk mund të bëjmë. Ne mund ta bëjë presion, të debatojmë dhe të gjithat, por qeveria e ka rolin kryesor. Ju kisha lutur të mos të nxitojmë, sikur ju që sot keni nxituar sikur të ishte ndonjë cirkus. Me këto deklaratat, me këto gjëra ... jam i hutuar me disa sjellje, disa etiketime, disa ... Ne këtu e kemi dëgjuar dhe palën serbe nga Kosova dhe Metohija ... ju këtë e dini, dhe ne nuk kemi reaguar, ne kemi qenë të qetë dhe paqësor, dhe ju them se nuk duhet të nxitojmë, na jepni kohë për të diskutuar në të gjithat instancat, me të gjithë, me anëtarët e familjes e viktimave, vetëm atëherë do të vijë koha. Në këtë moment është shumë herët. Ju falënderoj.

Vesna Terselic: Ju faleminderit, merrni pakës kohë. Radhas është Deli Avdiu.

Deli Avdiu: Kërkoj falje, pasi të gjithë kane qëndruar ne këmbe dhe unë do të qëndrojë. Në punën dy ditore të organizatorëve të kësaj konference e kam një vërejtje, të cilët kanë lejuar brohoritjen dhe duartrokitjen . Në këto vende, në këto situata, ku diskutohet në lidhje me këto raste, mendoj se nuk është as vendi as koha për të duartrokitur. Si mësues, më të vërtet më vjen keq që unë duhet ta paralajmëroi të nismëtarët për themelimin e një kësi Këshilli Iniciativë neper vendet të po sa formuara. Unë si një mësues përveç një plani vjetor që e mbajë, një ore e mesmit tim për të pasur sukses unë kam nevojë për dy deri në tre orë para përgatitje, para se të shkojnë në klasën dhe për të pasur në fund rezultat. Nënvizoi edhe një herë, si një mësues, pasi këtu kemi avokatët, mjekët e shkencës, shumë avokatë të ndryshëm që të mbrojnë interesat e të gjithë anëtarëve të familjarëve këtu, nëse të vinte koha për të mbrojtur. Më duket shumë e çuditshme, që ata të lejojnë diçka të tillë! Mendimi im është se Këshilli për iniciativën, duhet të përgatitet më mirë. Kjo përgatitje, megjithëse është keq se po ju them unë por duhet të them , sepse unë shoh se askush deri tani nuk e ka theksuar diçka të tillë. Nismëtarët është deshtë për ta bërë plan programin, statutin, rregulloren me të cilën Këshilli do te punonte. Këto tri dokumente është deshtë t'iu shpërndanin shoqatave të cilat punojnë në gjetjen e të zhdukurve, pastaj neper të gjithat këshillat për të drejtat e njeriut, në të gjitha shoqatat civile. Pastaj pas diskutimeve është deshtë për të përgatitur këtë konferencë dhe ti merr në konsideratë të gjitha mendimet. Edhe një herë ju përshëndes të gjithëve.

Vesna Teršelič: Hvala. Jel' Bogdan Ivanišević u dvorani ovaj čas? Bogdane, izvoli. Meni je žao, užasno je duga lista, evo sad je Jasna... treća, treća ste na listi.

Jasmina Bogojević: Ja moram da kažem da sam ja malo sumnjičava kad neko kaže da predstavlja 19 organizacija. Ja nekako ne mogu da se zakunem da mogu da predstavim ni svojju porodicu. Malo sam sumnjičava kad neko kaže da predstavlja 19 organizacija koje broje toliko i toliko članova. Međutim ako je to i tačno, a recimo uzmimo da je tačno, onda bi mi bilo drago da saznam na koji način su oni upoznati sa ovom inicijativom jer ja vidim da se ovde jako brkaju te dve stvari, Komisija i inicijativa. To nisu iste stvari, nisu ni slične stvari, jedno je podrška drugome i zbog toga mislim da trebaju znači te konsultacije da budu na drugi način organizovane, da se približi to ljudima tim, organizacijama žrtava nestalih i tako dalje i tako dalje i mislim zaista da vreme prolazi, umiru i žrtve i porodice, zaboravljaju, što je prirodno, i žele da zaborave, za to vreme počinioci gaje unuke i bašte svoje po Argentinu ili ne znam gde i mislim da nema mnogo vremena da mi sada tu odugovlačimo nego treba svako u svojoj sredini da širi ovu ideju da mi imamo što veću i što jaču podršku da izvršimo pritisak na ovih sedam vlada da se osnuje Komisija za utvrđivanje činjenica što je i glavni mandat ovoga.

Shaban Terziu: Ju përshëndes, unë dhe dje e mora fjalën, quhem Shaban Terziu vijë nga shoqata, Lansdownen "në Gjilan. Për fillim do të doja të përshëndes të nismën, sepse pa këtë iniciativë nuk do te kishim mundur të bëjmë asgjë.... A ka përkthim? A ka

Unë e përshëndes këtë nismë, çdo grumbullim i njerëzve, shoqatave, njerëzit me vullnet të mirë, me qëllim të mirë janë gjithmonë pozitiv dhe të suksesshëm flas nga përvoja. Unë nuk jam viktimë, emri im nuk është viktimë, por jam anëtar familjes të gjer të viktimës. Shtëpia ime është djegur dhe dy muaj unë jam veshur me rroba të huaja, unë dhe familja ime. Unë jam nga Gjilani dhe tërësisht është e djegur shtëpia ime. Kështu që unë jam një viktimë materiale dhe anëtar i familjes së gjer të viktimës. Jo anëtar familjes se ngushtë por të gjer. ... Sa për qeverinë, mos presim ndonjë gjë nga qeveria, sepse qeveria nuk mund të bënë çfarë mund të bënë shoqëria civile. Këtë tani e flas nga përvoja. Qe një shembull konkret: Kur ishte kryeministri i Kosovës Bajram Kosumi me të cilin kam biseduar në atë kohë, ne e kishim një projekt. Aj është habitur kur unë kam thënë që të ne në shoqatë, Lansdownen "nga Gjilani dmth. shqiptaret dhe serb janë duke mësuar gjuhët lokale. Shqiptarët mësojnë gjuhën serbe, dhe serb mësojnë gjuhën shqipe. Kemi mbajtur gjashtë kurse, tre muaj, gjashtë muaj dhe një vit. Ai ishte i habitur dhe menjëherë e futi si ide në plan programin e qeverisë për katër komunat e Kosovës. Por nuk ka pasur sukses. Ky është një shembull se shoqëria civile mund të bënë atë që nuk mund të bënë qeveria. Ka njerëz, supozoj dhe në qeveri që janë kriminelë, të cilët kanë bërë krime, për nuk është ne favor te tyre qe të formohet një koalicion i tillë, sepse ai e ka ndërgjegjen të papastër, dhe ai normal do të shpërthente, e jo për ta mbështetur këtë nismë. Normal se për ata nuk është e mirë, dhe nuk do ta mbështesnin kurrë. Z. Kosumi është këtu dhe ai do të jap një mendim, nuk e di në se do të japë opinionin e tij apo të qeverisë, por prapë e përsëris qeveria nuk mund ta bënë atë çka ne si një shoqëri mund ta bëjmë. Shoqata e ka autonominë e vet, dhe e ka vullnetin e mirë, dhe askush nuk mund t'ia mohon atë. Shoqata jep llogari vetëm Këshillit Koordinues, jo qeveris dhe kurrë nuk do të bëni atë. Nëse ne jemi të financuar nga qeveria, atëherë në do të jemi nën ndikimin e saj, dhe kurrë nuk do të përparonim. Unë e mbështes, dhe unë jam për një iniciativë të mirë, sepse ne kemi përvojë nga koalicioni. Si iniciativë është e mirë, le të formohet statuti, rregullorja e tjerat do të vinë vete prej vete. Faleminderit.

Vesna Terselic: Ju faleminderit . Shukrie Gashi.

Shukrie Gashi: Gjatë këtyre dy ditëve kam mësuar shumë gjëra, që nuk kam pritur që do të zhvillohen kështu. Gjithashtu kam pasur mundësinë për të reflektuar për të gjithat këto çka kanë ndodhur gjatë këtyre dy ditëve. Të gjithë këto që po ndodhin këtu, të gjitha ndryshimet që ekzistojnë rreth pëlqimit dhe qëndrimit, mospajtimet për ekzistencën e koalicionit janë të natyrshme sepse lufta ka ndodhur dje, ende nuk ka kaluar shumë kohe. Të gjithë ne e dimë që është shumë pak kohë për historinë, për historinë ka ndodhur dje. Rreth këtyre çështjeve nuk duhet të reagojnë me mllef, me pakënaqësi. Shoh se këtu mes nesh dhe sot janë disa individ, qytetarët të cilët janë në dilemë dhe nuk dëshironin as ta pranonin realitetin e ri. Deri në atë moment kur në nuk e pranojmë si një realitet të ri i cili është formuar në të gjitha vendet e ish Jugosllavisë, pra konstatoj se do të jetë shumë vështir për ne dhe si individ, në rrallë të parë si individ, përsëris për t'u bashkangjitur kësi lloji të iniciative që janë në një nivel të lartë të ndërgjegjes e njeriut. Për kësi lloji iniciativa sot kamë kuptuar se ka nevojë për një kohë, sepse vetë mënyra e qasjes, ndryshimet kombëtare, fetare, dhe të tjerët reflektohen këtu për dy ditë radhazi. Ndërsa disa individ janë duke u përpjekur ta paraqesin me ngjyra por në paketimin e ndryshëm. Në qoftë se unë do të jetoja në Kroaci, Kroacia do ta pranoja realitetin e Kroacisë me të

gjithat fatkeqësi që i kanë ndodhur popullit Kroat, popullit Boshnjak dhe popujve tjerë që jetojnë atje. Nëse unë do të jetoja në Serbi, do të përpiqesha ta pranoj realitetin e të gjithave fatkeqësive që kanë ndodhur në Serbi, Kosovë, Kroaci dhe kudo tjetër. Ndërsa në që jemi këtu edhe pse mendojmë se jemi njerëz të vullnetit të mirë, e vijmë të ngarkuar me paragjykime dhe madje as nuk provojnë ti ndryshojnë këto paragjykime minimale, prandaj unë mendoj se kjo nismë e marrë dhe nuk duhet të ushtrojë presion (nxitojnë). Qëllimi është shumë i mirë, unë ethëm që është në nivelin ma të lartë ndërgjegjes së njeriut. Kjo është nivelin më të lartë të vetëdijes njerëzore për fillimin e procesit të luftës kundër krimit, ndëshkimit e krimeve, sepse ne të gjithë e dimë se krimi ka një emër të vetëm akt i kryer, çdo marrje e një jete e kujt do qoftë, as kush nuk e ka këtë drejte, sepse një ditë do të vdesin, do ta lemë këtë bot. Kuptimi i jetës është bashkëpunim, angazhim me synim të mirë, bashkëjetesë dhe paqe. Por, si duket plagët janë ende të freskëta, frika ende ekziston, presionet nga anë të ndryshme, mohimi dhe mospranimi realitetit ekzistuese duket se është pengës, të cilën njerëzit nuk mundën ta pranojnë për të bërë një hap përpara. Prandaj, apeloj se do të ishte mirë që ti jepet pak ma shumë kohë grupacioneve, shoqërive nga ish-Jugosllavia, që se cila individualisht të flet brenda shoqërisë civile të saj dhe më anëtarët e tjerë të shoqërisë, që te bëjnë studime rreth këtyre pyetjeve dhe pastaj pas kësaj të bashkëngjiten iniciativës. Faleminderit.

Vesna Teršelić:Faleminderit Shukrije. Absoulitisht çdo ditë në muajt dhe në vitet përpara neve secili mund të vendos dhe të bëhet pjesëmarrës apo pjesëmarrëse e Koalicionit. Për këtë nuk egziston asnjë presion për ta bërë këtë sot apo javën e ardhshme. Në rradhë është Shefika Muratagiq .Ju, ju më falni.

Bakira Hasečić: Unë do të flas shkurt për iniciativat, propozimet e Komisionit për të vërtetën. Katasrofë, do të ishte për të ardhur keq dhe shumë e mjerueshme që pas 16 vite argesioni në Bosnë e Hercegovinën time ende nuk e dihet e vërteta. Unë flas në emër të viktimave,që jam një viktim dhe presidente e Shoqërisë së Abuzimit Seksual të Femrave dhe Meshkujve, por edhe pjesëtare e familjeve të mbytur para syve tonë, mendoj që ky Komision është i vonshëm. Unë sot do të isha më e lumtura nëse do të kisha mundur të shkëmbej mendime me Mirsad Tokaqa me të cilin sot ndoshta njihem për herë te parë, nuk shihemi me vite në Sarajevë me zonjën Natasha dhe me juve zonjë, të jap një propozim që do të kishte qenë më mirë që ky Komision të emërtohet, Komisioni për përpunimin e stretegjisë për procesimin e kriminelëve të luftës në territorin e ish-Jugosllavisë, e me këtë të vërtet mirren organet hetuese më shumë që 10 vite. Dhe kisha cekur vetëm një gjë. E vërteta tani është mes nesh, agresioni dhe gjenocidi. E jona e nderuara zonja Hartman e cila në librin e saj të vërtetës, ku do të fitonte drejtësia dhe do të kishim fakte për agresionin dhe gjenocidin e Serbisë dhe Malit të Zi, asaj dje i ka filluar gjykimi në Hagë, ne këtu të gjithë heshtim e të tjerët flasin në emër timin, të vajzës sime, familjes sime, kunatit tim...dëgjo në Vlasenicë ka qenë një shtëpi publike. Besoni sot jam për herë të parë në kësi mbledhje sepse unë mirrem me gjëra që mirret Haga dhe Prokuroria e Bosnës e Hercegovinës, jo vetëm unë, 1 500 anëtare të shoqatave tona në Bosnjë dhe në tërë botën. Nuk do të lejojmë që çdo kush të na manipuloj ose të flas në emër tonë, ata që nuk e kanë përjetuar këtë në lëkuren e tyre. Unë tani Bakira Hasecic ju garantoj që në Bosnjë e Hercegovinë nuk do të funksionoj kjo iniciativë. Në Bosnjë e

Hercegovinë drejtësi është Prokuroria dhe Gjykata rajonale dhe etnike e shtetit deri sa nuk shuhet Tribunali. Unë ju kisha lutur që sot ti japim mbështetje zonjës Hartman e cila për ne në të cilët është bërë gjenocidi dhe argresioni mund të përfundonte në burg dhe të bredh rrugëve për të paguar atë dënim sepse dëshiron të thotë atë që nuk ka guxuar kur ka qenë në Hage, që kanë fshehur të gjitha ato veprat e monsturnit Miloseviqit, te cilat për ne do të janë të panjohura, ajo është argesioni i fshehtë në Koraci, Bosnje dhe Hercegovine dhe i planifikuar në Kosovë. Të gjithë ne e kemi një agresor të përbashkët Sërbin, APJ, planifikuesit, iniciatorët dhe ekzekutuesit. Faleminderit.

Vesna Teršelić:Ju faleminderit për propozim.Tani menjëherë shkojmë me Kada Hozic.

Kada Hotić:Ashtu siç disa nga ju e dini unë jam Kada Hodzic nga Shoqata e Lëvizjeve të Nënave nga Enklava në Srebrenicë dhe në Zhepë kur ka filluar të flitet rreth formimit të Komisionit për vërtetimin e fakteve nga e kaluara, nga kjo luftë unë në një menyrë jam gëzuar. Kam menduar që ky Komision me të vërtetë do të punoj në menyrë intensive drejtë rrugës së vërtetës. Unë sot në rast dëgjimi të deklaratave të dëshmitarëve, kam vërejtur që secili flet të vërtetën por edhe secili e fajëson tjetrin. Shqiptari ka serbin,serbi shqiptarin,boshnjaku atë, atë, atë dhe në njëfarë mënyre ne vijm tek ky lloji i të vërtetës që të gjithë jemi fajtorë dhe viktimë.Shkak i fajit nuk është populli, populli popullit nuk ia ka bërë të keqen në mënyrë të pavarur. Popullin dikush e ka nxitur. Ajo që politikanët nuk mund te nxirrin në dritë, me atë që nuk mund të pajtohen, që as Bashkësia ndërkombëtare, as më i larti nga më të lartët e presidenteve i cili është i strumbulluar në Bosnjë e Hercegovinë nuk mund të pajtohet me faktin qe kush është fajtorë.Unë do t'iu them diçka ma kanë aneksuar shtetin, ma kanë vrarë të birin, mi kane vrarë vllëzërit, bashkëshortin, e une jam e dëbuar.Unë ndoshta mund të kthehem sipas marrëveshjes të Dejtonit në pronën time por unë atje nuk kam të drejta, ajo që me herët është quajtur Bosna e Hercegovina, ku unë kam lindur tani quhet Republika Sërpska, atje edhe ajri është serb, atje për Kadën nuk ka të drejta. Per këtë të flasim o njerëz,e jo për një amnesti për asgjë...Unë do t'iu tregoj barazimin e viktimave dhe agresorëve të krimit. Por duhet të gjejmë shkakun e gjithë kësaj, ti gjykojmë autorët e vërtetë, shkaqet e krimeve. Unë kam shpresuar që një Komision i tillë apo initiative, quajeni si te duani, do të ishte diçka shumë me e fuqishme se polititikanët në këtë ish-Jugosllavi dhe në Bashkësinë Nderkombëtare, e cila ka shikuar symbyllurazi dhe shikoi gjenocidin që u bë në Srebrenicë. Por jo vetem në Srebrenice. Kanë legalizuar atë, çfarë me gjak është e fituar, atë qe duhet dënuar. Me kanë vjedhur një çantë të madhe me para dhe kanë gjetur kriminelin e kanë burgosur por i kanë thënë mbaji paratë e Kades. Po pse athëre ai kriminel gjendet në burg? Kjo më dhemb mua. Unë nuk kam kurfar synime as diplomatike e as politike nuk e di se si jam perfshirë ne këto të dyja por unë këtu shoh që gjithçka duhet të rishikohet me kujdes,të pajtohet,të bëhet amnestimi i kriminelit. Po njerëz unë e dua popullin tim, tërë popullin por krimet duhet ti vë në pah, më të vërteta, emra konkretë, nuk e kanë vendin aty,p ërpara gjyqeve, në burgje, nuk e di, e ajo që është paguar me gjak le të shkatërohet, ajo qe është e nënshkruar në Dejton, legalizuar nga ana e kriminelëve, nga ana e ndërkombëtarve të tjerë te cilet kanë caktuar fatin e Bosnës e Hercegovinës, duhet ti anulojmë.Nëse kjo Bashkësi Ndërkombëtare nuk do, të cilët kanë

qenë iniciatorë që kjo të ndodh, atëherë mundemi edhe ne, populli, e populli do të jetoj prap së bashku. Une e dua popullin tim edhe atëherë kur ky Komision do te punojë në atë drejtim, unë do ti pranoj duarhapur. Tani për tani do të jem e permbajtur në emër të shoqatës time. Ju faleminderit.

Vesna Teršelič: Ju faleminderit .Urdhëroni

Aleksandar Todorović: Faleminderit. Unë jam Aleksandar Todorovic, vijë nga Sllovenia. Vetëm me një fjali do t'iu tregoj kush jam dhe çfarë jam. Jam perfaqësues i një grupi por jo përfaqësues i tyre ligjor, luftoj për ata që janë zhdukur në Slloveni. Kjo është një situatë e posaçme. Gjaku nuk ka rrjedhur por ka ndodhur një gjenocid virtual me fshirjen e regjistrave të cilat momentalisht janë alfa dhe omega e të gjitha statuseve të mbetura njerëzore. Megjithatë unë mendoj që është e mjaftueshme, kam dashur të koncentrohem, kam shpresuar që kjo pasditë të jetë takim punues kemi shumë gjëra të konstatuara për të qenë në gjendje të fillojm të mendojm për Komisionin i cili duhet të themelohet. Ne duhet të jemi të vetëdijëshëm që lepuri është ende në pyll, por ne mundohemi ta mendojm a është mjaft i yndyrshëm ose a është mjaft i pjekur, e lepuri është ende larg në pyje. Po na pret. Të gjithë njerëzit që janë këtu, ne duhet ta dimë... edhe unë kam menduar ashtu aha, kur e zbulojmë që kjo ka ndodhur në Slloveni puna do të jetë e kryer. Jo, nuk do të jetë e zgjidhur për një kohë të gjatë, të gjatë, të gjatë. Sot kam pritur, e mendoj e falemnderoj Zotin që ngadal po diferencohemi, që njerëzit po arratisen, që njerëzit po deklarohen, është ashtu edhe pse pak e vrazhdë. Ky është një bashkim vullnetar, nuk kemi ardhur për darkë dhe për pije por kemi ardhur të bëjmë diçka. Faleminderit Zotit që disa janë shprehur qartë, ndoshta më vonë do të na bashkohen. Kam dëshirë të them diçka të rëndësishme. Gjërat e pjesërishme të cilat sot jemi duke i përmendur, une nuk ju kam folur për zhdukjen, gjëra të frikshme kanë ndodhur, megjithatë duhet ti harrojm gjërat pjesërisht. Ne të gjithë jemi njerëz të vullnetit të mirë. Dikush tha që është shumë herët, mendoj që dikush nga Kosova. Jo nuk është shumë herët, nuk është. E njejëta ngjarje ka ndodhur në Bosnë dhe Kroaci në vitin 1991. Ne duhet të harrojmë ato interesat e pjesërishme dhe duhet të kemi komunitet. Vetëm edhe një fjalë mos t'iu bezdis. A ka ndonjë mundësi terminologjike apo strategjike që të fillojmë të mendojm çka presim nga Komisionet, kë do ta kërkojm për Komision, në ç'mënyrë do ta kërkojm, si do të prezentohet në media . Sepse më duket se më debat nuk ka pas dëshmisë të sotme ,supozoj që të gjith e kanë të qartë, që të fillojmë të zhvillojm strategji, që nuk kemi ardhur të kalojmë mirë dhe të bisedojm vetëm rrëfimet zotëruese. Programisht ajo është e kryer, sytë i keni të hapur të gjithë, ndoshta po na dhemb zemra dhe duhet të fillojmë të mendojmë që na pret punë, punë dhe punë. Dhe për mendimin tim të gjithë që nuk janë të gatshëm për maraton, me mirë të thonë tash çka kanë thënë që mos të marrin pjesë. Ky mosbesim i cili po kultivohet, i cili po përpiqet të zë vend, ai mosbesimi cili na sjell atë që na sjelli nga viti 1991 deri më 1999 dhe këtu në pjesëmarrje të shumë njerëzve vazhdon. E perseris edhe një herë unë jam për atë që duhet t'ia nisim punës. Faleminderit.

Vesna Teršelič: Ju falemnderoj juve dhe këto jane pytjet dhe të gjitha të adresuara për ne, jo vetëm për këtë debat por edhe kur arrijm në shtëpi dhe bisedojme me ata qe punojme ditë për ditë. Vehid Čehić.

Vehid Sehic: Po, unë menjëherë do të them se unë do të mbështes Koalicionin rajonal për vërtetimin e fakteve për një arsye të thjeshtë, për shkak se ajo është realiteti dhe kjo është nevojë. Sa i përket Komisionit unë jam skeptik, jo sepse ajo nuk duhet të formohet, por se nuk ka vullnet politik në mesin e aktorëve politikë për të formuar diçka që do të përbënte një institucion i cili do të kishte përcaktuar faktet sepse për fat të keq shumë aktorë politikë kanë histori të kohës së luftës duke frikësuar për vërtetimin e fakteve të caktuara. Unë do të them vetëm se ne duhet të marrim parasysh kur flasim për këtë koalicion që ne kemi fat që anën tonë kemi gjykatën e Hagës, pa marrë parasysh çfarë është Haga që mos të kishte qenë ajo kurrë nuk do të ishin procesuar krimet e luftës në rajon. Duhet të jemi real që kurrë në Kroaci, në Bosnë dhe Hercegovinë apo në Serbi nuk do të ishte bërë as një procesim i krimeve të luftës po të mos ishte presioni nga Bashkësia Ndërkombëtare, e jo me vullnetin e këtyre shteteve dhe duhet të kujdesemi edhe për diçka. Thonë që e ardhmja nuk është e përcaktuar. E ardhmja është e përcaktuar për të gjithë ne, e ajo është që vdekjen e kemi të siguruar. Por para se të vdisim ne duhet të marrim masa, për një shkak sepse të gjithë jemi të vëtdijëshëm për veprat posaqërisht ne në Bosnë dhe Hercegovinë ku fatëkeqësisht një numër i madhë i personave të cilët janë të dyshuar për krime lufte, të cilët edhe e kanë kryer atë. Kurrë nuk do të procesohen po duke përcaktuar fakte për disa gjëra. Bile jetën e tyre të ardhme do t'iu bëjmë të paqetë sepse me të vërtetë do të brenë ngërgjegjja dhe do të dijnë që në kemi njohuri për atë. Pse unë mendoj që ky Koalicion duhet të egzistoj? Numri i viktimave është i madhë këtë duhet theksuar. Ne duhet nëpërmes punës së këtij Koalicioni të inkujarojmë që pas 15 viteve në Bosnë dhe Hercegovinë gjenden shumë varreza massive në të cilat janë rreth 15 mijë njerëz, një numër i madhë i njerëzve është fshehur në Kroaci dhe këtu në Kosovë. Po të kishte një mënyrë për të gjetur vendin ku janë varrosur të zhdukurit. Nuk kisha dashur... këtu shumë shpesh përmendet amnestioni, nuk mund ne të amnestojmë askënd sepse amnestionin mund ta bëjë intiuicioni kompetent shtetëror, ne nuk mund të jemi komisioni i cili ka qenë në unitetin e Afrikës Jugore, që ka pasur atë mandat. Por nëse ne i zbulojm faktet të cilat mund ti përdorin gjykatat në këto shtete, atëherë do të kontribuojm pjesërisht në zbulimin e vërtetës dhe kryerjes së obligimit ndaj drejtësisë. Nga qëllimi i thjeshtë këtë fjalim do ta përfundoj sepse jam duke folur me terme profesionale sepse dikur kam punuar si gjykatës, me keqardhje gjykatat në shumë lëndë kurrë nuk mund të vërtetojnë apo pjesërisht e vërtetojnë të vërtetën, sepse ata janë të ndërlidhur me standard të caktuara që mund të përdoren dhe nëse ne me fakte të vërtetojmë disa gjëra, atëherë do të krijojmë opinion kritik të public. Mjaftushëm është që ai kriminel i cili ka kryer krim gjatë këtyre viteve e din që ne e dimë cili është ai. Dhe në fund mua me vie shumë rëndë kur thonë që nuk është koha. Nga lufta në BIH kanë kaluar rreth 15 vite e në Kosove 10 vite. Jeta është e kufizuar. Me këtë a jemi duke amnesuar dikë që natyra do të dërgoj në vend tjetër? Mendoj që është koha, the populli thotë hekuri kalitet deri sa është i nxehtë. Derisa fotografitë janë ende të freskta, derisa egzistojnë deshmitarët, derisa egzistoton vendnosshmëria dhe dëshira për të thënë të vërtetën, ne duhet ta bëjmë atë. Mendoj që është fjala nga eskperienca e BIH, nuk është koha, nuk është koha e ne jemi duke e parë se çfarë po bie koha, harron shumë gjëra dhe faktikisht ndoshta është edhe një mënyrë ku ne pa vetëdije amnesojmë shumë njerëz që duhet të përfundojnë në gjykatë. Kështu që pajtohem me tërë ata që nuk e dëshirojnë. Ky nuk është Koalicion i domosdoshëm, ky është labil, mund të hysh, mund të dalësh por mendoj që nuk ka njeri që nuk dëshiron të

vendoset drejtësia, së pari për viktimat e luftës dhe sigurisht ndaj 25000 personave të zhdukur. Ju faleminderit.

Vesna Teršelić: Faleminderit shumë. Janë dhe tre bisedues, tani do ta kemi një pushim të shkurtër t'i shpërblejmë të gjithë ata që kanë dëgjuar dhe kanë dëshmuar me durim, janë kthyer për t'i parë se cilat janë organizatat e përcaktuara për Koalicion dhe të mirremi vesh rreth përfundimeve dhe hapave të nevojshëm. Urdhëroni!

Emsuda Mujagić: Unë jam Emsuda Mujagić vij nga Kozarac, nga një vend i vogël i cili gjendet në veriperëndim të Bosnjës dhe Hercegovinës, i cili i përket komunës së Prijedorit në njësinë e tanishme të quajtur Republika Srpska. Unë kam dëgjuar me vemendje dhe edhe sot të gjitha prezantimet dhe diskutimet dhe shumë nga to unë bie në dakord, por dhe ka shumë nga ato që dhe nuk bie në dakord, por ndiej nevojë për të thënë disa fjalë me rastin e kësaj çështjeje. Unë mendoj se është shumë e dobishme të organizohet koalicioni, i cili do të ndihmonte themelimin e Komisionit për përcaktimin, në fakt gjetjen e së vërtetës në lidhje me ngjarjet në ish-Jugosllavi. Mendoj se këto fakte, apo gjendja faktike mund të përdoret jo vetëm në zbulimin e kriminelëve të luftës, krimeve dhe gjithë ajo që është e përfshirë në këtë, mendoj se kjo mund të jetë shumë e dobishme për tekstet shkollore në të ardhmen në shkollat tona, në mënyrë që ne nuk kemi disa të vërteta, në varësi të cilit kanton i takone, lidhur me Bosnje dhe Hercegovinë, të cilit kanton apo entiteti i takon. është mënyra me e thjeshtë që fëmijët të mësojnë historinë, ata e mësojnë dhe në atë mënyrë e cila nuk është e përshtatshme. Unë mendoj se këtu është duke provuar dhe kjo, shumë njerëz këtu e kanë njohur që kjo nismë është aktualisht duke punuar për t'i barazuar krimet dhe kriminelet, të themi, në të gjitha vendet ka ndodhur e njëjta gjë, por nuk do të mundet të gjendet gjendja faktike e cila do të flet mbi numrin dhe mënyrën e krimet e kryera dhe për kriminelet, në çdo rajon, në çdo vend, çdo komunë dhe shtetit. Gjithashtu dhe me kanë goditur fjalët e Natashes e cila tha as kush nuk ka ardhur nga entiteti republika Serpska, me atë ka menduar në serbët dhe nuk është çudi. ata kurrë nuk janë përgjigjur.

Vetëm në rajonin e Prijedorit, komunën nga e cila vija unë, atë nuk ka pasur luftë, por ka pasur mijëra e mijëra viktime, që do të thotë se ato nuk janë të motivuar për të punuar në hulumtimin e fakteve dhe përcaktimin e fakteve, prandaj unë mendoj se në të ardhmen nuk duhet për të menduar ne at mënyrë sepse në fakt kjo është e organizuar dhe vepron në emër të viktimave dhe për këtë arsye duhet të shikohet në atë mënyrë.

Unë mendoj se ne duhet të organizojmë një konferencë të tillë në komunën e Prijedor dhe unë mendoj se njerëzit pastaj do të mendoheshin pak sa ndryshe, për të u inkuadruar në bisedimet lidhur me faktet që kanë ndodhur atje, veçanërisht ata që kanë kryer krime do ta ndjejnë një forcë që do të punojë në drejtëm të zbulimit të tyre dhe që do t'i sjellë para drejtësisë. Prandaj, mendoj se kjo nismë është shumë e mirë, se duhet të mbështetet dhe duhet të përpiqemi që në qoftë se ka disa gabime në punë, në hap të korrigjohen dhe se nuk duhet më përpara të gjykohet për diçka çka nuk është provë konkrete. Shumë faleminderit!

Vesna Teršelić: Ju falënderoj shumë, faleminderit për propozimin për ta organizuar një ngjarje sikur kjo në Prjedore- Zoran Pajiqi.

Zoran Pajiq: Quhem Zoran Pajiq, jam profesor i drejtësisë ndërkombetare, dhe ligjëroj në Univesitetin e Londrës, deri tek lufta kam qenë professor i së njëjtës lëndë në Fakultetin e Drejtësisë në Sarajevë. Unë këtu nuk do të loboj as do të bëj presion për arsye së këtë jam në rolin e presidentit të Bordit Drejtues të Fondit për të drejtat Humanitare nga pranvera e këtij viti dhe mund të ju them se kam nderin e veçantë. Atë çka deshta të them është kjo: "Ende jam i shqetësuar nga ato që dëgjoja nga nënat dhe baballarët, nga këta të rinj të cilët kanë qenë viktimat apo më të afërmit e tyre kanë qenë viktimat. Për mua kanë qenë shumë tronditëse, me të vërtetë të gjitha këto të cilat i kemi dëgjuar. Por, mua me ka tronditur fakti i asaj të cilën nuk e kam dëgjuar. Duke dëgjuar për këto viktimat fillova pastaj të mendoj sa njerëz dhe gra nuk kanë mundësi të drejtohen në këtë mënyrë opinionit të gjërë. E drejta e cenuar për shkak të manipulimit, dhe vullnetit jo të mirë për të krijuar situatat, kushtet, forumet ku këto çështje të cilat jua kemi prezentuar opinionit dhe njerëzve në njëfarë mënyre e kishin lehtësuar bartjen e barrës nga supet e tyre apo e kishin nda dhembjen e tyre së bashku me të tjerët, me ata të cilët kanë qenë viktimat apo me mua të cilin nuk kam pasur këtë eksperiencë. Njëra nga personat së cilës ju ka cenuar e drejta e dëshmisë është nëna ime për shkak së ka qenë hebreje. Me kujtohet, kam qenë në klasën e parë të shkollës fillore dhe ajo ka qenë farmacistë, erdhi nga puna në shtëpi dhe i tha babait tim ashtu e ngazëlluar: - jam sikur e helmuar ai Dosheni është duke u shetitur nëpër rrugët e Banja Llukës, sikur mos të kishte ndodhur asgjë". Dosheni ishte gardian i burgjeve kroate „ustash” një kohë. Asnjëherë nuk është i gjykuar, e as njerëzit që ishin viktimat e tij nuk kishin mundësin për tu trajtuar publikisht dhe në njëfarë mënyre t,i nxjerrin në opinion faktet të cilat i dinin. E gjithë kjo në lidhje me nismën e koalicionit dhe unë mendoj se në këtë punë jemi duke e bërë për arsye për mua të paktën e çartë dhe normale e kjo është për të krijuar kushtet dhe në njëfarë mënyre me hapa të vegjël, të vazhdueshëm dhe në kontinuitet për çfarëdo satisfikcioni aposa për t'i kënaqur viktimat. Për fat të keq edhe se jam një avokat, fatkeqësisht gjyqësia moderne, veçanërisht kodi penal ka krijuar një instrument shumë të fortë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut të të akuzuarit dhe të të gjykuarit para gjykatave. Duke filluar nga gjykatat ndërkombetare deri tek ato kombëtare. Megjithatë, viktimat janë tërësisht të braktisura, shpesh herë të dorëzuara të vetë-kujdesit dhe kryesisht janë nën kujdesjen e OJQ-vë, e shumë më pak shtetit. Përsa i përket komentit se kjo mund të jetë iniciativë e parakohëshme unë aty nuk do të mbaj qëndrim të fortë, por duhet të them këtë. Nëse ndjenja e parakohëshmërisë vije nga inertionet ballkanike të njohura për neve, frika nga e krijimi i një te reje, diçka tjetër e bazuar në atë domethënie tipike për neve, mos pashë nënën, mos fut ndonjë risi, atë që kemi është mjaft e mirë. Unë mendoj se kjo nuk është një qasje e duhur dhe nëse dikush këtu prezent në këtë bazohet në rezervat e tija për këtë iniciativë unë apeloj të rishqyrtohet. Megjithatë, lidhur me këtë kuptim që dhe pas Luftës së Dytë Botërore, kanë kaluar pesë vite jo te plot kur u vurën themelet e Bashkimit Evropian Kush ishin iniciatorët kryesorë të idesë së Europës së bashkuar? Dy armiq të gjakut nga Lufta e Dytë Botërore,

Franca dhe Gjermania. Kështu rrefimet rreth parakohmerisë disi më shumë me nxisnin të përcaktohem për atë, që tani nuk mund të gjej personin, dikush ka thënë se jemi vonuar. Dhe kjo ka sigurisht alternativa, kur përpiqet të shpjegohet. Unë jam një përkrahës i madhe qasjes rajonale në drejtësi në rajon nga arsyeja e thjeshtë që ne nuk duam me këtë nismë ta shkruajmë historinë, ne nuk jemi duke kërkuar përgjigjen se kush e nisi artilerin, ju lutem, kjo është tërësisht jashtë fushës sonë. Ne fakt ne duam të tregojnë ose mendojnë se mund të del nga e gjithë kjo, që askush në këtë rajon nuk ka monopol mbi rolin dhe ndjenjat e viktimave. Pra, unë këtë jam duke e folur për shkak se këto dy ditë e kame aktivizuar shqisën e gjashtë në pauza, dhe këtu kam ndjerë diskutime shumë gjentile dhe njerëzore në mbledhjen plenare, kam pasur mundësi të dëgjoj në pauzë akneksat sikur, më çka janë duke folur këta Kosovarët, mjaftë më me ata, ne në Bosnje kemi më shumë probleme se ata, ne kemi vuajtur më shumë, serbët thonë çka dëshirojnë këta shqiptarët, këto janë tregime për fëmijë të vegjël, shpesh shqiptarët reagojnë në deklaratimet e serbëve, ndërmjet Kroacisë dhe Serbisë gjithmone gjendet dikush i cili do të thotë se kjo nuk ka qenë ndonjë agresion dhe kështu me radhë. Pra, unë nga ky përfundim nxjerr se në psikikën tonë ka sinqeritet për të cilën ne nuk jemi të vetëdijshëm. Vetëm kanë një model të vëzhgimit në vende të tjera që rezultuan nga ish-Jugosllavia dhe ato transportohen edhe në keto bisedime. Unë personalisht mendoj, këtu flitet për shumë shoqata kombëtare dhe sigurisht dëshmitar jeni ju përfaqësuesit e disa shoqatave. Unë po e shoh komponenten rajonale sikur një korrekтив shoqatave kombëtare të cilat shumë bien nën ndikimin e shtetit, bien nën ndikimin politikës etnike institucionale të vendeve të tyre dhe me ato është duke u manipuluar. Unë mendoj se nuk është asgjë e re që do të them, ndoshta ju e dini më mirë se unë si analist, por janë manipulime të mëdha, kur vjen puna të shoqatave, përpjekjet e lidereve kombëtarë, udhëheqësish për të treguar numrin e viktimave shumë më të lartë se që është, kështu me radhë dhe unë mendoj se ju e dini këtë, jeni në mes të këtyre ngjarjeve ku shumë shpesh shpie deri tek konflikti në mes të disa shoqatave, disa e kanë mbështetjen e shtetit, disa në të vërtetë janë të pavarura, të veprojnë si organizata jo-qeveritare. Dhe në fund të them se Iniciativa rajonale si i tillë mendoj se mund të kontribuojë harmonizimit të metodologjisë së hulumtimit të fakteve. Pa marrë parasysh çfarë është këtu duke u zhvilluar, kam frikë se do të bëj një gabim në numrim, por supozoj shtatë shtete, nuk do të bëj një gabim, pa marrë parasysh se janë në pyetje shtatë shtete, të gjithë në vijmë nga Kroacia, Serbia, Kosova, Mali i Zi, Bosnje dhe Hercegovina, ne trashëgojmë të njëjtin sistemin ligjor të ish-Jugosllavisë, e dëshirojmë ne at apo jo, ne jemi duke u kuptuar mjaft mirë, të paktën avokatët, shumë mirë kuptohemi rreth terminologjisë, ne lidhje me Institute, në lidhje me procedurën dhe unë mendoj që përvoja mund të aplikohet mbi metodologjinë e përcaktimit të fakteve nga të gjitha shtetet në një plan, që tani është Koalicioni apo nismë, ndoshta mund të bëhet apo të ndikojë në krijimin e Komisionit. Falemnderit që më keni dëgjuar!

Vesna Teršelić: Falemnderit shumë! Tea Preleviq Gorjanc.

Tea Gorjanc Prelević: Mirëdita të gjithëve, unë dje kam folur në sesionin e parë, për atë nuk dua për të ju marrë shumë kohë, por vetëm të ju përkujtoj, unë vij nga Mali i Zi, nga OJQ Akcioni për të drejtat e njeriut e cila është përgjegjëse për organizimin e konsultimeve të organizatave joqeveritare dhe përfaqësuesit aktivistve të tjera nga

shoqëria civile nga Mali i Zi . Në të vërtetë përfaqesojmë lëvizjen kundër luftës e cila egziston në Mal të Zi që nga vitet 90-at. Nëse marrim parasysh se sot këtu nuk ka shumë organizata nga Mali i Zi, nuk janë të gjithë, unë kisha pasur dëshirë që shumë shkurt të flas. Besoj se do të kemi mundësi të dëgjojmë listën e organizatave të cilat e kanë mbështetur këtë iniciativë. Nga 15 organizata dy janë shoqatat e viktimave të krimit, ndërsa 13 organizata, organizatat për të drejtat e njeriut. Domethënë këta janë kolegët e mi të cilët nga fillimi i viteve 90-a edhe më vonë duke ndërmjetësuar rreth përcaktimit të fakteve, ndërmjetësojnë rreth përgjegjësisë se kryevepruesit të krimit, për dëmshpërblim dhe për drejtat e tjera lidhur me viktimën. Këto janë organizat të cilat veprojnë në Mal të Zi, aty ku jetojnë dhe ndërmejtësojnë në përcaktimin e se vërtetës për krime të cilat kanë ndodhur në territorin e Malit të Zi nga ana e autoritetit të Malit të Zi , sepse mendojmë se modestia elementare na udhëzon ta bëjmë pastrimin në oborrin tonë. Dëshiroj të theksoj se është e rëndësishme çka ka ndodhur në Kosovë, çka ka ndodhur në Bosnë e Hercegovinë, në Kroaci, në të gjitha vendet, duke përfshirë edhe atë çka tha zotëriu nga Slovenija. Neve na ka mbetur deri të ajo që të forcohet e vërteta. Çka do të thotë që kryesit të dënohen, viktimat në të gjitha vendet të dëmshpërblehen. Ne në Konsultimet në Mal të Zi kemi ardhur deri tek një dijeni, pse duhet të themelohet një Komision Rajonal, për çka kishte me qenë ajo e dobishme, çka do të thotë për interesat e tona këto të cilat janë dhe çfarë janë, besoj se nuk janë vetjake, por normal edhe për viktimat. Kisha pasur dëshirë të flas diçka konkrete në kontribut të komisionit. Me vjen keq se këtu nuk është prezente dhe zonja Bakira e cila ka thënë se në Bosnë e Hercegovinë të vetmet vende ku viktimat mund të vijnë tek drejtësia janë gjykatat dhe prokuroria. Unë si juriste, me të vërtetë me intereso çka është duke ndodhur përtej kufijve, dëshiroj të them iniciativë dy komisioneve për përcaktimin e së vërtetës në Mal të Zi, njëri është për Srebrenicë, e i dyti...me falni, në Bosnë dhe Hercegovinë, njëri është për Srebrenicë, e i dyti për Sarajevë të cilat i ka inicuar Këshilli për të Drejtat e Njeriut, apo ... me falni nëse gaboju në terminologji 1.22.02, por Gjykata Kushtetuese në Bosnë e Hercegovinë për shkak se ka qenë e stërmbuluar me ankesa nuk ka pasur kohë të zgjedh. Dhe gjykata, që do të thotë institucioni shtetëror juridik, kanë kuptuar që është e nevojshme të themelohet Komisioni. Sa i përket kësaj, pasi Jugosllavija, të cilës i kam takuar si qytetare më nuk egziston, jam e tyrpëruar për shkak të krimeve të kryera në hapsirat e saj. Unë mendoj dhe ju them që unë personalisht dhe organizata ime dhe të gjitha këto organizata nga Mali i Zi, kanë mbështetur me boshëllëk një ide e cila për tani na duket që ja vlen vëmendjen dhe mbështetjen, për çka dhe e kanë inicuar Fondi për të Drejtën Humanitare, Dokumenta dhe Qendra Hulumtuese Dokumentuese nga Sarajeva të cilat e kanë treguar me punën e tyre të deritanishme kanë vërtetuar që janë të paanshëm në përcaktimin e së vërtetës në lidhje me viktimat dhe krimet. Sigurisht të ju them, unë nuk e di a do të qëndroj mbështetja ime deri në fund dhe a do të jenë të gjitha këto organizatat të cilat që tani seriozisht kanë dhënë mbështetje këtij koalicioni do të mbesin në koalicion deri në fund. Unë që tani deklaroj se nuk do ta mbeshtes koalicionin pa kompetenca të mjaftueshme. Unë personalisht nuk do ta mbeshtes , por do të jem e sigurtë do të ndërmejtësoj se dhe organizatat tjera nuk e mbeshtesin këtë Komision e cili nuk do ta ketë drejtën e qasjes në arkivat shtetërore si çka ndodhur në Argjentinë. Unë gjithashtu nuk do ta mbeshtes Komisionin e cili do të ketë mandatin sikur komisioni i Vojislav Koshtunicës, për tu marrë me arsyet të cilat eventualisht kanë shkaktuar shkatërrimin e Jugosllavisë sikur të ishte ndonjë Institut Historiografik. Të humbasim kohë në punë pa

fund, e mos të miremi me përcaktimin e fakteve. Ta shkurtoj tregimin, dhe të ju tregoj edhe diçka pasi unë e kam planifikuar tregimin për amnesti. Unë kam meduar që ky diskutim do të ishte pak më i shpejtë, por po shoh se ende nuk është radha e saj dhe pajtohem nuk është as koha, vetëm të ju shpjegoj amnestin eventuale në të cilën gjendem dhe çka kam sugjeruar unë dje. Grasijela nga Argjentina, të cilën unë e kam modeluar, gruaja e cila e ka humbur djalin, dhe siç dëgjuat dhe ju vet e cila ka treguar për mija të zhdukur, ajo me ka treguar se në fillim, kur ju ka zhdukur djali, ajo ka dëshiruar vetëm hakmarrje, ajo ka dëshiruar vdekje për ata cilët e kanë mbytur. Por, me kohë e ka kuptuar se për atë shumë më e rëndësishme është ta din ku e ka djalin, dhe ta varros dhe në njëfarë mënyre të vije deri të njëfarë loje qetësimi. Dhe ajo me ka treguar, unë do ta shkurtoj, ajo me ka treguar se mënyra se si te vije deri tek e vërteta është nëse njerëzve ju jap njëfarë lloji karrote të cilët mundën për të na udhëzuar në vendet ku gjenden varret masive. Unë nuk di amnesti absolute, Zoti na ruajt! Çka jeni duke menduar, që unë jam duke ndërmejtësuar që kriminelet mos të denohen, por të mirret parasysht zvogëlimi i denimit njerëzve të cilët sinqerish ishin dalë në opinion dhe kishin treguar ku gjenden trupat e zhdukur dhe të tjerat. Kjo është temë për bisedë. Shumica nga ne deklarohet se nuk duam zvogëlimin e denimit, në rregull, por kjo është tema për bisedë. Unë dëshiroj të them, të propozoj, unë mendoj se tash mundem të përforcoj këta njerëz të cilët i kam organizuar, kam thënë dhe të shtunën në Mal të Zi, me seriozitet t kemi punuar se për shkak respekti, më mirë të them për mirëkuptim më të suksesshëm, në asnjë mënyrë, apo Këshillin koordinues këtyre organizatave, dhe ka qenë propozimi im, por e bëra rishikimin e hapave të bërë nga Kosultimet deri tek 2006. Për shembull, nuk kemi biseduar për asnjë lloj pajtimi. Shumë bukur, nëse deri tek pajtimi vije, por pajtimi nuk do të kishte qenë dashur të jetë në mandat Komisionit Rajonal as nuk figuron në konkluzionet të cilat deri tani i kemi. Domethënë mandati është përcaktimi i fakteve. Kush pajtohet, lum ai, por askush nuk ka folur për njëfarë lloj pajtimi, bashkim-vëllazërim, çka ta di unë. Mendoj se për kuptimin tonë, veçanërisht kuptimin e kësaj ideje nga ana e organizatave të cilat rishtazi janë bashkangjitur. Më të vërtetë të ju tregoj as unë nuk jam bashkangjitur në vitin 2006, por vitin e kaluar. Edhe unë nuk kam pasur shumë paqartësi. Domethënë mendoj dhe sugjeroj konkretisht Natashen dhe Vesnen dhe të tjerët nga Këshilli Koordinues. Që në ta bëjmë përbmbledhjen e çështjeve konkrete me të cilat jemi ardhur në Konsultime. Që do të thotë, që këtë iniciativë e cila egziston në material në dy faqe në njëfarë mënyre ta modernizojmë me atë çka kemi arriur deri tek dita e sotme. Që do të thotë, pse Komisioni Rajonal... po edhe një çështje e rëndësishme, ne kemi biseduar që do të bashkëpunojmë, a po ideja e Komisionit ka qenë të bashkëpunon me gjykatat, prokurorit. Jo ti shfuqizojmë gjykatat dhe prokurorit, jo ti zëvendësojmë, e njëta vlen dhe për institucionet, sikur që është Komisioni qeveritar për persona të zhdukur, askush nuk e ka pasur në mendje ta shfuqizojmë këto institut dhe komisionet qeveritare të cilat veç egzistojnë në këto vende, por përkundrazi, që Komisioni Rajonal të bashkëpunojë me këto institucione. Për atë mendoj se frika është plotësisht e paarsyeshme, po tash është kjo një iniciativë në përleshje. Me këtë e mbaroj, që do të thotë që atë deri të cila kemi aritur në sot të plotësohet për tu kuptuar në më lehtë, që organizat e reja të cilat dëshirojnë të na bashkangjiten ta dinë se së cilës ide i bashkangjiten dhe që ideja nuk është ende e përfunduar, a është kështu? Neve na pret ende shumë punë rreth këtyre rekomandimeve dhe rreth definimit se çfarë Komisioni rajonal në më të vërtetë dëshirojmë ta mbeshtesim. Ju falënderoj të gjithëve në vendje.

Vesna Teršelič: Ju falemnderit Tea, ne propozime mjaft konkrete dhe lus Miroslavin që...

Miroslav Varga: Që, unë do të ju marrë vetëm 20 sekonda jete, jo më shumë kam premtuar. Unë ketë koalicion e shoh sikur si ka thënë një poet, Vasko de Gama apo Oskar Daviço: „Nëse britma jonë nuk arrin deri tek qielli, bar e dimë se kemi brit si duhet”. Besoj se me ketë mesazh mund të shkojmë në pauzë.

Vesna Teršelič: Kemi vetem edhe nje vote, ju lus per pake durim. Bekim Gashi.

Bekim Gashi: Unë quhem Bekim Gashi, dhe vijnë nga komuna e Suva Rekë, unë jam anëtar i shoqatës: „Shpresimi", gjithashtu jam anëtar i familjes me të 22 viktimat të vrara, mbështet iniciativën për formimin e Komisionit Rajonal për zbardhjen e fakteve në lidhje me krimet e luftës. Ata njerëz që flasin në emrin tim dhe emrin e familjes sime që është herët, ata mund ta përfaqësojnë vetëm veten dhe jo mua dhe familjen time. Kisha dashur ta parashtroj një pyetje për ata: A e dini se sa janë nëntë vjet? Dua të them se nuk është herët për mua nëntë vjet janë si nëntë shekuj. Ndoshta duhet të them se është shumë herët për të kërkuar falje nga Serbia, të kërkon Serbia falje për pajtim, por për krijimin e Komisionit i cili është për zbardhjen e së vërtetës për krimet dhe faktet e luftës, për mua dhe për familjen time dhe shumë familje të tjera, pavarësisht nga përkatësia kombëtare dhe fetare nuk është e herët. Faleminderit.

Vesna Teršelič: Falemnderit shumë! Falemnderit shumë! Pauza, dhe ju lus pas 10 minutave kur ta dëgjoni zilen të ktheheni, ta përfundojmë dhe së bashku ta bëjmë një përmbyllje. Nëse ndërkohë dikush largohet ju lus t'i dorëzoni dëgjueset, për t'i përdorur ne.

Pauza

Vesna Teršelič: Ju lutem për pak vëmendje. Në këto dy ditë kemi kryer shumë punë, kemi pasur arritje të vogla, sikur disa nga pjesëmarrësit janë ardhur në Kosovë dhe i kanë njoftuar njerëzit e Kosovës dhe i kanë dëgjuar çka ka ndodhur, mendoj se është tejet e rëndësishme që i kanë nda vuajtjet e tyre dhe i kanë përshkruar ato çka ju kanë ndodhur, njëkohësisht kanë hasur në dëgjues të durueshëm. Duke ardhur në Prishtinë, e kemi ditur se është duke u themeluar një koalicion jozyrtar të cilin do ta zurtarizojmë tani këty. Tash do të ju lexojmë organizatat, individët të cilët na u kanë bashkangjitur, na kanë dorëzuar deklaratën për bashkangjitje, do t'i lexojmë të radhitura nëpër shtete aty ku është e mundur. Dhe kisha pasur dëshirë që të mos na keqkuptojnë nëse dikend e kapërcejmë, sepse shumica ka vendosur këtu të bashkangjiten dhe nëse e kemi kapërcyer dikend mundeni të shtoni. Unë do ta lexoj së pari Bosnën & Hercegovinën, pastaj Andrej Nosov do ta lexojë Malin e Zi, do të shkojmë me abeced. Domethënë si pas shteteve, jo me abeced sipas organizatave se nuk kemi arritur t'i selektojmë. Nga Bosna & Hercegovina janë bashkangjitur: Shoqata Gratë grave, Parlamenti i Helsinkut i qytetarëve nga Banja Luka, Shoqata e te burgosurve dhe shoqata e logorashve Brčko, Forumi i qytetarëve të

Tuzles,... kjo është një shoqatë sapo e shoh unë, por unë nuk do të hy në këtë, por do ta rishqurtojmë më vonë me ata të cilët e kanë nënshkruar. Pastaj Amir Taliq nga Sanski Mosti, Emsuda Mujagiq Me zemër deri tek paqja nga Bosna, Shoqata e të burgosurve dhe familjet e personave të zhdukur nëpër burgjet e Prijedorit 1992, OJQ Çelësi i ardhmerisë, Onda Amir Talić iz Sanskog Mosta, Emsuda Mujagić Srcem do mira iz Bosne, Udruženje Amir Kulagiq nga Srebrenica, i cili dje ka mbajtur fjalim, Biro për të drejtat e njeriut nga Tuzla, Komiteti Helsinkut për të drejtat e njeriut nga Bosna dhe Hercegovina, Shoqata Sefer Hallilović, Forumi i grave dhe Qendra akcionet te kundërdhunshëm me zyre në Sarajevë, do ta lexojmë prapë, sepse i ka zyret dhe ne Beograd

Andrej Nosov: Mali Zi: Akcioni për të drejtat e njeriut, Anima Kotor, Forumi Ndërkombëtar Mali i Zi, Liga e votuese e grave nga Mali i Zi, Lobi i grave malazeze, komiteti juristve malazezve për të drejtat e njeriut, Shoqata qytetarëve nga Bukovica, Plevla, Shtëpia për sigurinë e grave, Qendra për zhvillimin e sektorit joqeveritar, Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut nga Mali i Zi, Instituti alternative, Qendra për edukimin e qytetarëve, Shoqata e familjarëve të kidnapuarve dhe të vrarëve në Kosovë dhe Metohi Bozhuri i kuq, Shoqata e juristëve nga Mali i Zi.

Vesna Teršelić: Falemnderit Andreja. Kroacia: Domenta, Nenat e Vukovarit nga Vukovari, Alenaca e shoqatave të burgosurve dhe të zhdukurve mbrojtëse të Kroacisë, Grupi për të drejtat e grave Babe, Qendra e grave nga lufta Rosa, Legallis, Censura a po Shoqata censura plus nga Spliti, Qendra për mbështetje dhe zhvillim shoqërisë civile Delfin nga Pakraci, Grupi koordinues i grave, Grupi lezbejkave Kontra, Altruist qendra për mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga Spliti, Qendra për studimet paqësore nga Zagrebi, Qendra për paqe, kundër dhunës dhe për të drejtat e njeriut Osijek, Luç për dialog dhe kundër dhunës nga Berka, Nensen dialogu qendra nga Osjeku, Homo nga Pulla pastaj kemi edhe disa individ të cilët na kanë përkrahur si për shembull Jarosllav Voza përfaqësuesi i pakicës çeke. Milladin Jakovleviq i këshillit kombëtar nga Pakraci gjithashtu Zlatko Grafina nga Pakraci. Këta nuk janë këtu me neve, por na kanë dërguar deklarata, sepse ata në Pakrac, ata kanë mbajtur bisedime dhe e kanë identifikuar këtë iniciativë sikurse tejet vacante, Teodora Krok, Tim Gazivoda nga Qendra për të drejtat të njeriut, Marica Sheatović nga Novska, Ana Kvesiq nga Vukovari dhe Zagrebi, Varga Miroslav nga Osijeku, Maniq Zhelko nga Knini. Dhe për Bosne, tash e pastaj se ka ende nga Bosna, kam harruar fondacionin Cure dhe tash shkojmë në Kosovë.

Vesna Teršelić: Falemnderit Valdet, Yamir Net nga Kroacia, por unë supozoj se Golliq /Golić Sead dhe Faylloviq Novallija/Fazlović Novalija janë nga Bosna. Nga Slovenia janë Peace Institute Liubiana apo Insitiuti i paqes nga Slovenia, nga Maqedonia Aco Stojanovski, nga Mbrojtësit e Unionit nga Maqedonija dhe në radhë është Serbia.

Andrej Nosov: Nga Serbia nëse ndokënd e anashkalojmë...Fondi për të Drejtën Humanitare, Gratë në të Zeza, Komiteti i juristëve për të drejtat e njeriut, Iniciativa e të rinjve për të drejtat e njeriut, Shoqëria e gazetarëve të pavarur të Vovodinës, Fraktalli, Këshilli i Helsinkut për të drejtat e njeriut nga Serbia, Qendra për rajonalizim nga Novi Sadi, Qendra për paqe dhe domakraci, Qendra për promovim të drejtësisë legale, Qendra

per zhvillimin, Qendra në Beograd për të drejtat e njeriut, Qendra për zhvillimin e resurseve civile nga Nishi, Këshilli i të drejtave të njeriu nga Leskovci, Këshilli I Sanxhakat për të drejtat e njeriut nga Novi Pazari, Qendra e traumatuarve Incest, Kvirija, Labris, Impuls nga Tutini, Flloros nga Sjenica, Urban nga Novi Pazari, Iniciativa regjionale e grave nga Vojvodina, Shoqëria Baçka Pallanka, Qendra akcioneve të dhunshem QADH, Iniciativa e demokracisë në tranzicion, Linet, Forumi OJQ Krlevë, Gratë për paqe Leskovce, Qendra qytetarëve nga Vojvodina, Qendra Qytetarve nga Kragujevci, Biro, Nisma Evropa nuk ka alternativë, Gurishtja Krushevece, Iniciativa qytetarëve Pançevë, Magjar sot, Shoqata e të vrarëve dhe të kidnapurave në Kosovë, Qendra Informative dokumentare nga Beogradi, Shoqata qytetarve Gest nga Tutini, OJQ Dora nga Tutini, Shoqata qyteti i rrafshit Sombori dhe Bordi për iniciativen qytetare nga Nishi, të cilën e kemi lexuar nga kjo list , Forumi i qytetarëve nga Novi Pazari, tani i kemi individet. Ndoshta dikush nga këta individë nuk i takon Serbisë, por nuk kemi pasur kohë t'i selektojmë. Boriq Stevo, Zhanka Stojanoviq, Nevenka Billa, Gordan Petroviciq, Jasmina Bogojeviq, Marinko Gjyriq, Vukelliq Millorad, Shariq Boshko dhe Mandiq Drinka.

Vesna Teršelić: Unë kam dhe një shtesë për Bosne e Hercegovinën, Shoqata e Prijedorit Burim, Edin Ramuliqi, dhe për Korrigjimin nga Slovenia, Iniciativa e Civilëve Aktivistëve të Shlyer nga Slovenija dhe kam ende nga Slovenija Dimitri Anakijev, regjisorin. Kemi organizatat nga Gjermania, Forum ZDF, domethënë janë duke na mbështetur kritikues të ndërgjegjjes, Impunity Watch dhe mbështetja të cila arrin jashtë rajonit tonë. Janë duke mu çartësuar deri sa jam duke i shikuar. Këto deklarata për bashkangjitje, shpresoj se i kemi të gjitha adresat e atyre të cilët e kanë nënshkruar, besoj që i kemi dhe të gjithave organizatave, por s'kisha pasur dëshirë të ndodhe, që ju, dikush e nënshkruani deklaratën e ne mos ta kemi adresën. Nëse nuk jeni të sigurtë që e kemi adresën e juaj , kishte qenë mirë ta lini adresën të jemi në kontakt, është shumë e rëndësishme të komunikojmë. Lidhur me konkluzione nga ky Forum, për te rinjtë dhe ballafaqimi me të kaluaren do të na tregojë diçka Emina Buzhinkiq, pastaj na mbetet të mirremi vesh se si do të koordinohemi.

Emina Bužinkić: Faleminderit, Vesna!. Mirëdita të gjithëve. Dje në panel ballafaqimi i të rinjve me të kaluaren kemi propozuar t'i paraqesim rekomandimet qeverive të shteteve të ish Jugosllavisë, që në strategjitë dhe dokumentet e tyre të cilat referohen të rinjtë, të integrojnë mësimin nga e kaluara, mbështetja paqes, në njëfarë mënyre mësim paqësor. Unë ju kisha lexuar përmbajtjen e teksit të cilin sot e kam shkruar, i cili do të jete i përfolur në Grupin Rajonal për të rinjtë, pastaj me të gjithë pjesëmarrësit nga ky tubim dhe në fund do të ju dërgoj qeverive të cilat i përmenda. Teksti është:

Ne të rinjtë, pjesëmarrësit të Forumit të katërt për themelimin e së vërtetës në vendet post-Jugosllave, i cili është duke u mbajtur në Prishtinë, në Kosovë, nga data 27.10.2008 deri me datë 29.10.2008, dëshirojmë të gjitha qeverive post-jugosllave t'iu paraqesim rekomandimet që brenda strategjisë shtetërore për të rinjtë, dmth politika e të rinjëve apo politika rinore, të përmban masa të cilat bazohen në informim afatgjatë dhe arsimim për histori, faktet të cilat janë themeluar nga luftërat me procese afatgjate për ta ndërtuar paqen dhe themelimin e drejtësisë në rajonet post-konflikte të ish Jugosllavisë. Me rëndësi të veçantë dënimin publik të çdo forme të mosdurimit dhe intolerancës, urrejtjes së

gjuhës, pasqyron forma të sjelljes dhe të aktit të çdo nacionalisti. Ne të rinjtë kga ky tubim apelojmë që të investohen të gjitha resurset, që vlerëshmeria, mosperdhunimit, tolerancës, kuptimet e ndryshimeve të afirmohen në hapsirë publike dhe të njihen dhe të veçohet roli i afirmimit i të rinjëve me të njëjten vlefshmëri. I ftojmë qeverite të shteteve të ish Jugosllavisë. Me rëndësi të veçantë dënimin publik të çdo forme të mosdurimit dhe intolerancës, urrejtjes së gjuhës, pasqyron forma të sjelljes dhe të aktit të çdo nacionalisti. Ne të rinjtë kga ky tubim apelojmë që të investohen të gjitha resurset, që vlerëshmeria, mosperdhunimit, tolerancës, kuptimet e ndryshimeve të afirmohen në hapsirë publike dhe të njihen dhe të veçohet roli i afirmimit i të rinjëve me të njëjten vlefshmëri. I ftojmë Qeverite të e shteteve të ish Jugosllavisë që me seriozitet të nixisin procesin e ballafaqimit me të kaluarën nëpërmes dokumantave të tyre dhe me aktet e tyre dhe drejtëpërsëdrejti ju mundësojnë jetën e të rinjëve me trashigiminë e luftës por një jetë me paqe. Përpos kësaj i ftojmë Qeveritë e shteteve të ish Jugosllavisë së më aktet e tyre i shtojnë të rinjtë, të marrin pjesë aktive në proces të ballafaqimit me të kaluarën themelimin e fakteve dhe pjesëmarrjen në procesin e kuptimit të paqes në këto vende si këto trashëgime nga lufta mos të gjenerohen në luftime të reja, dhuna e re gjeneratave të reja.

Të rinjtë sot jetojnë me pasojat e të së kaluarës të cilat janë pjesë e këtyre vendeve. Pasojat e konfliktit të luftës dhe dhunës nuk guxojn të përsëriten, e politika e të rinjëve, a po politikat rinore janë njëra nga mënyrat që qeverija mund ti parandaloj konfliktet dhe të ndikoj në kualitetin e jetës të rinjëve në vendet post-jugosllave. Ne të rinjtë nga ky tubim dëshirojm të kuptojmë qka ka ndodhur në këto vende të ish Jugosllavisë për të pasur mundësi konstruktivisht të mirremi me pasojat e konfliktit. Ne nuk jemi ardhmëri, ne jemi e tanishmja.

Do të thotë këtë tekst do t'ia propozojmë të gjithë personave të rinjë të cilat kanë qenë në këtë tubim, të paraqes pjesëmarrësve dhe pas rregullimit të fundit, dhe autoritetit të këtyre shteteve.

Vesna Teršelić: Faleminderit Emine? Natasha, a dëshiron tash ti me konkluzione?

Nataša Kandić: Unë do të provoj në bazë të diskutimeve, ti veçoj disa rekomandime dhe përfundime, në bazë të asaj se disa herë ato janë të veçuara dhe kanë qenë qëndrim i përbashkët i pjesëmarrjeve. Se pari, një konstatim themelor që sot zyrtarisht është themeluar, dhe ka filuar të funksionoj Koalicioni i shoqërisë civile për të ofruar përkrahje për themelimin e Komisionit regjional për përcaktimin e fakteve të krimeve të luftës dhe shkeljet e tjera të rënda të drejtave të njeriut, të cilën shkurtimisht e emërtojmë Koalicioni për KOMRA, ky Koalicion numëron më shumë se 100 organizata, dhe nuk e kemi numrin e saktë të individëve. Nga ky çast të zyrtarizimit të Koalicionit për KOMRA, hapim debatin për mandatin dhe karakterin e Komisionit Regjional, unë mendoj që qëllimi është se tërë procesi konsultativ të na shërbej që ne si Koalicion i shoqëris civile ta definojm karakterin dhe mandatin Komisionit Regjional, ti përcaktojm të gjitha elementet e nevojshme të propozuara nga ne, të cilët munden t'iu ndihmojnë qeverive, por edhe neve për t'iu drejtuar Parlamentit Nacional në miratimin e vendimit për formimin e Komisionit Regjional. Dëshirojm të jemi të sigurt, që kur ti drejtohem Pealamentit Nacional ti kemi të qarta pasqyrat e të aritura e këtij procesi konsultativ me

të gjitha elementet e nevojshme, duke ja filluar nga karakteri, pastaj dhe nga kriteri për të përzgjedhur antarët deri tek mandati, programet e reparacionit të cilët eventualisht do të ishte dashur që Komisioni ti propozonte, por edhe për të qenë në gjendje dhe të kemi mundësi që gjatë procesit pranimit nga organet shtetërore, ne kemi mundësi të përcjellim, të rishqyrtojmë dhe të kërkojmë që Komisioni të themelohet në përpuethshmëri me modelin e propozuar nga ne. Koalicioni do të funksionojë me një organ operativ, i cili tash veq se egziston, Grupi koordinues, Keshilli Koordinues në të cilin egzistojnë individët të cilët veq tani mund të shërbejnë antarëve të Koalicionit të cilët do të organizojnë konsultime të nivelit lokal, nacional apo nëse organizohen konsultimet apo forumi në nivelin regjional. Tani, kemi filluar të funksionojmë në atë mënyrë. Unë do t'iu jap vetëm një shembull. Akcioni për të drejtat e njeriut nga Mali i Zi të shtunën e kaluar ka organizuar konsultimet me përfaqësuesit e shoqëris civile dhe me kanë ftuar mua të flas rreth inicijativës regjionale për themelimin e Koalicionit dhe rreth inicijativës për themelimin e Komisionit Regjional. Në Vukovar ne të tret, të katërt, ne të cilët jemi nga fillimi pjesëmarrës në të, jemi munduar të sigurojmë me informata të nevojshme të gjithë ata të cilët kanë marrur pjesë në të. Të gjithë neve na nevojitet kohë dhe ky proces konsultativ do të zgjatë, por ne duhet ta kufizojmë, ne kemi planifikuar se në fund të vitit të ardhshëm ta përfundojmë tërë procesin e konsultimeve së bashku me një milion nënshkrime. Deri atëherë në proceset konsultative me këmbëngulje do të diskutojmë rreth mandatit dhe karakterit Komisionit, duke i përfshirë dhe cilësit tjera të propozuar rreth këtij, të cilin shkurtimisht e kemi emërtuar si KOMRA. Ajo çka ka qenë në terësi evidente dhe është dëgjuar në fjalime të shumta të pjesëmarrësve, është së prioriteti duhet të jetë dënimi i ekzekutivëve për krime të luftës. Është përmendur dhe strategjia e procesimit por mos të harrojmë se e gjitha është githëmonë nën juridiksionin e organeve shtetërore, me atë se organizatat joqeveritare janë bamirëse me ndihmën e tyre të cilën ju ofrojnë organeve shtetërore në krijimin e strategjisë për procesimin e krimeve të luftës. Ka pasur edhe dyshime rreth gjykatave të disa shteteve, se sa mund të arrijnë drejtësinë, por në kohën e post-konflikteve është e natyrshme të ketë dyshime asi soji por për atë egzistojnë organizatat për të drejtat e njeriut të cilat mund të garantojnë me pjesëmarrjen e tyre në gjykimet për krime të luftës dhe janë të gatshme të bëjnë qmos që drejtësia për viktima të jetë e përmbushur dhe ky është një rol i ri i organizatave për të drejtat e njeriut të cilin veq mund ta shohim dhe në Sërbë, në Kroaci dhe në Bosnë dhe Hercegovinë, ku shoqatat familjare të viktimave kanë një rol shumë aktiv duke ju ofruar mbështetjen prokurorive dhe gjykatave në procesimin të krimeve të luftës, ajo çka është tejë e rëndësishme, nuk kemi qenë të gjithë të barabartë të përfshirë në zhvillimin e konsultimeve. Duhet ta pranojmë se edhe neve të cilët e kemi nxitur kemi pasur nevojë për kohë të arrijmë të gjitha elementet të nevojshme të shohim dhe të zgjidhim më të mirën si dhe mënyrën më të përshtatshme. Ju keni mundësi që shumë qartë ta shihni që në tri organizatat të cilat e kemi nxitur këtë iniciativë me vetëdëshirë, me dijetshmëri dhe përgjegjësi të plotë, kemi refuzuar që në të udhëheqim procesin. Ne dëshirojmë të jemi shërbim, kemi organizata të cilat kanë qëndrim shumë të mirë, stojnë dhe profesional. Dëshirojmë të ndihmojmë, të jemi shërbim por të marrim pjesë në këtë Koalicion, të gjithë ato të cilat do të ndodhin në të ardhmen, të gjithë konsultimet do të mbahen në emër dhe në bazë të vendimeve dhe konkluzioneve të këtij organi të cilin e kemi themeluar ne, nga ky Koalicion. E kemi parë se disa shtete dhe disa shoqëri kanë nevojë për më shumë kohë se të tjeret. Sot kemi pasur mundësi të vërejmë se disa organizata për të drejtat e

njeriut dhe disa shoqata, kanë qenë më pak të kënaqshme sepse nuk ja kemi kushtuar vëmendjen diskutimve rreth Komisionit por prap duhet të kemi kujdes se këtu janë degjuar zërat e disa shoqatave të viktimave, gjithashtu të komuniteteve nga disa vende të cilat kanë nevoj për më shumë kohë për bisedime rreth inicijatives, dhe të kenë më shumë njohuri rreth asaj se si do të jetë Komisioni. Unë mundem vetëm të përsëris se ne të gjithë jemi të gatshëm, në të cilët jemi një kohë të gjatë në këtë proces konsultativ, jemi gjithmonë të gatshëm të vijmë, të shpjegojmë, t'iu dërgojmë tekste tej të vlerëshëm të cilat flasin shumë për këtë, tekstet me përvoja të tjera, çka keni nevoj ne jemi të gatshëm t'iu ndihmojm, vetëm ju lus keni kujdes se ne të gjithë duhet të jemi të barabartë rreth pjesëmarrjes dhe mos dyshoni se ne dëshirojm diçka kundër disa interesave të juaja. Ne i repsektojm dhe pranojm të gjitha ato të cilat ju sot dhe dje i keni parashtruar këtu por të jeni të bindur se ne jemi të gatshëm t'iu ndihmojm për çka do që keni nevoj lidhur me informimin, apo me informacione të nevojshme. Ndoshta ta thërrasim dikë nga vendet tjera që të flet. Unë dje kam vërejtur se me vëmendje e keni dëgjuar mysafiren tonë nga Argjentina. Dhe me dikë në fund, unë jam vërtet e lumtur se e kemi dëgjuar mysafiren tonë nga Argjentina. Dhe unë jam e kënaqur me këtë tubim. Më duket se kur ka përfunduar ai moment i ndjeshëm kur më duket që është e mundur të bëhet diçka çka veq e kemi bërë, atëherë ka shkuar mjaft mirë. Janë edhe ata të cilët janë të pavidosur, që në këtë moment nuk munden apo mendojn se kjo nuk është një iniciativë e mirë, gjitha këto janë të përfshira në procesin e koalicionit. Ju lutem, të gjitha këto do të regjistrohen, do të egzistoj transkripti nga ky tubim, të gjithë mundeni të lexoni çka keni fol ju apo çka kanë folur të tjerët. Unë jam e bindur se këta forumat tonë, konsultimet, dhe tërë ky proces i jonë një ditë do t'iu shërbej tjerëve që të mësojnë, të shohin si themelohet një organ për vërtetimin e fakteve për krime të luftës. Nuk ka sukses një organ kesi soji nëse nuk implementohet procesi konsultativ sikur ky të cilin ne jemi duke implementuar. Unë shpresoj se edhe ju mendoni sikur unë se këto dy dhe më shumë ditë kanë qenë një kohë e mirë, dhe se është e nevojshme të kemi më shumë takime sikur ky dhe që kemi nevoj të gjejmë mënyra të ndryshme për konsultime dhe ti përfshijmë antarët e koalicionit në të. Unë sot dëgjoja se në Nishë, në korniz të një programi që tani egzistues ka pasur diskutime rreth Inicijatives për formimin e Koalicionit, dhe rreth vetë inicijatives për Koalicion për themelimin e KOMRA-es. Gratë në të Zezë në Sërbi, Vojvodinë kanë pasur takime pa të numëruara me rrjetin e tyre në të cilat është diskutuar jo vetëm për Koalicion, por edhe të diskutojn dhe ftojn si mysafir grate të cilat kane qene anëtare ne komisione të ndryshme shoqërore post konflikte dhe post totalitare. Kisha dëshiruar se dhe ju sot bashk me mua ta ndani këtë disponim jo që vetëm ju kemi treguar viktimave të cilat kanë folur që janë për ne shumë të rëndësishëm por që dëshirojm komisionin i cili në mandatin e vetë do të ketë dhe dëgjim publik, për ti ndarë me ne se këto diskutime kanë qenë të rëndësishme, që është me të vërtetë dëm që sot nuk e kemi pasur askënd nga Republika Sërpska por është me të vërtetë mirë se sot në mesin tonë kemi pasur familjarët e viktimave nga Sërbija. Ky tubim është një ndër më të mëdha deri më tani , ditën e parë kemi pasur 460 pjesëmarrës, ditën e dytë 460 pjesëmarrës. Mos të kishin qenë njerëzit nga Inicijativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, kishte qenë me të vërtetë mjaft veshtirë të organizojmë tërë këtë protokol organizimi të komplikuar dhe ta implementojm në vepra. Përkthyesit kanë pasur një punë të rëndë por duhet të përmendet se këto përkthime nga anglishtja, prej anglishtes në serbishte dhe shqip, nuk janë në mënyrën e duhur, ka pasur pak vështirësi gjatë përkthimit, për atë arsye propozoj që në

forumet e ardhshme të kemi përkthime drejtëpërdrejtë nga gjuha e cila flitet. Unë kërkoj falje por duhet ta pranoj që për këtë proces konsultativ... Plotësisht të kuptoj dhe plotësisht ke të drejtë për këtë koment por unë nuk kam qenë mjaft e saktë dhe mjaft e qartë të them Shoqatat Sërbe Familjarëve të Viktimave, është e rëndësishme të kemi këtu sepse mënyra në të cilën ata kanë refuzuar të marrin pjesë këtu nuk është në dobi të askujt, nuk është e dobishme as për ta. Ju keni ardhur, e ata kanë refuzuar të vijnë me justifikime se ata nuk e pranojnë Kosovën.

Por, edhe ata janë të nevojshëm dhe duhet të inkuadrojmë në procesin konsultativ.

Emsuda Mujagić: Nataša, ne kemi eksperiencë që të krijojmë dhe të organizojmë takime apo konferenca kësi lloji brenda atij entiteti, por nëse bisedohet për viktime dhe për diçka çka ne sot jemi duke biseduar, prandaj dua të jem e sinqert dhe të shprehem se ata nuk kanë vesh për këtë. Vetë fakti tregon se në shumicën e vendeve entitetit Republika Serpska nuk ka pasur luftime, e ka pasur me mijëra dhe mijëra viktime civile, gra, fëmijë, të moshuar dhe djem të rinjë dhe tjerë të cilët kanë pësuar. Është i vetmi shkas që disa kanë rezistencë për të folur dhe për të përcaktuar gjendjen faktike, për atë arsye ndoshta në kokat e tyre ende egziston një rezistencë por unë shpresoj se kjo gjendje do të ndyshoj nëse ju provoni të hyni në të dhe nëse bisedojmë në vende publike me një numër kaq të madh njerëzish.

Nataša Kandić: Unë shpresoj. Është me rëndësi që edhe ata të marrin pjesë në procesin konsultativ. Do të provojmë të organizohemi, që, ju në Kozarac apo ju në Banja Llukë, do të provojmë të organizohemi se procesi konsultativ nuk mund të jetë i sukseseshëm nëse nuk marrin pjesë të gjithë. Unë në këtë çast nuk jam duke i përfshier institutet dhe institucionet shtetërore sepse ky proces konsultativ është duke u zhvilluar në kuadër të shoqërisë civile dhe ne si shoqëri civile do të dalim para organeve shtetërore vetëm me pjesën e KOMRA-s të cilën ne do t'ia propozojmë, por parlamenti do ta krijojë dhe ta themelojë.

Ivan Zvonimir Čičak: Diçka shumë të rëndësishme, ndoshta për ju më pak e rëndësishme. Këto nuk janë vendet pas ish- Jugosllavisë, por janë shtetet e trashëguara nga ish-Jugosllavia. Përsëris, shtetet e trashëguara, jo vendet, është korigjim i rëndësishëm. Faleminderoj.

Vesna Teršelić: Faleminderit. Unë do të kisha lexuar emrat në deklaratat të sapo arritura, Avdić Reihja nga Udruženja Žena Srebrenice u Tuzli Avdiq Reihja nga Shoqa e grave të Srebrenicës nga Tuzlla, Hasanović Naza iz Udruženja Žena Srebrenice, sa sjedištem u Tuzli/ Hasanović Naza nga Shoqata e grave të Srebrenicës me seli në Tuzell, Muhić Safeta iz Srebrenice/ Muhiq Safeta nga Srebrenica, Zdravković Snežana Zdravković Snezhana/ Džinić Sadeta/ Xhiniq Sadeta, Hakija Smajlović/ Hakija Smajllović, Selimović Suada/ Sellimović Suada. Individët nga Mali i Zi janë Sead Sadiković/ Sead Sadiković, Aleksandar Zeković/ Aleksandar Zeković, Petar Komnenić/ Petar Komneniq, Slavica Brajović/ Sllavica Brajović, Koča Pavlović/ Koça Pavllović, Dragoljub Duško Vuković/ Dragolub Dushko Vuković, Veseljko Koprivica/ Veselko Koprivica dhe Snežana Nikčević/ Snezhana Nikçević. Dhe kam dashur t'iu tregoj se në kohë të koalicionit joformal para këtij çasti të sotshëm formalizimit të punës së Grupit koordinues, në të cilin

jemi Nataša Kandić/Natasha Kandiç,Valdete Idrizi/Valdete Idrizi, Vesna Teršelić/Vesna Tersheliq, Andrej Nosov/Andrej Nosov, që po na shihni këtu. Këtu ulur gjendet edhe Eugen Jakovčić/Eugen Jakovleviq. Eugene, të lutem ngritu të shohim dhe gjithashtu disa gazetarë të cilët sot nuk janë me ne Dinko Gruhonjić iz Novog Sada/ Dinko Gruhonjiq nga Novi Sadi dhe Aleksandar Trifunović iz Banja Luke/ Alleksandar Trifunoviq nga Banja Lluca, sepse te dyve është duke iu ndodhur diçka me fëmijët e tyre të vegjël,me ne këtu është dhe Amir Kulaglič/ Amir Kullagiq dhe Mirsad Tokača/ Mirsad Tokaqa të cilët kanë qenë të detyrur të kthehen në Bosnë dhe Hercegovin. Ne kemi pasur bashkëpunim të mirë dhe do të dëshirojmë që ta koordinojm këtë punë deri tek Forumi në Podgoricë të cilin me të gjitha gjasat do të mbahet në prill, vitin e ardhshëm, për atë dëshirojm të dimë a ju konvenon. Na vjen shumë keq se nga Mali i Zi nuk ka marr pjesë askush , Tea Gorjanac Prelevic veq tani i ka organizuar konsultimet në Mal të Zi, dhe më deshirë të madhe kisha dashur që të na bashkangjitet sepse ky komunikim në disa shtete është pjesa më e rëndësishme e procesit të cilin duhemi ta përpunojmë dhe ka me rëndësi tejë të veçant që për këtë inicijativ të dëgjoj një numër i madh i njerëzve, me kushte cilësore që bart një person të jetë në funksionimin e Grupit koordinues, sepse Grupi Koordinues takohet mesatarisht një herë në tri javë. Por pasi gjatë verës nuk jemi takuar shpesh ,jemi takuar çdo dy javë. Ajo është punë e madhe, për atë ne propozojm të na bashkangjitet dhe Tea, dhe ta kemi këtë grup Koordinues deri tek Podgorica. Qka thoni ju për këtë? Ju falemnderoj në përkrahje.

Nataša Kandić:Është shumë e rëndësishme sepse dikush pytë se si do të komunikojm më tutje. Tash për tash egziston personi i cili teknikisht i organizon të gjitha takimet, nuk është vetëm përgatitja teknike në pyetje, kjo është me të vërtetë një mundim i jashtëzakonshëm, pastaj komunikojm përmes e-mailave, unë mendoj se ne te gjithë posedojmë, për këtë ju lus, juve të gjithë që në këto materijale mund të gjeni e-mail adresen e Fondit për të Drejtën Humanitare Beograd, Fondit për të Drejtën Humanitare Kosovë, adresën e Dokumenti gjithashtu dhe Community Building Mitrovica, dhe Nismja e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut. Ju lutem, ne tash do të provojmë ti rradhisim konkluzimet, dhe ti heqim të saktat, ju dërgojm të gjethëve, ti vendosim në web sajt, dhe pastaj do të mendojm si të vazhdojm më tutje, por nëse nuk ka, nëse nuk egziston, të gjithë të keni të qartë se nuk ka ndonjë fond të rezervuar për procesin e konsultimeve. Nuk egziston. Ne kemi premtime për mjete të dedikuara për Forum në Mal të Zi, Vesna Tersheliq do ti organizon Konsultimet me historijanët, sociologët në Zagreb dhe në nëntor dhe që... zotëri Haki Kasumi... Ka shkuar? Sa di unë ai është historian a është ashtu? Më duket se duke ju afruar fundit, ai është më larg dhe më larg. Jam duke bërë shaka. Por ky është njeri nga hapat e ardhshëm. Atë qka e kemi me rëndësi, ne të gjithë duhet të propozojm, të mendojm, Gratë në të Zezë veq tani e kanë hartuar, si ato do ti organizojnë konsultimet. Ne jemi të gatshëm të ndihmojmë lidhur me informacinet rreth komisionit, me përvojat e të tjerëve,vetë inicijativës, gjithë jemi të gatshëm të vijm. Nëse ndonjë nga ju ka propozim, ndihmoni sikur me pjesëmarrjen tuaj që keni kontribuar ti qartësojm disa çështje, dhe të kuptojm çështjen e Koalicionit, dhe çështjen e Komisionit Regjional. Dhe të qartësojm tërësisht dhe të gjithë të kenë më të qartë që ne nuk jemi duke e formuar Komisionin por qëllimi i procesit konsultaiv është qasja për formimin e Komisionit Regjional, dhe ne si shoqëria civile dhe si Koalicion tërë kohën do t'ia përkushtojm diskutimeve dhe shqyrtimeve rreth asaj se si duhet me qenë Koalicioni, për

cilësin dhe mandatin saj, dhe do ti nxerim përfundimet e ketij procesi si model më i sakt për Komisionin Regjional për përcaktimin e fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të drejtave të njeriut. Si do ti qasemi? E kemi deklaratën e cila paraprkisht duhet të nënshkruhet, do të egzistoj një libër, dokument në të cilin do te arkivohen deklaratat e nënshruara me dorëshkrim, mund ta dërgoni dhe deklaratën me e-mail, por në të duhet të konfiguroj nënshkrimi. Ne e paramendojm këtë libër si një dokumet të bukur me të cilin një ditë dhe me një milion nënshkrime me të do të shkojm drejt parlamentit. Atë libër nuk do t'ia dorëzojm asnjë parlamenti sepse do të ketë vetëm nje ekzemplarë, do të vendosim ku do ta ruajm dhe do të mbetet si diçka e vlerëshme për gjeneratat e ardhshme mbi të cilën do të mësonin si këtu një shoqëri civile pas 17 viteve e ka filluar dhe udhëheq themelimin e procesit konsultativ për themelimin e drejtësis në post Jugosllave, mos të them vendet por shtetet post jugosllave, trashigimtarët e ish Jugoslavis.

Vesna Teršelić: Deklaratat për bashkangjitje nga Kroacija janë të arkivuara në Dokument, kopjet janë të arkivuara në vend tjetër dhe ne në Kroaci do të kemi takim me 4 nëntor 2008 në orën 14:00h në të cilin do të mirremi vesh rreth komunikimit brenda Kroacisë. E shfrytëzoj rastin t'iu informoj se jemi një numër i madh, dhe shoh se janë te ngritura disa duar për të kërkuar të drejtën e fjalës. Ata të cilët kanë kërkuar fjalën janë Dragica Alleksa, pastaj Gordan Bodogov, pastaj Mirjana Gallo.

Nataša Kandić: Disa janë duke u nisur vetëm t'iu informoj, jemi të deturuar të kryejm, sepse disa janë duke udhëtuar.

Vesna Teršelić: Te jeni konciz, eshte e tera. Dragica.

Mirjana Galo: Po, mos të mbet ndonjë padrejtësi këtu, vetëm t'iu përkujtoj se këto ditë ka qenë prezente dhe kolegja jonë nga Banja Luka, Lidija Zhivanoviq nga Parlamenti i Helsinkut qytetarëve të Banja Llikes .

Vesna Teršelić: E kemi lexuar organizatën e saj.

Mirjana Galo: Po, por ka qenë këtu, sepse ka pasur fjalë që askush nuk ka arritur nga ato vende, a po?

Vesna Teršelić: Faleminderit Mirjana. Gordana Bodog atje pas, Dragica Alleksa, kush dëshiron i pari.

Dragica Aleksa: Mirëdita, së pari do t'iu njoftoj se unë jam Dragica Aleksa nga Berka, nga Zhupania Sremi –Vukovarit në Kroaci. Pyetja ime drejtuar ekipit koordinues. Njëri nga qëllimet është edhe grumbullimi i një milion nëshkrimeve? Ne këtë moment jam duke folur nga ai këndi cili punon në komunitete dhe cili e din se është mjaft vështirë që të deportojmë një informacion me përgjegjësi. Nga përvoja ime mendoj se mënyra më e lehtë për të deportuar një informacion është kur formohet një grup nga më shumë se 20 vetë. Dhjetë prej tyre do të ndien kënaqsinë. Do të thotë gjysma e tyre, është një punë e madhe. A ka menduar ekipi koordinues për përkrahje, kush do ti grumbulloj këto nënshkrime, mendoj normal se ne do ti bashkangjitemi, ne te cilët jemi bashkangjit do të

ndihmojm në atë drejtim, por cila është mënyra dhe përkrahja e grumbllimeve të nënshkrimeve dhe cilat janë grupet planifikuese nga te cilet mirret nënshkrimi?

Vesna Teršelič: Po kemi menduar Dragicë, është një sfidë e madhe dhe jemi duke ndërtuar rrjetin e aktivistëve dhe është një detyrë e cila na pret në gjysmën e dytë të vitit 2009 dhe nuk është direkt e përfshier në muajt në vijim. I lus të gjithë duke dalur nga salla ti dorëzoni dëgjueset se po shoh se disa janë duke u ngutur, disa udhëtojnë, për atë mos harroni ti dorëzoni. E kam parë dhe një dorë të ngritur, shumë shkurt, në këtë fazë nuk mund të vazhdojmë me diskutime sepse njerëzit i presin transportet.

Gordan Bodog: Nuk kemi pasur kohë ta hapim diskutimin rreth mandatit për Komision. Ka pasur bisedime rreth kësaj, unë kisha thënë se një varg organizatash nga regjioni mendon për bashkangjitje, dhe deri më tani nuk janë bashkangjitur sepse nuk e kanë ende të qartë formën, mandatin të gjithë ato të cilat i përmendi pak më parë Natasha Kandić. A mund tash ta përcaktojmë përafërsisht se për sa kohë do të ketë nevojë, që konsultimet dhe ashtu radhas, kur do të kuptojmë formën e KOMRE-s, draftin, kur do të kemi diskutimet të ngjajshme, eja të përdorim dhe të themi bashkangjitje Koalicionit. Mos është ndoshta Forumi në Podgoricë vitin e ardhshëm? Ju faleminderit shumë.

Vesna Teršelič: Idea është, që programi do të përgatitet për Forum në Podgoricë, të cili do të na lehtësonte bisedimet rreth mandatit.

Nataša Kandić: Unë kisha përfunduar me kaq. Nuk kemi kohë, autobusat janë duke pritur. Unë mendoj se na ka arritur një mesazh mjaft i bukur, ai është Marinko Gjuriq. Ai është nga Istogu, dhe dëshiron ti falemnderoj njerëzit nga Kosova, qytetarët e Kosovës për tolerancë dhe mikëpritje.

Vesna Teršelič: Në emër të gjithëve këtu prezent të cilët kemi ardhur sikur mysafir ju kisha faleminderuar, një faleminderim i madh, shumë i falemnderoj dhe aktivistët e Community Building Mitrovica, Fondin për të Drejtën Humanitare në Prishtinë dhe Inicijativën e të Rinjëve për të Drejtat e Njeriut se pa të e gjithë kjo nuk do të ishte e mundur. Gjithashtu e falemnderoj Jelena Simiq e cila nga Beogradi i ka organizuar të gjitha, ka komunikuar me ne, ka ardhur në Prishtinë dhe shumë, shumë kanë punuar Valdeti, Bekimi, Dijana ... kjo është e te tëra, një duartrokitje ju lus.

Nataša Kandić: Darka është poshtë në restaurant!

Valdete Idrizi: Vetëm pak . Dëshiroj të falemnderoj të gjithë... e humba çfarë desha të them në gjuhën serbe, OK, ju dëshiroj punë të mbarë, dhe besoj se jeni ndërë mirë këtu do të shihemi dhe herën tjetër. E di se na pret një punë shumë e madhe edhe herave tjera.